

BIBLIOTEKA
SHTETIT

25432

T 81

TOKA e PËRGGJAKUN

TREGIME NGA AUTORË KOSOVARË

814-32

T 81

TOKA E PËRGJAKUN

TREGIME

nga autorë të Kosovës

BIBLIOTEKA E SHITIT
GURKASTER

29670
~~58701~~

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

Mbledhur e përgatitur për shtyp nga:
DHURATA XOXA e JORGO BULO

Kopertina nga: SAFO MARKO

Tirazhi 4000 kopje

Format 78x109/32

Stash: 2204-65

Shtyp. NISH. Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NENTORI» — Tiranë, 1972

AI MENDONTE RRETH TË VETAVE

Mjegulla e bardhë, palë-palë e trashë, tash sa ditë kishte kapluar atë majën e thatë të Kosmaqit dhe pësh-tillej e nuk zbriste nga ato majat me gurë të verdhë. Ai nuk ja ndante sytë atij errësimi. Dëshironte të shikonte rrëzën e bjeshkës që, e stërpikur nën dengjet e trasha, heshte e pupëzuar në atë mugëtirë. E shikonte dhe përbihej ëmbël, thua jse pikëlat e mjegullës shkrepnin ëmbëlsirë. Kënaqej duke kundruar atë plaf të bardhë që, orë të tëra, nuk shkepej. Shpresonte se tani, dy-tri ditë më vonë, shiu do t'ja lëshonte si rëndomë, kur mjegullat e ngjeshin me dengjet e bardha majën e bjeshkës. Por, kur shikimet i lodheshin duke kundruar atë anë, kur një mendje i thoshte se do t'i humbte dita kot së koti, se mjegullat kanë kohë të rrinë me javë të tëra, me muaj, rrinë sa të donë dhe shkojnë kur t'u teket, me shi apo pa shi pas, krejt një, atëhere, do mrrola të trasha e të thella, do rrudha si lugjet e Kosmaqit bëheshin të thella dhe të errëta në ballin e tij, atëhere Sylja shante, truante. «Rren Kosmaqi, rrenjë mjegullat, rren toka...» pshtynte në tokën e plasaritur dhe shtonte: «Nuk ka mbetur t'i besosh kujt. Ul kokën dhe humb rrugës kah ja ke mësyre. Mjegullat kanë kohë të pështillen sa t'ua dojë qejfi. Ka nisur të rrejë edhe toka.» dhe këpuste fillin e mendimeve për mjegullat, për shiun. Fillonte t'i përtypte buzët, thua jse ato thatake të shkrumbëta fajto re pse atij i është mër zitur jeta, pse i duket se gjë e ka marrë teposhtëzen dhe se dreçi e as i biri nuk mund ta ndalë, nuk mund t'ja ndërrojë rrjedhën e keqe që ka marrë me hov kjo jetë, kjo kohë...

I shtypte grushtat dhe buzët, sepse mendonte se edhe ato janë fajtores për të gjitha të këqijat që njerëzit ja sjellin vetes dhe njëri-tjetrit. Po. Ai kishte menduar gjatë për të gjitha këto. I ishin tretur, shpesh, shumë orë të netve të gjata pa pikë gjumi rreth kurçakafjës dhe i ishte dukur se vetëm buzët dhe grushtat i sjellin të gjitha të pamirat në jetë. «Qe, mendonte ai, buzët përtypin gjithfarë fjalësh, gjithfarë të zezash e prej tyre, me to, njerëzit e thyjnë qafën, bëhen copë e grimë mes veti. Për çka? Për një fjalë goje! Për një pëshpëritje të buzëve. Për kurrjë. Kurse grushtat? Qe, edhe këta janë fajtorë ndonëse të rendit të dytë. Ja lëshojnë dikujt ndonjë grosh në xhep dhe menjëherë ja thyjnë mendjen. E bëjnë ta përmbysë të vërtetën si të mos kishte qenë kurrë e gjallë mbi dhe. Menjëherë. Një grosh dhe qe — një njeri afër vetes e larg drejtësinë. Larg të vërtetës, ndonëse e vërteta u mbështillet njerëzve nëpër këmbë dhe, herët a vonë, ajo del — duket para syve të botës. Për këtë pse njëri i ra me fjalë të rëndë tjetrit, pse njëri i bishtëroi të vërtetës për një grosh, kërset pushka. Derdhet gjaku. Rrjedh ai lëng i kuq, sikur të ishte uji i Drinit të Bardhë. Njeriu humb para groshit. Bëhet i vogël. I padukshëm. Groshi? Çka? Kurrjë! Groshi — trupi! Dhe — asgjë tjetër. Turp në pikëdite para syve të botës. Por, vëlla i dashur, s'ka të keqe të vetmuar. E keqja ka shumë motra. Edhe këtu në vend të pështyhet e të largohet, i keqi, prej të gjithëve, jo, more, qe besa, ai bën edhe më shumë shokë. Pas groshit shkojnë edhe njerëzit. Të këqitë shumohen. Sepse askush nuk do të jetë vetëm. Fundi i fundit është e ditur se, kur qan gjithë bota, nuk mund të qeshësh vetëm. Po, pra. «As në xehnet, kanë thënë, nuk bën të shkosh vetëm.» Çka të duhet. Nuk ja di as lezetin, jo! E pse pra, thotë secili, nuk bëj edhe unë çka bëjnë dynjaja! Eh, tokë, oj tokë! Po nuk bën, more vëlla, nuk bën.

«Duhet dikush t'i prijë punës kah e mbara, se kështu vjen kiameti!» rezmonte Sylë Meta dhe i binte me dorë fytyrës së thatë e të hajthme në të cilën i dalloheshin prej largu ato mollëza të qitura jashtë, ato vetulla të trasha e gjysmë të thinjura dhe ajo hundë e gjatë e picërrake si

ushujzë e urët. Rezmonte Syla rreth çdo gjëje, që i kujtohej. Shante e pështynte në fytyrën e të gjithëve dhe të gjithave që ja merrte mendja se janë për t'i pështyrë e sharë, dhe ecte. Hapat i kishte disi të lehtë. I dukej se, kur shfrynte me të shara të majme, letësohej dhe hapat e lodhur pleqërie harronin se kanë mbetur shtaga të thara.

Ecte lehtë, i pezmatuar asaj rruge, të cilën e merr shpesh këto ditë, kur nisin të piqen kumbullat.

— Si je, Sylë? — e përshëndetën do kalimtarë, që i takoi rrugës.

— Allaharazolla, ku jeni, si jeni! — u gjegj ai dhe prapë e ndrydhi buzën e poshtme. Mendoi se edhe këtu diçka nuk është në rregull. Në këtë: «Si je, ku je!» nuk ka rrenë!» — mendoi. «Këtu njeriu e thotë të vërtetën. Vetëm këtu e thonë të gjithë!» shtoi.

— Qysh e keni verën, ej? — shtoi kalimtari në kohë.

— Thatë, valla, — u gjegj shkurt.

— Asht mrrol kah jugu, nashta ishalla don me ja lëshue ni bereqet i hajrit! — e zgjati fjalën ai plaku i thirë.

Syla heshti. Nuk i besonte as jugut, as veriut. Nuk i besonte askujt. Deri vonë kishte besuar se kur bie mjegulla në Kosmaq, shiu nuk vonon. Ja lëshon rrëke. E ul atë rrisht të shkumbur që i është ngjitur tokës së plasurit. Por, tani e kishte humbur besimin. Ditë të tëra rri ajo mjegull ul përtokë në atë bjeshkë të murme, java po bëhet gati, e, asnjë pikë shiu, asnjë re e zezë — aso resh me bark të mbushur ujë, nuk e solli era kah këto shpate. Asnjë. Mjegulla sillet e pështillet e shiu askund. Hiq. E kështu, Sylë Meta, duke shikuar atë mjegull, për çdo mëngjez kishte menduar për shumë gjëra. Kishte menduar për njerëzit, që janë prishur. Nuk e mbajnë fjalën. Ka humbur besa. Të rrejnë sy a më sy dhe s'i japin pesë pare. Dhe për të gjitha këto nuk habitej. I dukeshin gjëra të vogla, të imta... Por, i ishte mbushur mendja se edhe toka është lazëruar. Ka zënë të çoroditet. Të rrejë. Tani nuk i besonte as jugut, as veriut. Ishte mashtruar shumë herë. Shpesh frikohej për këto mosbesime se mos, rastë-

sisht, mëkatëronte, por shumë më shpesh nuk e kishte gjalle për atë punë. I dukej e tepërt dhe frika. Edhe mëkati. I harronte, për një çast, të gjitha që, para disa ditësh ja kishin shtie tmerrin. Atëhere druante mos ja sjellë djalli, ato mendime të këqija që ta shtynte të mëkatrojë, të digjet, të humbë para syve të të Madhit. E tani, e thoshte troç. «Arat nuk dinë për dokrra. Ato donë shi, donë të mbillen.»

— A po mun mahesh, more mixha Sylë? — e ndau prej mendimeve tuba tjetër e udhëtarëve, që kthehej prej tregut.

— Paj mirë, mirë! A mun erdhët ju? — gjegjej dhe pyette ftohshëm. Fliste vetëm pse i duhej të thoshte diçka, pse ishte ndër më të vjetrit dhe i vinte turp t'ja thoshte ndokush ndonjë fjalë pas sysh. Tek e fundit kjo s'i kush-tonte asgjë. Mund të përgjegje ashtu shkurt e ftohshëm si e kishte zakon dhe të vazhdonte rrugën duke menduar për shiun, për verën dhe hallet e veta, apo edhe për gjithshka që ja donte qejfi.

Rruga, e mbushur me copa gurësh të shkepur, gjarpëronte faqes së atij mali të mbyllët. Hiqej ashtu lakadredhas dhe shpesh humbte nëpër çufrarajat e mbyllëta, që ja mbulonin skajet. Syla ecte ashtu i humbur në mendimet e tij të gjata e pa mbarim. Tirrte në mendje çdo gjë që ja kapte rradakja. Kali i ecte pas. Era e kumbullave të pjekura, që i kishte mbushur thasët e ngarkuar, e mbushte udhën me një erë të këndshme, erë që ta përkujtonte stinën e verdhë. Ai e shtrëngonte lakun e kalit në grusht dhe ecte.

Kur zbriste në luginë, rëndomë, e thërriste dikënd t'i ndihmojë për t'i shkarkuar barrët e rënda të kumbullave. Kushdo që qëllonte aty pari kthehej pa përtesë t'i ndihmojë plakut. Dikujt ja kishte ënda t'i ndihmojë Sylës, se e dinte që nuk e lë plaku pa një grusht kumbulla të mira, të zeza, aso kumbulla të hershme që rriten në Arat e Lugut të Sylë Metës. Dikujt tjetër i dhimbsej plaku dhe nxitonte t'i ndihmojë. Të dy palët, për Sylën, ishin të njëjtë. Atij i ishte pjekur në mendje se të gjithë vrapojnë

për një grusht kumbulla, për diçka. Dhe mezi u falënderohej.

— Shumë kumbullat i kishte pasur, more Sylë — e nguci një prej atyre djerrakohësve, që i plakte orët e ditës nëpër kafenetë dhe shitoret e luginës kot së koti, pa pikë pune.

Syla e shikoi një copë kohë. E njihte.

— Po, bre jaran, shumë valla — i tha duke kruar majën e mustakut të majtë. Deshi t'i thotë diçka, të mos e lëshojë pa një fjalë, por e dinte se fjala e tij ishte tepër e rëndë, prandaj e mbajti veten. Heshti.

— U idhnove, mixha Sulë, a?

— Jo, bre bir, jo. Po hajt, ma mirë këqyr punën tande e mos e hup kohën badihava.

— Gjithkush gajlen e vet, a? — shtoi ai djerrakohësi. Ai e dinte se, sa më shumë të zgjatë bisedën, Syla bëhej gjithnjë e më i padurueshëm e, kur hidhërohet e bëhet pelin, atëhere, e çon atë krrulën e thatë dhe kënd ta gjejë afër, ja kup, derisa të thyhet.

— Ta merr mendja, biro. Ka thanë i moçmi: «Gjithkush gajlën e vet — mulligjija të vetën — u mbajt edhe kësaj radhe pa thënë asnjë të keqe.

— Gjithkush të vetën, a?

— Ta merr mendja!

— Po, more mixha Sylë, por po na mërztitën përnatë. Duhet me i ndërrue kajherë jemeqet, o Sylë plaku! — edhe ua dha këmbëve.

— Syla deshi të çojë krrulën, por heshti. Nuk e tha asnjë fjalë. I ndrydhi grushtat dhe shikojë anash mos sillet kush t'ja blejë kumbullat.

«Pis milet», pëshpëriti nëpër dhëmbë. «Ku e merr m'i pasë këta grushta të gjatë tamamn sa shinat e trenit e me t'ja thye të dy kambët qifti të këtij hajrsuzit!» tha dhe rrotulloi shikimin mos këhen kush për kumbulla. Kur pa se gjithkush kryente punët e veta e askujt nuk i binin në sy thasët e hapur të kumbullave, u nis kah depoja e kooperativës truar si dinte ai. Hyri në depo dhe i tha atij rrapaçukut të thinjur që të dalë t'i marrë thasët e kumbullave. I dhimbsheshin t'i japë për atë çmim, por

çfarë të bëjë. Nuk shiteshin më shtrenjtë. Ai dëshironte, të paktën, t'i shiste dy pare më shtrenjtë se në kooperativë, jo edhe aqë për fitim, por qe, ashtu i ishte pjekur se, ato pare tepër, edhe pse ishin shumë pak, i dukeshin të ëmbla dhe disi ndjente një farë kënaqësie që nuk ja shiti atij rrogëtarit të vet që tani punon aty në depo.

— Qe besa, i kishe pasë kumbullat e mira, Sylë! — ja bëri punëtori i depos. Ai ja dinte hujin dhe përherë mudohej t'ja lëmonte qimen.

— Po bre, po kurrëgjja. Po shkojnë badihava.

— Janë mbushë gazet, nuk po shiten kërkund ma shtrenjt!

— Ani, ani, po mati ma shpejt, se më nxuni vonja! — e shkurtonte bisedën Sylë.

— Djali apo të vjen najherë?

— Theftë qafën ai tek!

— Ma Sylë, ma! Bet djalë a' qe besa!

— Kohë e keqe, kohë e mrapshtë!

— Aiii, Sylë, ti bile je njeri i meqëm. E din qysh shkojnë devret. Mos ja le seri. A pe shesh po qysh po ndërrojnë hesapet. Dje ishte kështu e sot, ndryshe. Qe.

— Nuk jam unë kundra shkolle, jo, o shoq. Po nuk mësojnë kopilat. Janë metë as me sheher, as me dhe.

— E kryen, Sylë, e kryen! — thoshte punëtori dhe, edhe ai kishte dëshirë të këputet muhabeti, se nuk qitet me plakun.

— Sa po më bjen me i marrë. Bani hesap!

— U idhnove, a?

— Kallxomë sa po më bjen m'i marrë e lej muhabet!

— Ani, ani! — pëshpëriste punëtori i depos dhe hiqte lapsin e shkurtën nga veshi. Niste t'ja llogariste të hollat. E mbyllte llogarinë shpejt dhe ja shtrinte dorën. Sylë e merrte atë letër dhe, pa shikuar punëtorin, që mbetej me dorë të zgjatur, dredhej në shitore.

Me perëndimin e diellit nisej, hypë në kal, me ato pak metra bez, basmë e cikërrime të tjera, leqeve të asaj rruge të hollë, që ngjitej shpatit përpjetë. Mendonte për bisedat, për njerëzit e luginës, për gjithshka. Nëpër majë

të gjuhës i mbështillej ajo fjalë e mbramë, që përherë në të ndamë nga lugina, dikush, doemos i thoshte: «Ani, Sylë, ani». «Ani de, thoshte më vete, nuk është Sylë thmi. Po, po! Dhe pikë.»

«Ani, Sylë, ani!» i endej nëpër kokë.

«Ani de!» i ndrydhte buzët e thara.

«Po nuk bën gjithmonë kështu, o Sylë. Duhet ndërruar bashkë me devret,» i thoshte një zë i vogël nga brenda.

«Gjithkush le të këqyrë të vetën. Sylë të vetat!» thoshte, dhe ja kupte dy-tri të holla vitheve të doriut, i cili shpejtonte vrapin asaj rrëpine të mbyllur në çufraraja.

Sylë mendonte rreth të vetave e bota le të mendonte për kënd të donte. Krejt një është për të.

RRISKAT E SHKRUMIT

«Në qytetin tonë asht një lagje... e në atë lagje asht një kishë. Mbrenda në kishë asht një lypës, në të cilin jeton një dëshirë: me jetue.»

Migjeni

«Sot është e diel dhe po bie shi. Sa mos ta marrësh me mend. Nuk mundet njeriu as të dalë kund, e jo më të punojë, çkado. Kështu i mbyllur brenda, në këto dhoma që u vjen era djersë, njeriut i duket dita sa një muaj i tërë. Gjer vonë u enda poshtë e lart, pa ditur çfarë të bëj, kah t'ja nis. Por, kot. Asgjë nuk fillova pos kësaj letre të gjatë, të gjatë dhe ndofta pa mbarim. Po them kështu, sepse më janë ngjitur do rriska shkrumi, që djegin thellë në shpirt e frymën ta këpusin në fyt. Më ka kapluar vërshimi i një malli të rëndë, sa më vjen të zhgrehem në vaj si fëmija. Po. Të qaj me ngashërim si fëmijë i përma-ltuar; vetëm këtë mund ta bëj sot.

Çdo rresht të ri që shkruaj, në letër, mendja ikën. Ndahet prej meje dhe veton atje diku, në shpatijet e kuqërremta, ku gjethe e bar janë palosur të tharë përtokë, atje në qoshet e vrugëta të kasolles sime, ku erren ata krymtha të vegjël me loken e lodhur; atje nën strehën e shkurtë thekrishte, ku është struktur një pjesë e shpirtit tim.

Ja pra, tani uluni diku. Hape letrën ngadalë e me kujdes se, prej mallit, kam shkruar edhe brenda në pliko. Shikoni secilën gurmë të lakuar dredhas, secilin rresht të shtrembër, se në brendinë e tyre jam unë, vetë unë...

... Shikimet i kishte shkepër nëpër secilën pëllëmbë të arës së vogël, që lëshohej si fizgë e shqyer në shpatullën e gjerë të shpatinës. Shikonte, shikonte dhe nuk ngopëj, thuajse dëshironte t'i përbindte ato cukëla dheu të paktë, që ishin ngjitur për faqen e gurit e përmbi i rriteshin fijet e holla e të shpeshta të grurit. Shikimet i kishte të kthjellëta, e herë herë i ndante vetëm në një kënd të arës për t'i hedhur më vonë në secilën pjesë, ku merrnin frymë ato fije, që atij i dukeshin më të buta se të mëndafshit, më të dashura se vetë gjaku i tij, që në vështrimin e frytit të vet binte valë-valë e hovshëm në damarët e ligësuar. Ara, në ata sy të përlotur, prej diçkafit të idhët e të paemër, që i binte rëndë në shpirt dhe ja gulçiste edhe frymën në fyt, i dukej gjithnjë e njëjtë me trajtën e zakonshme; ashtu e lëshuar gjer në lugajë për t'u këputur në shullin e malit të mbyllët, që Riza e ruante për ditë të vështira, kur veriu, si i tërbuar, hedh borë të ngrirë si me shekë...

Tani i shtohet dëshira të kërrusej pak, të këpusë një grusht fije të grunajës e ta fuste në xhep, apo ta mbështjellë mirë e mirë, e sa herë të marrë udhë dëshira, të tretej në soditje të asaj rrizge të vogël në shpatinë, t'i nxjerrë e shpalojë fijet e grurit, t'i puthë e ledhatojë gjersa të humbin ngjyrën, trajtën e tyre. E kur fijet të humbin ngjyrën, të mbesin si kashtë e terur, kudo që të jetë, të lëshohet në shtrat, ashtu lodhshëm, e mendjes t'i çelë udhë, larg, larg ndër dhena, fluturimthi, gjer në shpatinë ku rrezet rrëzohen të zjarrta. Sa dëshironte të jetë gjithnjë pranë asaj grunaje të vogël: të shohë rritën e secilës fije të grurit, ta ndjejë frymëmarrjen e tyre në rritje, të mos ndahet kurrë, kurrë prej asaj trohe larë në djersë. Por: «Hajde, Rizë, hajde se koha nuk pret!» i thote vetes si në jermi. E hapat filluan të ndërrohen, përpjetëzës, kah tymonte oxhaku i nxirë i vatrës së tij.

Në shtëpi ishte çdo gjë gati: ja kishin palosur të

gjitha çaklat mirë e mirë dhe e pritnin gjersa të kthehet, ai, kur të vijë koha për nisjen e Rizës. Nisjen në rrugën e gjatë e ndofta edhe... Oborri i rrethuar, muret e shtëpisë së vjetër dhe çdo gjë që ndodhej e shkepur nëpër oborr, atij i dukej se shikojnë kah ai me një sy që lotin e ka në bebëza, dhëmbshëm. Të gjitha, të gjitha i dukej se e ndejnë fort ndarjen prej të zotit, ndarjen prej së vetmes dorë, që i shtie në punë, që u jep vleftën, arësyeën e ekzistimit.

Ndalej dhe shikonte gjatë. Gjërat e shkepura e kishin trajtën e rëndomtë. Heshtnin ashtu të palosura. Ai endej dhe i matte me sy të gjitha. Secila i dukej më e bukur, më e dashur se çdo ditë tjetër. E një rriskë shkru-mbi trashej në zemrën e ligë të atij trupi, që kalamendej si hije e që shpesh harronte çka duhet bërë tani.

— Udhë e marë, loke, të priftë e mara, o bir, se nashta, kur të kthehesh, nanën e gjen në dhe! — dëgjoi fjalët, përshëndetjen e së ëmës, që derdhej rëndë nëpër ato kokërra të bardha të lotve, që rrokulliseshin fytyrës së prerë tërthori të lokes së lodhur, plakë e këputë në vargun e gjatë të moteve, skamjes. Shikonte rrudhat e thella, që mbusheshin me atë hidhërim, që rrëshqiste gjer nën mjekër duke e djegur, përcëlluar.

— Mos u mërzi, nanë. Nuk rri shumë. Veç sa për ato borxhe e telashe! — pëshpëritën buzët e tij të terura, që ishin gati të dridhen, të lagen në lot, si dikur në fëmijni që zhgrehej në vaj për çkado. — Mirëmbeçi, loke! — shtoi edhe një herë dhe theku hapin gurores së rrëpinjtë, që nën shpatijet e atij thepi lëshohej kah lugaja, prej së cilës, orë e çast vinin fishkëllimat e mbytura të trenave dhe zhurma e tyre, që zhdukej tok me ta.

Ai preftonte një rrugicë të ngushtë, ashtu i tretur në diçka të humbur, që mendja e lodhur nuk mund ta veçonte, të mendojë vetëm për të. Ishte kërrusur nën peshën e çaklave të ngarkuara, që ja rëndonin cepat e thatë të krahëve e dukej si hije e gungtë që ikën, ikën të zhduket diku në largësi...

... Atë ditë qytetin e kishte kapluar një re e mbyllët, që pështillej si e plagosur nëpër majat e shumëkatesheve. Ajo re mbështillej e njollat e saj të shprishura binin gjer në tokë duke përfutur e mbyllur horizontin në të errët. Ai shikonte atë mjegullirë dhe tymin e trenave që mbyllnin peronin e kuqërremtë. Maste me sy secilin kënd të vërshuar nga turma e madhe, udhëtarët që rëndnin për në caqet e tyre. Para syve i endej, ashtu siç ishte, e tërë shtëpia me muret e saj të liga dhe strehën e shkurtë thekrishte, që era e dimrit e kishte shprishur e shkapërdërdhur, e shirat e lagnin edhe miellin në magje. Mandej shifte oborrin me thepat e gurëve të thatë dhe arën e tij të vogël... I shihte duke u rrokullisur rëndë lotët e tokës së tij të lodhur, që e digjnin atë diku në thellësitat e padukshme të atij shpirt, tharë e djegur në përpjekjet e mundimet e jetës, nëpër të cilat kalohet vështirë.

— Keni ardhur për punë — e ndali në rrugë pyetja e një djaloshi trupshkurtë, që, nga ngjyra e fytyrës, atij ju duk fort i afërt dhe i dashur. E shikoi një copë herë. E mati me sy, gjatë, thua jse dronte t'ja thonte të vërtetën.

— Po! — pëshpëriti, më në fund, nëpër buzët e thara.

— Po deshtët, mund të vini te na. Vend kemi! — tha djaloshi çiltas e pa ngurim thua jse ishte rritur me Rizën.

— Ju... prej kah jeni? — pyeti Riza pak i hutuar e me droe.

— I Kosovës, o vëlla, po ec, ec shkojmë në banesat tona, se erdhi nata, e këtu... — këputi fjalën djaloshi. Dëshiroi të thonte: këtu është vend i largët e i panjohur, por heshti. I erdhi keq ta nisë bisedën për gjëra të tilla.

Riza nuk bëri zë. U nis pas hapave të tij, që përfitonin nëpër turmën e madhe, e cila i kishte mbushur trotuarët e asfaltit të lagur. Në qytet, dritat filluan të ndizen. Reklammat shumëngjyrëshe të shitoreve ndizeshin e fikeshin

orë e çast. Tani ajo rrugë e gjatë, që dukej e pafund, shkëlqente në bardhësinë e dritave. Ata, ashtu të hesh-tur, ecnin...

— Më fal, nuk po ta di emrin? — tha djaloshi pak...

— Rizë! — gjegji ai shkurt, dhe e shikoi edhe një herë.

— Po mirë, Rizë, a do me nejtë shumë këtu?

— Kësaj vere, bile veç deri në të korra!

— Pse aq pak, Rizë?

— Shpinë e kam lanë vetëm. S'ka kush ma shtjen verën mrena!

— Nuk ke vllazën?

— Jo! ... po, punë, a gjinet këtu? — tha Riza, që dëshironte t'ja ndërronte kahjen bisedës! se mu këtu e digjte flaka e një zjarri të hershëm, flaka e një kujtimi të idhët. Dhe dëshironte t'i heqë dyshimet për punë, të mos mendojë më për të.

— Ka punë, ka! Besoj se edhe në fabrikë do të gjesh masandej po deshe e mujte, gjen edhe kështu... — tha *djaloshi*.

— Çfarë është pagesa?

— *Si puna!*

Heshtën.

Trupuan një rrugicë; në të majtë dukeshin banesat e punëtorëve, do shtëpiza bërë prej dërrasave të vjetra, që i kishte kaptuar një ngjyrë e mbyllët, ngjyra e vjetërsisë...

3

...Shikonte secilën pjesë të dhomës ku pikëlat e shiut kishin rrëshqitur murit teposhtë, e pas kishin lënë njolla të verdha, që ishin zbardhur prej një rriske të hollë myku. Shikonte e herë herë i dukej se nuk shihte asgjë, pas një mjegullire që nisej mu aty, para syve të tij, dhe zgjatej larg, larg nëpër një vijë të hollë, që kishte rrëshqitur buzës së përroskave, buzë lumenjve e rrafshirave të gjera, që dukeshin se nuk kanë fund, se nuk dinë të nda-

len kurrë. Gjithë ato përpëlitje e kotje të mpime, gjithë ato gryka e tunele të nxira dhe stacionet e shumta që mbështilleshin në vrushkujt e tymit dhe mbeteshin pas; gjithë kjo i dukej si një ëndërr e shkurtër që përfton vetimthi nëpër mendje dhe të vjedhë gjumin për të lënë, gjithë natën, sygapër... Vetëm para pak orëve kishte qenë larg, larg këtij qyteti të mjegullt e tani që shikon i habitur dhomën dhe murin e plasarit, njollat e tij.

— A jeni krejt në atë anë? — pyeti një djalosh, që gjersa Riza kotej përgjumshëm, lexonte një gazetë të vjetër.

— Po, po! Mirë krejt rahat! — gjegji Riza duke belbëzuar.

Pyetjeve të shumta mezi u përgjegjej.

Dëshironte me qëndrue i qetë; ashtu i shtrirë, dhe të vështronte fytyrën e secilit që hynte duke hapur derën me zhurmë.

O

Punëtorët ktheheshin atë mbrëmje, kush prej pune e kush prej qyteti. Secili, që dëgjonte se ka ardhë një i ri të gjejë punë, shpejtonte të shihte, ta njihte. Kush, vallë, prej kah është? Secilit, i dukej, se vatra i ka ardhur për një hap më afër. Se diçka e afërt, e tij, gjendet mu këtu, në shtëpizën e vjetër të dërrasave që lëshojnë pikën gjer në themel. Një dëshirë, të ndiej, qoftë edhe më të voglën fjalë, e shtynte secilin t'i shpejtonte hapat kah ajo dhomë. Një pasë një, dhoma mbushej plot punëtorë. Plot hije të zymta që përshkoheshin nga një buzëqeshje e hollë, buzëqeshje e dashur, e ëmbël. Pas secilës hije shtohesh një vrushkull i dendur i tymit të duhanit. Të gjithë e pinin, e thithnin thellë atë tym, atë shkrum për ta shlyer shkrumin në zemër.

Dhoma mbushej plot punëtorë, plot hije të zymta, plot tym...

«Sa të rinj» mendoi ai e mendja i rrëshqiti atje prej nga kanë ardhur, në vatrat e tyre të braktisura. Andej kah enden lazdrueshëm kujtimet e secilit prej tyre...

— Folë, bre Rizë, kallxona diçka! — këputi hesh-tjen një burrë i shtyer, që i kishin sharruar sytë thellë në gropa e mollëzat e dalluara dhe ngjyra e verdhë e fytyrës i jepnin një pamje të rëndë, të mjerë.

— Besa nuk po di, more burra! — tha Riza.

Heshtja u këput rëndë.

Endeshin vetëm shikimet dhe fjollat e dendura të tymit të duhanit. Secili kishte sharruar në botën vet të vogël. Ishte tretur në kujtimet e vogla e të mëdha, që i kanë ngelur pas gjurmave e rrugëve të gjata.

Plaku shkepi një rend cigare, dhe u mundua t'ja ni-ste bisedës, por disi, secila fjalë e tij sharronte në tretje tok me tingujt që shuheshin ngadalë. Pas pak u bë edhe çaji. Riza shikonte i heshtur. Ashtu i tretur në hallet e tij, që nuk ishin të vogla, pa ndërruar me kend fjalë as duhan, ndjeu tingujt e një rriske malli, që sa kishte lëshuar rrënjë në zemrën e tij. Por, jo! Ajo ishte vetëm një puih e lehtë, freski e këndshme. Këngë, tingujt e secilës nisën të derdhen edhe në qoshet e dhomës së mbushur plot. Ata tinguj, ajo këngë, binin në të gjitha skutat e ndyra në thellësitë e shpirtrave të etshme për gjallërimin e buçitjen e këngës.

— Hajde, bre djem, thonja në kupë të qiellës se zem-rat po na qesin tym. Thonja bre shahira... — këputi fja-lën plaku, se disi, në gjak ju lidh një lëmsh, që ndrydh e rëndon shpirtin e lodhur. I erdhi keq të vijojë fjalën e nisur se më të i përmallonte të tjerët. «Të rinj janë, keq është»... mendoi në heshtje dhe nuk bëzani i ulur lodh-shëm afër Rizës, që ishte shndërruar në veshë e dëgjonte, mundahej të përbijë çdo tingull të asaj kënge që pikonte rëndë në zemra.

Telat e qiftelisë kumbuan edhe më dhimbshëm. Zëri

i djelmoshave u mbështoll me ata tinguj, kurse dhoma, ajo, e tëra sharroi në flatrat e një kënaqësie që lind rrallë e fiket shpejt.

4

...Në të dy anët e Savës kishin vërshuar njerëzit gjysmë të lakuriquar. Dielli sa ishte lëshuar mbi majat e bjeshkëve të përhimta që niseshin mu aty, në bregun e majtë të lumit.

Ai mbështeti trupin në bisht të lopatës dhe shikoi majën e bjeshkës, kah zgjohej dielli tok me rreze. Çdo gjë ju duk e rëndomtë; edhe freskia e agut të hershëm, edhe cicërrima e zogjve që mbështillej me zhurmën e ujit të lumit, edhe kthjelltësia e qiellit...

Shikoi luginën, valët e lumit, shpatijet e vërshuara prej punëtorëve që mbushnin me zall qerre e automobila. U kërrus dhe mbushi lopatën e madhe me zall. Të situar, të lagët. Në heshtje, ashtu pa bërë zë, rrotullonte lopata me zall në kamionin e madh. Grumbulli i zvogëlohej. Djersa e valë, kokrra-kokrra, i rrëshqiste trupit.

Dita zhagite ngadalë, zapullueshëm...

Kamioni i mbushur u nis me një zhurmë të fuqishme. Pas i la shtëllungat e një tymi të zi, që i vinte erë e keqe. Erë e naftës së djegur...

«Shkoi edhe kjo...» pëshpëriti ai në heshtje. «Nji kamion» shtoi duke u përpjekur të bënte llogarinë e punës gjer në pikëdite. Dëshironte të dijë sa do të ketë fituar gjer në pikëdite, me tërë atë djersë të derdhur nëpër zallishtën e zjarrtë, por, sa niste të mendonte për punën që kreu, trupin ja përshkonin të therurat e muskujeve të lodhur: «Rizë, u lodhe, a?» fliste me vete: «Jo, jo! Nuk ke shtek të lodhesh. Punë është edhe kjo. Duhet punuar, si gjithë të tjerët. I sheh? I janë kaptisur zallishtës dhe nuk prajnë në asnji çast. Po pra, edhe ti duhet. Duhet të punosh më tepër se të gjithë. I ri je. I zoti i punës, po. Duhet mbushur edhe shumë e shumë kamiona. Duhet tubuar ndonjë dinar. Po, pra, ke lënë shtëpinë vetëm. Fëmijët.



Nënë. Ata të presin ty, ty, Rizë. Dorën tënde!» shtoi thua jse i lutej qiellit që të lëshojë një pikë freski sa t'i mbushë mushkëritë me ajër të freskët, t'i shuajë ato rriska shkumbi që trashen. Hapat i ndërronte kah valët e lumit.

Sava përplasej me rrëmbim. Ai u kërrus pak. Preku ujin e valëve. Dielli kishte rrëshqitur prej majave të bjeshkës, e tani, fare afër luginës, në qiellin e saj si grusht i bërë gërryes, derdhte vrushkujt e zjarrit. Digjte. Zallina që ishte bërë më e zjarrtë se vetë dielli, digjte, përcëllonte këmbët e zathura të Rizës së lodhur. Ai, duke shikuar ashtu, uli sytë përtokë dhe aty, afër lumit, mbushi grushtat ujë. Porsa bëri t'i afrojë buzët e shkru muara, vërejti se, nëpër ujë lëviznin mijëra e mijëra mikrobe të dukshme. Dhe — nëpër duar nisën t'i shkepen do penjëza të kuqe, që ngadalë e skuqën tërë ata ujë që mbeti në grushtat e tij të gjera. Lëkura e duarve i dogji. Hodhi ujin në lumë, i shikoi i habitur, plasat e thella në shuplakat e duarve. Penjëzat e kuqe, prapë, zgjateshin prej atyre plasave të përçallura dhe shkepeshin. Ishte gjak i duarve të plasaritura.

«Shiu ende nuk pushoi. Para shtëpizave të punëtorëve është krijuar një liqe i vërtetë prej turbullirës që po krijohet. Dita shkoi e, edhe letrës, tani i jap fund. Por nuk mund të ndahem prej saj pa thënë edhe diçka, edhe shumë gjëra. Sepse, disi, në secilin rresht të ri, më duket, shfryhem dhe kënaqem duke biseduar me ju të gjithë. Edhe me shpatinën. Edhe me gurët...»

«Megjithatë, po e përfundoj me dëshirë që të gjithëve t'u gjejë shëndoshë e mirë, se të korrat janë afër, e tash, këto ditë, edhe unë do të vij. Do t'i këpusim bashkë kallinj të grurit të pjekur në arat tona. Të lahemi në djer sën e punës sonë, se, disi, jam përmalluar tepër t'i qepem punës nëpër ato bokërima. E pas të fshirave, atëhere kur vjeshta nis të trokasë këndshëm, kasolles do t'ja

ndërrojmë edhe pullazin, do t'ja kallim thekrishten e vjetër, që është kalbur dhe po e lëshon pikën. Po nënë, po! Vetëm ty të të gjejë shëndoshë e pa lot në sy për mua e skamjen tonë.»

«Ju thashë: letrën e zgjata, por tepër të gjata kishin qenë kujtimet që shtuan, secila nga një, rrishtat e shkruarit në këtë zemër. Prandaj e lexoni me kujdes prej fillimi dhe mos ma shihni për të madhe se herët më janë trashur gishtat e gërrat kanë dalë të shtrembëta e të mëdha. Po, po! Sepse, njëmend, vështirë ishte të jesh krahëthatë...»

HIJA

E di se rrëfimi im është rrëfim i rëndomtë, rrëfim i thjeshtë, fare i thjeshtë. Madje, ndofta është edhe ndër ato që nuk kanë pikë bukurie artistike, ndër ato që nuk i takojnë të bukurit. E di se vërtet është ndër të jashtëzakonshmit e artit, por megjithatë vlen ta dëgjoni. Vlen t'ja lëshoni një sy sa për ta takuar dritën dhe errësirën e thjeshtësisë, që lidhen nyje mu para bebëzave të syve dhe nuk dallohen dot për ngjyrën dhe dhembjen e tyre.

Dhembja ime është mu si fjalë e thjeshtë, që me heshtje rrëfen kuurçkafen, apo më mirë idhtinë e jetës. E jeta, bashkë me valët, ligjet e saj, është e çuditshme. Ajo vërshon shtigjet e gjallërimit rrëmbyeshëm. Vërshon pa dhembje nëpër gjakun e secilës qenje, dredh penj në lëkurën e secilit njeri, në poret e secilës zemër të mbushur me bukurinë dhe shëmtinë e të jetuarit. Dhe mu ato valë janë ngatërruar diku në thellësitë e qenjes sime dhe brejnë idhtas secilën skutë të qetë. Vlojnë, digjen bashkë me mua që të mund të vijnë deri te fjala e thjeshtë. Te fjala që rrëfen për dhembjen e saj.

I këtillë është rrëfimi im. Rrëfimi i keq, që nuk di as si t'ja filloj, si t'ja nis. Nuk di, më besoni. E di se, po ta përshkruaja tërë jetën time, do të ishte më lehtë, sepse do ta filloja nga lindja. Jeta fillon me lindjen. Po. Kështu është dhe hyrja. Por rrëfimi im do të mbetet pa hyrje, me fjali të cinguara, me rrjedhën e tyre të shkapërderdhur. Megjithatë, dëgjojmë, lëshojmë një sy — lotit tim që rrokulliset mes germave të këtyre rreshtave.

Desha të thom edhe diçka: kam pasur babë! E dini

edhe këtë. Të gjithë kanë ose kanë pasur babë. Secili doemos do të këtë pasur një babë. Edhe një nënë! Por, a dini pse e thashë këtë? Baba im ka qenë pak ndryshe. Ai ka pasur mustakë të trashë, të zez e gjysmë të thimë. Vetulla po ashtu të trasha. Ai ka pasur edhe sy të zez e të mëdhenj sa ta shtinin tmerrin. E ka pasë një fytyrë të gjerë e të prerë thellë prej do rrudhave të idhëta pleqërie. Baba im me shtat ka qenë mesatar. Kur e shikoja gjatë, më dukej se para syve kam një ah të vjetër, të parritur e të lidhur tërë nyje-nyje. Ah me nyje të shumta e të trasha, që nuk i pret as sharrë as sopatë. Desha të thom se ai ah i vjetër në vend të kokës e kishte një nyje të fortë sa njimend s'e prente sharrë as sopatë, s'e djer-sitte vapa as nuk e ngrinte acari. Ajo nyje në majë të atij ahu, ka qenë shumë, shumë e fortë.

Baba im, mu si ai njeriu i Gorkit, i ngjante lisit të stepës, të ndezur nga rufeja, por prapë i fortë, i fuqishëm dhe krenar me fuqinë e vet.

Megjithatë, keq bëra që e nisa rrëfimin për babën tim.

Keq... Sa herë e kujtoj babën, trupin ma mbulojnë djersë të ftohta. Djersë akull. E vështirë ishte të jetosh me trup të ngrirë. Me gjak akull në damar. Me vdekje në jetë. Vështirë, vërtet shumë vështirë ishte të ietosh me vdekje. Me të vdekurin. «I gjalli me të gjallin», kanë thënë, e jo «i gjalli me të vdekurin». Kurse unë jetoj edhe me të gjallët, edhe me të vdekurit. Jetoj në dy jetera, apo ndofta, në asnjë.

Jetoj?

Besa nuk di, po a jo?

Pse dyshoj në të qenunit tim tani?

...Ndër varre është një mjegullirë. Retë e qiellit kanë rënë përtokë dhe lotojnë bashkë me mua. Retë e rënda të qiellit janë lëshuar poshtë, poshtë. Janë mbështjellë me gurët e verdhë të varreve dhe lëshojnë pikla të imta. Pikla të idhëta. Lotë. Lotët e qiellit të mrrolur e shoqërojnë lotin tim të vakët ndër varre. Retë e kanë ndie gjëmën, rënkimin e kësaj zemre që rreh me dridhje. Zemra që rreh me vdekje në damarë.

Varri i babës tim hesht si të gjitha varret. Por jo: ai merr frymë, ofshan. Rrëqethet bari që e ka mbuluar ashtu si unë, si lëkura ime.

— Dëgjo, babë — i pëshpëris varrit. — Dëgjo, e mos hesht tash, kur nuk duhet. Kam ardhur ke dheu i trupit tënd, te djersa dhe gjaku yt i terur. Kam ardhur të bise-
doj me ty. Po, me ty, babë, e jo me hijen tënde — i them i mbushur mall e pezëm. Malli më djeg për t'ja puthur njëherë ato buzët e shkrumta, por zemra më mbushet mlllef pse hesht varri i babës tim. Pse heshtin varret?!

«Po flet, babë? Po flet apo do të dëgjosh? — pyes ngadalë dhe me zë, por varri hesht. Hesht, hesht. . .

Retë mbështillen me gurët e verdhë. Lotojnë. Bashkë me lotin tim lagin barin e tharë dhe heshtjen e tretur, heshtjen e qytetit të shurdhët, qytetit memec. . . Ky qytet është i fortë. I heshtur. Qytet me pallate të mbuluara me myshk e pluhur të kohës e moteve që parakalojnë me heshtje. Në qetësi.

«Ani, babë» — i them rishtas. — Ti hesht, unë do të flas. Do të tregoj mjerimin tim, të zezën tënde. Po, babë, atë që e ban vdekja, hija jote!»

«Me errësirën e çdo nate, babë, hija jote troket në dritaren e dhomës sime — nis t'i rrëfej varrit. — Hija troket lehtë dhe hyn brenda, në dhomë. Hija jote vjen ngadalë duke prekur, duke u dridhur nëpër terr. Hyn dhe ecën nëpër dhomë, lehtë. Dron se po i zgjon nga gjumi fëmijët e mi të shumtë.

Hija dron dhe dridhet.

Ajo ecën duke u dridhur dhe troket fare afër veshit tim të përgjumur. Më zgjon. Më thërret me një zë që s'ka tinguj. Me një zë të marrur. Me atë zërin e shterur të vdekjes. Unë zgjohem. Gjumi tret, then qafën dikah, pa kthim. Ik larg qepallave të mia të lodhura. Hija vjen edhe më afër meje. Ulet në gjoksin tim. Më ndal frymën ngadalë dhe flet diçka, ashtu zëmarrshëm. Unë droj të përgjegjem me zë. Droj se po e zgjoj tufën e vogëlushëve të mi që kanë mbushur dhomën dhe gërhasin në gjumin të ëmbël. Të flas droj edhe prej vetes, sepse dëshiroj që tanë kjo të jetë ëndërr, ëndërr e keqe dhe e mundimshme.

Por hija më ndrydh. Ajo flet. Unë hesht dhe dëgjoj. Hesht edhe pse humb çdo tingull, çdo fije jete nga unë. Vdes për një çast dhe jetoj me të vdekurin. Po, babë, kështu, për çdo natë. Kështu për çdo çast të qetësisë sime të vogël. Kështu, babë. . .»

«Të kam thënë njëmijë herë! Çka po pret më?» më thotë hija jote.

«Nuk mundem, babë», i them. I them «babë», sepse në vizat e saj vërej po atë fytyrë të babës. Po atë zë, atë trup. Vërej në vijat e hijes një qenje të njohur, që akoma e mbaj në mend edhe frymëmarrjen e saj.

«Ta mora shpirtin!» klith hija jote. Çirret me atë zërin e saj të marrë.

«Mirë!» i përgjigjem. «Mirë, mirë merre», shtoj në vete edhe dy-tri herë të tjera, sepse nuk më mbetet tingull për ndonjë fjalë tjetër. Kështu them dhe ndjej vetëm shushurimën e kësaj fjale në thellësitë e qenjes sime. Thellë, thellë diku në brendi të shpirtit.

«Nuk dua të ta marr shpirtin. Jo. Ti ashtu kishe për të dashur. Të vdesësh lehtë. Jo, jo. Nuk e bëj atë. Kam për të shtyrë të vdesësh nga dy herë në natë. Po, nga disa herë do të vdesësh prej duarve të mia. Ashtu! . . .» pëshpërit hija gjithnjë zëmarrshëm. E ndjej zërin dhe erën e saj. Hijes i vjen era dhe. Varr. Me atë erë mbushet e tërë dhoma. Çdo skutë kundërmon erë varri. Erë të errësirës dhe mjegullirës së kalbur. Dhoma mbushet me atë erë dhe më duket më shumë i ngjet një varri të gjerë e të lartë se sa vetë vetes. Varr me shumë të varrosur të gjallë, të varrosur që marrin frymë.

Dikush dridhet, dikush fle në qetësinë e natës së vonë.

. . .

«Ndofta nuk jam fajtor, babë!» i them hijes, rishitas.

«E di unë çfarë faji ke!» klith hija jote dhe shtrin trupin e saj të zi e të mbetur vetëm eshtra, të brejtur prej atij dhëmbi të dheut. E shtrin tërë atë trup mbi mua. Fryma nis të më ndalet. Të shteret.

«Më thuaj, babë, se do ta lë mëkatën po qe se kam mëkatuar. Do të bëhem theror i dëshirës sate që të të nxjerrë prej varri. Do të bëhem pjesë e trupit dhe e tokës për ty, babë?!»

«Ta merr mendja, babë më ke!» flet gëzueshëm hija dhe shton: «A më do për babë?»

«Më duhet të të dua. Po, babë, më duhet...» them.

«Jo më duhet, por tregomë drejt: po ose jo?»

«Të kam pasur babë dhe më është dashur të të dua!»

«Nesër... a, diçka po dua të them?» shton hija jote tanimë e qetë.

«Po, e di! E di: ti kurrë nuk gabove të përsëritësh ndonjë tjetër fjalë pos asaj të mallkuarës «nesër, nesër!» i them dhe pëshpëris me vete: «Ku e merr, o jetë, o dreq, të mos e lindësh atë të nesërme që e dëshiron hija e tim eti. Të mos gdhijë kurrë për mua agu i asaj të nesërmeje që është mbyllur në dëshirën e kalbur të një zemre të shterur» flas si në jermi, por një mend e dëshiroj mos lindjen e agimit të ri. Dëshiroj që kurrë, kurrë të mos lindë ajo ditë që e shqipton zëri i marrë i hijes me erë varri.

«Borxh ma ke, bir, borxh. E borxhi duhet paguar. E di atë këngën:

«Nuk ka mbet gjak pa u kthye,
ja me grosh — ja me krye...»

«Borxh ta kam vetëm një lot dhe dy gurë, babë!» i them hijes.

«Më tepër, bir. Më tepër. Jetën, por jo vetëm tënden. Jetën edhe të tetë fëmijëve të tu. Tetë jetëra. Tetë!» thotë hija e jote e zezë, babë.

Kështu pëshpërit hija që vjen nëpër futën e zezë të natës, nëpër futën e mbyllët që mbyll me errësirën e dendur çdo skutë e pore toke. Kështu...hija hyn me tërë heshtjen dhe qetësinë e varrit. Dhoma mbushet me atë erë. Bëhet varr i të gjithëve: i të gjallëve dhe i të vdekurve. Varr i madh.

«Folë, o dreq, o engjëll i mallëkuar. Folë. Tregomë çka të kam borxh? Folë?!» e pyes hijen tënde, që nuk

më largohet asnjë çast prej trupit tim të mbushur erë dheu të kalbur.

Nesër prapë e përsërit refrenin e zi të asaj kënge, he mallëkuar qoftë kush e polli dhe shton:

«Nesër të ma marrësh gjakun. Gjakun tim. Të ma sjellësh këtu ndër varre edhe atë qen. Edhe atë ngor-dhësirë, që rreh gjoks pse shtiu një plumb në mua. Pse më ndau prej mauzerit tim të kuq, që mbante një teste fishekë në gushë. Atë që më ndau prej përkëdheljes së flakës sime të kuqe!»

«Jo, babë!» i them hijes tënde. «Unë jo, kurrë!»

«Paguaje dikë që ta tubon këmbëzën e kuqe. Këmbëzën e gjakut. Dikë që i jep flakë e zjarr e ta zbardh fytyrën ty dhe varrin mua. Paguaje...» klith hija rishtas.

«E ke vra ti, babë, me dorën tënde babën e vëllaun e atij. A di, babë? A të kujtohet ahu im i vjetër kur ja tubove këmbëzën e zezë asaj të mallëkuarës tënde. Kur i palove dy jetëra në tabut. Kur ra qielli poshtë, poshtë, dhe nisi të lotojë bashkë me sytë e shterur të nënave. Bashkë me gurët e nxirë të vatrave tona. Po, babë, të kujtohet kur hyre në tubën e atyre burrave që i kishin palosur shikimet përdhe. Kur erdhe ti në mesin e tyre. U lëshove lodhshëm pranë dy kufomave të dyllëta mbi ato fytyra që me atë dorë ua këpute njomësinë. A di, babë, kur e hoqe shallin e bardhë dhe i fshive kokrrat e lotëve, që të pikuan për herë të parë në jetën tënde. Po, babë vetë i vrave, vetë i gave. Me lot.

«Ashtu ka qenë zakon në brigjet tona, more bir. Ashtu bajnë burrat!» çirret hija tmerrshëm.

«Burrat edhe falin gjak, babë!»

«Duhet ta vrasësh. Unë nuk fal!»

«Jo!» i gjegjem shkurt. Por, hija tmerrohet. Bëhet edhe më e zezë. Edhe më e trishtueshme. E nxjerr gjuhën e gjatë një metër dhe më vjen me të deri te sytë. M'i lëpin sytë, hundën. Dhe më shan e më ndrydh në njëmijë gjuhë e mënyra.

«Të them, ti gjallë, gjaku im gjallë — jo!» shton hija dhe rishtas e nxjerr gjuhën dhe m'i shtyp qepallat.

«Kanë ndërruar kohët, kanë ndërruar kanunet. Nuk

ban, nuk mundem!» i them hijes dhe mundohem t'u bie me dorë djersëve të ftohta. Djersëve që vërshojnë trupin tim të tharë, trupin tim të mjerë.

«Gjallë është ai dhe i biri. Si e preve lisin, si ja preve rrënjën, një është».

«Lisit të thatë preja rrënjën kot. Ai është tharë i tëri. Më nuk i dhemb!»

«Duhet t'ja presësh të gjitha rrënjët edhe të thata qofshin. Por rrënja e tij është gjallë. E di unë. Dhe po mbeti të jetojë gjatë, do të lindë pipa të rinj. Do të bëhen shumë lisa».

«Ata lisa bëhen të butë. Ashtu si unë që, edhe pse nuk dite të më shartosh ti, më shartoi koha. Koha, babë, më ka shartuar, edhe pse kam qenë rrënja jote. Koha ka për të shartuar edhe shumë lisa, pipa të rinj që do të lindin në trungjet e thara, në rrënjët e etërvet...»

«Kush është koha, bre? Çka lyp ajo në gjakun tonë? Pse të shtjerë dorë në pjellën time. Jo, bir, kurrë, kurrë nuk ta fal, kurrë...» klith hija jote babë dhe i shtrin ato duar të gjata. Ato duar, që kanë ngelur vetëm eshtra të përziera me dhe. Duar që vetëm dhëmbi i dheut ka mundur t'i gërryejë, t'i brejë dhe t'i lejë vetëm eshtra të gjalla, eshtra me erë varri. Duart i shtrin hija gjithnjë e më afër meje. E shoh grinë e tyre të bardhë; atë pëlhurën që e mbështolli kufomën tënde. Duart vijnë përherë e më afër meje.

«Unë të vras njerëz? Unë të marr gjak? Unë? Jo për tokë e për qiell. Jo, jo dhe njiqind herë jo!» e ndjej shushuritjen e zërit tim të shterur në përpëlitjet e mia. I fshij djersët e ftohta. Vendin e tyre e zënë djersë të tjera. Akull.

«Burrat vrasin!...» thotë hija dhe i shtrin eshtrat e duarve të gjata. M'i bie ashtu të shtrira gjer afër frymëmarrjes sime dhe e përthekon atë. Mundohet ta kështoj fare.

«Po! Burrat vrasin, por jo vëllanë, babë!»

Hija përsërit:

«Nuk ka mbetë gjak pa u kthye.

Ja me grosh — ja me krye...»

Dhe shton : «Kështu ka qenë gjithmonë, kështu thotë kanuni!»

«Kanuni i ndytë, ai kanuni i zi...»

«Kanuni është yni, o bir. Ai e ka pastruar këtë tokë prej të zezave dhe e ka larë këtë tokë me gjak? Ai kanuni i marrë, që e quan ti!» thotë hija tani më prajshëm.

«Njëmend ashtu ka ndodhur. Kanuni juaj e ka pastruar këtë tokë prej të zezave, prej të këqijave dhe prej të këqive. Zaten, ju vetë keni qenë të tillë dhe në vend që t'ja drejtoni tjetërkujt atë të shkretë, ja keni shkrepur vetes në lule të ballit. E keni pastruar tokën prej të këqijave, se ju, ju vetë jeni ata që e keni dëshiruar plumbin, varrin. Ju që e keni pjellë kanunin për të ligën e kokës suaj, për të zezën e vatrave tona që tymosën në varfëri e mjerim, për të zezën e bijve të tu. Po, po. Kështu ka qenë e vërteta!»

«Thoni pra se jemi bijtë e kudrës dhe të qenit, thoni, thoni çka të doni, por mos thoni se jeni pjellë e gjakut tonë. Theni qafën dhe humbni rrënjë e gjak».

«Koha, o babë, koha!» pëshpërit në mundimin e tmerrshëm dhe mundohem të dëgjoj gërhamzën e fëmijve të mi, fëmijëve të mi. Fëmijëve të kohës. Mundohem për të menduar se vallë a do t'u bjerë hise edhe këtyre që të përpëliten me mykun dhe pështymën e shekujve që përrënduan. Mendoj se bukur kishin me qëndisë këto lule këtë truall, vetëm po që se e harrojnë këtë të zezë. Këtë pështymë. Këtë myk që lindjet e diellit t'ja shpalojë porret. T'ja zhbijnë rrënjën.

«Pjellë e poshtër, e flliqtë!» shan hija jote.

«Mos, babë, gabon!» i them.

«Po më pate babë, merre pushkën dhe mblihdhja këmbëzën!» gjëmon hija tmerrshëm.

«Por, babë, vëllaut mishin me ja gri — eshtrat duhet me ja ru», vetë keni thënë kështu. Kështu edhe është. Vëlla e ke. Vëlla!» i them hijes.

«Më thuaj shkurt: do ta vrasësh nesër?...»

«Nesër da ta vras dikë!»

«Cilin, më thuaj, pra?»

«Hijen e babës tim!»

FIFI

«Heeeeej, Fifi!»

Fifi është miku im. Ka do ditë që sillet para meje sikur të mos më ketë parë kurrë, por përsëri Fifi është miku im.

«Heeeeej, Fifi!»

Fifin e njoh qëmoti. E njoh më shumë se ç'e njihni ju dhe e njoh më shumë edhe se ç'e njih ai veten.

«Fifi! Fifi!»

Një, dy, një, dy, një, dy...Kishte vënë duart rreth kokës dhe numëronte: një dy, një, dy...kështu i numëronte Fifi hapat e veta.

«Heeeeej, Fifi! Heeeeeej, Fifi!»

Dukej se ishte i gëzuar Fifi. Fifi gjithnjë kështu është. Si Fifi qofshin të gjithë.

«Stop! Fifi, stop!»

Ndalet. Unë ndalem pas tij, disa hapa më larg. E kam kthyer kokën andej kah ai e ka kthyer shpinën dhe shikoj: është hija e tij ajo që është prapa tij. Hija ime është para meje.

Fifi flet i pari. Fifi gjithnjë, flet i pari.

Elegant është Fifi.

«Mamaja ime sot kishte përgatitur për drekë një supë shumë të lezetshme. Nuk mund ta marrësh me mend se sa e lezetshme ka qenë. Në daç besomë, në daç mos më beso, por unë i kam ngrënë rrumbullak dy pjata të plota. As më pak e as më shumë. — Do edhe një pjatë — më thotë mamaja mua? — E si të mos dua, e dashura mama, — i them unë — si të mos dua edhe një pjatë prej kësaj supe

të shkëlqyer? Kjo nuk është aspak gjë e zakonshme për mua, sepse unë rrallë e kapërcej masën — prandaj edhe mamaja ime më shikoi tepër e shkujdesur. — Fifi, — më thotë — diçka nuk është në rregull me ty. Nuk bën ta kapërcesh masën, shpirti im, — më tha — nuk bën — më tha përsëri ajo. — Po mama, — i thashë unë — kjo supë është aqë e shijshme, sa edhe njeriu që nuk di asnjëherë të thotë se ç'është e shijshme e ç'nuk është, pasi ta kishte ngrënë një pjatë prej kësaj, menjëherë do të kishte kërkuar edhe një. Mandej ti e di se mua më pëlqen gjithnjë supa prej këpurdhave. — E di, xhani im, e di, prandaj edhe e pregatita. — Unë, — i thashë përsëri unë — unë do të kërkjoja edhe tri pjata, po të mos ishte kjo e tepruar. — Fifi i nënës, shpirti im, e di ti se kjo të bën dëm në organizëm. Doktor Kika thotë se nuk bën të teprohet ushqimi, pasi kjo gjë është tepër e dëmshme për organizmin. — Doktor Kika ka të drejtë, mama. — i them unë.

— Nuk bën të kapërcehet masa e duhur, të gjitha duhet të jenë në rregull. Bile, dhe këtë e thotë doktor Kika, nëse dreka nuk hahet në kohë të caktuar, nëse darka nuk hahet atëherë kur duhet, kjo mund të jetë shumë e rrezikshme, sepse, si thotë ai, mund të formohet edhe i thati në bark. Qoftë larg, mama. — i them unë ëmbëllsisht e ajo më fërkon mandej lehtë me dorën e saj të butë në flokët e mia të krehura mirë. — Prandaj nuk bën të teprohet, shpirt. — Po, mama, të lutem, unë i hëngra vetëm dy porcione sot, pasi kjo gjellë nuk ishte si gjellët e përditshme. Të premtoj se nesër nuk do të ndodhë kështu. Do të jem i përditshmi. Të premtoj se nesër nuk do të ndodhë kështu. Do të jem i kujdesshëm, nënoçka ime, do të jem i kujdesshëm si gjithnjë. Dhe...merre me mend, mamaja ime m'i lejoi as më pak, as më shumë, por dy pjata nga ajo supë e shijshme. Krim është që nuk ke mundur edhe ti të provosh një gjë të tillë. Supa prej këpurdhave është mjaft e mirë, e aqë më shumë kur atë e pregatit mamaja ime. Do t'i kishte kërkuar edhe ti me siguri dy pjata si unë, po të ishte dhe po ta kishe provuar të paktën një lugë. Mamaja ime di të përgatisë aqë gjëra të mira, sa mund të ngijesh vetëm duke marrë

erë. Asgjë nuk të duhet më tepër. — Mama, — i them unë asaj — ti je e vetmja, e vetmja në botë, e shtrenjta ime. Si ti kurrkush nuk mund të jetë, kurrkush. Mama, — i them unë përsëri asaj — çfarë do të bëja po të mos të të kisha ty? E di ti se do të vrisja veten, po të mбетesha pa ty? — Ç'flet kështu, shpirti im, — më thotë ajo gjithnjë — ç'budallallëqe që përmend edhe ti... E si do të ndjeja veten unë, po të bëje ti vetëvrasje?» — Po do të vep-roja kështu vetëm nëse ti nuk do të ishe më me mua, nënoçka ime, vetëm atëherë, se nuk do të mundja të qëndroja pa zemër, pa shpirtin e loçkën time. — Po unë jam, Fifi, unë jam: premta se nuk do të bësh vetëvrasje.

— Nuk do të bëj. Ja, të premtoj: nuk do të bëj, de-ri sa ti të jesh me mua. — Edhe mandej, më thotë ajo, edhe mandje... — Këtu mos më, është puna ime kjo. Kush do të isha unë mandej? A? Më trego, mama, kush do të isha unë mandej? — Fifi, xhan të kam! — Mama, shpirt të kam! — E tillë është mamaja ime. Si ajo nuk është kurrkush në botë. Kurrkush, të më besosh, kurrkush. Ja ku po ta them; uo kam thënë edhe të tjerëve; ja kam thënë edhe asaj vetë e ta them edhe ty, që ta marrësh vesh mirë këtë punë: asaj gjithnjë ja përsëris: — Sikur të mos ishe ti, mamaja ime, unë do të bëja vetëvrasje! E ç'do të më duhej mua jeta pa ty, i kam thënë shpesh, çfarë do të kisha unë, sikur mos të të kisha ty? Ajo qeshet ëmbël dhe m'i përkëdhel flokët. — Duhet të qethesh, shpirti im, duhet të qethesh patjetër. Flokët të janë rritur për-sëtepërmi, e kjo gjë nuk bën. Duhet të qethesh. Je bërë si ndonjë prift i parruar e i paqethur, je bërë si ata prif-tërat ortodoksë, që nuk çajnë kokën për qimet e flokëve dhe të mjekrës. E unë i them: — Si urdhëro, mama; ne-sër menjëherë do të shkoj e do t'i qeth, flokët. — T'i thu-ash që përpara mos të t'i marrë shumë; përmbas t'i pas-trojë me maqinë deri te ky asht e përsipër të mbesin vetëm katër centimetra të gjatë. — Si urdhëro, mama, si-urdhëro, përsipër vetëm katër centimetra të gjatë. — Kë-tu te balli të të bëjë një vijë të drejtë. — Siurdhëro, mama, këtu te balli të më bëjë një vijë të drejtë. — Fifi, shpirti im, — më lëshohet ajo e më puth ëmbëlsisht në

ball, — çfarë do të kisha unë, po mos të të kisha ty, xhani im? — Nënocka ime, — ja kthej unë me atë ëmbëlsi dhe e puth në qafën — e çfarë do të isha unë, mama, po mos të të kisha ty? — Fifi, xhan të kam! — Mama, — ja kthej unë dhe tretëm në prehërin e saj. Kështu kalojmë ne. Si ne kurrkush nuk është. Ajo mua në ballë, unë atë në faqe... gjithnjë kështu, unë e mamaja ime. — Në sa ora do të kthehesh, Fifi? — më pyet gjithnjë ajo kur nisem të dal. — Në sa të duash, mama. — Kthehu para tetës. Siurdhëro, mama, para tetës. Kthehu në tetë e dyzet e pesë! — Siurdhëro, mama, në tetë e dyzet e pesë. Kthehu më më parë, shpirti im, se nuk mundem të rri vetëm, nuk mundem të rri pa ty. — Siurdhëro, mama, sa më parë, sa më parë. — Fifi, loçka ime — më thotë ajo butësisht. — Mamaja ime e shtrenjtë, — ja kthej unë edhe më butë. Pastaj ajo më puth në ballë e unë atë në faqe dhe dal. Vrapoj shpejt e shpejt para hyrjes së banesës sonë. Ajo del në ballkon dhe ma bën me dorë e unë qëndroj poshtë dhe ja bëj me dorë.»

«Heeeej, Fifi, Fifi!»

Fifi kthehet.

«Mirë dita.»

«Oh, mirëdita, ju lutem, ju qenkeni? Më falni se nuk ju pashë menjëherë.»

«S'ka gjë, Fifi.»

«Auf! Nuk bën të shtrëngohet aq shumë dora, nuk bën.»

«Më fal, Fifi, të lutem, më fal.»

«Nuk ka gjë, por nuk bën të përsëritet kjo.»

«Nuk do të përsëritet...»

«Është shenjë e egërsisë, miku im, nuk bën ashtu.»

«Më fal, Fifi, më fal!»

«Ju lutem.»

Vazhdojmë të ecim trotuareve të rrugës duke biseduar me zjarr për një vepër që para disa ditësh ka dalë prej shtypi. Fifi qëndron kryelartë, duke ndrequr kohë pas kohe tokat e mëngëve të këmishës e palcën e rënë të flokut. Herë pas here ndalet të shtrembërojë fytyrën

pas ndonjë fjale të pamatur, që mua më shpëton nga goja. Derisa ashtu më heq përpara udhës, kokën e mban gjithnjë lart e të kthyer ëmbël në një anë, ndërsa pjesën e sipërme të trupit e shtyn përpara — jo për t'u fryrë, apo për të më treguar atë krahëror të mbetur në brinja, po për të tërhequr gjithnjë pas shikimit tim kureshtar.

Mbrëmë biseduam me mamajë time për «Kultivimin e tulipanëve» dhe ajo, mamaja ime, më duket se ka thënë një mendim shumë të drejtë e të qëlluar për këtë vepër, aqë sa mua ma merr mendja se deri sot nuk ka arritur njeri të japë as përafësisht asi vlerësimi. Pasi hëngrëm darkën shumë të shijshme dhe pasi pimë pas darke kompostin e kajsive të freskëta, u ulëm në dhomën e ditës dhe, pasi edhe një herë shikuam se ç'kishin në plan për të biseduar atë natë, na u kujtua... në të vërtetë kjo m'u kujtua mua, se në radhë ishte vepra e posadatur prej shtypi: «Kultivimi i tulipanëve». — Unë mendoj — tha mamaja pa u zgjatur në formalitete të panevojshme, ashtu si e kanë zakon njerëzit që kanë frikë të qëllorjnë në vendin e duhur — se kjo vepër është diçka që rrallë shihet në vitrinat e librave tona. — Bile, — thashë unë — më lejo, mama, të të ndërpres për një moment (t'u preftë e liga) dhe të shtoj edhe këtë, se për këtë vepër duhet të ndajmë një kohë pak më të gjatë dhe të bisedojmë më shumë se ç'kemi biseduar për libra të tjerë, që nuk e kanë vlerën e kësaj dhe që na e kanë harxhuar, pothuajse për kot, kohën e ndarë për biseda të tilla. — Pajtohem, shpirti im — tha ajo dhe vazhdoi edhe më tutje të fliste, pasi dha një herë një hyrje të shkurtër për autorin e kësaj vepre, pasi përmendi edhe vepra të tjera, që i kishte botuar ky autor dhe pasi tha se kjo është, mëdyshje, vepra më e mirë e tij, që ka shkruar deri tash. Përveç të tjerash ajo tha se ky është një emër i ri, që meriton çdo respekt dhe se unë kam të drejtë kur them që duhet të ndajmë një kohë pak më të gjatë për bisedë. Mamaja tha, midis të tjerash, se redaksitë e botimeve duhet të kenë pak më shumë kujdes ndaj tij dhe të mundohen që në një farë mënyrë ta nxisin atë për të na dhënë edhe diçka të mirë, për çka jemi të bindur se ai mundtet të japë si

dhe duhet me të të sillen ashtu si do të silleshin me një njeri të pjekur e me përvojë mjaft të pasur pune. Për sa i përket anës fiziologjike të tulipanëve, — tha mamaja ime, — unë mendoj se këtu autori është ngutur pak dhe është anuar vetëm në përshkrimin e disa fenomeneve, të cilat nuk meritojnë edhe aqë shumë kujdes, sa për shembull, meritojnë anët e tjera dhe mënyra e transformimeve të elementëve inorganike në organikë, për çka, ma merr mendja se te tulipanët duhet të ketë një dukuri mjaft të veçantë. Unë mandej shtova se libri i ka gjithsejt 323 faqe, ndërsa për këtë pjesë janë ndarë vetëm 37 faqe, çka edhe mua më duket se është mjaft pak dhe tepër e varfër për t'i argumentuar të gjitha ato fenomene. Mamaja me këtë plotësisht u pajtua dhe mandej shtoi se autori si duket e ka tepruar kur u ka lëshuar një vend prej 92 faqesh të tëra vetëm kushteve klimatike, në të cilat duhet të rriten tulipanët. Unë shtova mandej se libri i ka edhe disa pjesë të tjera, siç janë: pjesa e llojeve të tulipanëve, kujdesi për pastrimin e parazitëve dhe gjysmë parazitëve prej trollit ku ata rriten, elementet dëmtuese, llojet e truallit ku duhen të mbillen tulipanët etj. etj. si dhe në fund është ndarë pjesa e zakonshme ku shënohet bibliografia, regjistri i emrave, përkthimet e termave latine (natyrisht në ato vende ku duhet) dhe falënderimet që ua bën autori miqve të ndryshëm për ndihmën e madhe, që i kanë dhënë dhe për sugjerimet e ndryshme, që ka marrë prej tyre, gjë që mundësoi daljen në dritë të kësaj vepre. — Mua më kënaq fakti — tha mamaja, midis të tjerave, — se autorit më së shumti i pëlqejnë tulipanët e kuq dhe gëzohem që nuk kam mbrojtur me ngulm, se tulipanët e kuq janë më të mirë dhe më të bukur prej gjithë të tjerëve. — Edhe mua më së shumti më pëlqejnë tulipanët e kuq — u nguta të jap mendimin tim unë. — Ta merr mendja, xhani im, — më tha ajo — kjo dihet edhe sikur ti të mos e thoshe. Një gjak kemi në dej e një kulturë kemi kultivuar. Unë i urrej, shpirti im, kulturat heterogjene në një shtëpi të vetme. Unë, të them të drejtën, mbeta mjaft i kënaqur nga kjo bisedë, prandaj edhe i propozova mamasë që të zgjasim edhe për një tridhjetë minuta, ja-

shtë orarit të caktuar për biseda të tilla. Mamaja u pajtua, prandaj edhe vazhduam më tutje. — Unë mendoj — tha ajo — se në të gjitha lulishtet e ndryshme, ku kultivohen këto lule, njerëzit duhet të kenë më së shumti kujdes ndaj tulipanëve të kuq. Ngjyra e kuqe e tyre ja hijeshon edhe më tepër pamjen qytetit dhe i kënaq sytë e njerëzve të lodhur duke ndenjur tërë ditën me laps në dorë mbi aktet e ndryshme. — Të mos largohemi prej temës, — vërejta unë — po të kthehemi edhe një herë te libri. — Dakord, — u pendua mamaja ime, — ke të drejtë, me të vërtetë më duket se u humba pak në anën tjetër, që nuk ka aspak vend në këtë bisedë, shpirti im, — Si guxon të thuash kështu, nënoçka ime, si guxon, të lutem — u nxeva unë! — Duke të të parë ty, unë gjithnjë e humb kuptimin e kohës, se më duket që ditët nuk ecin përpara, po kthehen gjithnjë pas e të bëjnë përditë e më të re. Të gjitha ato vija, që i ke pasur kur ke qenë shumë e re, më duket së i ke edhe tash. Po, po, kështu është, e shtrenjta mama, kështu është. Ti nuk i ke vërejtur këto se njeriu shumë pak i vëren ato gjëra që ndodhin në të, por unë, unë kam mundur të shoh mirë një gjë të tillë. — Me sytë e tu më paftë gjithkush, biri im, — më tha ajo — kështu si më do ti, më dashtë e gjithë bota. Por, përsëri, ashtu të duket ty, se më do më shumë se ç'më duan të gjithë të tjerët. — Përkundrazi, mama, këtë ma kanë thënë edhe shumë të tjerë. Të gjithë të duan dhe të çmojnë ashtu si të çmoj unë, mama. Fisnikëria e shpirtit tënd, ajo ndjenjë e pastër dhe padjallëzore që ruan ti në shpirt, i bën njerëzit të mahnitën para teje. Ja, për shembull, miku im (e kisha fjalën për ty) më tha një ditë: — «Interesante është ajo që vërej të mamaja jote. Më duket, tha ai (e kisha fjalën përsëri për ty) se vjetët sikur janë të pafuqishme t'ja ndërrojnë pamjen e saj.

— Kështu është, — i thashë unë — kështu, miku im. Ajo sa ditë shkojnë të duket se është më e re, megjithëse ka kaluar dhe ka përcjellë disa gjenerata. — Çudi pra, — më tha miku im (përsëri e kisha fjalën për ty).

— Ehe, — i thashë — mamaja ime duket sikur të jetë e njëjta që ka qenë edhe para tridhjetë vjetësh, me-

gjithëse prej atëherë kanë kaluar shumë kohë. — Të kthehem edhe një herë te libri — ma tërhoqi vëmëndjen mamaja ime. — Dakord, — u pendova unë — me të vërtetë u larguam shumë e posaçërisht unë, prej asaj që kishim në plan të bisedojmë për sonte, por nuk e di si të ta them, mamaja ime e shtrenjtë, kur është fjala për ty, nuk mundem kurrsesi të zë në gojë gjë tjetër dhe të bisedoj për gjëra që para fytyrës tënde janë krejtësisht të parëndësishme dhe të dorës së dytë, të tretë... bile edhe të njëzetë, karshi teje. — Oh, djali im, në këtë unë më së pakti dyshoj, se e di që ke gjakun tim dhe nuk mundet të ma mbushë njeri mendjen që ti mund të mendosh ndryshe. Edhe unë, si ti, ashtu e kam dashur mamanë time, e ajo këtë e ka ditur shumë mirë, prandaj shpeshherë, atëhere kur unë isha e ndarë nga burri im (babai yt i pakultivuar), më fal që kështu e quaj, ajo më drejtohej mua në këtë mënyrë: — «Nuk mund ta marr me mend, e shtrenjta ime, se si dikush mundet të pranojë të ndahet prej teje, kur ti je në gjendje të duash aqë shumë dhe aqë sinqerisht, sa në këtë nuk do të mundej të dyshonte as ai zemërguri më i madh që jeton në këtë botë. — Kështu ishte puna atëherë, mama — i thoja atëhere unë asaj, biri im, kështu ishte puna.» Unë gabova mu atëherë kur duhej t'ja matja dhe t'ja barazoja vetitë e tij dhe të gjitha ato që e bëjnë njeriun të jetë i kultivuar dhe të sillet rretheve që jeta ja cakton, t'i gjurmojë ato që duhen me precizitet dhe pedanteri të matur... Më fal, biri im, se të ngatërrova pak këtu, po ka një kohë të gjatë që ka ndodhur dhe që është bërë kjo bisedë, prandaj unë nuk mund t'i kujtoj hollësitë e saj. — Nuk ka dert, e shtrenjta mama, nuk ka dert, sepse unë marr vesh çdo gjë të ëmbël që del nga goja yte; aqë më tepër, edhe këtë e di mirë, sepse e kam dëgjuar edhe disa herë më parë. — S'ka fjalë, shpirti im, unë nuk dyshoj në asnjë fjalë që thua ti, se e di që janë thënë nga zemra. — Por... më duket se erdhi koha ta ndërpresim pak bisedën, mamaja ime e shtrenjtë, kaluan edhe ato tri-dhjetë minuta, që i caktuam për këtë temë. — Dakord, shpirti im. Para se të nisemi për të fjetur, unë mendoj që

duhet të vendosim për nesër mbrëma të vazhdojmë po këtë temë.

— Dakord, nënoçka. . .»

«Më kënaqe, Fifi!»

«Nuk është se unë i them këto për të treguar diçka, por mundohem në një farë mënyre të të tregoj se kjo është ajo që kërkohet për afërsin ndërmjet njerëzve. . .»

«Afërsinë?»

«Ashtu diçka. Kini kujdes, ju lutem dhe dëgjoni këtë që do t'ju them: më ka rënë shpesh të shoh do gjëra të papëlqyeshme dhe do virtyte tuaja, që e kapërcejnë çdo masë. Jam i sigurt se këto nuk do t'i kishit, po të mos silleshit kurrë në rrethin e atyre njerëzve, t'i quaj kështu, megjithëse nuk meritojnë, që përqeshin gjithçka që është e bukur, dhe fisnike».

«Me Fifin jemi ndalur para shitores së stofrave dhe vështrojm një dezen të ri, i cili, si thotë Fifi, u prin të gjithë të tjerëve për nga bukuria dhe shija estetike, me të cilën është punuar. Kombinimi dhe harmonia e ngjyrave, thotë Fifi, është i tillë, sa njeriut nuk do t'i mbetej asgjë tjetër, përveçse t'ja shtrëngojë dorën atij që e ka punuar këtë model. Bile, thotë Fifi, nuk do të dyshonte aspak (nëse e blente këtë stof), se mamaja e tij do të mbetej e mahnitur për shijen, me të cilën e ka zgjedhur një gjë kaq të bukur. Unë vetëm e ndoqa pas dhe nuk më mbet kohë as të habitem për atë që nuk më dukej se është e rëndomtë. Megjithatë. . .»

«Pajtohem, — i them unë Fifit — ky stof është shumë modern.»

«Kini kujdes ju lutem kur ta përdorni fjalën «modern». Mendoj dhe me siguri këtu ndaj edhe mendimin e mamasë sime të shtrenjtë se kjo fjalë nuk duhet të hiqet e të përhiqet aty ku nuk e ka vendin. Përdorimi me vend i kësaj fjale, apo. . . si të them ndryshe, më ndihmoni ju lutem. . .»

«. . .Frazë. . .»

«Ah, më dëshpëruat, më dëshpëruat, — dhe Fifi mblo dhi gishtin tregues me gishtin e madh duke bërë një mënjanim me kokë, ashtu siç e kishte zakon të bënte

gjithnjë kur diçka nuk ishte thënë si duhet e me vend dhe i përplasi dy-tri herë qepallat e syve, derisa nuk shpërtheu më në fund, por... gjithnjë me atë maturinë e tij të rëndomtë: — E ç'vend ka kjo që thatë me gjithë këtë që folëm deri tash? Kini kujdes kur përgjigjeni, ju lutem, kini kujdes kur jepni mendimin tuaj për gjëra të tilla. Mamaja ime me siguri nuk do të ishte përmbajtur, po të dëgjonte gjëra të tilla. Ajo është shumë e ndijshme dhe nuk duron t'ja vrasë veshin ndonjë fjalë e pamatur dhe e pa përtypur njëherë mirë e mirë në vete».

«Po... si të them ndryshe, Fifi?»

«Kjo nuk ka edhe shumë rëndësi, se fjala ishte diku tjetër, por mua më duhet ta ndërpres që tani. Kini mirësinë e më lejoni t'ju kërkoj falje. Ora është gjashtë e njëzetetë minuta e unë duhet të jem në shtëpi në orën gjashtë e tridhjetepesë minuta. Taksi! Taksi, ju lutem! Taksi! Uf, sa të pasjellshëm që janë dhe sa pak kanë kujdes në punën e tyre.»

Shko Fifi. Iku.

Me lëvizje të matura dhe elegante e hapi derën e veturës dhe, pasi rregulloj mirë mantelin, drejtoi palcën e rënë të flokut, humbi pas qelqit të mjegulluar e të djer-situr. Duke u larguar ai, nuk pushoi për tërë kohën të ma bëjë me dorë, në atë mënyrën e vet, duke i lëvizur pedantërisht ata gishtërinjtë e tij të hollë dhe të bardhë. Unë mbeta aty ku isha, në trotuarin e ftohur dhe nuk më mbeti asgjë tjetër, përveçse të shoh hijen time të shtrirë deri te kockat e rrugës së gjerë ku kalonin njëri pas tjetrit automobilat e shpejtë dhe të gjej vendin ku pak më parë shtrihej hija e hollë e Fifit.

* * *

Fifi është miku im. Ka kohë që e njoh. E njoh edhe mamanë e tij.

Dikur banesa jonë ka qenë mu pranë banesës së tyre dhe ne na binte shpeshë që të rrinim dhe të bisedonim së

bashku. Fifi nuk i kishte qejf lojërat, prandaj edhe unë nguroja gjithnjë kur duhesha të thërras ndonjëherë të luajmë së bashku. «Kujdes të lutem, — më thoshte, — nuk jemi fëmijë. Duhet të sillemi si njerëzit e rritur. «Unë nuk mundesha ta dëgjoj shpesh, prandaj edhe për-vidhesha tinëz dhe i bashkohesha turmës së fëmijëve të tjerë. Prej tij që në fillim mësova se kjo nuk qenka gjë e mirë, sepse gjithnjë, kur më shifte në rrethin e shokëve të lagjes, shtrembëronte turinjtë dhe më thoshte:

«Ti nuk u takon atyre. Nuk bën të sillesh me ata rrugaçë.»

I tillë ishte Fifi.

Ndodhte që shpesh të vinte në shtëpinë tonë dhe me atë maturinë e rëndomtë dhe me fjalët e përhekura zhag, t'i thoshte mamasë sime:

«Ju lutem, zonjë, kini mirësinë dhe lejojeni djalin tuaj të vijë për disa momente në shtëpinë tonë. Mamaja ime ka dëshirë ta gostisë me disa ëmbëlsire mjaft të shijshme, që i ka përgatitur sipas një recete të re.»

Mamaja ime rrudhte gjithnjë fytyrën pas tij e mua më vinte shumë keq, sepse Fifi dhe mamaja e tij më dukeshin tepër interesantë dhe mendoja se prej tyre duhet të mësoj atë që deri atëhere nuk e kisha mësuar.

— «Përse, mama, ja rrudh fytyrën Fifit, përse? — i thoja unë shpesh i hidhëruar kur ajo nuk më lejonte të shkoja!

«E po, në mos mësofsh gjë prej asaj palavozke dhe atij kopili që duket se i ka krymbat në bythë.»

Ha-ha, mendoja unë me vete, të ishte tash Fifi e t'i dëgjonte këto fjalë, a thua çfarë do të bënte. Ai shpesh më thoshte se ajo që bënte mamaja ime nuk qenka e mirë dhe nuk bën të sillet ashtu me mamane e tij, e cila qenka mjaft e kujdesshme dhe shpirtmirë. Bile, thoshte Fifi, mamaja ime thotë se nuk është mirë të edukohet fëmija ashtu siç është duke të edukuar jot ëmë.

Unë në të vërtetë atëherë shumë pak merrja vesh prej gjithë atyre gjërave që m'i tregonte Fifi dhe mamaja e tij, por bëhesha sikur unë i kam mësuar këto prej ko-

hësh dhe nuk jam i paditur, sepse më pëlqente gjithnjë kur ato më thoshin:

«Ti je djalë shumë i mirë. Për pak kohë dhe me pak kujdes, ti mund të zhvillohesh në një qytetar të ndershëm që nuk do t'i gjendet kurrkund çifti».

Kur ja tregoja të gjitha këto mamasë sime, ajo rrudhte përsëri fytyrën në të njëjtën mënyrë si ja rrudhte edhe Fifit e mamasë së tij dhe bërtiste:

«Pallavra! Ata do të më mësojnë mua sa të eci e si të kem kujdes që të bie në sy të botës më mirë. M'i marrshin pleshtat, të m'i marrin.»

Unë përsëri qeshesha dhe nuk harroja të përsërisja me vete: «Sikur ta dëgjonte Fifi, çfarë do të bëhej?»

Por pas një kohe ne e ndërruam banesën tonë dhe dolëm në një shtëpi tjetër në paralagje të qytetit. Babai atëherë e kishte ndërruar punën dhe merrte më pak të holla, kështu nuk kishte mundësi ta paguajë qiranë e duhur. Prej atëherë shiheshim më rrallë me Fifin e me mananë e tij. Gjithnjë, kur takoheshim në rrugë, unë kisha dëshirë të dëgjoja diçka më tepër prej tij, por ai gjithnjë më sillte do gjellëra që s'i përtypja dot.

Kështu sillej Fifi derisa nuk i ndodhi diçka e papritur.

* * *

«Heeeej, Fifi».

Ja Fifi. E shoh se si ngarend anës tjetër të trotuarit.

«Heeej, Fifi! Fifi!»

Qenka pak i vrarë në fytyrë dhe nuk mundem më ta vërej atë gjallërinë e tij të zakonshme. Edhe hapat e numëruara nuk i paska si gjithnjë.

«Heeeej, Fifi! Fifi! Fifi!»

Më në fund më dëgjoi dhe vrapoi në drejtimin tim. E kapërcen rrugën me shpejtësi dhe thuase prej kohësh ka harruar atë kujdesim prej makinave dhe automobilave, që sillen nëpër rrugë. Edhe sytë nuk i paska të gjallë më.

«Fifi, Fifi!»

As dorën nuk ma dha.

«Shkova unë. Vdiqa! Mbarova! U dogja, u përvëllova! Shkova unë! Vdiqa! Mbarova! I ziu unë, i ziu!»

Në sy, në trup, në lëvizjet e pamatura të duarve dhe në flokët e pakrehur, njohja Fifin tjetër.

«Qenke shumë i turbulluar sot, Fifi...»

«Qenkam shumë i turbulluar a? Qenkam i turbulluar! Kini kujdes, ju lutem, dhe përshtatuni pak në situatën, në të cilën gjendem unë tani. Unë humba i tëri. Ju këtë nuk e dini. Dëgjoni, mik i dashur, dëgjoni: më erdhi ajo që kurrë nuk e prisja, më erdhi ajo më e zeza dhe ajo më e papritura. Ku mbeta tash unë i shkreti, në ç'djall ta thej qafën dhe në ç'lumë të mbytem? Më tregoni, ju lutem, në dini, më tregoni! E pat puna ime.

(Çudi, deri tash asnjëherë nuk e ka përmendur mamënë.)

«Më vdiq mamaja, mik i dashur, e shtrenjta mama, e mira mama, e ëmbla mama më vdiq. Mbeta vetëm... shkoj, heeej, dëgjove, shkoi nënoçka ime, nuk është më me mua. Ashtu si erdh në këtë botë, e pastër, fisnike, e drejtë dhe padjallëzore, ashtu edhe shkoi, pa fijen e fajit, pa fijen e mëkatit. I ziu unë, i ziu. U dogja. Vdiqa! U përvëllova! Në ç'lumë të mbytem tani, në ç'djall ta thej qafën. — Mama, i thashë unë asaj para se të vdiste, mama, ti do të rrosh, do të rrosh edhe gjatë bile. Nuk ke si të më lësh vetëm. Bashkë gjithnjë do të jemi, e shtrenjta ime, bashkë! Në një varr le të na varrosin mandej. Ti nuk ke si të vdesësh se kujt faj nuk i bëre, nënoçka ime, me kënd një fjalë të keqe s'e ndërrove. Nuk ke si të shkosh. — Unë do të nisem, — më tha e ndjera — se më presin tufa e profetënve dhe engjujve, do të nisem dhe bile tepër e kënaqur se të kam lënë ty pas. Atë që kisha ta mbaroja, ta kam lënë ty, shpirti im. Pas të lashë, se pas të desha gjithnjë. — Po mama, — e ngushëlloja unë — ti nuk ke si të shkosh, nuk ke si të më lësh të vetëm. Unë i vetëm mbetem, pa njeri, pa dashuri dhe pa kujdesin e shpirtit tim. Nënoçka ime e shtrenjtë, ti do të rrosh, do të rrosh edhe shumë kohë që të mundemi t'i mbarojmë të gjitha ato që i lëmë në gjysë. Na presin orët e vona të natës, mama, na presin bisedat e përzemërta, na presin

të gjitha ato që duhet të kryhen prej nesh, se kurrkush tjetër nuk merr guxim t'i vlerësojë ashtu si i vlerësonim ne të dy. Të shihje se ç'hije i kishte rënë se. Të shihje ç'fjalë fliste. Të prekte mu aty ku njeriu është më i hollë dhe më i ndijshëm. Fytyra i ishte zverdhur e gishtërinjtë e hollë vazhdimisht lëmonin palcën e rënë të flokëve të mi. — Fifi, — më tha në fund, — premtomë përpara se nesër me siguri do të shkosh te rrojtari dhe do t'i qethësh flokët. — Të premtoj, e shtrenjta ime, të premtoj, nënoçka ime. — Do t'i thuash të mos i pres shumë, tash është dimër e bën ftofët. — Të premtoj, shpirt, të premtoj. — Edhe te balli të t'i marrë drejt... Siurdhron, edhe te balli t'i marrë drejt. — Këtë palcën të mos e shkurtojë shumë. — Siurdhëron këtë palcin të mos e shkurtojë shumë. — Fifi im, xhani im. — Nënoçka ime, e shtrenjta ime. — Me këto fjalë të ëmbla ajo i mbylli sytë. — Shkova, Fifi, shkova, mes engjujve dhe profetëve kërkomë. — Pas do të më kesh mama, pa ty nuk rroj dot... — Dhe i mbylli sytë e bukur, dhe i paloi duart e ngrohta që prekën dhe lëmuar aqë herë palcën e flokut tim, dhe qetësoi kraharorin ku pushoi të rrahë një zemër aq e butë, aq e ndijshme dhe aq delikate. E shtrenjta ime, e ëmbla ime, tash endet nëpër qiell me tubëzën e engjujve para e pas saj. E unë? Ku mbeta unë tash? Ah, miku i dashur, ku mbeta unë tash? Në ç'lumë të mbytem? Në ç'djall ta thej qafën? Pas mamasë sime kush do të më tregojë rrugën e drejtë? Vdiqa! Humba, miku im! U dogja, u përvlova!

... Dhe muar rrugën pa më thënë as atë lamtumirën e zakonshme dhe pa i dredhur në largim e sipër as ata gishtërinjtë e hollë. Nuk mbërrina as ta ngushëlloja.

«Heeeej, Fifi!»

«U dogja mik i dashur, u përvlova!...»

«Fifi, Fifi!»

«Një shtupë në zemër kam, një shtupë të rënë...»

«Po... Fifi!»

«Shkova ta djeg, mik, shkova ta tres...»

Humbi Fifi, pa pritur as ta ngushëlloj!

Shkoi.

Nuk keni dëgjuar? Fifi është shtrirë në spital.

Nuk e di prej çkasë, nuk e di si dhe nuk e di kurrë, por e di se paska afër tri ditë që Fifi qenka shtrirë në spital. Këtë sot ma tregoi një miku im, i cili e kishte parë me llërët e përveshura dhe me duart e lidhura. Në fillim nuk munda të besoja, se Fifi mjaft i kujdesshëm për shëndetin e tij dhe gati kurrë nuk lëngonte. «Duhet të ruhesh derisa nuk je sëmurë, më këshillonte ai shpesh mua, se mandej është vështirë ta përmirësosh gjendjen dhe të shërohesh.» Por ai vetë nuk e paska dëgjuar veten dhe ja, qenka shtrirë në spital. Derisa nuk mbërrina pranë derës së dhomës së tij, çka nuk më ra ndër mend. Më kujtoheshin të gjitha ato biseda, që ai m'i tregonte, më kujtohej premtimi që i kishte dhënë mamasë së tij, se pas saj ai do të vriste veten, pasi nuk mund të rronte pa të, më kujtoheshin mandej të gjitha fjalët në lidhje me sëmundet të ndryshme që ai m'i tregonte dhe të gjitha bisedat rreth shëndetit të tij. Por përsëri nuk mund të besoja se Fifi mund të lëngonte prej diçkasë.

Para se të hyja në dhomën e spitalit, vura veshin dhe përgjova brenda. Zërin e Fifit e njoha përnjëherësh, po një zë i hollë femre, që dëgjohej herë pas here nuk më vinte i njohur.

«...Kini plotësisht të drejtë (ky ishte zëri i Fifit) dhe unë nuk mundem e nuk dua ta mohoj atë që thoni ju. Këtë bile shumë para jush e ka thënë edhe mamaja ime e ndjerë, të cilën ma përkujtoni me këto fjalë të ëmbla edhe ju.»

«Më vjen shumë keq (ky ishte zëri i panjohur i femrës) që nuk arrita ta njoh mamanë tuaj të ndjerë. Kështu si ma përshkruani ju dhe kështu si marr guximin ta paramendoj unë, duhet të ketë qenë grua shumë e mirë. Bile, më lejoni ta them edhe këtë, rrallë sot ka njerëz, ashtu si ka pasur nderin të jetë mamaja juaj.

«Keni të drejtë, keni të drejtë...»

Derisa nuk dëgjova të flitej për mamanë e Fifit si për një njeri të tretë dhe të ndjerë, nuk do të gjendej njeri

që do të mundej të më bindte mua se nuk është ajo vetë.»

«Ah, më në fund, erdhët edhe ju», — bërtiti Fifi kur më vërejti se si hyra në dhomën e tij dhe pa pyetur u ula në teun e shtrazit të tij — «por, ju lutem, kini kujdes dhe trokitni herëve të tjera.»

«Bile, — shtoi ajo femra pak e trashë në trup dhe e veshur me teshat e motrave të spitalit, — më lejoni t'ju bëj edhe unë një vërejtje, nëse nuk hidhëroheni, nuk bën të uleni në shtratin e të sëmurit, sepse këtu më së shumti kërkohet pastërtia, e ju me ato tешa jeni ulur kah mos e kah jo.

«Erdha të të uroj fejesën, Fifi. Urime, urime!»

«Fejesën? E ku e morët vesh këtë gjë ju? Ne mu sot kemi vendosur të fejohe mi e më duket se nuk i kemi treguar asnjërit e ju vini të ma uroni. A, shpirt, i kemi treguar ndonjërit?»

«Edhe unë mu tash e mora vesh, Fifi, pak para se të hy në këtë dhomë, atëhere kur vura veshin dhe përgjova pas dere.»

«Nuk bën të përgjohet në dhomën e huaj» — tha vasha e spitalit dhe foli edhe diçka, por unë nuk e dëgjova më, se u gjenda në rrugë ende pa mbaruar ajo.

QETËSI DETI

Simbas zakonit, qysh prej mëngjezit merrte me lexue. Kur lodhej, ndalej pak dhe fillonte me mendue. Kështu deri në drekë. Kështu mbasdreke... Por, kur atje kah muzgu koha përmirësohej, ai mbyllte librin dhe e largonte më një anë. Nuk dëshironte ma as me lexue, as me mendue. Tue qenë tejet i lodhun, dëshironte vetëm të mundte me qëndrue disi pezull midis qiellit e tokës. Thjesht — mos me ndie kurrëgjja, mos me ditë as për vete as për botën. Por prapë nuk mbërrinte me e plotësue këtë dëshirë. Sepse... prap mendonte. Ashtu, pahiri. Pa lidhje, shturazi. Përkundër përpjekjes me u shkëputë prej tyne, mendimet prap e sulmojshin. Edhe pse nuk i donte ma. Edhe pse përnjimend përpiquej me u ikë...

Tue mos dijtë se çka me ba, u kthye ma në fund nga radio-aparati dhe zgjodhi njëfarë muzike. Mandej qëndroi pranë dritares. Posa nguli shikimin në largësi, e ndjeu veten ma lehtë. Kështu i vinte ma mirë, sepse, pothuej, tash nuk mendonte gja. Madje edhe muzikën e ndiente ma pak. Ishte zhytë i tani në bjeshkët e largëta. Humbë diku në hapësi dhe ndihej si mos të ishte ma aty, nën kulmin e shtëpisë së vet.

Ma vonë shikimi ju kthye prap. Kqyri pak rrëmujën e rrugës dhe treti përsëri në largësi. Mandej u kthye prap në rrugën dhe jetën e saj. Këtë herë, madje, u ndal mjaft në te. Jo për shkak të botës laramane. As për veturat që kalojshin vetimthi. Vemendjen e tij, tash, e tërhoqi njëfarë karroce e vjetër, që e ngrehshin dy kuaj të mëdhej e të mbajtun keq. Kjo bani që të kthehej përsëri në mendime. Në kujtimet e fëminisë dhe të së kaluemes

së megjullueme. Dhe qe — ai tash e pa veten si kaca-
virret në boshtin e mbramë të një karroce si kjo. Madje
ndien se si i dhemb edhe tuli mbrapa prej tronditjeve,
kurse ai nuk shkoqet as nën frushkullin e kamxhikut
të karrocierit, që mundohet me e përzënë... Qeshi, prej
kësaj dreqnie të dikurshme. Mandej i vetuen para syve
shumë vegime të tjera, plot trimni fëmijore... Dhe prap
bani buzën në gaz. Kënaqej prej atij rreshtimi kujtimesh,
prej atij kalimi fantastik të fëmijëve të dikurshëm të një
shoqnie guximtare voglushësh që gëzime ti rrëmbejshin
vetë. Vetë — sepse atyne kurrkush e kurrë nuk u kishte
falë asnjë kojnak e jo ma topt. As revole teneqje, as
harmonikë goje. Aq ma pak trotinet. Edhe ma pak biçik-
kletë — këtë andërr kurrë të plotësueme...

Karroca ishte largue ma, kur ai lëvizti mbi karrocë-
zën e vet ortopedike tue e sprovue me ba diçka. Mandej
u kthye në qëndrimin e maparshëm, por tash pak i pre-
kun, i shqetësue. Tue mbështetë kryet në shuplakën e
djathtë, prap humbi në mendime...

Në një kohë, deri në vetëdijen e tij, depërtoi edhe një
herë muzika e harrueme e radios. U kap në valët e saj
dhe filloi me u lëkundë lehtazi me karrocëz. Por, kjo
nuk zgjati shumë, sepse befas u trand prej diçkafes. Në
këtë gjendje rrëmbeu një shkamb para vetes dhe e për-
plasi me forcë. Në heshtjen që u ba, tash muzika ju duk
si një jehonë e largët, e cila në një kohë edhe përkdhel
edhe godit. Kjo e tërboi edhe një herë. U trus disi çuditshëm
dhe i shtrëngoi shuplakat në grushte.

«Ç'u banë andrrat e mia?... Ç'u banë... Ç'u banë?»
— pëshpëriti i dëshpëruem dhe mbeti i plandosun në
karrocëz.

Në qiellin e mbramjes pikoi ylli i parë. I madh dhe
i ndritshëm. Mbas tij edhe një, ma i zbetë. Ai ende s'i
shihnte, sepse rrinte symbyllun dhe mendonte. Në të vër-
tetë jo vetëm që mendonte, por shtrydhte diçka në vetë-
vete. Diçka që, ngultas, gufonte prej tij dhe donte me
shpërthye jashtë. Donte me fluturue, me klithë fuqishëm.
Në vend të të gjitha kujtimeve, ai vetëm shtrëngon ma
fort dorëzat e karrocëzës së vet. I trandi me idhni dhe i

lëshoi. Kjo ishte krejt çka mund të bante aty e në atë çast. Ndërsa dëshironte diçka ma të fuqishme, diçka shumë ma të fortë. Dëshironte me kcye dhe me krisë diku. Të shndërrohej në stuhi, të treste në hapësi... Po, por kambët e tija të gjymta... Ato mbetën pa lëvizë, fare të paaftha me ju bindë.

«Sa e çuditshme asht kjo! — pëshpëriti pa shpresë. — Sa e çuditshme!»

Në at çast në dhomë u ndigjue befaz zani bukur i fortë i një cinxri. Kjo e çliroi sakaq prej mendimeve të zymta. Shikoi rrotull, mbajti vesh... Cinxri u ndëgjue prap. Atij tash i shkrepri dëshira me u lidhë me te. Me e gjetë dhe me e shikue për së afërmi, me e pa qartas se si ai i bante ato dreqnit. Por, kjo s'i erdhi përdore përnjherë. Jo aq për shkak të muzgut, sa për mungesën e vazhdimit të zanit të cinxrit, sepse ai tash kishte pushue. Ngacmoi vetëm kureshtjen dhe prajti menjjherë. U mësheh diku dhe pushoi urtas. Ngacmim i vërtetë për lojë!

I lodhun në pritje që të ndigjohej cinxri, ai e shtyni karrocëzën mbrapa. Posa lëvizën rrotat, cinxri këndoi kandshëm: — Prr-frrr, Prrr-frrr...

«Sa za i fuqishëm!... Kangë e hatashme. Gjithsejt dy tinguj të afërt, por shumë të tingëllueshëm, të kandshëm...»

Mbasi e ndigjoi pak, i shtrini buzët në të qeshun dhe menjjherë u nis me e kërkue. Por, posa mbërrini atje, kah vinte zani, cinxri prajti.

«Ah, gastor i mbrapshtë! — pëshpëriti gëzueshëm. — Ta dish, do të të gjej!»

Tue pritë që të ndëgjohej përsëri, ai u ba i tani sy e veshë. Endte durueshëm sytë nëpër terr, drejtonte veshin kah ja merrte mendja ma shumë se do të ndëgjohej prap. Por, kësaj here, kjo zgjati tepër. Ju ba se cinxri kishte dalë mëshehtas prej dhome. Se kishte fluturue jashtë, ashtu si kishte ardhë. Mu kur durimi po e lëshonte, cinxri u ndigjue tingëllueshëm. I ndezun prej gëzimit, qeshi i kënaqun dhe e çoi me fuqi karrocëzën kah dera. Por, posa mbërrini atje, cinxri përnjherë u ndal.

«Ah, shejtan! — e qortoi miqësisht. — Prapë po tallësh me mue, a?»

Kësaj here u ndal me durim aty ku ishte. Vendosi ngultas me e vazhdue deri në fund lojën e fillueme.

S'kaloi shumë e cinxri u ndëgjue prap. Ai u ndie edhe një herë i gëzueshëm dhe e shtyni karrocëzën ma afër derës. Veshi i prini atje kah pjesa e sipërme, edhe pse sytë nuk dallojshin gja. Megjithëse ishte terr, në pjesët e ndritshme prapë mundohej të dallonte insektin, për të cilin nuk mund të thuhej se ishte edhe aq i vogël, kur mundet me nxjerrë një za aq të fuqishëm. Por mund të bahet që të jetë edhe një ngjyre ma të errët, sepse — a thue, si kishte mundë me qenë ndryshe një cinxër? Po, e tanë kjo, prap, nuk ndihmonte për me e pa. As atëherë, kur e hapi sapak derën, për me vërtetue se, ndoshta, mos ishte mëshehë në ndonji zgavër.

Mandej, tue ba edhe një provë të pasukses për me e zbulue, u nis ma në fund me ndezë dritën. Por, kjo mund ta trembte — mendoi — dhe do ta largonte prej dhome. Kurse ai dëshironte pa tjetër me e gjetë dhe me e pa. Tash kaq e kërkonte këtë, sa nuk pajtohej kurrsesi me mendimin se s'kishte me ja dalë kësaj ndjekjeje mbas cinxrit cinxërues. Prandaj u ndal. Dora, posa e shtrime, u tërhoq menjherë dhe karrocëza u ndal në vend.

Meqenëse edhe mbas disa përpjekjesh të reja nuk mundi me e pa, vendosi me e ledhatue, me e ndjellë me za. Në fillim kjo ju duk qesharake, por e provoi. Kur me fjalët e tija përkëdhelëse cinxri e mbushi tingëllueshëm dhomën me kangë, ai u dalldis. Në at kënaqësi të thellë filloi edhe me i folë, me e pyetë... Në fillim me mahi dhe me të qeshun, kurse mandej e tanë kjo u shndërrue në një bisedë të mirëfilltë.

Megjithëse ishte shumë i kënaqun, që e lidhi punën me te, ai vendosi që të provonte edhe një herë me e pa. Prandaj ju afrue kanatit të derës sa ma tepër. Kur cinxri u ndie prap, e drejtoi veten kah vendi i caktuem dhe zgjatej sa mundej ma tepër mbi karrocëz. Edhe pse gjindej në një qëndrim të vështirë, ai vazhdoi me pritë tue përgjue. Posa u ndie cinxri, ju duk se e zbuloi me si-

guri vendin ku do ta shihte ma në fund. Tue mbajtë mend vendin e caktuem, u shty shpejt në skajin tjetër të dhomës. Muer s'andejmi elektrikun e xhepit dhe ja mbuloi xhamin me shami. Mandej u kthye fill kah dera. Atje e ndezi dhe e drejtoi me kujdes kah vendi ku duhet të ishte cinxri.

Drita e butë rrëshqet lehtas kah ana e sipërme e derës, diku në naltësinë e çivisë por, edhe pse ishte plotësisht i bindun se insekti gjindej aty, në fillim nuk dalloi gja. Madje ju duk se, ndoshta edhe kësaj here, ishte mashtruar. Mu kur vendosi rrezet e dritës me i çue pak ma nalt, diçka ja tërhoqi shikimin. Për me pa ma mirë, u mbështet me duer në karrocëz dhe këqyri. Në at çast cinxri u ndëgjue me të madhe me at kangë plot fuqi.

«Aha, mik, këtu qenke! — i shpërthyen klithjet e gëzueshme. — Eh, tash do të shihemi pa tjetër!»

Kësaj here e pa përnjimend. Tue e vërejtë ngultas, qeshte prej një gufimi të kënaqshëm. Gjatë asaj kohe insekti qetas derdhte muzikën e vet tue fërkue krahët e jashtëm. Duhet pohue se u zu gand prej dukjes së cinxrit, sepse në vend të një insekti të madh e të murrmë, si e mendoi deri në at çast, para tij gjindej një qenje shumë e hollë, me një pamje fare të njomë. Po syve të picërr dhe trupit të hollë, shumë të hollë, gjithshka tjetër e kishte të ngjyrës së ndritshme, gati të tejpashme. Edhe ato kambët e tija të gjata. Edhe ato brinthat. Mandej ajo qafa shumë, shumë, e zgjatun dhe kryet... Çdo gja e kishte disi të tejpashme, si ajri. Gjithshka, pos atyre dy syve të picërr dhe mesit të ngushtë të trupit të zgjatun.

Pak ma vonë cinxri pushoi së kënduemi, po ai nuk i largonte sytë prej tij. E shikonte ngultas. I këqyrte hollësitë e trupit dhe pritte me durim që të ndëgjohej prap. Kjo dukje e njomë e insektit dhe zani i tij tejet i fuqishëm e rrëmbyem plotësisht. I përfshimë prej kësaj ndjenje, ai tash u zhyt i tani në atë kënaqësi lirike të cinxrit të vet dhe të mija të tjerëve që ja thojshin të njejtës kangë nëpër fushat e afërme tue mbushë hapësinën me valët e çuditshme dhe shumë të kënaqshme të tingujve.

«Sa i dashun që je! — pëshpëriti me buzëqeshje. — I bukur, tërheqës. Po... unë deri tash të mendojsha se je disi... i murrëm. Si një insekt me fletë të vrazhda që, rastësisht, e ka ate za të mrekullueshëm... Po, mu kështu të kam parafytyrue. Për ma tepër edhe me një kokë të madhe dhe me një trup të shturur, prej të cilit del vetëm një za i kandshëm e kurrëgjatë. Kurse ti, që, na dole fare ndryshe, drejt i vogël! Plotësisht në harmoni me ate kangën tande ngacmuese... Pa tjetër je i çiltër në ndjenjat, kur dukesh i këtillë. I pastër në synime, kur këndon dhe dukesh kaq i bukur...»

Me një shprehje kënaqësie në fytyrë, u përkul pak kah cinxri dhe ja preku me kujdes njenën nga fletët që i dridheshin. Insekti u shqetësue dhe menjherë e preu kangën. Ai vetëm qeshi.

«Thuej: a po shpreh kështu ndonji gëzim, apo... thërrret, ndoshta dashnoren tande?... Kallëzo, a asht kjo kangë gëzimi për jetën apo për dashnoren?... Ndoshta edhe njena edhe tjetra, apo jo?... Por s'ka gja, s'ka gja... Unë e kuptoj këte. Për ty tash asht çasti i jetës, këte e di mirë. Kulmi i lumnisë. Prandaj edhe je i dalldisun, plot kangë... Po, po, unë të kuptoj mirë. Të kuptoj, sepse edhe vetë dikur e kam fillue jetën kështu, jetën që m'u ka dukë e mrekullueshme. Po... për habinë time të madhe, ma vonë, shumë gjana më dolën të pamira, madje plot helm. Unë atëherë fillova me këndue gjithnjë pak e ma pak, e me mendue gjithnjë ma shumë. Ma në fund e ndala kangën fare. Ndërsa çasti i jetës sime ende jetonte, merre me mend këte! Ende isha në kohën, kur jeta gëlltitet ma shumë, kur ajo asht e tana kangë...»

Nata ishte e qetë, e prajtn. Nën qiellin plot yje jetonte kanga e mija cinxrave. E tanë hapësina luhatej prej saj, përkundej me ritëm. Ndërsa cinxri zhytej me kangën e vet, në ate gëzim jetësor, të të vetëvet të panumërt, ai u ndreq pak në karrocëz dhe e lëshoi kryet mbrapa. Mandej mbylli qepallat dhe u fut në një harresë të kandshme. Kur insekti prajti përsëri, ai menjherë i çeli sytë, ju afrue edhe ma dhe vazhdoi:

«... Kështu, mandej, erdhën mendimet, ndjenjat e

idhta. Ma në fund kundërshtimi, kacafytja e rreptë... Në vend të gëzimit për jetën, rrokja me te. Në vend se me e pritë ashtu si më ofrohej, unë ngula kambë me e ndreqë, me e pastrue prej ferrave që më dukej se e shëmtojshin, e bajshin të keqe... Mu këtu filloi ajo kryesorja e ma e randa që ti nuk mundesh me e kuptue, miku im i dashun. Nuk mundesh, kuptohet, sepse je i llojit tjetër, insekt, sepse nuk di se ç'ka mësue Konfuçi e çka të urtët tjerë. Ti nuk mundesh me ditë kurrëgjja prej punëve tona, e askush prej sojit tand... Prej jush, besoj, kurrkush sh'mundet me u dashunue në diçka që s'asht as e dashun, as lule e erëkandshme, apo jo? Për shembull, në iluzione. Në ato andrra mashtruese që të joshin fuqishëm. Që me një forcë magjike e tërheqin njeriun në një botë të imagjinueme. Një botë plot me kuptim dhe harmoni. Në një botë mbushë me bukuri të gjalla... Kurse këso, si po e sheh, ka ndër ne. Dhe, çka asht edhe ma për t'u çuditë, në qoftë se nuk imponohen, shumëkush i trillon, i krijon vetë!.. Qe, mik, pse nuk kam qetësi, pse kaheerë s'e kam. Madje, as që e mbaj mend prej ç'kohe s'e kam. Nuk e mbaj mend, sepse në thellësitë e mia, moti asht vendosë trazimi, kurrë i qetësuem, kurrë i prajtun, a po më merr vesh, a jo? Ai trazimi i andrrave ma të bukura».

Diçka e shtrëngoi në krahnuer, ja shoi fjalën. Zani ju dobësue, u dridh. Ma në fund prajti fare. Por, kjo nuk zgjati shumë. Me idhti të madhe në za vazhdoi:

«E kur fillova me hy në jetë... po, atëherë edhe unë i shtrija duert kah dielli. Kah dashnorja dhe lulja. Po, po, sepse... hapat e parë janë aq të vrullshëm, aq dalldisës! Edhe te ju do të jetë kështu, jam i bindun. S'ka gja se jemi të ndryshëm përka natyra dhe me fat jo të njejtë. Njisoj...»

Këtu e ndali prap njifarë brengje e brendshme. Për t'i ikë, lëvizi në karrocëz. E shtrëngoi rreptë dhe shpejtas e lëshoi. Si të donte me atë mundim edhe një herë me dëbue diçka.

«Po mandej?... Mandej çdo gja ndryshoi, mik i dashun. Çdo gja u ngatërrue, u ba ma e randë. Merre me mend — për andrrat e mia vetëmohuese, për bukurinë e

jetës që e kam kërkuë jo vetëm për vete, deshën me më heshtë me frikë. Deshën me më vu prangat, me më zhdukë në burg. . . Po, të gjitha këto deshën me m'i ba, kurse unë, atëherë, luftoja e kacafytesha me ta. . . Ja pse po më dridhen duert, dhe kambët e mia nuk janë ma të miat. . .»

U ndal sa me marrë frymë, me e mbushë krahnorin me ajër. Dhe, si ta shndërronte idhtinë në fuqi, vazhdoi me za të ngritun:

«Por, nuk më vjen keq për fjalën që i dhashë vetes! Nuk më vjen keq as për besimin që i dhurova botës. Nuk më vjen keq për asnji send! Për kurrigja, sepse kam pa njiqind rrugë, e vetëm një zgjedha. Dhe ndashtë, pse në këte, të shumtën, e kam ngjye kafshatën me krypë. Ani, po them, sepse njiqind rrugë të parrugë kishte për mue e vetëm njena e drejtë. Rruga e andrrave të mia dhe e punëve të mëdha.»

Tash e ndjen veten disi çuditshëm. Çuditshëm, sepse. . . para syve si t'i fluturojshin zogj. Po, zogj. Madje kah jugu. Mbas tyne edhe yjet. Nji tufë e tanë yjesh vizëlluese. Edhe ato kah jugu. Me të vërtetë për t'u habitë, pse. . . Ai vetëm sa kishte kapsitë sytë. Dhe nuk ndjente me pa kurrigja, kuptohet. Vetëm pandieshëm, prajshëm dhe mëshehtas, llokoçiste në vete njifarë turbullimi të randë që e mundonte. . .

Kur në kullën e qytetit filloi rrahja e orëve të natës, si pavetëdijshtëm u zhyt në ato rrahje, filloi me i numrue. Mbasi u mbaruen të gjitha dhe mbretnoi heshtja, atij ju duk u pabesueshme që kishte kalue një copë aq e madhe e natës. Por, sa u pajtue diqysh me një mundësi të këtillë, tingëlloi një seri e re rrahjesh. Kjo tash e pruni plotësisht në vete dhe filloi me numrue me kujdes. Kësaj here madje me një kujdes të veçantë. Kur ra ora nandë, çdo gja prajti.

«Ky do të jetë ma i saktë! — filloi me vete. — Po, e pse pak ma parë trokiti mesnatën?! Pse, ma në fund, bie kështu sonte? Duket se do t'i ketë punët keq. . .»

«Po çka do të jetë keq? — kundërshtoi diçka vrullshëm. — Bjen kur don me çka? Në qoftë se s'i pëlqen, pran kreyt. . .»

«Mirë, po ai asht sahat!»

«Çka don me thanë se asht sahat?»

«Kur asht sahat, duhet edhe me i tregue orët. Madje jo si don ai, por ashtu si duhet. Me rrahë me kohë, a e kuptove? Po... në qoftë se varet dikush prej tij, prej rraheve të tija?! Me u drejtue simbas tij...»

«Ç'farë iluzioni!...»

Posa i dha fund kësaj grindjeje në vete, prej kullës u shkreh një varg i tanë tinguish, vetëm se kësaj radhe ma i shkurtë se përpara. Gjithsejt katër të rame. Kjo e idhnoi. Murmuroi me ironi:

«Pra, drejtohu atëherë, o botë!.. Çdo gja asht në rregull, vetëm mbrapsht...»

Në atë kënaqësi tundi karrocëzën dhe u shty në drejtim të dritares. Shikoi kah qyteti. Mandej në largësitë e mbulueme me një cipë të hollë errësinë. Ndjeu atëherë njëfarë lodhjeje, trokitjen e gjumit. Dhe, mu kur vendoste a me e ndezë dritën dhe me lexue diçka apo me shkue me ra, cinxri u lëkund dhe befas fluturoi. Ai këte as që e vu re. Ishte i kthym nga jashtë, dhe pa vetëm aktin tjetër, ate dramatik: cinxri, në fluturimin e vet, ra drejt në rrjetën e marimangës në kandin e epërm të dritares. Mu në ate çast, prej prite, u lëshue në te një marimangë e hatashme. Ndërsa insekti përpiquej me të gjitha fuqitë me u çlirue diqysh prej kthetrave vdekjepruese, ai, i tërbuem, vetëm tundte pafuqishëm duert, tundte karrocëzën tue kërkue në ate mënyrë me i ndihmue cinxrit, me e pengue ate mbarim tragjik në çastin jetësor...

Kalojshin sekondat fatale, e ai ende qëndronte pa mundë me ndërmarrë ndonji gja. Në kët ndodhi të çuditshme, ishte ma se i dëshpëruem. Në një çast, si t'i kujtohej vetëtimthi diçka, i shtrëngoi dhambët me tërbim dhe me sa fuqi pat e hudhi llambëzën mu në rrjetë... Tash atje s'mbeti gja. Gjithshka u zhduk. Edhe llambëza, edhe marimanga me rrjetën e saj, edhe cinxri...

Mbasi u qetësue pak, filloi me gjykue për përfundimin e ndërmarrun. Tue matë çdo gja që shkonte në dam ose në dobi të insektit, ju duk se prapë kishte veprue mirë dhe me kohë. Madje ishte mjaft i bindun se miku i

tij i çuditshëm edhe vjetve të ardhshëm do ta këndonte këngën e vet të hareshme. Nën ate përshtypje e ndjeu veten disi të gëzueshëm, plot shend, madje edhe të lumtun.

Tue u mbështetë, mandej, në kandin e majtë të dritares, ja tërhoqi vemendjen pllaka e madhe e hanës, e cila sa po ngrihej prej naltësive të zymta të malit. Pamja ishte shumë tërheqëse, disi fantastike, gati rrëqethëse. I përfshimë fuqishëm prej kësaj ai i shtriu duert përpara.

«Alo, Hanë!.. Alo!.. Alooooo!..»

Kur erdhi në vete, nuk ishte aq i sigurtë se a e kishte ba këte me za apo kishte qenë vetëm dëshirë. Luejti vendit mbi karrocëz dhe u orvat me e kapë në vetëdije, me e ndie disi zanin e vet të ikun. Të sigurohej se a përnjimend kishte bërtitë, apo e kishte thirrë hanën vetëm me mend.

Jashtë ndëgjohej kanga e cinxrave.

Kurrnja tjetër.

Kurrnja, përveç cinxërimës së tyne.

1961

SHTËRGATË

Në rrugën e madhe të qytetit vlojnë njerëzit dhe buçet zhurma. Mbas zaneve — heshtjet përgjat trotuareve.

Mbi kalldram ashpër kumbon goditja e çizmeve ushtarake. Ushtria e zaptuesit ecën në një rresht të mreku llueshëm. Kryeneçe, e fuqishme. Me kangë zindjellëse të marsheve.

Në të dyja anët e rrugës valëviten një mori dorëzash. Dorëza të zeza e të bardha dhe — asgja. Të zezat çue në shenjë besnikërie, të bardhat në shenjë përuljeje. Edhe njana, edhe tjetra palë tunden buzëgaz, përshëndesin.

Po heshtjet?.. Ç'bajnë ato?

Ato vetëm prajnë me duer në xhepa. Prajnë të mrroluna, t'idhnueme sa s'ka.

* * *

— Jeta kishte mundë me qenë kangë. Pse nuk asht? Ai s'i foli fare.

— ...Lulja e bukur, që ambël shikon, ndrit prej lumtunisë. Ai vetëm heshtte, mendonte.

— Folë!.. Folë një herë, pse jeta nuk asht si kangë e si lule?

— Po, ku e di unë! — murmuroi ma në fund por ftohtazi.

— E din, e din!.. Më thuej ma!

— Pyet andërruesin për këtë.

— Ti je andërrues! — bani vajza gazmueshëm.

Djaloshi buzëqeshi. Kjo ja shëndriti fytyrën, ja gja-

lloi hapin. Kur u ndalën, qëndruen pak mbi bar. Mandej u ulën në një bankë. Tue u mahitë, po si. Gjithnji tue u mahitë.

— A ka bimë të pikëllueme? — pyeti ajo me kurreshtje.

— Të gjitha janë të pikëllueme, kur fillojnë me u vyshkë — ju përgjegj me buzëqeshje.

Shikimi i vajzës u lëshue tash mbi degë, pastaj mbas një zogu në fluturim.

— A ja ke lakmi fluturimin? — pyeti djaloshi tue e shikue. — Ose kangën cicëruese ndoshta, a?

— Gjithshka ja kam lakmi, gjithshka. Ai asht kurdoherë i lumtun.

— Ndoshta kishe me dëshirue të ishe edhe ti njëfarë shpendi? — bani djaloshi tue e shikue plot dashuni.

— Po! — ju përgjegj vajza gazmueshëm.

— Çfarë shpendi, pra?

— Pëllumbeshë!

— Pëllumbeshë?.. Po e kuja, a më thue?

— E ytja!

Për rreth e rrotull s'kishte njeri gjallë. E dita ishte e ngrohtë — gati drekë. Kohë e papërshtatshme për me ndejtë në park. Po, por ata ishin aty dhe flitshin si të cicërojshin.

— Po ti, pëllumb i kujt je? — vazhdoi ajo hareshëm.

— Dihet ma kjo!.. I yti deri në amshim.

Shikimet e tyre u megjulluen. Buzët lëvizën kah njëna-tjetra. Sytë u mbyllën. Nji çast, dy... Ajo mandej e këqyri përskithi. Qeshi ambël dhe pyeti:

— Çka do të bante pëllumbi, sikur të zhdukej pëllumbesha?

— Nuk më pëlqejnë kësofarë sprovimesh.

— Joo, nuk e pata për atë!.. Desha vetëm me u mahitë pak.

— Hm, ashtu. Pëllumbi, atëherë, do ta kërkonte gjatë, gjatë...

— Po sikur mos ta gjente?

— Atëherë, vaj për pëllumbin! Kishte me mbarue prej pikëllimit.

Të dy i vërshoi shendi, një e qeshun e përbashkët.

Shtegut shkonte një ushtar, soldat gjerman, disi mendueshëm. Kaloi kësajde me hapa të ngadalshëm dhe u ul në bankën kundruell tyne, pak si anësh. Kur u rehatue mirë, i nguli sytë në tokë përpara vetes. Ma vonë e nxori cigaren dhe e ndezi.

Djaloshi tash, si ta ndillte tymi i duhanit. Nuk duroi shumë. Shkoi ndaj ushtarit dhe ju lut për zjarm.

— Pse shkove atje?.. Nuk ke ba mirë.

— S'kam shkrepse.

— Ani, kishe mundë me durue pak.

— Bravo! — ja ktheu djaloshi. Tash të due edhe ma shumë.

— Po, kurse këndeje i drejtohesh një shkelësi...

— Ke të drejtë, por më duket se ky asht i pikëlluem diçka.

— Ashtu?! E pse të jetë i pikëlluem?

— Kush e din. Ndoshta e ka marrë malli për pëllumbeshën...

— Hm, ai nuk asht pëllumb, me pasë pëllumbeshë. Ai asht zog rrëmbyes.

— Mos u ngut. Ndoshta nuk asht njeri i keq. Shih sa asht i ri, dhe prapë aq i mendueshëm.

— Nuk më pëlqen kjo bisedë. Të ikim prej këtuhi!

Vajza u çue dhe u nis. Po edhe djali bani ashtu. Kur kaluen para ushtarit, ai vetëm i këqyri mekshëm.

Diku ma larg u ulën përsëri. Vajza ju drejtue djaleshit:

— Më pate thanë se kemi diçka shumë të randësishme për sot. Pse nuk po ja nis?

Djali mbet i heshtun. Në vend të përgjegjes, vetëm ndezi cigaren në duqin e asaj së parës. Tue e thithë tym mbas tymit, hudhi shikimin diku larg. Ajo vetëm e këqyrte dhe pritte. Qëndrimi i këtillë i tij, filloi pak me e shqetësue. Prandaj, tash ju lëshue edhe ma tepër për ta ba me folë.

— Po, pata thanë... dhe qe, edhe asaj i erdhi radha.

— Ndoshta s'asht ndonji gja me randësi? — tha vajza.

— Asht, qysh jo? — kundërshtoi ai. Me shumë randësi bile.

— Pse po e zgjat atëhere?

— Vështirë asht për ty, qe sepse...

— Vështirë për mue?

— Po.

— Ani, le të jetë! — bani vajza vendosmënisht. Hajt, trego! Ndoshta edhe nuk asht puna aq e vështirë sa mendon ti.

— E di mirë se asht, prandaj edhe ngurroj... Thue se nuk e ke vu re, a. Ti zhgurrit për këtë për ate, pa e ça kryet, kurse unë sillem ashtu sa mos me ta prishë harenë.

— Po, e kam vu re qysh në fillim se mësheh diçka. Humbet disi në mendime, i vonon përgjegjet... Por, ta lamë këtë tash. Tregomë, ku qëndron puna. Hajt folë!

Nuk desh me ja thanë përnjherë. Thithi tymin dhe e lëshoi shikimin mbi bar. Ma në fund ja nisi:

— E kemi një shok në spital, në dhomën e burgut. Asht i plagosun, por jo aq randë...

— Mendon se mundem me ndihmue diçka? — pyeti vajza.

— Duhet ta rrëmbejmë para se ta kthejnë në burg. A mendon tash se një punë e këtillë nuk asht e rrezikshme për ty?

— Po për ty? — bani ajo tue e shikue.

— Jo aq sa për ty.

— Pranoj atëhere! — tha vajza vendosmënisht.

— Nuk po më pëlqen kjo gatishmënia tande e shpejtë — ja ktheu ai.

— Pse tash kështu?! — belbëzoi ajo gati përvajshëm.

— Sepse pranove tepër shpejt. As që mendove bile pak.

— Por, kur asht puna me shpëtue njeriun...

— Sidoqoftë, sidoqoftë!.. Asht dashtë të mendosh. Të thashë se asht punë e rrezikshme.

— Prapë po të them se do të baj gjithshka asht e nevojshme.

Djaloshi e shikoi. Desh me u bindë edhe një herë për vendosmëninë e saj.

— Ndoshta pëllumbi, mandej, ka me mbarue për pëllumbeshën...

— Jo, jo! — ndërhyri ajo me të butë. Unë do të kem kujdes.

— Po, por prapë ajo mund të ngjasë. Ajo ma e keqja. Kurrnga nuk dihet...

— Pse mendon kështu?

— Sepse kjo asht dyfish e rrezikshme për ty.

— Po tallesh me mue.

— Aspak. Po flas me gjithë mend. Rreziku i parë asht se duhet të sëmuhesh aty për aty. E ai i dyti asht atje, në burgun e spitalit, kur të krisë rrëmuja...

Vajza sikur mos ta kishte të qartë këte.

— Mirë, po... pse të sëmuhem?! — pyeti.

— Për me të pranue në spital, qe pse. E kjo duhet të bahet qysh nesër, ndoshta.

— Por, si mund të sëmuhem kaq shpejt?! — bani ajo ende pa i kuptue të gjitha.

— Fare lehtë: ke me pi diçka që kam me të dhanë.

Vajza hapi sytë sa mundi.

— Ky asht, pra, ai rreziku i parë për të cilin të fola. E kur shtrihesh në spital, detyra tande ka me qenë vetëm kjo: në kohën e caktueme do të na hapish dritaren e shënueme në katin përdhes. Kaq, pra, s'ka tjetër. Duket lehtë, a?.. Po, por prapë e tanë kjo asht e rrezikshme. Asht e rrezikshme sepse... nuk dihet kurrnga me siguri se si do të përfundojë.

— Hiç mos ki dert! — i dha zemër vajza tue çue buzën në gaz. Çdo gja ka me dalë mirë.

2

Berzati shprushi zjarrin. Mandej mori një gacë dhe ndezi cigaren. Kur u çue, përfundoi edhe një herë se dikush kishte ba diku një marri të madhe.

— Ti qenke nisë për në aradhë, shoqe, a? — ju drejtue mysafires së përcjellun.

Vajza vetëm rrudhi krahët dhe bani një të qeshun me sy në dysHEME.

Ishte dimën. Natë e stuhishme. Bora vende-vende deri në brez.

Ai e këqyri edhe një herë. Mandej u ul dhe filloi të trokasi me gishta mbi tryezë. Pak ma vonë, sa me shkëputë heshtjen, vijoi:

— Besa, edhe unë kisha me shkue në aradhë, por qe... vepro aty ku je, thonë, dhe prit. Por kjo e pritun, më duket, u zgjat ma shumë se vetë lufta.

Kur u duk zonja e shtëpisë, dhoma ndriçoi. Ajo grue e hijshme dhe e gjallë, menjherë krijoi një gjendje të kandshme. Mbas e pinë çajin që u kishte nxjerrë, Berzati e luti që ta merrte mysafiren me vete në kuzhinë. — «Atje asht ma ngrohtë» — tha. Në të vërtetë, këte e bani që të mbetej vetëm me shokun, i cili e kishte prurë vajzën.

Bertzati e ndjente veten disi jo fort në qejf. Prandaj, ma me kënaqësi ndëgjonte fishkëllimën e stuhisë se sa me zhvillue bisedën, mbasi duhej me folë gjithnji për vësh-tirësitë.

— Nëse nuk mashtrohen, kjo do të jetë ndonji mahi ndoshta, a? — tha mendueshëm.

— Çka? — pyeti shoku.

— Kjo de, që po thue: ta çoj vajzën për në aradhë.

— Jo, bre burrë, çfarë mahie!

Buzëqeshja e Berzatis, megjithëse spontane dhe pa qëllim të keq — fyente.

— Pse buzëqesh kështu? — u zemëruë shoku.

Në vend të përgjegjes, ai e pyeti:

— A mos kemi kund ndonji aradhë femnash, a thue?

— Paj, çka ke kështu, pash zotin!?

— Po pyes!

— Unë nuk po të kuptoj, pra!

Bertzati i afroi cigare.

— Ndize! — tha miqësisht.

— Tash e qita.

— S'ka gja, ndize! — nguli kambë Berzati.

E ndezën të dy dhe heshtën për pak.

— Çka mendon, shok, a mos janë partizanët eunukë, ndoshta? — vazhdoi me shpejtësi.

Shoku edhe një herë u hutue, por ma në fund qeshi.

— Të hangërt dreqi, të hangërt! — bani me të madhe. — Për këso punësh po më fut llugave, a?

— E kam me gjithë mend! — ja ktheu Berzati me një shprehje të ftohtë në fytyrë.

Shoku prapë u ngrys.

— Ti je ba sonte krejt i çuditshëm! — i tha me zemërim. Çka të ka zanë, bre burrë!?

— Mue, kurrëgjja, më duket, por ate, që i ka ra në mend me e çue këte vajzë në aradhë, duhet me të vërtetë me e pyetë se kah po i kullosin mendtë!

— Por... ky asht vendimi i shokëve, or vëlla.

— Dreqi i shokëve!.. As që e kanë pa ndoshta. Por mirë, le të jetë edhe kështu. E hajt tash ta analizojmë punën vetë ne të dy. Pikësëpari, ç'asht kjo: aradha partizane?

— Kjo, të paktën, dihet.

— Eh, kur dihet, pse u nxjerrin njerëzve punë, pra?

— Unë prapë nuk po të kuptoj.

— Mirë, po e marrim atëherë kështu: a janë ngatërresat — punë e vogël?

— Pse ngatërresat?! — u çudit edhe një herë shoku. Kah po i merr edhe këto tash?

Berzati heshti pak tue e shikue, mandej vazhdoi:

— Po shoh se me ty duhet edhe ma konkret. Qe, po e zamë kështu: nëse kjo vajzë kishte shkue për në aradhë, çka mendon ti, a e kishin lanë rahat atje? A nuk do të sillëshin rreth saj e, madje, edhe me urrejtë njëni-tjetrin, mështazi së paku?

— Uh, sa i çuditshëm që je! — ja priti shoku. Paj, ata janë luftëtarë, bre.

— Nuk më pëlqejnë frazat!

— Mirë, edhe mue s'më pëlqejnë, por... kjo punë sigurisht qëndron kështu.

— Nuk po them se kanë me ra në gjuj para saj, por... a mos po mendon se ata do të jenë të ftohtë kundrejt

bukurisë së saj, me u ba cungje, kur nuk janë? Ke pa edhe vetë se çfarë krijese asht. Femën e plotë! Tërheqëse edhe kah të pamit edhe kah të folunit...

— Ashtu asht, me të vërtetë, por çka t'i baj unë. Më thanë me ta dorëzue ty që me lidhjen e parë ta për-cjellësh në aradhë. Kaq kam pasë unë.

— Kjo s'asht punë me mend! — u idhnue Berzati. Ktheje prap!

— Si me e kthye?!. Ate tashma po e kërkon policia.

— Policia?.. Çfarë policie?.. Ku e din ti?

— Më thanë shokët. Për kët shkak edhe po e largojnë prej terrenit të saj.

— Mbanje atëherë këtu në qytet. Kishte me krye ndonji detyrë.

— Por, si mundet kjo, shoku Berzat! E din edhe vetë se sa ngushtë jemi për banesa ilegale.

Berzati u vra. Nuk mundej kurrsesi me e kuptue punën e të dërguemit të saj në aradhë. Dikur ju drejtue shokut:

— Duhet doemos të gjejmë ndonji zgjidhje tjetër!.. Nuk ban kështu. Tregoju shokëve këte që biseduem ne të dy. Le të mendojmë pak. Ndoshta prap ka ndonji shteg-dalje. Ka kohë me pritë. Sidoqoftë, me kët mot të lig s'besoj se vjen shpejt ndonji lidhje...

Shoku doli vrik në rrugën e pushtueme prej territ. S'kishte mbetë edhe shumë minuta, që ora policore ta ndiqte edhe qytetarin e fundit prej rrugëve.

3

I ra murit dy herë me shuplakë.

— Urdhënoni, ju lutem! — ju paraqit çapkençe zonja e shtëpisë.

— Po më tall! — ja ktheu Berzati buzëgaz.

— Jo, jo, vetëm se po t'i zbus gjembat.

— Por, unë nuk jam iriq ndoshta.

— Nuk je, por gjemba ke se ke! — ja lëshoi ajo në-gaz tue u tërhiekë.

— Eh, atëherë, prit pak e të baj...

— Nuk mundesh me më zanë! — e nxiti ajo tue mbajtë dorezën e derës, e gatshme për t'u zhdukë.

— Mundem, por nuk due.

— Nuk mundesh, jo!

— Nuk due.

Grueja e Berzatis u qetësue ma në fund dhe ju qas ma afër.

— Pse më thirre? — pyeti.

— A e mësove ate shoqen me përdorë armët?

— Jo ende. E lamë për ma vonë. Eja ma parë të shohim diçka!

— Çka me pa?!

— Eja, eja!

U nisën korridorit. Grueja i prini kah dhoma e fjetjes, kurse vetë u ngut pak përpara dhe e çeli derën hapkrah.

— Këqyr! — briti mandej shend e verë.

— Ohoo! — bani Berzati i befasuem. Çfarë andrre po shoh.

Vajza vetëm buzëqeshi, tue ndejtë në kambë si me qenë nuse. Berzati, tue mos i hekë sytë prej asaj çka shihnte, hyni ngadalë në dhomë.

— Paj, çka asht kjo, a doni me më kallëzue? — pyeti tue hapë krahët përpara atyne punimeve të shumta femnore të rreshtueme nëpër dhomë.

— Nuk po të kujtohet, a? — bani grueja tue e shikue çapkençe.

— Jo, hiç!

— Pajë vashënie, qe se ç'asht!

— Çkaaa?!

— Uh, që qenke i pamundun! — u idhnue pak grueja. Pse s'po mrekullohesh pak, por vetëm po habitesh?

— Mirë de, nuk asht puna se nuk po mrekullohem, por unë me të vërtetë jam i hutuem.

— Qe nji dhuratë edhe për ty! — ndërhyri vajza tue buzëqeshë dhe ja dorëzoi nji qindisje të bukur.

Berzati e këqyri me mëdyshje vajzën dhe e mori dhuratën, tue mos kuptue gati fare ate që ndodhte.

— Ti, duket, qenke nisë me dhurata për në aradhë?
— ja bani Berzati në vend të falënderimit. — Sa të bukura që janë, sa fantastike!.. Por, pse i ke marrë këto me vete? — pyeti në fund tue e shikue ngultas.

Vajza vetëm i hudhi sytë në një qëndisje që ishte ma afër dhe buzëqeshi pak si turpshëm.

— As unë nuk e di — tha me një za të këputshëm. I kam dashun shumë këto sende dhe...

— Dhe nuk munde me u nda prej tyne, a? — e plotësoi Berzati tue qeshë në mënyrë miqësore.

— Jo, por...

Këtu u ndal. Nuk diti çka me thanë tjetër dhe vetëm uli kryet. Berzati ju ba e qartë se nuk i dha përgjegje të drejtë dhe se mëshihte diçka në vete.

— Ka vendosë, thotë, me ua nda të gjitha shokëve... — u përzie grueja tue këqyrë me të butë vajzën.

— Mirë po çka do t'u dhurojë krushqve, kur t'i vijë radha edhe kësaj pune një ditë?

— Qe, po i dhuron qysh tash! — shtoi grueja.

— Jo, nuk pata ndër mend ate... — nisi me u mbrojtë vajza.

— Po mahitem, po mahitem! — ja bani grueja një rëzishëm dhe e përqafoi. Unë të kuptoj fill e mirë. Nuk jam si Berzati, e mbushun me gjemba...

Mbasi u kënaqën tue shikue pajën dhe u nginjën tue qeshë e mahitë, Berzati tha:

— Eh, tash pak ushtrim luftarak për shogën! Në këtë çerdhe këtu dhe jo vetëm këtu, duhet pa tjetër me ditë me qitë pushkë, me sulmue dhe me u mbrojtë, me u përleshë... Kjo, ta merr mendja, asht një lojë e egër, por çka t'i bajsh, kur kanë ardhë kohë të vështira.

E zonja e shtëpisë ju afrue dritares dhe, prej perdes së trashë nxori revolen e mëshehun dhe e vendosi mbi tryezë. Pastaj u kthye përsëri mbrapa dhe, prej një anës së tjetër të perdes, nxori një bombë dhe e vu mbi tryezë edhe ate.

Derisa bahej ushtrimi, Berzati i kreu do punë në dhomën e vet. Kur u kthye prapë, vajza merrte frymë thellë dhe dridhej nga pak. U shihte qartas se ishte bu-

kur e shqetësueme prej takimit të parë me armët e zjarrit. Berzati bani dy-tre hapa nga dritarja dhe u ndal. Mandej u kthye kah vajza dhe e këqyri në sy si të donte me zbulue diçka në shpirtin e saj. Dikur tha:

— Më duket së mirë po i ban ballë kësaj pune, shoqe, por megjithkëtë nuk do të shkosh në aradhë.

Ajo u shtang prej asaj kthese të papritun. Sytë e saj të mëdhenj flakëruen prej nji ndriçimi të mrekullueshëm, si t'i reshnin lotët.

— Domethanë se nuk i kam kushtet? — foli ngadalë me të dridhun.

— Nuk thashë ashtu.

— Atëherë, nuk po e kuptoj...

Berzati e shikoi edhe nji herë. I erdhi keq, por s'kish-te çka me ba tjetër. Këte duhej t'ja thoshte dikur, në mos sot — nesër.

— Nga ana jote i ke të tana kushtet, shoqe, por... rrethanat nganjherë urdhënojnë ndryshe. Prandaj, do të mbetesh këtu në qytet, në mbrapavijën e kundërshtarit.

Kaq — dhe duel.

E shoqja e Berzatis mbeti me te. Shumë kanë bisedue atë ditë. Vajza i tregoi edhe për vrasjen e të dashtunit te saj, me rastin e akcionit në burgun e spitalit.

«... Ai ka qenë andrra dhe zhgjandrra ime, rruga dhe udhërrëfyese im. Ndoshta i tanë fati im në jetë. Këtu gjindet edhe përgjegja e vërtetë e pyetjes së burrit tand, Berzatis, se çka më ka shty që u largova prej shtëpisë, tue marrë me vete edhe pajën time të vashënisë të pregatitun me aq kujdes e dashuni...»

Për ato pak ditë që kaluen bashkë, ajo fitoi aq besim dhe përkushtueshmëni ndaj grues, e nëpërmjet saj, edhe ndaj të shoqit, Berzatis, sa ju ba se tek ata gjeti shumë nga ato cilësi njerëzore, që i donte dhe i çmonte mbi çdo gja tjetër.

4

Prap natë skëterre dhe konspirative dimni... Nji dritare e errët përgjonte qorrthi në diagonale kah ana tjetër

e rrugës, në drejtim të shtëpisë ku banonte Berzati me të shoqen. Largësia — as njiqind hapa. Prej asaj dritareje, vajza, që një orë, shponte terrin me sy tue pritë ardhjen e Berzatit për me marrë udhëzime në lidhje me detyrën që i kishin dhanë. Kjo vonesë e tij i ndolli mendime të kobshme. Madje i shkoi mendja se i kishte ngja diçka. Diçka e tmerrshme, ndoshta ndër ma të tmerrshmet... Mu në ato mendime, ndëgjoi një pëshpëritje mbas shpine.

Berzati, tue folë me të vogël me tezen, hyni në dhomë. Mandej ju afrue dritares dhe tërhoqi perden e trashë. Vetëm atëherë u pa drita.

— Më fal, teze, se u vonova pa fajin tim. Ndodhi diçka e papritun e mandej... Po, ta lamë këte. Më duhet të kthehem shpejt.

— Rri pak, pash zotin!.. Përherë: më duhet kjo, më duhet ajo. Ngrina tue të pritë poshtë te dera.

— Ke të drejtë, teze, por kët herë, përnjimend, hiç s'kam kohë.

— Lene, lene, ndize një cigare dhe trego diçka. Ndoshta ka ndonji të re për Tushin tim. Natë e ditë frigothem për te. M'u kanë shpifë edhe do andrra sa... zoti m'i rrujtë mendtë.

— Ti mos ki aq shumë kujdes e mos fut hall për te. Ai patjetër duhet të jetë mirë, kur gjindet me pushkë në dorë dhe në mes të shokëve. S'ke pse të frigohesh kaq shumë. Ai nuk asht kështu si ne, që rrimë në mes të nofullave të ujkut dhe presim kur do të mbyllen ato dhe të na bluejnë eshtnat... Kryesore asht se për ate ende flitet se gjindet diku si rob lufte. Thonë se e ka pa njeni e tjetri... Kjo asht punë e mirë. E heq dyshimin prej shtëpisë. Por, hajt t'ja fillojmë punës — ju drejtue vajzës.

Berzati u çue dhe filloi me i endë sytë nëpër dhomë, tue u kujtue se ku e çka gjindet. Mandej u përkul kah dyshemeja dhe e çoi një dërrasëz.

— Këtu e ke, shoqe, ate kryesoren: maqinën e shkriimit... Dreqi kryesorja! As kjo nuk vlen pa tjetrën. E tjetra, pra, asht atje në mur. Mbas asaj fotografisë së varun. Atje i ke sumbullat e radios së murosun.

Vajza këqyri kah vendi i treguem.

Berzati mandej u drejtue nga skaji tjetër i dhomës dhe kapi një ibrik të madh bakri, të cilit ja shtrëngoi fundin me shputa dhe e ndau.

— Ky ibrik asht lidhja e vetme me botën e jashtme — shpjegoi. — Kur të marrësh lajmet radiofonike, do t'i shtypësh me letër kopjative dhe do t'i shtiesh këtu në fundin e dyfishtë. Mandej, si ta kesh bashkue mirë, do t'ja dorëzosh ibrikun kësaj tezes sime. Kështu çdo ditë e përherë, në të njejtën kohë. Ajo e din se çka ka me ba me te ma tutje. Në qoftë se të vjen ndonji porosi me anën e ibrikut, ban ashtu si të shkruhet aty.

Derisa ajo e ndigjonte pa i nda sytë prej tij, Berzati u rrotullue edhe një herë rreth vetes dhe i lëshoi një sy dhomës.

— Kështu!.. Tash e ke të qartë se ku gjindet çdo send dhe si duhet të punojsh. Besoj se s'kam harrue gja... Aha! Teze, ku janë letrat?

Plaka ju afrue një vendi të mështë dhe ja tregoi.

— Mirë, shumë mirë. Tash, mendoj, se çdo gja asht në rregull. Vetëm, shoqe, për gjithshka — përpikni absolute!.. Ndonjenit s'i mjafton me ja thanë edhe njëqind herë se sa e randësishme asht kjo, por... përpikni asht mbrojtja e vetme në këso punësh. Prandaj, kurrë me u dukë, shoqe!.. Posa të mbarojsh punë, gjithshka në vendin e vet. Të mos shihet kurrfarë gjurme në dhomë. Me kerrkend lidhje, pos me tezen. Në shtëpi s'ka me ardhë kush...

Vajza luejti kryet në shenjë se i kishte kuptue të gjitha.

— Kujtoj se tash asht thanë e tregue gjithshka. Po, dreqin! Nuk ta kam dorëzue listën me shënime për radio-stacionet dhe emisionet e tyne. Qe, merre! Por, mos mendo se kjo asht ndonji copë letër me shënime të parandësishme për policinë dhe të mundesh me e lanë ku të duesh. Posa t'i bajsh përmendsh shënimet — digje letrën!.. Kështu. Tash lamtumirë e ju la shëndetin, sepse ndoshta s'kemi me u pa për shumë kohë! Gjaset janë se ma në

fund do të më lejojnë që të shkoj në aradhë. Por, edhe diçka! A ke pasë deri tash ndonji emën ilegal, shoqe?

— Jo.

— Eh, mirë. Hajt, pra, zgjidhe një. Na duhet një ditë ndoshta.

Vajza u mat me kujtue diçka. Këqyri në tavan, mandej në dysheme. Ma në fund vetëm bani buzën në gaz.

— Nuk e gjete?.. Atëherë, pra, po e zgjedhim bashkë. Po e zamë: si e ka pasë emnin një grue bukuroshe, së cilës burri, në shenjë dashunie shumë të madhe, urdhënoi t'i ngriheshin do kopshte të varuna e të mreku-lueshme.

Ajo posa qeshi me një hije të dukshme turpnimi.

— Semiramidë! — u përgjegj ajo dhe menjherë e skajoi shikimin.

— Tamam!.. Por ti do të marrësh për vete vetëm gjysmën e parë të atij emni. Do të quhesh, pra, S e m i r a . Deri më sot je quajtë Igballe, tash e tutje Semira. Kaq, besoj, ka me qenë mjaft enigmatik edhe për hundën ma të rrekun policore.

Vajzës i qeshën sytë.

— ... E, a ka me të ndërtue ndonjeni edhe ty ndonjiherë kopshte me lule, këte do ta shohim një ditë, në qofshim gjallë.

Vetëm fotografitë të varuna nëpër mure nuk qeshën.

5

Edhe këte herë që natë, tashma natë pranverore. Plot yje dhe e butë. Vetëm Hana ishte vonue...

Automobili i policisë hyni ngadalë dhe dhelpënisht në rrugën e zbrazët, të errët e të ngushtë. Tue depërtue me një kujdes hajni, u ndal — tak, para shtëpisë së Berzatit. Në hapësinën e gjanë ende çohej vetëm gargaritja e bretkocave.

Në vetëdijen e Berzatit, zhurma e motorit depërtoi qysh kur automobili ishte në ecje, por prap nuk u zgjue. Këte e bani mu kur maqina u ndal dhe — vetëm pse u

ndal. A e njohin policët kët fenomen të çuditshëm, a thue?

Berzati nuk ju afrue dritares ashtu si bahet kjo punë zakonisht. Jo, ai kërceu shkathshëm nga ajo dhe përgjoi vjedhtazi. Nji grimë ma vonë, ai vishej dhe rrëmbente armët...

Prej automobilit policor duelën tre vetë. Ngadalë dhe me shumë kujdes. Njeni, që ishte me rrobe civile, bani pak përpara dhe zu pritë. Dy të tjerë ecën kah dera. Trokitën. Te trokitja e dytë dhe ma e fortë, u ndëgjue zoja e shtëpisë. Sa me fitue kohë, me qetësue zemrën dhe me përmbledhë veten.

— Kush po troket në kët kohë të vonueme?

Bashkë me thirrjen për me e çelë derën, çizmet e policëve u tërbuen tue i ra derës. Ajo ma në fund krisi dhe u hap krah më krah.

Ajo, prej shtratit dhe me të shpejtë u gjet pranë dritares, prej ku, si në ndonji andërr të keqe, dalloi njifarë pamje të shëmtuet: atje poshtë, përgjatë rrugës, në përden e dhomës së ndriçueme, ishte vizatue fytyra, sikur e grues së Berzatis dhe diçka si dorë me revole... Mbeti gojëhapët prej befasisë.

Tashma ajo u gjet poshtë në rrugë, e shqetësue me deri në damarin e fundit. Mu në ate çast disi, në shtëpinë e Berzatis u ndëgjuen bërtimat dhe krismat e revolverit. Tue mos pasë ma çka me mendue, ajo hudhi bombën në drejtim të automobilit policor dhe vetë shpejt u palue në tokë. Posa plasi bomba, ajo u hudh përpara. Në plumbat e agentit të mëshehun, edhe ajo, qetë, vrapon pa u ndalë... Diku te dera u pengue në diçka dhe u rrëzue. Revolverin nuk e kishte ma në dorë. Për ta gjetë, preku nëpër terr andej-këndej, e kërkoi...

— Semirë! — bërtiti grueja e Berzatis që e ndeshi.

— Si ke guxue me e lanë detyrën tande?! — bërtiti idhnueshëm Berzati. Mos je e plagosun?

— Jo, më ra revolja...

— Lene! — shtoi mandej dhe e kapi. — Shpejt me ne!

Rruga kumbonte butë nën kambët e tyne të zbathuna. Ndërsa kojshitë e trazuem mateshin me kuptue se çka

po ndodhej, ata i kapshin sekondat e fundit jetësore . . . Atje ma poshtë diku, qiti pushkë dikush. Berzati ju përgjegj. . . Tash duelën në rrugën trup. Mandej shpejt në tjetrën. . . Ma në fund u zhdukën prej vendluftimit e ranë poshtë kah një shtëpi e njohun. Atje u ndalën, u mbushën me frymë, dhe të ndërruem tanë sy e veshë.

— Kërceni! — i urdhnoi Berzati dhe nisi me u ndihmue. Shpejt, shpejt! . .

Kur i vendosi në anën tjetër të murit, ngau si shigjeta kah lumi. Tash i dukej si të fluturonte, si të mos prekte në tokë. . .

Në bregun e lumit u ndal. U kthye rreth e rrotull, mbajti vesh. Aty edhe e pa se ishte plagosë, se po i pikonte gjaku edhe prej kreje, edhe prej dore.

Diku larg, jehoi një krismë e vetme. Mandej një raketë e bardhë e shëndriti qiellin. Ju ba se diçka po kumbonte rrugës, diçka si trokitje këpucësh ushtarake në vrap. Ndjekja! . . i vetoi në krye. Mu në at çast zhveshi shpejt setrën dhe e hudhi kah rryma e lumit. Vetë mandej u zhyt buzë bregut, tue i mbajtë me të vështirë plagët mbi ujë. Ndërsa ai tërhijeq ngadalë lumit përpjetë, ndjekja ngutej lumit teposhtë tue mbulue me zjarr setrën e tij që notonte.

6

Shefi ende mendueshëm nëpër dhomë. Mandej ju afrue tryezës dhe e këqyri edhe një herë letërzën e kapun. Muer lapsin e kuq dhe nënvizoi diçka. Ma në fund ju drejtue ndihmësit:

— Ju, sigurisht, e keni vu re këtë vendin këtu, apo jo?

— Po, zotni shef! . . Asht bukur interesant.

— Çka mendoni, në qoftë se kanë shënue diçka me «*ibriku dy*», a s'asht e logjikshme atëherë që të ekzistojë edhe diçka që e kanë shënue me «*ibriku një*»? . . Ndoshta edhe me «*ibriku tre*» e kështu me radhë?

— S'ka dyshim, zotni shef.

— E çka i thoni ju kësaj këtu: a thue asht fjala për persona apo për ndonji send krejt tjetër?

— Nuk kisha mundë me e thanë me aq siguri, por... kam përshtypje se do të jenë do sheja për punkte, ndoshta.

— Përgatitni shënimet e duhuna për rrjetën civile dhe jepjuni njerëzve instruksione për në atë drejtim! — përfundoi shefi. — Por... rezultatin nuk mundem me e pritë ma shumë se tri ditë.

— Si urdhënoni, zotni shef! — ja ktheu ndihmësi dhe humbi për derë.

* * *

Ditë vere, plot diell dhe e nxehët. Fëmijët luejshin rreth shatërvanit të madh, tue stërpikë njeni-tjetrin dhe tue klithë prej gëzimit. Ndonji grue kalonte me enët e ujit, idhnohej me fëmijët ose ndërronte ndonji fjalë me të njohunat. Mandej prapë mbeteshin vetëm fëmija dhe uji i shatërvanit. Nji lojë e hareshme dhe pikat e ujit në diell.

Në ambëltoeren, matanë rrugës, qëndronte nji njeri me moshë mesatare, tue u flladitë me pije e tue shikue kah rruga me nji palë sy që gjurmojnë tinzisht dhe kërkajnë në mënyrë të mbështjellun, pa u vu re.

Atje në rrugë, shkeptonte nji grue plakë. Me te ecte nji çunak. Të dy mbanin nga nji ibrik në dorë. Të dy ibrikët njisoj, të bakrit dhe të ndritshëm. Dalëngadalë edhe ata ja mbërrinë te shatërvani.

Po në kët moment, agjentit i ndriti mendimi për diçka.

— Shiko, kend e thirrin këtu «Ibriku nji» e kend «Ibriku dy»? — pyeti ambëltarin papritmas.

Ambëltari i hutuem vetëm e këqyri. Mandej hudhi nji shikim mbi tryezat e thata, tue kërkue ndonji kuptim për atë pyetje të çuditshme. Ma në fund rrudhi krahët:

— Më falni, zotni, por nuk po e kuptoj se çka po pyetni.

— Mirë, s'ka gja! — u tërhoq me dinakëri spiuni. Sa kam me pague?

Ambëltari e muer bankënotën dhe i ktheu kusurin. Agjenti menjherë u çue dhe shpejt duel përjashta. «Njeri i krisun», mendoi ambëltari tue i shikue shpinën.

Plaka, ajo tezja e Berzatit, ju afrue ujit. Çunaku, mbasi ja dorëzoi ibrikun e vet, u nda dhe u përzie në lojë me moshatarët.

— Ndëgjo, ti, vocrrak, kush asht në mahallën tande «Ibriku *nji*» e kush «Ibriku *dy*»? — e pyeti ambël njeriu dinak.

— Nuk e di, mixhë, se kush asht *nji* e kush *dy*. Të *dy* janë *njisoj*.

Agjenti nuk qëlloi aq mendjehollë për ta kapë fijen e lamshit, të cilën padashtas ja ofroi vocrraku. I ra vetëm me gisht dhe shkoi. Çunaku mbeti i habitun me veshin e skuqun në shuplakëz.

Plaka i mbushi enët dhe u drejtue kah shtëpia, si çdo ditë, si çdo herë në të njejtën kohë.

— Ama tash ibrikun tim! — ja kërkoi çunaku.

— Po e baj edhe pak dhe mandej ta jap. Mos të lodhesh tepër.

Disi bukur të papritun, nëpër qytet u çue britma e sirenës për alarm. Njerëzit u shqetësuen dhe shpejt filluen me ikë. Edhe plaka u mat me nga në shtëpi, por nuk i shkonte.

— Bir, merre enën tande dhe ikë! — i tha e shastisun.

Por, posa ja dha ibrikun, e qortoi veten:

— Ndal, biro, se jam hutue!.. Ky asht tandi e jo ai. Po, po, ky... Hajt tash, nga e mos më prit mue!

Plaka sot, për të parën herë, bani gabim me ibrikët *nji* e *dy*.

Skuadrila sulmuese bubulloi mbi qytet dhe e mbuloi me zjarr. Mbas kësaj, pllakosi qetësia, paqa. Dikur u ndigjue prapë sirena. Këte herë ndryshe, me të preme. Sulmi, pra, kishte kalue.

Gjatë asaj kohe të shkurtë, plakës, tue nga për në shtëpi, i ra të fikët në rrugë dhe mbet aty. Pranë saj, hapej i ndamë, fundi i «*ibrikut nji*», prej të cilit shiheshin letrat. Aty, mbi sheshin e gjanë të qytetit, para syve të botës...

Nji natë ma parë, Semira pat andërrue nji farë ylli të madh të praruem e të ndritshëm në qiell. Kishte shtri duert kah ai, kishte nga mbas tij si me dashtë me e mbërri, me e marrë në duer. Por ylli kishte ikë, ishte largue shpejt në hapësinë e paanë. Edhe Semira kishte fluturue mbas tij, gjithnji ma larg, gjithnji ma nalt. E magjepsun, e dalldisun... Ma në fund, ylli i andërruem ishte zhdukë pa e mbërri. Sot edhe ajo vetë asht zhdukë. Asht zhdukë me të gjitha andrrat e saja, me ato të natës dhe ato të ditës. U zhduk përgjithmonë, sikur të kishte qenë edhe ajo vetë nji andërr...

1956

NGRICE

Asht luftë. Luftë e madhe në botë. Terzija Ndoc Anton Hili shërben tash si ushtar nëpër fronte tue besue me të madhe se po lufton për një çeshtje shumë të drejtë. Kurse gjatë asaj kohe, grueja e tij, e vetme dhe ndër të huej, kacafytej me jetën për me mbajtë gjallë katër fëmijë të njomë. Ajo mundohej prej mëngjezi deri në mbrajmje me u nxjerrë kotheren e thatë. E pamësue me në vujtje të tillë, herë-herë i kisha ra të fiktë. Fëmijët e saj, të frikësue me sa s'ka, dy herë deri tash e kishin çue e shkëndë prej podi... Kishin qa me këtë rast, kishin qa idhshëm.

Për me ja lehtësue sadopak, dy fëmijët ma të mëdhej u shoqnuen me fëmijët e tjerë të mëhallës dhe filluen me u endë nëpër kazermat ushtarake me qëllim që të afroheshin deri te kazerat në kohën kur u ndahej ushqimi ushtarakëve. Me mbërri deri atje donte me thanë me nxjerrë diçka. Me çue në shtëpi të paktën një copë bukë, në qoftë se jo edhe pak gjellë. Po, por kjo s'ishte punë e lehtë. Të ndalojshin rojet që ishin shpirtgur. Prap, mund t'ua hedhësh, ashtu si edhe këta fëmijë ua hodhën një ditë.

Tue u endë rreth e përçark, ata gjetën një vrimë në mur. Ishte afër toke, por bukur e ngushtë. Shërbente si kalesë, kur bijshin shina të mëdheji. Megjithkëte fëmijët i ranë në fije. Ja hynë dhe e zgjanuen dhe kështu mundeshin me përbirue lehtë nëpër te. Tinëz dhe pa farë mudi mi futeshin në rrethin e kazermës. Për mos me u zbulue, nuk ktheheshin kurrë të njejtës rrugë. Shkojshin deri te një nga tri dyert, ku roja, tue u britë, i përzente jashtë

e njiherit çuditej se si futeshin aty e kush i lejonte me hy brenda. Fëmijët për kaq s'çajshin krye. Kur dilshin, qeshnin me të madhe. Por, jo gjithmonë. Kur rastiste të ktheheshin duer e enë thatë, nuk u qeshej. Atëherë dukeshin të mërzitun, madje edhe të piklluem.

Gonxhja, megjithëse nuk ishte mësue, i bante ballë me zemër punës së tepërt dhe të mundimshme, edhe pse haptazi shihej se po dobësohej nga trupi. Ma në fund u sëmue në mushkëni dhe shpejt vdiq. Sa pikllim! Sa goditje e madhe për fëmijët e njomë! . . . Por ky detal i vocërr i një lojë të amëshueshme, ta merr mendja, nuk ndryshoi gjë në botë. Njerëzit vazhduen edhe ma tej me u thërë apo me u gazmue. Me ba qejf apo me vuejtë. — S'u ndryshue gjë as për një qime. As dielli, ta merr mendja, s'pushoi së ndriçuem, e as yjet s'u shuen. . . Vetëm fëmijëve të saj u ndryshoi diçka. Atyne pushoi t'u shkëlqejë diçka, ju terrue përgjithmonë.

Miqtë e dashmirët e Ndoc Shkodranit e përcuellën të vdekunën deri në varr. E varrosën dhe shkuen nëpër shtëpia. Ata ma të ngushtët i muerën fëmijët pranë tyne, derisa t'u kthehej i ati, të cilit i çuen menjherë letër. Kur i shkruen gjithshka asht zakon në këso rastesh, shtuen: «. . . Ne as për fëmijët tanë s'kemi sa duhet, prandaj, ban si të bajsh e kthehu me i mbledhë.»

Ai ishte vullnetar dhe s'e lëshonte vendin për kurrëja në botë. Mendoj e çmendoj dhe ma në fund vendosi me kërkue vetëm një transferim të shkurtën. Këte ja dhanë e ai menjherë erdhi. I mbledhi fëmijët, i vendosi në shtëpinë e vet dhe i rehatoi. Kaloi do ditë me ta dhe u kthye në kazermë. Mbasi ishte i ardhun në at vend e s'kishte kend të afërt, la pranë fëmijëve një plakë, sa të mos frigoheshin natën. Por, plaka gati s'ishte për kurrëja. Dehej simbas adetit, dhe tevona iku. Fëmijët mbetën prap të vetmuem, sepse ai vetëm ditën vinte nganjherë te ata. U sillte bukë dhe u rregullonte shtëpinë. Mësonte Marijen, vajzën e vogël për këte ose at punë dhe shkante në kazermë.

Shtëpia e Ndocit ishte e ulët dhe e vjetër, por shumë e rehatshme dhe në vend të mirë. Megjithëkëte kthi-

nat e saj të mëdha nxijshtin tash si shpella të vërteta. Prej tyne frynte diçka e ftohtë dhe e frikshme për fëmijët. Ndërsa kur hecete dikur e ama nëpër to, kur ajo, tue rregullue shtëpinë i thirrte orë e çast ose i qortonte, i mësonte dhe i ushqente, i vinte në gjumë me kangë dhe i ruente. . . ato kthina ishin të dashuna dhe të stërdashtuna. Po tash? Tash u bahej me ikë prej tyne. Me ikë kah sytë kambët, vetëm mos me qenë aty, në to.

Kur u ngrysën fëmijët për herën e parë vetëm në shtëpi, ranë posa u err, tue u rrasë ngushtë njani me tjetrin. Për me e reshtë frikën, vunë te kryet një shkamb e mbi te llambën e ndezun. Drita do t'i mbronte prej territ dhe vetmisë së tmerrshme. Kur u lodhën në at ankth frike, i mori gjumi i ambël fëminor. Atëherë nata nuk i mundonte ma. As heshtja e as errësina e saj. . . Ata tash, tue marrë frymë thellë, andërrojshin. Andërrojshin — dikush nanën, dikush bukën në dorë.

Marija ishte ma e madhja. Në përkdhelje e thirrshin Beba. Me moshën e saj tetëvjeçare bukur mirë e mbantë barrën e kujdestarit të shtëpisë. Ajo u zgjue e para në mëngjez. Mbas saj, Matea, i cili posa kishte nisë të ecë. Atij i duhej kujdes. Menjiherë filloi me kërkue dhe lypë diçka. Ajo e qetësonte ngadalë dhe shpejt u çue prej shtrati. Mbasi u vesh dhe u la, ju afrue shporetit dhe nisi me punue diçka rreth tij. Ma në fund përgatiti dhe mëngjezin mu ashtu si e kishte mësue i ati. Mandej, kur shpejt u çuen, edhe fëmijët e tjerë u rreshtuen të gjithë rreth shporetit. Lyheshin mbas së motrës, si dikur mbas së amës.

Kur e mbaruen mëngjezin, filluen të sillen sa majtas, djathtas, tue ndie një zbrazëtinë të pakufishme. Për lojë as që u shkonte në mend, sikur të mos kishin ditë për te. Ma në fund, mbas një endje të gjatë nëpër dhomë, Nikolla kapi shkambin dhe e afroi pranë dritares. Si të ishin marrë vesh, të katër u gjetën menjherë mbi te. Tue i hapë sytë nëpër dritare, pritën shumë t'u vinte i ati. Pritën e pritën dhe ma në fund i kapi një brengë e madhe.

— Ejani të shkojmë te nana! — ja bani Petriti për-vajshëm.

Në ato fjalë të tija fare të paprituna, fëmijët u shikuen një grimë pa ba za, çuditshëm. . . Prap, ajo që tha ai tash, u duk si të kishte qëllue mendimin e të gjithëve. Ate mendimin ma të bukur, i cili kishte mundë me u vetue ate çast. Mbasi ndërruen shikimet, pa folë, dhe sikur të ishte marrë vendimi, u kapën përdore.

— Po shkojmë! — u pajtue Marija dhe i tërhoq.

Fëmijët tashma ishin në rrugë. Dita e bukur plot diell dhe mendimi se po shkojshin te nana si t'ua çilte fytyrat. Tue u mbajtë përdore, ashtu si edhe ishin nisë, kalojshin gjallnisht nëpër rrugët e shtrembta. Por, kur mbërrinë në të dalë të qytetit, hasën në një njeri me moshë mesatare, që ishte i njohun i atit tyne. Ai i këqyri përkëdhelshëm dhe i pyeti:

— Ku po shkoni, fëmijë?

— Po shkojmë te vorri i nanës! — u përgjegjën njëzani.

Njeriu, njëherë u çudit. Mandej u pikëllue, e ma në fund luejti kryet dhe ofshani mbytas. Kurrëgjja s'mundi të fliste prej befasisë. Vetëm vazhdoi rrugën dhe vijoi të mendohej.

Ata kaluen bukur do orë në varrin e së amës. Në ate harresën fëminore, punojshin gjallnisht tue rendue guraleca rreth varrit. Shkulshin barishtet e këqia dhe rrafshojshin dheun me duert e njoma. . . Nganjherë edhe haheshin për ndonji guralec që i dukej ndonjanit prej tyne se nuk ishte aq i bardhë e i bukur sa të meritonte me u radhitë në varg. Ndërsa koha rrëshqitte pa u hetue, ata habiteshin rreth varrit, tue ndie njëfarë lehtësie, diçka që të përkëdhel dhe të mbron. Diçka që asht, që asht. . . si nana. Por, kur dita u tret bukur shumë, Marija erdhi në vete menjherë.

— Ejani në shtëpi! — tha e shqetësue. Vjen baba. . .

Si të ishin ba të vetëdijshtëm për këte, menjherë u kapën përdore dhe u nisën. Kur mbërrinë në të dalë, u ndalën një grimë dhe shikuen edhe një herë vargun e bardhë të guralecave rreth varrit. Ndien njëfarë gëzimi për te. Njëfarë gëzimi naiv fëminor, prej të cilit ju përflakën fytyrat. Mandej u ngutën. I shpejtuen hapat me një

shpresë mashtruese se do të mbërrijshin me kohë në shtëpi. Por i ati kishte shkue. Këte e muerën vesh prej bukës ushtarake që gjindej mbi tryezë, rregullimit të dhomës së druve të çame... Përnjimend i kishte pritë mjaft. I kishte pritë dhe ishte çuditë se ku mund të kishin shkue ashtu.

Ate ditë fëmijët hangrën drekë e darkë bashkë dhe, kur ra së shpejti edhe terri, ata ishin në shtrat. Si edhe mbramë, ranë plot frikë prej natës e errësinës. Prandaj llamba nderi prapë ndezë mbi ndenjësen te kryet. Ata prapë u strukën dhe u rrasën te njëni-tjetri dhe i mbuluen edhe krenët. Mandej kaloi edhe kjo natë. Kaluen kështu edhe shumë net, kurse ata nuk mundshin kurrësesi me u mësue në terr e në vetmi. Madje prej frigës së madhe filluen ma në fund me dyshue se po ndodhte diçka nëpër shtëpi. U bahej se po ndëgjojshin dofarë zanesh në mesore, diçka si ofshame e dënesje të mbyytuna. Në ato orë të vona nate ndëgjojshin edhe do shushurima, madje edhe hapa. Nji herë, edhe pse dritaret dhe dera ishin mbyllë mirë, fryni diçka aq fort, sa u shue edhe llamba mbi ndenjësë... Fëmijët atëherë, prej frigës së madhe, u rrasën edhe ma shumë njani te tjetri, dhe e tërhoqën mbulojsen edhe ma tepër mbi krye. Vetëm gjumi i shpëtoi prej asaj frige të natës.

Mbramë prapë ndodhi diçka. Ndihej sikur diçka trokitte me kambëngulje në xhamin e dritares. Natyrisht edhe mendja e tyne filloi të punojë. Si për çudi ato për herë të parë tash vendosën me u çue e me këqyrë vendin e dyshimtë. Kështu, mbasi pëshpëritën gjatë nën mbulojë, si nji, kërcyen në kambë. Mu në ate çast, Marija e largoi nji arkë që zente nji pjesë të dritares. Nikolla sakaq afroi llampën. Për befasinë e tyne të madhe matanë xhamit panë nji zog të zakonshëm.

— Zog! — thirrën të gëzuem. — Zog!..

Ai i pupruem në qoshe shikonte sytë e fëmijëve. Por, kush e din se pse, zogu as nuk u mat me ikë. Madje as atëherë, kur llamba dhe duert e fëmijëve u gjetën mu afër tij, ngjitun në xham. Tue pa këte, fëmijët menjherë hapën dritaren. E futën zogun brenda dhe u vunë me e

shikue dhe përkëdhelë. Mbasi e mori çdonjani prej tyne dhe e fërkoj në faqe, e vunë në një vend të përshtatshëm dhe ranë. Moti nuk kishin fjetë kaq qetë si ate natë, kur kishin në dhomë edhe zogun.

Por terzia Ndoc Anton Hili, tash ushtar i garnizonit të vendit, gjithnji e ma vështirë mundej me ardhë te fëmijët, me i mësue, trimnue, me u rregullue shtëpinë, me u pru ushqim. . . e shi me këtë ushqim shkonte puna ma keq. As huatë, as shitja e herëpashershme e sendeve të shtëpisë nuk mundën me e sigurue ushqimin ma të thjeshtë për fëmijët. Ndërsa ata s'dijshin tjetër pos me tërheqë mendjesen afër dritares, me u rreshtue mbi te dhe me shikue rrugës kah do të vinte ai. Tue u gjetë në një ngushticë të këtillë, ai filloi me e mbyllë bukën dhe me u dhanë vetëm nga një sasi të caktueme. Buka kështu u vu ndën çelës, po uria? A mundet me u kyç uria? . . . Ai e dinte mirë këte marri, ta merr mendja, por a mundej me ua shpjegue fëmijëve se çka asht lufta dhe pse nuk ka bukë në botë?

Uria i shtyni fëmijët një ditë në rrugën e ndërmarrjeve të veta. Ndërmarrjet e para të tyne filluen me të lypun. Kjo u dukej disi ma lehtë, edhe pse vjedhja u bahaj se ishte ma pak poshtënuese se ajo trokitja lypsake nëpër dyert e hueja. Por, pa marrë parasysh se në to kundërshtonte ajo ndjenjë e turpit dhe e krenisë së mbrendshme të njeriut, ata nën shtytjen e pamëshirshme të urisë, prap i afroreshin ndonji shtëpie.

— Trokit! — ja niste ndonjeni prej tyne.

— Nuk due, trokit ti!

— Le të trokisi Petriti, atëherë! — përzihej tjetri.

— Jo, unë, jo. Nuk due.

Ma në fund dora e njenit zgjatej me trokitë, por prapë tërhiqej. Nisnin me u hangër edhe.

— Mirë, po ja bajmë kështu: Beba le të trokisë, kurse unë po flas.

— Jo ashtu por, ti trokit kurse unë po flas.

— Nuk ban ashtu. Ma mirë le të trokisë Beba, kurse Nika të. . .

— Nuk due, nuk due! . . .

Qysh në fillim luhatjet e këtilla zgjatshin shumë. Nganjherë shkonte aq gjatë sa ma parë qëllonte të vijë ndonji i shtëpisë e t'i pyette çka dojshin, se sa të vendosnin se kush do të trokitte e kush do të flitte. Ndodhte edhe ajo që, mbas një të hanguni e të matuni të gjatë, të largoheshin prej derës së ndokujt pa trokitë fare.

Kaloi kështu do kohë e atëherë filloi edhe ndërmarrja tjetër. Nji ditë në krenët e tyne lindi idea për inisiativën e re. Mandej u muer edhe vendimi. Ata kishin vu re se çdo mëngjez, në të aguem, para shtëpisë së tyne kalonte qerrja ushtarake plot arka me simite. Mbasi biseduen pak për këte, i dhanë fund se ato i merrnin prej furrës aty afër dhe i çojshin në kazermë për oficerët. Menjherë u ba dhe plani i akcionit. Mëngjezin tjetër, pikërisht në ate kohë, Nikolla me Marijen do t'ja behshin në furrë dhe do të bajshin çka t'u vinte përdore për me rrëmbye prenë. Mbas nji vendimi të këtillë, fëmijët, nga nji anë prej shqetësimit dhe nga ana tjetër prej pritjes së dëshirueshme të simiteve të nxehta, shumë pak fjetën ate natë. Para se me ague, Marija i pëshpëriti Nikollës:

— Ndoshta qerrja ka kalue e na s'e kemi ndëgjue.

— Jo, jo, unë kam përgjue! — ja ktheu ai i përgjumshëm.

— Edhe unë kam përgjue, por tash del dita. Ma mirë të nisemi përnjiherë.

— Vetëm edhe pak... Po më flihet shumë.

— Jo!.. Po deshe tash, mirë, po s'deshe, atëherë...

Nikolla, tue mendue se ajo mund të pendohej e mandej të prishej e tanë puna, kërcëu fill në kambë dhe nisi m'u veshë. Kur duelën në rrugë, ishte ende natë, por në prag të agimit. Tue e përzanë gjumin me të fërkuem prej syve, mbërrinë shpejt pranë furrës. Posa u afruen, vunë re se aty ishte ajo qerrja e njohun. Domethanë se ajo kishte ardhë disi pahetueshëm aty dhe ushtarët punojshin diçka rreth saj. Sillshin kanistra plot simite të nxehta dhe mbushnin arkat me brumin e posapjekun, i cili përhapte rreth e rrotull nji aromë shumë tërheqëse.

Mëshehtazi dhe me sy shumë të hapun Nikolla dhe Marija, pa u hetue, u shtynë deri në vendin ma të për-

shtatshëm. Mandej vëzhguen me kujdes dhe çmuen çdo gja. Nji arkë ishte mbushë ma, këte e vërtetuen lehtë. Dy hije ushtarake zbrazën kanistrat e tyne në arkën tjetër dhe u kthyen edhe nji herë në furrë me hapa të përtueshëm tue e përrakllisë diçka.

«Tash» depërtoi nji za i padëgjueshëm në kryet e Nikollës, dhe ky kërcëu si maca në qerre. Pa e zgjatë asnji grimë, mbas tij ngau edhe Marija. Të dy sulmuen në simite. I rrasnin në xhepa, në gji, në duer. I rrasnin me nxitim, pa u ngi! U dukej gjithnji se ishin pak, dojshin edhe ma, edhe ma. Por çastet largoheshin, ikshin. Rreziku ishte afër e ma afër, gati ishte mu aty. Ata, megjithate rrëmbejshin, rrëmbejshin... Si të ishin magjepsë prej ngrohtësisë së simiteve, nuk mundeshin me u largue prej saj. Nuk mbërrijshin me u largue mirë e mirë e mandej me u dhanë kambëve sa s'ishte ba vonë.

Në derën e furrës u dukën prap ushtarët me kanistrat e tyne. Po në at çast, fëmijët u lëshuen si hije në tokë. Mandej u kërrusën pak dhe shpejt u lëshuen ashtu dathun nëpër gjysmëterrën e hollë të mëngjezit.

Ndërsa agimi shkrepse ngadalë, katër fëmijët e Ndoc terzisë përtypshin pangopshëm kafshatat e simiteve të bardha. Për ta lindte një ditë që mbahet mend. Kjo i jepte disi zemër. U kallte dëshirën se prapë mundeshin me mbetë gjallë. Se mundeshin me depërtue në jetë, me qëndrue ne te. Por, vetëm, në qoftë se rrinë njeni bri tjetrit, në qoftë se kujdesen, ndihmohen...

Ndërmarrja e tyne e dytë qe prap sulmi për ushqim. Endeshin nëpër rrugë, tue u mbajtë përdore. Në nji çast u ndalën para nji dere gjysmë të hapun. Njani prej tyne u përkul dhe përgjoi në oborr. Shpejt mandej, si të kishte vëzhgue ndonji send shumë të mirë, u rras edhe ma tepër kah dera.

— Atje po tymon diçka! — pëshpëriti ma në fund Petriti.

— Ç'ka tymon? — pyeti Marija dhe u afrue edhe ma.

Mbas saj u afruen me përgjue edhe të tjerët. Të gjithë me radhë u banë rrodhe në derë dhe i ngulën sytë në

hajat. Atje përnjimend avullonte një tenxhere xinku prej së cilës dukej bishti i goruzhdës.

— Kaçamak! — bërtiti mbytzazi Marija dhe këqyri të tjerët. — Kaçamak tue u ftohë!..

Fëmijëve tue e soditë prej larg, u dukej se po ja ndjeshin edhe shijen. Ju ba mandej se edhe shijen e kishte shumë të lezetshme. Ata të kapun prej kësaj ndenje pothuajse u ngjitën për derë.

— Ta marrim! — propozoi guximshëm Nikolla.

Ndërsa sytë e untë femënorë e shprehnin pajtimin e tyne vetëm me të hapun, Nikolla u rras brenda. U afrue shpejt e shpejt dhe e rrëmbeu tenxheren në dorë drejt në shtëpi. Mbas tij u lëshuen edhe dy të tjerët tue ngrehë me të vështirë ate ma të voglin.

Kur u grumbulluen të gjithë, tenxherja avullonte mbi tavolinën e tyne në kuzhinë. Ndërsa, tjerët kërcëjshin rreth prej haresë, Marija e gëzueshme e ndante nëpër çanakë. Mandej filloi gostia tue i fry kaçamakut e tue bisedue gjallnisht. Tash secili kishte diçka me thanë. Dhe, mbasi u rrasën mirë me kaçamak, doli një punë e papritun.

— Kush do ta kthejë tenxheren? — pyeti Marija tanë dert.

Kurrkush nuk mendonte se pse duhej të kthehej tenxherja pa tjetër. Duel që ajo duhet të çohet atje ku u muer. Se kjo ishte diçka e natyrshme që s'mund të shki-let. Megjithëkëtë ata u hangrën mjaft rreth çeshtjes se kush do ta bante këte pjesë jo interesante të punës. Në këte e sipër edhe nata qasej ngadalë. Ma në fund vendosi Marija me e krye. Rrëmbeu tenxheren dhe ngau. Atje këqyri mirë rreth e rrotull dhe një grimë ma vonë ju afrue hajatit. Tenxherja e lame bashkë me goruzhdën në te rrinte tash mu në vendin prej kah u muer.

Marija turrevrap u kthye, kurse e zoja e shtëpisë çuditej se prej kah e si ja mbërrini tenxherja aty, kur njëherë ishte zhdukë ma. E habitun dhe e shastisun, grueja t'ja nisi një morie fjalësh fetare tue ju kujtue mirë se si pak ma parë kishte sha e namë aq tepër vjedhësin që t'i bahej haram çdo lugë kaçamaku që të hante. Tash tanë

kjo punë për te doli shumë e çuditshme, e mëshehtë, madje edhe e lidhun me fuqitë qiellore.

«... Këte vetëm engjëjt munden me e ba, shpirti im mëkatar! Vetëm ata janë kështu të padukshëm, kështu të mirë. Mandej kush tjetër e kishte pastrue dhe kthye tenxheren, kush? Kush pos tyne!?. Këtu kam qenë, këtu nëpër shtëpi dhe s'kam pa e as ndigjue gja. Po, po, vetëm engjëjt kanë qenë. Ato krijesa të buta dhe të hyjnueshme... Vetëm ato munden me e ba këte. Ato e kurrkush tjetër!»

Të ngimë dhe tue e ndie veten mirë, fëmijët e Ndocit këte herë nuk ranë me fjetë me terr. Tue folë e tregue, harruen dhe nuk ju kujtue menjherë friga prej natës dhe vetmisë. Po edhe zogun e vet nuk e kanë harrue. Edhe ate e kanë ngi, si jo.

Paloheshin kështu ditët njena mbas tjetrës, vargoheshin vjetët. Në varrin e nanës shkohej gjithnji ma rrallë, gjithnji ma pak kërkohesh ngushëllim atje. Duert e vogla u banë tash ma të mëdha. Ato nuk shtrëngojnë ma njena-tjetrën aq fort, sa ma parë. Vdiq mandej edhe baba i tyne, Ndoc Anton Hili, terzi nga Shkodra i cili me aq mjeshtëri i zbukuronte dikur petkat e pasanikëve, tue i qëndisë me pe ari dhe argjendi, me pe mëndafshi të çdo lloj ngjyre. Fëmijët u banë tashma burra. Jeta atëherë i shkapërderdhi nëpër botë, i ndau njenin prej tjetrit, i ftohu.

Sot, kujtimet ma të afërta të tyne janë ato prej kohës së ngricës. E, kur u kujtohen nganjherë, fillojnë me qa. Me qa pa za, mëshehun, në thellësi. Njerëzisht me qa.

1951

NISHANI I GURBETQARIT

Nakja atë natë, mbasi i kreu me rend punët e shtëpisë, u qiti gjave, pulave ua mbylli qymezin, dyerve ua vu shulat përmbra. . . , ra bashkë me vëllaun e vogël në një shtrat. U shtri në kokërr të shpinës dhe e shtrëngoi sherveten mu nën fytyrë.

Disi të rrëmbyeme prej zjarrmisë nuk e merrte gjumi. Vërtitej prej njenit krah në tjetrin. Asnji natë ma përpara s'ishte këndellë si tash. Faqeve të bufatshme i fërfëllonte ajo flaka shqetësuese, që dukej se shkon bashkë me gjakun prej majës së kresë deri në fund të kambëve. I vlojshin në shpirt dasmat e fshatit, e bashkë me ato edhe dajret, lodrat, britmat. . . Andërronte veten si nuse në krye të vendit. . . I fuste dy duert e veta topolake nën këmishë dhe, ngadalë, i kapte tollumbat e gjive. I shtrëngonte thimthat mu në majë me të dy gishtat. . . Ma përpara shtrihej si top sheqeri në shtratin e leckosun dhe, menjherë, e merrte gjumi, por tash, jo besa. Nji zabullinë tinzake i lëpihej nëpër krahanuer dhe e bante mos me shti pikë gjumi në sy. Pra, si në lentë, i përfytyroheshin të gjitha takimet me Hasanin. Disi, si me dashje, dëshironte t'i ketë të gjitha kujtimet aty turrë dhe të ngrohta. Kështu, vetëm kështu, e ndjente veten ma të lumtun dhe të qetë. Jetonte me ato dhe i përziepte si fijet e çarapit me të dy duert. . .

Në grilën e dritares, të zanun me letër të bardhë, tropolloi një majë pardine. Ajo brofi tue ja mbulue kryet vëllaut me çipin e jorganit. U ngjesh mirë dhe, kambë mbas kambe, doli jashtë kah pojata me kashtë thekne.

Nata ishte sterrë. Qentë e fshatit në të katër anët ulëritshin.

— Nake — u ndie një za i butë.

— Pësst... Erdha — ju përgjegj ajo.

— Ku? — shtoj zani.

— Te gardhi i pojatës.

Ai, Hasani, u drejtue kah pojata tue u ndalë në çdo dyrek që të mos binte në kurth bashkë me Naken. E dinte se fshatarët i kanë rrebet si brina dreqi, dhe mos u rafsh në dorë për këso punësh, se shkon si qeni në rrush.

U mbështet në tallën e kashtës dhe gërshanët e dhenve, që i mbante mbas shoqe, i futi në palën e brezit.

— A i ka zanë gjumi? — pyeti.

— Baba gërhet, po njerka... S'di!...

— Atëhere ulu që aty në kashtë dhe mos ban ciau!

— Jo, s'due. Do të rri në kambë.

— Po... çka të gjet sonte që e ke rritë inatin si mushkë?

Ajo qeshi përvjedhtas. E shtrëngoi tojën e skutaqes dhe, tue e thye belin, ju avit deri në majë të hundës.

— Mos u hangariz, se edhe sonte jemi... Mandej, ti e di.

Ajo e uli kryet dhe ofshani pa ju përgjegjë.

— A e di, a jo!? — ngurroi ai me pyetjen e parë.

— E di, e di, plasja i raftë atij shkretshi... Më duket si gjarpën përpara sysh.

— Kur do të kthehem, çka dëshiron të të bie? — pyeti ai.

— Kurrnja s'due! — tha.

— Kurrnja, hiç kurrnja?! Si ta nxe goja?

— Due që ti të kthehesh shëndoshë e mirë, për të tjera... pse janë duert?! Do të hakatim natë e ditë dhe do të fitojmë një krodhe bukë.

— Nake, mos u marro! Thuej çka të të bie?

— Të më biesh... një palë krrabëza, që çarapat e dhandërrisë t'i thur me telatina, me mjedis, dhe një gjylpanë për ojme.

— A kaq?

— Kaq.

— Do të bie edhe një fyshek sheqerna të shkrueme prej gurbeti. — Ajo qeshi prap.

— Sa ambël qeshesh. E ambël je si buka e grunit — i tha dhe e kapi për duersh. Ajo u zmbrops.

— Nake, pse sonte të kanë hy orët?

— Mos më prek, të lutem!

— As dorën, as majën e gishtit?

— Hiç, hiç. As dorën, as majën e gishtit. Ate natë tek arra, kur i pritshim dhentë, m'i shtrëngove duert si me dana dhe... Vajza nuk preket deri kur të hyjë në shtrat me burrin e vet, deri kur të lidhë niqah dhe të bahet dasma.

Hasani heshti.

— Atëhere asht ma mirë edhe për mue edhe për ty, që kajdet t'i lamë për natën e parë kur do të martohemi, dhe...

— Dhe çka?

— Kurrqja! — ju përgjegj ajo tue i tkurrë supet.

— Unë, Nake, kismet, herët në mëngjez, do të marr udhë për gurbet...

— A asht shumë larg ai ukubet? — ndërhyri ajo.

— He-he! — bani një pash Hasani me krahun e djathtë. — Përtej shtatë mijë e shtatëqind bjashkësh. Atje ku soset toka... në det...

— Pooo, kur do të kthehesh?

— Kah dita e lumeve, Nake. Ishalla kam kambë të mbarë dhe më jepet përpara. Kur do të kthehem, oj Nake, do të bie një thes pare. Ty do të sjell një palë nallane, që bajnë tak-tak-tak-tak kur e lëshon thembrën për-tokë.

— Atëhere, a do të martohemi?

— Po, po, do të martohemi menjikerë, do të bajmë dasëm — pohoi ai.

Ajo e uli kryet dhe mëshehtas i fshiu lotët me çip të shervetes...

Flokët e bardhë të borës i zbardhojshin lëmishtet. De-gët e drujve vazhdojshin rrapamën e tyne dhe ma egër.

— Unë do të shkoj, po!... — e tori bishtin e fjalës.

— Çka po? — ndërhyri ajo, që i hukaste duert dhe majat e gishtave i raste në gojë prej të ftohtit.

— Bie fjala, ti, posa të humbesh mbas rrahut, qet sevda me ndonji tjetër dhe nis t'ja lëvritish bishtin e synit andej e këndej. . .

Ajo i shtrëngoi dhambët dhe një rrëqethje ja shtan-
goi shtatin.

— Hë, pse nuk flet? Si duket të zuna në lakna —
shtoi ai.

— Mos folë si të të vijë nëpër gojë. Unë mbas teje. . .
Pranoj të hyj me të dy duert dhe me të dy kambët vetë
në truall se sa të. . . Për mue ma asht nda rrisku. . .

Kah ugrajat hukllonte hutini.

— Nake, posa do të mbërrij atje, në letrën e Kadriut
edhe ty do të shtie një pusullë, sa për t'u marrë vesh. . .

— Jo, s'asht nevoja, mbasi s'di të lexoj.

— Po, atëhere?

— Kur do të më marrë malli, do ta pres gishtin e
vogël të dorës dhe, mbasi do t'i lyej të dy duert me gjak,
do t'i vej mbi letër. . . Ta dish, ajo asht letra ime.

Kikiriten gjelat e mesnatës anekand fshatit.

— Nake, po shkoj.

— Prit pak! — i tha ajo dhe nxori nga fundi i dimive
një palë çarape me lule. — Hë, merri, mos të të ngrijnë
kambët në det.

Hasani i mori dhe nuk bëzajti.

— Na edhe ti, Nake, një thikë, që ta presësh gishtin
e vogël, kur të të marrë malli për gurbetqarin.

— Hasan!

— Nake!

— Ditën e luleve kurrë mos e harro!

— Letrën e kuqe mos ma vono!

Të nesërmen herët në mëngjez Hasani u drejtue nga
qyteti me ferexhenë në krah dhe janxhikun për brezi. Te
rrahu i drodhi sytë kah pojata dhe ofshani.

Dimni atë vjet u bë i ftohtë. Naka mblidhte kalamajtë
e lagjes së poshtme te mullari i lamës dhe, ditë për ditë,

ua bante plakun e borës. Njiherë fillonte nga kambët. Mu mbi trinën e tyne mundohej me mish e me shpirt t'i viza-tonte ndortat e bardha. Kambëve ua copëtonte ngricën e borës dhe i pyeste qyrrashët.

— Hë, a e dini pse bana kështu?

Ata qeshnin nën hundët e skuquna, që u kullojshin lang, dhe ja grahshin secili në mënyrën e vet.

— Jo — ua priste ajo. — Këto janë kambët e nji djaloshi të vorfën, që nuk ka opinga të reja, por shtrëngohet t'i lidhë me dredha dhe t'i tërheqë varrë natë e ditë tue shërbye si argat e rrogëtar te të huejt.

Fëmijët atëhere shpërthejshin. Njani thumbit e tjetri patkoit. Përmendshin, pa lanë mbas majës së gjuhës, të gjithë ata djelmosha, që s'kishin as ujë në sy.

— Mjaft ma, mjaft! — u briste ajo, kur ndjente prej gojës së ndonjenit se e përmendte Hasanin. I shtrëngonte gishtat e duerve dhe i kapte sytë me ata. Rrinte në kllapi nji copë herë dhe, mandej, si tue e ba buzën në gaz, ja rifillonte punës tue e rritë plakun e bardhë.

— Oj dada Nake, a do t'ja varësh mjekrën cjamin? — e pyeti njeni.

— Jo, dada — ju përgjegj ajo tue e përlye me bërllaqe rrethin e qeleshes ba prej nji topti të borës.

— Pse, dada Nake, e nxin simoskush? — e pyetën disa.

— Ky asht gurbetqar. Kur i kullojnë djersët curril në pikë të dimnit tue bajtë thasë dhe tue i ngarkue, rrethi i qeleshes ndryshket, thuejse dikush ja ka lye me blözë.

Fëmijët qeshën, por asaj ju dridhën buzët si majë thupre.

— Hajde, tash t'ja vemë emnin — u tha fëmijëve kur boralecit dukej se s'i mungonte ma kurrgja.

Fëmijët, tue u hangarizë, filluen ta vritshin mendjen me gjetë emna të ndryshëm.

— Jo, jo! — ndërhynte ajo mbas çdo emni.

— Dada Nake, e gjeta, Halim.

— Jo, jo — vazhdonte ajo.

Atëhere fëmijët mbetën për nji kohë pa folë, derisa nji, si ta thumbojishe me gjylpanë, shtoi:

— Hasan!

Nakja veç e priste këtë.

— Hë, mirë e ke besa, e gëzofhtë!

Nji fëmijë ngau në votër të zjarrit dhe mori nji thëngjill. Prej shpatullës së majtë deri tek ajo e djathta ja shkroi emnin me germa të mëdha.

— Ta martojmë Hasanin — briti me të madhe njeni.

— Ooo, hajrli, me kambë të mbarë! — shtuen të tjerët siç bajshin të rritunit dhe e martuen me dadën Nake.

Prej kësaj dite fëmijët mblidheshin ditë për ditë rreth Hasanit të borës. Nakja dilte mbas punëve të shtëpisë dhe ja daltonte sytë njeriut me borë, që ishte i dash-tun mu si ai, Hasani në limanin e detit. Kah mbramjet, kur fëmijët zhदारariteshin nëpër shtëpitë e veta, ajo dilte, dhe, me thëngjill, i nxinte gerrat e para, pse gjatë ditës thëngjilli shkrihej tue lanë vetëm disa gjurma mezi të dallueme.

— Hasan, mos u shkri, Hasan! Rri deri kah dita e luleve, derisa të kthehet ai, Hasani i vërtetë! — i pëshpëriste ngadalë në laprën e veshit dhe nxitonte kah punët e shtëpisë...

Nji ditë, kur ja ngjau Hasanit letrën me pikëlat e gjakut të gishtit të premë, shkoi tek ai i borës dhe gerrat e zeza i leu me gjak.

— Qe, Hasan, amanetin e çova në vend — belbëzoi si përgjamshëm.

Dimni mbajti gjatë, por, megjithatë, kah buza e pranverës bora u shkri menjiherë. U shkri si krypa në ujë dhe Hasani sa e sa herë i ndrequn me duert e saj.

Ajo e kundronte vendin e tij dhe ofshante. Por i rikthehej besimi në ate tjetrin, se edhe pak ditë, do të çelin lulet nëpër vija, do të dushkojë zabeli dhe, do të mbërrijë dita e luleve. Atëhere lumja, mori ditë!

— Or Demir, Demiro! — briti me za të thekshëm nji gurbetqar në krye të sokakut.

— Hoja — ju përgjegj plaku, dhe e hudhi shatin më nji anë.

— Po vij prej detit, e...

— Mirë se të ka pru zoti, e bujrum! A kam ndonji gjymisë fjale prej atij carrokut tim, hej?

Gurbetqari heshti. Demiri, baba i Hasanit, e ndali hapin dhe u kap për një hu gardhi.

— O shëndoshë të tjerët, mixha Demir, se Hasani e kishte pasë ymrin të shkurtën... — ja lidhi kryet ai me gojë të thatë.

Plaku u dridh për huni të gardhit.

— A më ke pru ndonji kaçitë nishan, bre bir? — e pyeti.

— Mixha Demir, po. Qe, ferexhenë me të cilën mbulohej natën, një palë çarapa me lule dhe... një kaçitë letër me dhetë gishta të përgjakun... Ate, rahmet pastë, e vorruem te një gur buzë detit, mbasi e nxorëm pa shpirt prej fundit të tij...

Te mullari Nakja lutej gjithmonë të kishte dimën.

KËPUCËTARI

Kundruell lumit të rrëmbyeshëm që gjarpnonte tue shkumëzue dhe tue murmuritë gumëzhimthi në amën e vet bukur të thellueme në ranë, gjendej punishtja e Ali këpucëtarit, një dyqan i katrithun si rriqën ndërmjet do muranave të trasha me ngjyrë të verdhë, që ishin në ronitje e sipër. Ishte i kavetuem me dërrasa për anë dhe brenda i lyem me gëlqere dhe llaç. Plasave pingule, që krijoheshin në çatme prej teheve jo të latuem të dërrasave, u kishte ngjitë përbrenda nga një shirit letre të bardhë që skuluvareshin si pendëlat e rosakut të pundulitun. Por, megjithëse ishte dyqani ma i vjetër dhe ma i shëmtuet në çarshinë e vjetër, Ali këpucari e ruente si dritat e syve.

Posa shkrepse vezullimi qiellor dhe ja jepte agimi i parë, Aliu i vishte rrobot e vjetra prej shajakut, ngjye me lëvozhga arrash, dhe ja behete me shkopin e tij të trashë, që i ngjante çomagës. Ecte shumë ngadalë. Njeriut shpesh i rrekej të thotë se Ali këpucari nuk ec si ecet, por po e vret bezdinë tue i numërue hapat për të provue se a mos vallë e ka lanë takati dhe zemra. Shumëkush i vriste dhambët për hallet e tij, por ai, edhe pse i bijshin në vesh, kurrë nuk i tirtë dhe stërtirtë. Shihte punën dhe hallin e vet, pse vetëm kështu e nxirrte kafshatën e bukës në një moshë bukur të thyeme. Kur mbërrinte përpara derës së dyqanit, drejtohej një herë si fillak përpara tij, e kërcëllonte qafën djathtas e majtas me grushtin e shtrënguem të dorës së djathtë dhe, mbasi e çilte drynin e madh, të ngjitun për shulthin e rezes, ma parë shtinte kambën

e djathtë. Ulej në një shkamb, të cilin as vetë s'e mbante mend se kur e kishte ndreqë. Ai i dukej si vend i shenjtë, si shprehja ma e naltë e pasionit të tij, që shpesh kalonte në ndjenja marroqe, mbasi jo një herë dalldisej si xhakoni në lter në shkathtësitë e veta të lidhuna për këtë ndjesë primitive. Kambët i rrate në stivzën e fundërrinave prej meshini, shojash, lëkurash, opingash, pushi të leshtë e të lintë dhe me të dy duert e zhdërvjellëta si shqarshi arnonte këpucët e vjetra të myshterijve. Kur e shihte vargun e këpucëve të vjetra përpara syve, një ndjenjë kënaqësie ja pushtonte rrëmbimthi shpirtin. Ngashënjehej si fëmijë...

Kalimtarët e rrihshin bukur mirë anën e tij, pse, mu përpara derës, sheshohej pazari i drithit, një prej shesheve të rrumbullakta në rranzë të Bjeshkëve të Sharrit, ku prorre djerraditshin anamalasit. Të tubuem si bleta në zgjue, merrshin nëpër gojë trung e mur.

Ali këpucari ua daltonte përvjedhas bishtin e syve dhe, si i kredhun në punët e veta, nuk u jipte kurrfarë shenje. E dinte se ata, sado që duken të përvujtë e të retosun, janë tepër të hollë dhe dinakë në animet e veta. Nëse u fliste, këte e bante vetëm atëherë kur ndonjerit prej sish i ftekej t'ja çonte një «selam» xha Aliut. Por edhe atëhere me një dorë rrihte meshinin e këpucës dhe me tjetrën lehtas zemrën. Kjo — si me thanë — ishte përsëndetja ma e përpiktë për kalimtarët. Ai tashma e dinte se dyqani i tij nuk vlente as pesë pare, por kurrë nuk e humbte besimin në shkathtësinë e duerve dhe gurrën e energjive gjithmonë të kërtënezta. Disa prej mocanikëve mezi e mbante mend. Megjithatë kurrë nuk i ikte mendja se tashma ka mbërrirë në zgripin e humnerës dhe se — mos ta zamë me gojë — do t'i trokiste një ditë në derë edhe atij...

Shumë herë mbetej fill vetëm në skutën e vet të errët. Atëherë, si i shastisun, e mbështette kryet në dy shuplakat e gardhueme dhe vetmohej ashtu heshtazi kushedi sa kohë. Kokërdhokët i rrukulliseshin plogshëtas në zgavrat e irnosuna dhe të thellueme si dy gropa vorri. Nëpër dy shiritat e buzëve të holla — ça e plasaritë si

plisa dheu — rektojshin ofkamat e tij. Nganjherë përleshje nëpër mrrrolje rrudhash të ravgueme si në daskull. Mjekra e bardhë i kreshpërohej, i kurtaleshej si kreshtat e iriqit. Rrinte sa rrinte, mandej ja lëshonte rrëshqitazi bizën e dritës së synit arkës së mbulueme me pluhun, ku një pushë i vjetër, kushedi përpara sa kohësh, e kishte pasë mbajtë visarin e vet të verdhë, mandej i përshkonte me radhë këpucët e vjetra, të vjeruna në kushak, të mëdha, të vogla, të trasha, të holla... I dinte përmendësh emnat e myshterijve dhe përmasat e kambëve të tyne. Shastisej se si mundshin «kokonat» të ecnin me take aq të holla, sa deng për nga hollësia s'u vjen as maja e telit. «Mirë, bre jarani i pites, këtu nuk rri xinxalla e ku ma një njeri me dy kambë e dy duer!» reshmonte ngadalë si në vetëvete që të mos e trazonte mëninë e ndonji dashamiri. Atëherë i shkripej sapak një fie hareje në përpëlitjet e buzëve të thata. Njiherë në majë të gishtave i numëronte luftat ku s'kishte marrë pjesë, mandej luftat ku kishte marrë pjesë, mandej njerëzit që ishin ndërrue gjatë moteve që të vije fluturimthi deri në ditët e fundit. Megjithëse kishte pa e vuejtë si askush, çdo trohë e kësaj jete të shembun i dukej disi e dashun dhe e përmallshme. Aty kah dita e luleve kishte shkelë në të tetëdhetat, por, kur i mblidhte ditët e veta bashkë me vjetët, i bahej se gjithë kjo e shkueme prej se mbahej mend nuk mund t'ja mbushte as grushtin. Prandaj, me të drejtë, thellohej në vetëvete për të gjetë tek-tuk ndonji plakarec të kohës së vet. E, kur e gjente, përlemzej në të ambël tue u lëpi dhe tue i ngushëllue parandjenjat e veta smirëzeza, hajnakeqe, zemërbrese... Randë, madje fort randë ishte të flasësh për çarshinë e vjetër, e ta shtish në të harruem këtë «Nurdashëm», si e quejshin pleqtë e kësaj hurdhe. Me të vërtetë kurrkujt deri më tash s'ja kishte turbullue ujin. I kapërthyem prej ndjenjës së fuqishme për zanatin e fituem si ushtar në mbretninë turke nuk çante kryet për të tjerët. Shihte punën e vet, vetëm të vetën... Sado që rrekej shpesh të bahej tejet vetiak, por edhe atëhere, si mos të kishte prirje për këtë ves, tregohej i butë dhe buzambël. Zaten edhe profesioni ja kërkonte këtë veti.

Të rijt i quente nipën, kurse të rejat bija dhe mbesa, e ata, pa ja nda sytë, kur u binte rruga të kalojshin pranë dyqanit të tij, e nderojshin me mirënjohje të kandshme.

Në shtëpi kishte nipin, babanë e të cilit një ditë, kur po kthehej prej fabrikës së tekstilit, e shkeli maqina. Jetoj sa jetoj sa për t'u shkri i gjallë dhe, një ditë vdiq. Xha Aliu mbeti hu vetëm me nipin dhe nanën e tij, edhe ajo punëtore në fabrikë. Kamba e dora, nuk do mend, po e lente dita me ditë. Në shtëpi kërrylej kalabaç. Nganjherë, bri tagarit, mbledhej galuç tue e shtrëngue me të dy duert barkun e vet, i cili i kishte mbetë ilet qysh në kohën e zisë për bukë. I pupërdhakun gjysmë përmbys, priste një fjalë të ambël prej dy shtëpiakëve të vet. I bahej si me ja falë botën prej ku lind e deri ku perëndon, nëse ndonjeni gojaplot i thotë, si ka dhanë zoti:

«Bablok, a po ta kanda një kafe? . . . Apo, nëse jo ma kandshëm, tek e fundit: Baba Ustabashi, a po të fteket, pash të mirat e ymrit, kur ka dalë «shajtanraba?»».

Përgjegjen e tirrte hollë e gjatë dhe ta thoshte pa nyna. Vetëm krahët për të fluturue i mungojshin kur e pyetshin për mend e kuvend. Trupin e vet të thatë e mbështette përmbi dy kupat e gjujve dhe ja kurdiste tue nisë pothuëjse gjithmonë: «Hej, në një farë vakti! . . .» edhe e soste tue e luhatë kryet pa kurrfarë drejtpeshimi në shenjë dorëzimi pa kushte.

— Bablok, pasha tokën he, shumë shën Gjergje do të presësh e do të përcjellish. Ja, ja, ende dybek, shyqyr! . . . at me shalë! . . . — ja lante kryet me akull i nipi, të cilin e donte mu si djalin e vet.

— Haj, këlyshi i gjyshit, të hangërt goja mjaltë! — i përgjegjej buzagaz ai. Po, menjherë mandej: — Jo, bir. Unë e kam ngranë kulaçin tim, një kambë në vorr, një mbi vorr. . . — ja priste tue e ulë zanin dhe luhatte pashin e dorës së majtë.

Nipin e donte me gjithë shpirt dhe nuk e ndante nga zemra kurrë. Gruen e tij, Lejlen, një femën vetullfis-kajë dhe shendambël, nuk e kishte për huj, sepse ulej kambë mbi kambë përpara plakut dhe ashtu, pa vra mendjen fort e fort për hujin e tij, ja niste të tymojë sa

dy herë ai vetë. Sidoqoftë mundahej shpesh, nganjisherë edhe pa dëshirë, t'u bahej i dashun dhe i matun. E këtë vetëm e vetëm që mos t'u dukej si barrë. Prandej, edhe kur i shtereshin fuqitë e krahut dhe e lente kamba, ai nuk ndahej. Kishte ndër mend që mbas vdekjes së tij ta përmendshin për të mirë dhe, nëse jo kurrëgjatë, t'i thojshin fundi-fundit me gjithë loçkën e shpirtit: «Pastë ndjesë!», ose «Ju baftë shpirti nur». Xha Aliu e dinte se të rijt e tashmë kërkojnë të kenë çdo gja në shtëpi, madje asi takamesh dhe orendish që ai, në kohën e rinisë së vet, as që i kishte andërrue. Këtë ja kishin thanë të tjerët dhe e kishte ndie edhe prej dy shtëpiakëve të vet. Prandej nuk u dilte përpara kurrnjisherë. Mbështetej në parvazin e dritares, që shikonte nga jugu, dhe ja mbushte mendjen vetëvetes: «Paj, shtyj atë farë... , more Ali kundraxhia, se ata janë të rij!...»

Atë ditë vjeshte, — si prore — mbasi u ngjesh e u mbath mirë e mirë, doli në dyqan.

Bryma e kishte zbardhë shpatet e Sharrit. Frynte një acar, një erë ndjellakeqe, që gjithmonë binte shi dhe rrënim. Mori një dy gaca zjarr te fqinja e parë, i mblodhi turrë midis targarit të truellit e u vu përmbi do lëmishte, kashta dhe krande. Mbasi i fryni disa herë djathtas e majtas, zjarri u kall. I ngrohu pak duert e skuquna dhe e fërkoj fytyrën si me dashë t'i derdhte gjakut pak ngrohtësi.

Përmbi pullazet e qytetit zhdavaritej lodrueshëm tufa e sorrave.

— Ishalla me të mirë — prozhmoi në vetëvete dhe vazhdoi ta rrihte thumbin e këpucës së një zonje...

Ma vonë, aty kah drekët e mëdha, ushtoi bubullima. Fitalat e zjarrtë të vetëtimave, që shkrepshin varg, ja merrshin sytë... në fillim ranë do kokrra të mëdha shiu, që i ngjajshin breshnit të pranverës. Njerëzit, kush hyni nëpër streha e kush vrapimthi u drejtue nga shtëpia, u rralluen në shesh. Xha Aliu e zgjati kryet në derë dhe sharoj në kujtimet e veta. Asnjisherë, si për inat, jeta s'e kishte përkëdhelë. Kishte qenë bari, rrogëtar, kallajxhi.

Së fundit u vendos në këtë dyqan. Malit ja dinte fare mirë rrobet, e dinte se si merr frymë secili dru, si gjakon secili gur... Shiu vinte nga kreshta e Sharrit me rrëmbim. Paralajmëronte fatkeqësi... Këtë e dinte mirë... Për pak gjethet fërfëlluen qiellit, era si dredhë i plapuriste dhe i mërgonte kushedi kah... Shiu ja grahi me rrëshkë. Ashkëlat, si të plyryna, pluskuen mbi ujë. Llofkat, disi si të përgjakuna, gurgulluen dhe çurgje-çurgje u mblodhën në shesh, prej kah dallgë-dallgë shpërndareshin qytetit. Të parën herë u mbushën brazat, hendeqet, mandej uji, pa kurrfarë përfilljeje dhe mëshire, nisi të gërmonte në temelet e shtëpive dhe dyqaneve...

Lumi gumëzhiti, solli me vete angullimën e egër të qenve të barijve... Ama mbushej me të shpejtë. Vrushkujt e parë, të egër dhe të njimbasnjishëm ju vërsulën urës së gurtë, urë e vjetër, për të cilën katundarët kishin thurë shumë gojdhana...

Nji suvalë e rrufeshme i ra derës së dyqanit, ku këpucari i mblidhte këpucët, i bante dy nga dy dhe i varte nëpër gozhda të dërrasve, që të mos i merrte uji. Veglat ma të imta të punës i ngjeshi për rreth shokës. Çekanin e madh dhe mëkambëzën i shtini rrëshqitas në shkekat e tirqve...

Njerëzit, pleq e të rij, vrapuen nga ura për ta mbrojtë, nga se po të shprishej ajo, fort randë kishte të shpëtonte jeta e lagjes së vogël, që gjendej mu në rranzë të lumit.

Këpucari i përvoli krahët deri mbi bërryla dhe ju kapërthye si bollë e vrame njanës dërrasë, që po lakohej. Vendosi të zvarritej drejt përpjetë tue zhagitë dërrasës, mbasi rrënimi gjithnji e ma tepër rritej dhe mbushte dyqanin me zall dhe degurina. Ju kujtue se çdo orvatje për të shpëtue jetën brenda në dyqan ishte e kotë. Prandej i mblodhi edhe fuqitë e fundit dhe vendosi të hypte nalt në pullaz të tij, prej kah, nëse i kërcënohej rreziku, do të kalavarej në degët e mollës, të cilat prej frutit atë vjet ishin lakue deri në tjegulla. Dha e mori disa herë, por, si të vepronte ndonji fuqi e mëshehtë kundra tij, trupin ja tërhiqte kryengulthi teposhtë. Binte si trupth i sharruem në lloçoçamën e ujit. Njiherë ai i mbërrinte deri

në kërcikë, por ma vonë rritej gjithnji e ma tepër. Të fundit herë, kur ra, uji ja mbuloi kambët, ijet dhe një pjesë të krahanuerit... i zgurdulloi sytë dhe i këqyri si për të fundit herë këpucët, që lundrojshin pizgërr nëpër rrënim.

— Hej, millet! — u shqerr gërhama e tij e përmbytun dhe pa kurrfarë shprese. — Kundrat e zeza me take të nalta janë të... — nisi t'i numrojë pronarët e këpucëve tue ndjekë rendin e tyne përpara syve.

— The qafën, marroq — ju ngërmue njeni prej qytetarëve, që vrapoi të shkreppte ndonji dërrasë në dyqanin e tij për ta ndalë lumin.

— Dyqanin, dritën e synit, amanet ja la nipit!... — ja priti ai i kapun për dërrase si ketër.

— Veni kambët mbi supet e mia dhe kapu në qoshin e kulmit — briti qytetari me të shpejtë, tue mos ja shkepë sytë urës.

Këpucari, tue u shilarë pullazit, shikonte me supin e tij, mandej, tue u kolovitë në pezullim, e vu edhe tjetrën dhe u kap për tabanin e kulmit.

— Bafsh hajr! — përshpëriti, tue shtue se, me të dalë rrënimin, një palë këpucë pa kurrfarë page ka për t'ja arnue dhe meremetue.

Njeriu e luhati vetëm pashin e krahut të majtë në shenjë mospërfilljeje për këtë cikërrimë dhe trupoi kah ura.

Këpucëtari, tue u shilarë pullazit, shikonte me tmerr rrënimin, që bahej gjithnji e ma i tërbue. I pështuem lemerie i ngriti duert përpjetë, tue e lutë qiellin që t'ja shpëtonte këpucët e myshterijve. Nji valë ruzgjer ja fërshëllini sytë. E fshiu mjekrën me jakën e këmishës dhe e trusi kësulën në puç të kresë.

Nji gur i madh dhe i rumbullakët, ku pushojshin katundarët ditëve të pazarit, luejti vendit. U rrokullis rrëmbimthi dhe, mbasi bani disa rrokullisje, ju përplas me fuqi dyqanin. Çatmja u dridh si prej trandjeve të tërmetit, mandej, tue u lahutë si shtizë flamuri, nisi të lakohej nga kalldrëmi i rrugës.

Plaku i hapi kambët dhe disi ju ngjit majës së degës,

e cila përplasej prej njenës në tjetrën anë. Mbas një kohe, kur dërrasat filluen të shkepen, ai u kap në majën e kulmit dhe i erdhi mullarshi disa herë, si të dëshironte të kërkojë ngushëllim.

Njerëzit vazhduen punën e vet. S'ishte gja e lehtë me vu penda dhe me i dhanë krye ujit nga krahu i majtë, nga ajo anë, e cila ishte ma e naltë se kjo përpara dyqanit të këpucarit. Po të rrëzohej ura, atëhere tejet vështirë do të ishte të mbrohej një pjesë e madhe e qytetit prej vërshimës.

Kah e vona shiu u ndal. Njerëzit, të pehatun nga stërmundimi, u renditën nën strehë, tue i fshi krahët dhe tue i shkundë rrobet.

Njenit i shkoi ndër mend xha Aliu dhe pyeti të tjerët, e ata i rrudhën krahët tue i ngulitë sytë në zallin e dyqanit.

Tue rrëshqitë trungut të mollës teposhtë, Aliu zihej në vete:

— Jo, jo, nuk vdes këpucari aq kollaj.

TOKA E PËRGJAKUN

Kur e mbylli derën e oborrit mbas vetes e kujdes-
shëm, por bukur me rrëmbim, disi vetëvetiu u kthye e
vërejti andej pa mendue gja që e lidhte me atë që e
shihte, por menjherë ju duk sikur diçka e randë ju këput
mu në mes të krahanorit dhe ju rrokullis në tokë. Mandej
ndjeu njëfarë gulshimi të çuditshëm; që ja këputi të dyja
kambët në gjunjë. Nuk e diti as vetë nëse ishte ai gul-
shim nga gëzimi, sepse as ai nuk mund ta dallonte në
vete plotësisht se ishte gëzim, apo nga njëfarë droje e
çuditshme, mbasi kishte do ditë që, saherë i silleshin në
kokë këto mendime, i dukej se do të mbetej në gjysmë të
rrugës. E ajo rrugë përherë i dukej aq e tmerrshme, sa
mozomakeq nëse mbetej. Mirëpo, mbasi e mbylli derën,
ju duk sot se ma tepër ishte kjo e dyta.

«Sot kam me e ble tokën time, tonën e të Muratit,
se atëherë as nda nuk e kemi pasë, të vëllait, që as vorrin
s'kam mundë t'ja shoh. Ta kish marrë vesh bile që tokën
e tij tash e ha unë! I shkreti vëlla! I ri ka qenë, po pat-
konjve të kalit nuk paska mundë t'u qëndrojë. Të ish
kthye edhe ai atëherë, nuk ish ba kjo, se këtu nuk ka
pasë kali i kujt me e shkelë aq keq...» Mirëpo, posa i
mendoi të gjitha këto, ju duk se mu në mes të krahanorit
ndjeu një të rame aq të fuqishme, sa e ndërpreu hapin
dhe mbeti si i habitun. Ju duk se një kalë i madh, i fortë,
si i trembun, e goditi pa fije mëshire. Nji çast ju dridh
krejt trupi. «Po asht shkruie aj dhe i atij vendi të largët
me i kalbë eshna e rreshna. . Se patëm shkue atje vetëm
sa me i lanë do vorre. . .»

Në atë freski të kandshme mëngjezi, kur dielli vetëm

sa po i hidhte rrezet e para në kodrat e perëndimit, plaku u kthye edhe një herë dhe e vërejti fushën nën katund.

«Tash e këndej e imja!» — i tha vetes me njiçarë besimi, por menjherë u shtangue, e ndali hapin në gjysmë, mendimet e vërshuen saora. Dorën, që vetëvetiu e pat çue kah xhepi i setrës, s'mundi ta tërheqë por e rrotulloi dy-tri herë, thuese kërkonte diçka aq të nevojshme në atë moment, e mandej nxuer qesen e lëkurës, të cilën vetë e kishte qepë para shumë vjetësh. E zgjidhi edhe tojën, me të cilën e mbante lidhun gjithmonë dhe nisi ta rrotullojë çuditshëm.

— Paaak... — i pëshpëritën buzët.

«Po kam me e ble, se kambë e gjallë në te s'ka me shkelë, deri të farohemi të gjithë...», e shpejtoi hapin i vendosun.

Kur u kthye ma vonë, sytë nuk mund t'ja ndante asnji çast fushës, aravet, gjelbërimit, thuese përpiquej t'i përbijë me shikim të gjitha.

«E imja!...», mezi pëshpëriti.

Në shtëpinë e Isuf Lahit gjithshka punohej për të holla. Shitën gjithshka që mund të shitej, kursejshin gjithshka, pa të cilën mund ta kalojshin ani pse lejshin diçka keq; edhe kafshatën e gojës zvogëlue e kishin, sepse nuk ishte lehtë të blejnë tokë, e ajo u mbetej përgjithmonë, prandaj ma mirë le të vuejnë tash pak, se gjithmonë.

Darkë hajshin sa perëndonte dielli, sepse as pikë vjguri nuk u ble në shtëpinë e tyne qyshse blen tokë, pos asaj llambe që rrinte përherë plot e ruhej për ndonji mysafir që rrallë kthehej andejpari. Të shtunave, kur në qytezë ishte ditë tregu, Isuf Lahi kthehej rëndom, vetëm me ndonji kilogram krypë të mbështjellun në peshqirin e vet, që tash sa vjet e mbante me vete për të mbështjellë gjithshka që i duhej të sillte në shtëpi, e me të cilin çdo të shtunë mbështillte ato pesëmbëdhjetë copë ve, që e shoqja ja kishte ruejtë prej së shtunës tjetër, e as fëmijëve, edhe pse kishin qajtë aq shumë, nuk ua kishte dhanë.

Me të hollat e tyne blente krypën, kurse ato që i teprojshin i bante palë në çantën e lëkurës.

Kafshët tashma i kishte shitë të gjitha përveç qevet të mëdhej, sepse pa qe qerre s'mund të mbahej shtëpia e as të fitohej gja. Vendosën, së bashku me të bijt, që vetëm ata t'i ruante deri në fund, deri një javë para afatit të fundit për t'i pague të hollat e tokës. Megjithatë, plaku nisi tash t'i thotë vetes gjithnji e ma shpesh se kishte fare pak të holla, prandaj droja i shtohej gjithnji e ma tepër.

«U bekoftsh, mori vjeshtë, po shpejt erdhe e... paret...», i thoshte ato ditë vetes shpeshherë, e mandej i dukej se gjithshka po i rrokullisej në njëfarë humnere, si një ortek bore e gurësh dhe me vete po e merrte edhe atë, e mozomakeq ku po e hidhte të vdekun. Por, menjherë mandej hetonte në vete se nuk ishte as i gjallë, as i vdekun. E atëherë një dridhje e çuditshme ja dërmonte trupin. fshante thellë, si njeriu që zgjohet nga gjumi mbasi ta ketë mundue një ankth i vështirë.

Dimni ju duk se po shkante gjithashtu shumë shpejt, edhe pse e numronte çdo ditë.

«Dita e shëngjergjit po afrohet, e paret... larg... shumë larg...», dhe shqetësimi s'e lente të qetë asnjë moment.

Në shtëpinë e Isuf Lahit të gjithë përpiqeshin për të holla. Natë e ditë mendojshin për to, përpiqeshin për to burrat, përpiqeshin gratë, e përpiqeshin bile edhe fëmijët. Dhe, plakat vështirë i vinte, kur i ndigjonte edhe fëmijët të thonë:

«S'ka pare! Duhet me i ruejtë paret...»

Vetë Isufi plak, Faiku e Selmani të fuqishëm punojshin të tanë ditën, e në mbramje ja shtojshin grumbullit të të hollave edhe ato të fituemet gjatë ditës me djersën që s'u kishte ndalë asnjë çast. E vështirë u vinte të pyesin të anë sa të holla kishin por, kur mbeteshin pa punë, i mbyteshin ato mendime friguese, që u ishin aq të randa.

Gratë i ngrehën vegjët dhe nisën të mbarojnë qylyma, pëlhurë e gjana të tjera, nga të cilat mund të fitojshin sadopak të holla, që gjithnji me aq kënaqësi ja jepshin Isufit; kurrë s'mund t'i falënderonte, por vetëm ndalej dhe i shikonte tinzisht disi fort çuditshëm.

Fëmijët i ruejtën atë vjet gjysmën e kafshëve të katundit e shpeshherë krenoheshin ndërmjetveti për të hollat që do t'i merrte Isufi dhe ndjejshin njëfarë mburrje që edhe ata mund të ndihmojshin.

Megjithatë grumbulli i të hollave nuk rritej ashtu si dëshirojshin ata. Madje Isuf Lahit ditëve të fundit nisi t'i dukej e pamundun t'i sigurojë të gjitha. Prandaj, saherë i kujtohej kjo, i dridhej tanë trupi, i thartohej gjuha, i këputeshin kambët në gjunjë dhe i humbte dikah fuqia, e mbetej si guri i palëvizshëm. Mirëpo s'mundte kurrë t'ja pohonte vetes atë që e ndjente ditë e ma tepër. Vetëm edhe një herë e kishte ndie veten të këtitllë, kur kishte kalue fusha, male e dete dhe i kishte thanë vetes: «Ku jemi tash?»

Çdo ditë i dukej se edhe dielli po perëndonte ma shpejt, e kështu një nga një po humbshin ditët dhe po afrohej koha, kur duhej t'i jepte të gjitha të hollat. Çdo muzg i shtonte plakut dronë, çdo agim ja forconte atë, kështu që tash as i hahej as i pihej, e as mund të gjente qetësinë natën a ditën. Mirëpo, të bijve s'guxoi ende t'ua shprehte dronë që e mundonte atë gjithnjë.

Kur e shiti tlyenin dhe djathin e verës, në shtëpi u kthye shumë i kënaqun. Rrugës disa herë vetëvetiu i shkante dora dhe e prekte xhepin, e nga ngazëllimi e shpejtonte hapin. Edhe në mbramje, kur i paloi mbi të tjerat, fytyra i buzëqeshi pak. Atë natë, mbas një kohe bukur të gjatë, plaku fjeti pak ma qetë, por u zgjue përsëri herët dhe, si i friguem, shikoi anësh në errësinën që posa kishte fillue të zhduket. Nëpër dritare i vërejti yjet, që ende piplojshin aty-këtu në qiellin e përhimtë. Mandej e preku veten. U bind se nuk kishte gja. Pak ma larg ndigjonte frymëmarrjen e të birit.

«Hajr o zo'!» i lëvizën buzët pa mundë ta largonte shikimin nga qoshi i dhomës. «Andej... plot... plot pare...», bani si me vete, tue e shtri dorën kah kandi i odës. «Sa shumë paret i pashë...», i tha përsëri vetes, tue e kujtue atë pamje që ju kishte dëftye në andërr me plot të holla. «Aq shumë kish sa!... Nisa me marrë. Kapa, sa mujta... I rrasa në gji, plot xhepat... Thashë se boll janë për tokë... Po... atëherë të duel një gjarpën i zi e i tra-

shë si... Këcveu e këcveu mbas meje në majë të bishtit e unë mezi ika. Kur më ranë krejt paret, atëherë u ndal, e ja nisi ai me i mbledhë. Atëherë më duel gjumi».

«Ferizi, qebesha, asht si gjarpni!» — i fshiu djersët nga balli dhe u rrotullue në krahun tjetër të mos e shihte atë kand të dhomës, ku herë i dilte gjarpni e herë të hollat. Por, tash prej të dyjave frigohej. I mbylli sytë dhe dëshiroi të kotej vetëm edhe pak, sepse tanë trupi ju kishte dërmue. Por, të hollat e gjarpni nuk ju hoqën mendsh, prandaj u detyrue t'i mbante sytë të gaprruem në terrin që po tretej ngadalë. Mendoj gjithshka. Përjashta ndëgjohej fishkëllima e veriut. Kishte kalue gjysma e dimnit, por ende bante të ftohët i madh. Madje ditëve të fundit ra aq shumë borë dhe u ba aq ftohtë, sa nuk mbahet mend. Prandaj plaku u struk ma mirë nën jorganin e arnuem.

Nji gjel ja theku kangës që u përzie me fërflazën e veriut, e cila, si dukej kishte me fare. Faiku, qe vetëm pak përpara qe zgjue dhe priste të ndigjonte kangën e gjelavet, fshani thellë dhe u shtri si përtueshëm, tue i nxjerrë vetëm pak kambët nga jorgani i nxehtë. Kur i mblodhi pak ma vonë dhe i futi rishtas nën te, ajo ngrohësi aq e kandshme i pëlqeu ma tepër se gjithshka prandaj, sikur të mos ishte puna e të hollave, nuk do të dilte për kushedi çka në atë shtërgatë të furishme. Qëndroi vetëm edhe pak, gjelat u ndëgjuen edhe dy-tri herë, e mandej, pa mendue gja, u ngrit dhe përtueshëm nisi të vishet. Gjelat me atë kangën e tyne, që i vinte së bashku me fishkëllimën e fërflazës, ju përzien në mendime.

«Pse këndojnë në këtë të ftohët?» — pyeti veten dhe disi gjithshka ju duk e çuditshme, ashtu si edhe vetë jeta e tij, si mundimet, si vështirësitë. E shoqja u ngrit dhe e ndihmonte të vishet, ashtu nëpër terr.

— A asht ndalë hiç ai i shkretë veriu? — pyeti ajo e brengosun, e në za i hetohej fare lehtë një keqardhje e madhe për të shoqin, që do të dilte në atë të ftohët.

— Po! — ju dridhën buzët lehtë Faikut, por ftohtas. Mbasi përgjoi edhe pak vazhdoi:

— S'asht ndalë, i bekuemi hiç, po... — Faiku ndjeu se koka i qe randue, por mendoj sigurisht nga pagjumësia,

sepse disa herë gjatë natës qe zgjue dhe pritte kangën e gjelave, derisa e mashtronte gjumi përsëri. I biri, që flinte, krrati nxanshëm, e pastaj pushoi, kështu që dhomën e mbuloi përsëri një heshtje, nëpër të cilën ndëgjohej vetëm shushurima e rrobeve. Edhe heshtja dukej e ftohtë, e ngrime, e akullt. . .

Veriu uluronte ende trishtueshëm, tue u ndeshë në pullazin e shtëpisë. Të ftohtët dhe fishkëllima e veriut qetësinë e natës së errët e bajshin edhe ma të randë, mемеce dhe disi të vështirë. Herë-herë veriu dukej sikur qetësohej, por vetëm mbas pak thue se turrej me krejt fuqinë, sikur të donte me shkatërrue gjithshka që gjente përpara. Atëherë, çdo gja e mbështillte prapë trishtimi.

Faiku e mbështuell rreth vetes shokën, e nën të vuni edhe një lëkurë delje, që t'ja ruente përmjetin nga të ftohtët.

— Sonte asht shumë ftohët. . . — i përzihej e shoqja herë-herë në mendime, më tepër vetëm sa për t'i folë diçka. Priste mandej bukur shumë që t'i fliste edhe i shoqi, por ai vazhdonte të vishej e të mbathej dhe nuk bëzante, por sigurisht e mendonte veten që kishte pasë asi fati e kurrë s'mund të qetësohej nga punët.

— Mos shko sonte hiç! — i lëvizën asaj buzët në errësinë e fytyra i muer pamje të çuditshme. E madhe ishte kjo dëshirë e saj. I shoqi vetëm e vështroi në fytyrë dhe prapë nuk e çeli gojën, por dukej pak i pikëlluem. Sigurisht zemërohej për fatin e vet.

— A po ndien, ej? Mos shko sonte, se shumë ftohët, e deri nesër ndoshta thyhet pak ky i bekuem. . . Thyhet pak të ftohtët. . . — mbeti gojëhapun.

— Sonte shiten drutë ma mirë.

— Po vështirë asht me marrë sonte rrugë. . .

— Vështirë, por. . . fitimi asht ma i madh. . . Po, kur s'e kam pasë u vështirë? . .

— E çove veten poshtë. . .

— Sot kanë me i ble ata shehërlitë sa të due vetë. . .

— Le vetëm sonte! — ju lut ajo përsëri.

— Jo, jo, s'më gjen gja mue. . . Në të ftohët jam le e rritë. . . As shtatë vjeç nuk kam qenë, kur ja nisa me

babën në borë e në shi. — e shoqja nuk bëzani dhe duel mbas tij në oborr, i ndihmoi me i ngjitë qetë, që gjithashtu i afroheshin zgjedhës me përtesë nga të ftohtët, sepse e dinin edhe ata se ç'i priste. E përcolli mandej deri te dera e oborrit, e vështroi mbrapa me keqardhje derisa e mbështuell fërfillaza, e atëherë u kthye.

«Loke, mos të gjetë ty ajo që e ka gjetë atë!» — i pëshpëriti të birit që flinte.

Gjumi s'e zu ma. Kot rrotullohej dhe përpiqej të gjente vend ma të përshtatshëm. Saherë e ndëgjonte fishkëllimën e veriut, i dukej se i depëronte thellë në trup dhe e dërmonte. Rabës dikur i ati i kishte vdekë nga të ftohtët. Nji fërfillazë që s'mbahej mend, por asaj i dukej që i ngjante mu kjo e sontmja, e pat zanë tue u kthye nga mullini herët, ai mot i keq, e në shtëpi nuk kishte trohë mielli. Atë ditë që e rroku thesin në krah dhe u nis teposhtë, e përcollën derisa e përbini fërfillaza, vetëm fëmijët me sy të gaprruem, në të cilët hetohej fare lehtë diçka interesante. Atë ditë edhe vetë Raba e kishte shikue të anë derisa i humbi në mjegullën e përzieme me flluskat e borës.

Ai nuk u kthye ma. Pritën, nji, dy, tri ditë, e ai nuk u sillte miellin dhe s'kthehej vetë. Atëherë u nisën mbas tij. Bora kishte mbulue gjithshka së bashku me gjurmët e njerëzvet. Vetëm mbas pesë ditësh e gjetën të vdekun, mbështetë për thesin me miell, të cilin s'kishte mbërritë t'ua sjellë në shtëpi fëmijëve të untuem.

Prej atëherët Raba i dron të ftohtët. E i dreshti aq shumë edhe sonte, prandaj nuk e zinte gjumi dhe mendimet e mundonin gjithnji e ma tepër. Ju kujtue disa herë edhe vdekja e të et.

Gjelat s'dishin të mejnë. Rabës i dukej disi therëse kanga e tyne që përzihej me mendimet e saj.

«Na ropi të gjallë kjo e shkretë tokë... Kurrë nuk mbërrijmë në fund... Po, ndoshta, atëherë i marrim kambët e... Le të heqim nji herë, po ndoshta jo gjithmonë...», i tha vetes dhe u kthye e mbuloi të birin.

Kanga e gjelave prapë u përzie me fishkëllimën e veriut.

«Sa e gjatë qenka kjo natë, e ai...»

Para agimit e zu gjumi.

Veriu s'kishte mejtë as në mëngjez. Binte borë pa ndërprërë, kurse katundi i mbështjellun në fërfillazën e tmerrshme dukej shumë i zymtë. Do tufa të vogla zogjsh fluturojshin prej hambarit në shtallë e s'vonoheshin dhe ktheheshin përsëri, kurse dy-tri sorra kishin zanë vend në degët e arrës në mes të oborrit dhe, të kthyeme kah veriu, dukej se koteshin. Tymi, që dilte nga oxhaqet që mezi dukeshin mbi borën e madhe, përzihej menjherë me veriun e me borën dhe humbte.

Kur ishte asi moti, rrallëherë hynte apo dilte kush nga katundi. Askujt s'ja merrte mendja me u nisë në rrugë ato ditë. Isuf Lahit, atë ditë, si gjithnji kur të bijt i janë në rrugë, nuk i zihej vendi vend. Doli sa e sa herë te dera e oborrit dhe i zgurdulloi sytë një kohë të gjatë andej nga duhej të kthehej i biri me ato pak të holla, që do t'ja shtonte atij dengut të maparshëm. Sa e sa herë e mendoi të birin tue ardhë, e aq i mendoi edhe të hollat. A gëzohej vallë plaku për kthimin e të birit, apo për të hollat që do t'ja lëshonte në dorë? Të drejtën me thanë, e këtë e mendoj edhe ai vetë, të hollat e gëzojshin, kurse i biri i dhimbej që do të ketë vuejtë në këtë të ftohtët që s'mbahej mend. Prandaj, ato dy gëzime i shkriheshin në një, që nuk e lente të qetë, dhe dilte aq shpesh të shikonte. E ma vonë i tanë ai gëzim ju përzie dalëngadalë me një farë droje që e shqetësonte.

Doli disa herë në rrugë, por s'pa gja. Droja e shtrëngonte gjithnji e ma tepër. Vështronte rrugën derisa niste të dridhej nga të ftohtët, tue mos i nda asnji çast sytë nga rruga derisa i përloreshin. Kthehej përsëri mbrenda dhe qëndronte fare pak.

Priti shumë plaku. Pritën të gjithë. Pritja u ba e randë; e kobshme. . . Errësina u lëshue përsëri mbi katund. Edhe errësina, të cilën thuese e solli veriu me të tanë atë fërfillazë, ishte e randë, sa të gjithë ndjeshin në vete diçka rrëqethëse, diçka të tmerrshme. Natën pakkush fjeti. Plaku nuk mbylli sytë bile, ashtu si edhe e shoqja, të cilët ato mendime i dërmuen aq shumë. Mezi pritën të agojë e

të nisen rrugës, asaj rruge që, siç mendonte edhe plaku gjatë natës, ishte fort e vështirë, e shumë njerëz kishte hangër në këso ditësh. Ju kujtuen mandej shumë të atillë, që ishin mësyje e nuk ishin kthye kurrë të gjallë, prandaj friga i shtoej edhe ma tepër.

Të nesërmen, me agimin u zgjue edhe plaku, e me të birin, Selmanin, u nisën asaj rruge me kambë të këputuna në gjunjë.

— Mozomakeq! — i pëshpëriste plaku vetes herë mbas here, tue parandie fare mirë, atë së cilës i frigohej ma së tepërmi. Selmani s'e priti të anë, që s'i kishte mbetë trohë fuqie, dhe vazhdoi rrugën nëpër borën e madhe që mezi e çante.

— Ecë, biro, ti ma shpejt se... — i tha të birit, kur e pa që ai u nda dhe shikimin e mjegullisun e drejtoi kah hapat dhe bora që ngritej e bante era mbas tij.

«Mos e ka gjetë gja e keqe, e mozomakeq, për zemër të plakut?» — pyeti mandej veten dhe ndjeu se i tanë trupi ju ligshtue.

«Medet, çka do me më gjetë mue sot?» — i dukej se mbi supet e veta të lodhuna mbante të dyja ato kodrat përreth, në mesin e të cilave kalonte rruga, ajo rrugë që e këtitllë plakut i dukej e mallëkueme. Veriu frynte. Bora dhe akulli ju banë dy gishta në mustaqe e mjekër.

— Ishalla jo! — pëshpëriste prapë.

— Medet, Faiku! Faiku...

«Toka, toka, e jonë...», mendoi dhe rrëshqiti ra në gropën bukur të thellë bri rrugës. Akulli u thye dhe ra në ujë. Mezi u ngrit, doli dhe nxitoi pa ja vu veshin. Nji kohë rrobet mbas tij pikojshin, e pastaj shpejt u ngrin.

— O vëlla — vëllai i jem. I mjeri u për ty e për vete! Çka na paska gjetë sot! Vëllai i jem... — plakun e stepën në vend këto fjalë që Selmani i thonte me za dhe kishte mbetë i ngurosun në vend.

— Medet... — bani plaku dhe u ndal buzë greminës, tue e shikue me sy gjysmë të mbyllun atë skenë rrëqethëse.

Bora kishte mbulue gjithshka. Edhe Faikun e vdekun. Poshtë në përroin e thellë ishte shtri Faiku, e mbi te ishin

palue do drunj. Bile njani me majë, aty ku vetë e kishte shkurtue me sëpatë, i ishte ngul në krahanorin e tij, kurse skaji tjetër mbështetej në bregun e rrugës, e mbi te randojshin të tjerët. Pak ma tutje qetë të mbuluem gati krejt nga bora shikojshin sikur të dojshin të pyesin se ç'kishte ngja.

Isuf Lahi mblodhi dikah një trohë fuqie e zbriti i pari. I largoi një nga një me atë grimë fuqie që i kishte mbetë drunjte nga i biri por, kur ja hoqi edhe atë që ju kishte ngul atij, Selmani ra përdhe si i korrun. Megjithatë plakut as s'ju dha ta ndihmojë bile...

— O biro, Faik, baba këtahen, tybe treqind tybe, s'ta ka kujtue kurrë, pëllumbi im, po të mirë të paska ba sot bora, e sytë çelë të paskan mbetë. Për kend, a thue, të mbetën sytë çelë, djali i babës?.. — fliste ai me vete dhe as që dinte se ç'thoshte.

«Për tookë». — Ju duk plakut se i tingëlloi në vesh, por përnjiherë ju duk aq e neveritshme kjo fjalë, sa pësh-tyni në tokë dhe e solli kokën, sikur të donte me thanë:

«Ç'ka na bani toka jonë!»

Kur u nisën kah shtëpia, dielli, sigurisht, kishte përrëndue, sepse nisi të erret. Sa pikëlluese dukej atë çast çdo gja rreth tyne. Faiku i shtrimë në do dru të rendueme në sajë, para tij Selmani e mbas tij i ati.

Veriu ulëronte trishtueshëm, ndeshej në ta, por asnjani s'kishte ç'ti bante...

KTHIMI I NJERIUT TË VDEKUN

... Dhe, si asht e mundun, që ai farë Zeke, të jetë ai kushdo qoftë, të thotë se unë kam vdekë, se me dorë të vet më ka lëshue në dhe. Unë, Haziri, kam vdekë. E sot unë jam gjallë?! — pyeta prapë veten dhe u çudita me ndërgjegjen e tij, me fytyrën e atij burri.

Kah lindja, atje ku gjindet katundi, hana ja dha mbi kunorat e lisavet. Pamja e këtillë më mallëngjeu përsëri sa qesh të qaj, mbasi diçka si lamsh m'u mbështoll në krahanorin, i cili më theri anë e përtej.

Kështu e kam pa shumë herë këtë anë — mendova...

E sot, unë, Haziri i vdekun, nuk kam as katund, as shtëpi, as fe... as grue... as babë. Jo, jo, fëmijë nuk mund të them se nuk kam, por me të vërtetë nuk... Nuk kam as shpresa se do të kthehem. Dhe, kur i mendova të gjitha këto, ashtu në errësinë përsëri ndjeva se m'u nxenë kapakët e syve, hetova turrin e lotvet të valë, por me të tanë fuqinë që më kishte mbetë i ktheva mbrapa. Vëreja prapë në errësinë që më mbulonte dhe prapë m'u duk sikur nuk kisha kend timin, se isha i vetmuem përgjithmonë e se i këtillë do të mbetem tash e tutje, e kështu si isha jam ma fatmjeri në botë.

E pse tjetri të thotë se unë kam vdekë?!

Drita më zbardhi në rrugë, në mes të fushës, pa njeri kund, ashtu si dëshiroja vetë, megjithëse edhe tash kjo vetmi më pikëllonte, e çdo gja rreth më dukej si shkreti, sa kisha përshtypjen se ndodhem në një hapësinë aq të pafund, që në ato momente më mundonte aq shumë, sa gati po humbsha vetëdijen. Kur e vëreja diellin që i bu-

zëqeshi natyrës me rrezet e para, pse nuk dëshirojsha fare të shkëlqente, veten e ndjeva edhe ma të dërmuëm, edhe ma të lodhun, edhe ma të pikëlluëm, sepse atëherë m'u duk vetja si njeri i humbun, si njeri që ec vetëm kah t'i shohin sytë, që e ka fare të qartë se nuk ka kend të vetin, që e kupton se nuk mund t'ja shprehë ma askujt ndjenjat e veta, si njeri që nuk do të ketë kurrë ma askend t'i tregojë bile një pjesë të intimitetit të vet, si njeri i-panjeri.

Tash nuk kam kah të shkoj.

— Zeka! — kjo fjalë më duket se më ther anë e përtej trupin, e mandej gjithshka më erret para sysh, kurse fuqia më humb dikah.

Tash unë jam ai Haziri që të kthehej para disa orësh në katund. Në atë katundin, ku shtëpitë janë strukë rrazë kodrës, e ku vetëm vjeshtë e pranverë ngjallet ai përroi herë me ujë të kthjellët e herë të turbullt e shkumbues, kur shkrihet bora e bie shi; në atë katund, që asnjherë nuk m'u hoq nga mendja, sa kohë qesh larg tij. E, asht jetë e kandshme ajo e katundit në pranverë, kur blerimi vesh ngadalë fushën, e njerëzit të lodhun nga dimni dalin në fushë të punojnë, por asht kënaqësi edhe ma e madhe në mbarmje, kur perëndon dielli i kuq, të kthehesh në shtëpi... Asht kënaqësi edhe verës, kur zgjohesh herët dhe del e ngihesh ajër të pastër e të freskët, kurse ditën të djeg vapa, të lodh e të dërmon, prandaj mezi pret të kthehesh, ani pse i lodhun, por i qetë në shtëpi. Asht kënaqësi, kur i sheh frutet e punës sate në vjeshtë, atëherë, kur mbushen hambaret plot. E asht kënaqësi edhe në dimën, kur bora bie jashtë e stufa në dhomë bubullon, aty zhurma e fëmijëve...

Por...

Zeka!?

Me dorë të vet më paska vorrosë!

Po, njëmend me dorë të vet më vorrosi sot çdo gja.

Çfarë njeriu! Çfarë fytyre! Çfarë ndërgjegje!

Ë unë sot nuk jam ma ai Haziri që jetojsha me të tana ato dëshira, që një ditë të kthehem, të takohem me njerëzit për të cilët më duket se jetoja, e sa vështirë qenka

të mos jetosh për kend, të mos jetosh për kurrigja, e të mos dish as vetë pse jeton! Sot jam i atillë, sa nuk më intereson asgja që ka lidhje me jetën time. Prandaj edhe kjo rrugë e imja e sotme asht e këtillë, e pafund, e padrejtim, e pacak. E, sa vështirë qenka të jetosh pa ndonji qëllim!

Herë - herë më duket se i ngjaj njeriut që kthehet nga vorrimi i të gjithëve, që i kishte pasë, dhe mbas vetes nuk le njeri të gjallë. Më bahet se vetëm para disa çastesh kisha mbulue me dhe gjithshka që kisha pasë deri atëherë dhe kisha mbetë bile pa pasë kush një fjalë ngushëllimi të ma thotë:

«Eee, kurrë të mos kthehem ma?» — e pyes veten.

Çfarë ndryshimi midis dy shkuemjeve të mia! Prej krejt asaj, që kam pasë dikur, tash më kanë mbetë vetëm këto dy shkuemje.

Atëherë largohesha nga katundi, por shpresoja e me vete lutesha të kthehem përsëri, por tash as që mund të mendoj për shpresa të këtilla, kurse në asnjë thërmi të trupit tim nuk mund të gjej ndonji dëshirë për lutje që të kthehem atje.

Unë kam vdekë për të gjithë!

— Zeka! — më kumbon në kupë të kresë.

Më duket se çdo gja rreth meje ka vdekë dhe se asgja nga e kaluëmja nuk ekziston ma. Jeta tani më dukej vetëm një rrugë e gjatë, e pafund, të cilën dashtë e pada-shtë më duhej ta kalojsha, sepse nuk kisha shteg tjetër. Dhe, vetëm një gja nuk më hiqet mendsh tash sa ditë.

— Ç'të mirë ka gjetë Zeka aty, ç'dëshirë ka plotësue ai, kur ja ka arritë qëllimit dhe e ka bindë babën tim se unë kam vdekë? Sa dëshirë e marrë paska qenë ajo e tij, që t'i gënjejë njerëzit! E çfarë fati të zi paskam pasë unë në këtë të zezë jetë? A thue kështu tash do ta kaloj të tanë këtë rrugë të gjatë të jetës së pafat? Çfarë gëzimesh përjetova në të?

I mendova saora të gjitha këto, e bisedova edhe një kohë të gjatë me veten dhe përsëri u ktheva e vërejta një copë herë andej kah mbeti katundi, grueja, fëmijët, prindët... Por ata nuk janë ma të mitë, sepse e di fare mirë

që unë nuk kam kend timin. Kurrëgjja në këtë botë nuk kam, bile nuk i kam as dy duer si të tjerët.

Menjherë m'u duk sikur e tanë ajo kodër m'u lëshue sipër dhe më ndrydhi ashtu të lodhun. Do lot përsëri m'i verbuen sytë, por si për inat nuk i lejova të më pikojsin nga qepallat që m'u dridhën. Prapë e vazhdova rrugën, pak si i lehtësuem, sikur t'i shpëtojsha kodrës që m'u duk se më ndrydhi.

«As tash nuk do të qaj!» — i thashë vetes, sepse doja të jem i qëndrueshëm, të baja zemrën gur e të mos dobësohem edhe para këtyne vështirësive të pafund, sepse më dukej që Zeka do të kënaqej, do të gëzohet, do të qeshte. Por jo, unë nuk do të qaj. Kurrë s'kam qa, edhe kur më kanë goditë vështirësi të mëdha, sepse kam mendue gjithmonë se burri nuk mund të qajë nga vështirësitë.

Kur mbërrita në qytet, muzgu ishte lëshue pandieshëm dhe i mbulonte shtëpitë e pluhnosuna të qytetit të strukun në prehnin e kodrave përreth, që kishin marrë ngjyrë edhe ma të errët nga dritat shkëlqyese.

Mandej u ktheva përsëri mbrapa që të vërej edhe një herë kodrën kah veriu, të cilën shumë herë e shikova atë ditë, edhe pse shpeshherë nuk e pashë, ose ndoshta desha të shikoja rrugën që e lashë mbrapa. Nuk e di çka kam dashtë të shikoj në ato momente, por një herë e shikova qiellin e përhimë, e mandej e shikova edhe rrugën, fundi i së cilës humbte në errësinën e dendun. Derisa isha ndalë dhe shikoja mbrapa, m'u duk se për atë kodër, — që tash nuk mund ta shihsha, por edhe për atë rrugë më lidhte diçka e fuqishme, që nuk më lejonte të ecja, të shkoj përpara. Por, mbasi tash nuk e di çka due dhe çka urrej, sepse i këtitë jam unë tash, që për të gjithë paskam pasë vdekë, njifarë ndjenje e çuditshme ma përfshiu trupin dhe ma nxeu gjakun.

* * *

Kur jam martue, deshta të them, kur asht martue Haziri, ishte pika e verës. Dasma bahej e madhe. Krisma

pushkësh, kangë, hareja e njerëzve. Të gjitha këto më kujtohen edhe tash. Por vështirë qenka t'i përtërish tash ato kujtime për natën e parë të martesës, për fjalët e para me gruen, për ato ditë të kalueme me të.

E tash, si do ta ketë pritë ajo Halimin, vëllain tim, më falni, ai vetëm ka qenë i imi, dhe sot... Si do ta ketë pritë Halimin, kur ka hy në dhomën time... të asaj?

Edhe natën e parë, para se të largohem nga shtëpia e pata pyet:

«— E ti, thueeee... thuese më pret gjithmonë? —» e pata pyetë.

«— Uh njeri! Pse sonte po flet kështu?» — qe zhgrehë ajo në vaj». — «Pse po m'i thue të tana këto? Mos e dhashtë zoti, me të gjetë gja e ligë!» — më pat thanë atëherë.

— Çfarë dasme paska qenë kjo e vëllait tim, a thue? A do të kenë bubullue tupanat, pushka a do të ketë jehue tash si atëherë? Cili prej ygdylxhive do ta ketë marrë i pari shenjën, a thua?

E baba qysh e ka ndie veten, a thue, për këtë dasmë? Për dasmën e vëllait që muer gruen e vëllait!

— Zeka! — më buçet zani i dilemës sime, që asnji çast nuk më le të qetë. Dhe prapë habitem: Ç'e shtyni Zekën të thotë se unë kam vdekë. E njerëzit jetuekan edhe nga shpifjet. Ç'të mirë gjekan edhe në gënjeshtëri ata? Ç'ndërgjegje paskan këta?!

* * *

Vetmia dhe bredhjet e pakta paskan diçka të për-bashkët. Dhe çuditë, sa fort u lidhkan ato në mes veti. E këto të dyja janë shokët e mi të pandashëm, sepse unë jam njeriu që për të gjithë kam vdekë.

Diqysh një ditë vetëvetiu kambët nuk më ndigjojshin dhe ecsha rrugës pa ditë as vetë kah t'ja mbaj, ecsha, si gjithnji, pa ndonji cak. Eca e eca deri në kodrën mbi qytet, sepse më dukej që ajo tollovi, të cilën nuk isha mësue ta ndigjoj dhe ta shoh, më ndydhte e ma zinte

frymën. Aty, në majë të kodrës së zhveshun, vetëvetiu isha ndalë i humbun në do mendime të randa dhe nuk munda të baj asnji hap ma tutje, sikur të më këputeshin të dy kambët në gjunjë. Shikojsha andej kah e disha se asht katundi. Shikova dhe që në çastin e parë ndjeva në vete përsëri diçka të çuditshme, që në fillim, ashtu vetëvetiu ma shtoi fuqinë, ma nxeu gjakun, ma shpejtoi tiktakun e zemrës, e mandej ma thartoi gjuhën, m'i gështoi kambët në gjunjë, sa mezi qëndrojsha. Krahanorin nuk mund ta ngijsha frymë dhe ndjeva do dhimbje të forta, që më përshkuan kryq e tërthor. Nji copë herë shikova andej nga e disha që asht katundi im, ai që dikur ka qenë i imi, sepse tash po e di mirë që nuk asht ma i imi. As unë nuk jam i tij. Unë dhe ai nuk kemi ma gja të përbashkët përpos atyne mendimeve që po më lidhin për të dhe nuk po më lanë të qetë. Kemi vetëm diçka të përbashkët, që mue më shty të mendoj, por edhe ta urrej. Megjithatë, duhet ta pranoj se, sado që po mundohem të ndahem, prapë diçka po më lidh fuqishëm dhe kurrë nuk mund ta heq mendsh, natë as ditë, i zgjuet ose në gjumë.

«Atje due të jetë vorri im...», i thashë vetes.

— Le të thonë njerëzit:

«Vorri i Hazirit, që vetëm i vdekun u kthye në katund, sepse dikush tha që ka vdekë, para se të vdesë, mandej baba i tij vendosi, të tregohet gojë mbas goje e brez mbas brezi, por mos u harroftë kurrë!...»

Kaluen bukur do ditë që nuk po mund të qëndroj e të mos dal deri në atë kodër dhe të vështroj nji copë herë andej kah verilindja, sepse ashtu më duket se çmalle-sha më çdo gja, më dukej se vërej gjithshka ashtu si ka qenë dikur. Por, edhe këto mendime gjithnjë më pikëllojnë, sepse menjherë bindem që nuk jam ma Haziri, ai që kam qenë dikur, kur kisha shtëpi, kur kisha prind, kur kisha grue e fëmijë. Por, tash nuk e di as ç'jam.

— Pse më pikëllojnë ato mendime për jetën e kalueme, për atë jetë të kalueme të Hazirit? Të gjitha i mendoj e më dhimbet edhe ajo, prandaj pikëllohem tash. E tash vetëm mbasdita më asht ma e lehtë, jam ma i qetë, më duket që e heq nga shpina nji barrë të randë, që jam i

detyruem ta mbaj natë e ditë. Tash më duket se çdo ditë e pres të nesërmen për një farë qëllimi, jetoj me njëfarë shprese. Të nesërmen nisem përsëri asaj rruge e si për çudi gjithshka andej. Dal mandej atje në majë të kodrës, ku nuk ka asnjë pjesë ma të naltë e, derisa lotët m'i mje-gullisin sytë, shikoj kah verilindja. Por, mos mendoni se qaj. Sytë vetëvetiu më përloten tue i picërrue drejt horizontit, ku përpiqem të shikoj sa më tepër, sepse mazallah që qajsha edhe në këso gjendje që jam. E më besoni, nganjihërë dëshiroj të qaj, sepse më duket që vetëm ashtu do të shfryj të tanë atë mulla që më ndrydh dhe don të më plasë. Por, menjihërë më kujtohet Zeka, e i them vetes:

«S'due të ligshohem para tij...»

Kur kthehem, çuditem se çfarë ndryshimi ndjej në vete. Shkoj disi gjithnji i shqetësuem e i mbushun frymë nga një dëshirë pushtuese që të mbërrij sa ma parë atje, thuese atje do të gjej dikend fort të dashun, që aq shumë e kërkoj, për të cilin kaq shumë vuej. Njëfarë dëshirë që ma përshkon trupin më forcon dhe atëherë, kur e ndjej veten të ligshohem, përpiqem të mos i dorëzohem pikë-limit.

E kur kthehem?

Me duket se gjithshka që kam pasë ndonjëherë e kam lanë në atë vend, në majë të asaj kodre. Në vete hetoj zbrazëti të çuditshme, e cila më mundon, më pikëllon, më dërmon. Tash e hetoj fare mirë që nuk jam ma ai Haziri i maparshëm, ai që i mbushun frymë nuk ndjejsa për lodhje bile pak ma parë tue u ngjitë përpjetë. E tash teposhtëzes mezi më mbajnë kambët. Çdo gja që pata pak ma parë, tash më duket se e kam lanë në majë të asaj kodre i kthehem i zhgënjyem, i raskapitun, i marrun mendsh, me dhimbje aq therëse në krahanor. Dhe, sa vështirë asht për njeriun, kur bindet se nuk ka kend të vetin. Kambët mezi i nxjerr nga dheu, e mezi lëshohem teposhtë, sikur të mos mundsha me e kontrollue as hapin tim. E kjo po më ngjan përherë, kur kaloj asaj rruge, që, megjithatë, më asht aq e dashun, ma e dashun se gjithshka që kam, por edhe ma e mundimshme dhe ma e vuejtun.

— Thashë: që kam! — po më rrok gazi. Por menjherë më kujtohet se unë nuk jam si të tjerët. Unë mund të jem një trup me dy mënyra jete: një e kalueme, që për mue ka marrë fund njëherë e përgjithmonë, sepse unë për të gjithë kam vdekë, e ajo e tashmja, që ndryshon prej të tjerëve, që vetëm tue e mendue atë të kalueme, aq të dyluftim interesant që zhvillohet në mue, nga ai dyluftim i rreptë, që natë e ditë zhvillohet në mendjen time.

I tanë ai gëzim i pakmaparshëm në mue tretet, sikur të mos kishte qenë, e tash e ndjej veten sikur për mue të kishte vdekë çdo gja, e unë sikur kam vdekë për të gjithë. Dhe e di se unë kam vdekë për të gjithë. Kam vdekë për babën, kam vdekë për gruen, për fëmijët, e kam vdekë edhe për vëllain. Për të gjithë Haziri asht i vdekun. E unë, që sot sillem rrugëve të këtij qyteti, ku njerëzit s'dinë gja për mue, as për dorën e shkurtueme, as për kambën e çalë, as për synin e verbuem, jam tjetër unë, sepse Zeka ka thanë që me dorë të vet në dhe më ka lëshue. Jo, jo, unë nuk jam ma i vjetri, ai që kam qenë përpara sepse, të isha ai, nuk do të isha këtu, nuk do të isha kështu, do të ndalesha atë ditë në katund, por unë vdiqa në rrugën e katundit tim, pak pa mbërritë në kodrën e mbishtëpiave. Të gjithë paskan qa për mue një ditë...

— E atij ç'ju desh të thotë se kam vdekë, se me dorë të vet më ka lëshue në dhe?!

— Edhe njerëz të këtillë paska! — habitem.

E vështirë qenka të jesh i ndamë në dysh: dy njerëz në një! Njani dëshiron të kthehet në katund, për të cilin zemra nuk i qetësohet kurrë, por dëshiron të kthehet vetëm nëse i harron të gjitha këto që i ndodhën tash sa kohë, të kthehet sikur atëherë, kur po vinte nga ajo rrugë e gjatë me të gjitha ato gëzime e askush të mos i dalë para dhe t'i tregojë se... se rruga asht e mbyllun, se baba, vëllai, grueja ja kanë mbyllë derën... Dhe tjetri, që me kambëngulje përpiqet të qëndrojë, që urren gjithshka të asaj ane, që nuk dëshiron të kthehet, atje ku i pari, që

dëshiron gjithnji i panjohun për të gjithë të jetë. Sa dilemë e vështirë qenka kjo. Fëmijët gjithmonë i kam dashtë fort. Dhe vetëm ata, më duket se i lidhin këto dy pjesë të qenjes sime, të cilat ngrehin secila për vete, secila në anë të kundërta; që përpiqen të pengojnë njana-tjetrën, që të dyja së bashku të detyrojnë të largohesh, të shkosh larg e ma larg që të mos të të njohin njerëzit, të mos i shikosh as ti gëzimet e pikëllimet e të tjerëve...

NË GJYQ

Po më pyetni, zotni gjykatës, pse nuk kam mendue pak, pse nuk i kam shikue gjanat ma tepër me mend e ma pak me zemër?

Po më pyetni: pse e kam pru veten në këte gjendje? Me dalë para popullit. Para gjyqit. Unë, vajzë e re (ju po thoni: vajzë e re) në vend se me mendue për të nesërmen time. Me rritë një njeri të ri.

Sepse — jetën e pata të sigurueme. Jam mësuese...

... Rri ulun në bankën e të akuzuemve. Shikimet i ndjej në mue, mbi mue. Të mbarsuna me gjithfarë ndjesish. Cirkojnë shikimet në mue prej të gjitha anëve. Përpara e përmbra. Anësh e prej së nalti. Si shiu i dendun. Si breshni.

Unë i kam lidhë duert mbi gjuhë. Ndonjiherë i hapi, luej me to. Luej me gishta. Nuk jam nervoze, por... luej me ta, pse më duket si gja e domosdoshme. Për të mos mendue për shikimet dhe predikimet e gjykatësit. Për kureshtinë e të pranishëmve.

Trupi gjykues rendit letrat, dosjet, pëshpërit diçka në vete. Fytyrat e tyne më duken pa kurrfarë ngjyre. A thue, njimend, të gjithë gjykatësit janë pa kurrfarë ngjyre?

Trupi gjykues duket mu ashtu si kam lexue shpesh në libra: janë mbledhë si të dojshin me krye ndonji detyrë tejet të rëndomtë, me ba diçka jashtëzakonisht të thjeshtë. Si me regjistruë një akt në arkivë, si me shikue një shfaqje në teatër, si me u ul me hangër bukë, me qëndruë në ndonji vend publik...

U ndigjue zilja e vogël. Shikova përpara, në drejtim të tingullit. Gjykatësi i kishte ra. U çue në kambë. Edhe trupi gjykues u çue në kambë. Edhe mbas meje, ndjeva, u çuen në kambë. Ma banë me shenjë: u çova edhe unë.

Heshtje.

A thue asht kush prej të mive në sallë? — më fluturoi në mendje, mu në këte heshtje, tue ba shamatë ma të madhe se zilja.

Njeni prej trupit gjykues filloi me lexue akt-akuzën time. E unë mendojsha: a thue asht tue ndigjue nana, daja, të mitë? ..

— *Ju lutem, e paditun, na i thueni gjeneraliet!*
Luejta kryet, në shenjë pohimi.

— *Si e keni emnin?*

— *Sadije, Sadije Maliqi. Kështu thirresha përpara,*
— *thashë të vogël.*

— *Emni i babës?*

— *Maliq.*

— *Nana?*

— *Meleqe.*

— *Profesioni juej?*

— *Mësuese. Në një katund mu afër qytetit.*

— *Kur keni lindë?*

— *Më 1930.*

— *Vendi ku keni lindë?*

— *Këtu, në këte qytet.*

— *A keni prindë?*

A kam prindë? .. Si të ju them, zotni gjykatës: edhe kam, edhe s'kam.

Gjykatësi përsëriti pyetjen. Unë e ndëgjova shumë mirë edhe herën e parë.

— *A keni familje?*

— *Babë nuk kam, më ka vdekë tash disa vjet. Asht vra.*

— *Ke keni tjetër, e paditun?*

Kur muerën vesh, më thanë:

Nana: po ku i pate mendtë, he të plaçin sytë!

Vëllai: si do t'u dal shokëve përpara, prej turpit? O, si nuk kërcet reja e me të lanë në vend, por i vret të pafajshmit e ua djeg kasollat!

Daja: për këso pune të rritëm, a? Me na marrë fytyrën, a?!

Kushërijt — edhe ata m'i porositën po këto fjalë .

Të gjithë filluen me kthye kryet prej meje.

— Hupëm prej shtëpie, he të shitoftë zana! — më tha nana.

— Po më vjen turp që të kam pasë motër edhe deri tash — tha vëllai.

— Dera jonë qoftë mshelë për ty sot e njëqind vjet!
— më tha daja. Edhe kushërijt.

— Ke kam tjetër, po pyeti, zotni gjykatës? Kam nanë. Edhe vëlla kam. Edhe një dajë. Dhe disa kushërij të largët.

Po, të gjithë këta janë gjallë. Gjallë janë njisoj si unë, si ju, si gjithë këta që po na ndëgjojnë këtu. Unë kam qenë bijë e tyne, motër, mbesë, kushërinë.

Mirëpo, prej atëherë nuk jam ma. Për ta — kam vdekë kaherë! Njisoj si baba. Edhe pse, sikurse po shihni, jam gjallë ende.

Po, zotni gjykatës, kur më pyetët — a kam kend, nuk ju thashë asnjë fjalë. Heshta. E nuk ju thashë mu për kët arësye. Sepse — kjo asht ma zi se mos me i pasë!

Si quhem sot? Padyshim kam shumë emna. Secili më thërret për qejf të vet. Secili më pagëzon simbas dëshirës së tij.

E di: emna të këqi më kanë vu.

E di: nuk më kanë pagëzue për të mirë.

Nji gja nuk di: çka mendojnë sot të mitë për mue?
A thue ç'asht tue ba nana kët ças? ..

Nuk kam qenë vajzë e llastueme. Kurrë nuk kam ndëgjue kend të më thotë se jam e llastueme. Por, prindët më përdhelshin e më dojshin, si gjithë prindët fëmijët e vet.

Edhe unë i dojsa këta pa masë. Isha e lumtun pse kisha kësi prindësh.

Kur u bana gjashtë vjeçe, baba më muer një nadjë për dore e më çoi në shkollë. Nuk ka nevojë me ju tregue të gjitha përgatitjet që më banë disa ditë përpara dhe at mëngjez. Sidomos nana. E mue më bahej vetja disi krenare, më dukej si të isha e rritun, e pjekun.

Më kujtohet mirë ajo ditë: nana më lau, më kreu, m'i veshi rrobet ma të reja. Tanë kohën më thoshte, se si tash e mbrapa kam me mësue, me u ba vajzë e mirë, me u ba e mençme, «uçitelicë» e nanës, që kanë me e lakmue kojshitë e krejt shehri.

Edhe rrugës, tue shkue në shkollë, i ndigjoshja fjalët e nanës: do të bahes «uçitelicë», gjithkush ka me të lakmue!

— A muj u çove, Maliq? — pyetshin babën të njohunit e tij.

— A në shkollë po e çon, për hajr, a?

— Për hajr, për hajr!..

Hymë në një ndërtesë të bukur. Sa pastër ishte brenda! Dyshemeja me pllaka të bukura shumëgjyrëshe, që shkëlqejshin. Tue ecë mbi to, më duhej me u mbajtë mirë për dore të babës, sepse mund të më rrëshqitshin kambët.

Nisa me u frigue. Disa të dridhuna filluen me ma përshkue shtatin. Nuk dijsa pse. Para një dere gjindeshin plot njerëz të tjerë me fëmijë, si baba im me mue. Pritshin dhe hyjshin me radhë në at dhomë. Disa prej fëmijëve, kur dilshin prej saj, ishin të përlotun, qajshin edhe me za. Kjo ma shtoi frigën edhe ma tepër. Pse qajshin ata fëmijë?

Erdhi edhe radha jonë.

Një njeri, krejt pa flokë, capllak, më muer para duersh. Më buzëqeshi dhe më pyeti, sërbisht, si e kam emnin.

— Sadije — i thashë.

Unë kisha mësue pak me folë sërbisht me fëmijët e fqinjëve.

— E kujt je? — më pyeti prapë.

— E këtij — gjegja tue tregue babën me gisht.

— Si e ka emnin «ky»?

— Maliq.

— Ashtu. E tash ma thuej edhe emnin edhe mbi-emnin!

— Sadije... Maliqi.

— Shumë mirë. Ti do të bahesh nrxanëse e shkëlqyeshme, apo jo?

Unë nuk thashë kurrqja. Baba nisi me ju përgjegjë pyetjeve të tij të shumta dhe të mërzitshme. Ai shënonte diçka në regjistër. Mandej na tha se regjistrimi u krye, e mue m'i përkëdheli flokët tue dalë.

Juve, zotni gjykatës, ndoshta do t'ju duken pa kurrfarë randësie këto imtësi rreth regjistrimit tim. Mirëpo, sikur të më ndigjojshit me vemendje, deri në fund, atëherë do të shihshit se secila «imtësi», simbas mendimit tuej, ka ndikue pak a shumë në prezencën time të sotshme këtu.

Isha fëmijë, por prej atëherë më janë rranjosë dhe më kanë shqetësue disa «imtësi», të cilat më shtyjshtin me mendue. Madje, mendoj se mu at ditë, të parën ditë të shkollimit tim, kam mendue së pari.

Sa dolëm prej asaj ndërtese, pyeta babën:

— Pse foli me mue sërabisht?

— Ashtu duhet.

— Unë nuk di me folë mirë sërabisht.

— Mëson, mëson, pasha babën!

— Pse nuk mëson ai vetë me folë si unë? Ai asht ma i madh. Unë due me shkue te «uçiteli» që flet si unë.

— Nuk ka asi «uçiteli», bijë — më tha baba si me pikëllim, tue shikue me kujdes a thue mos qe ndokush dëshmitar i asaj bisede të pafajshme. Por, gjithkush shikonte hallet e veta. Dy gjindarmë, që kaluen aty pari, banë që të ndërpritet ajo bisedë krejtësisht.

A ishte ky revolti i parë ndaj shoqnisë së atëhershme, qysh në hapin e parë të jetës? Nuk di. Por, i jam shumë mirënjohëse atij çasti, që më shtyni me mendue...

Po, e njoh, unë një vajzë, që ka ditë me mendue mirë e

mirë për gjithshka. Dhe gjithmonë i ka shikue gjanat ma shumë me mend se sa me zemër.

Ishte në klasë të parë të filllores, kur i ranë në sy shumë gjana, që nuk i kishte të qarta:

pse i thojshin shoqet «Turkinja», kur asnji fjalë turqisht nuk dinte?!

pse klasa e tyne ishte e ndame prej klasëve tjera?!

pse mësuesi i tyne i quente me gjithfarë fjalësh, që nuk i kuptojshin, me fjalë të ndyta?!

pse nxënësit e klasës së saj grindeshin me nxanësit e klasëve të tjera dhe i thojshin njani-tjetrit: «Turq» e «Shkije»?!

pse baba i saj nuk gjente punë, si të tjerët, si prindët e shoqeve të saj të shkollës, por jo — të klasës?!

pse baba i saj punonte vetëm argat: me lëvrue, me prashitë, me mbledhë fasule, në ara...

Kur i mbushi dhetë vjet, ajo ndigjoi së pari prej babëgjyshit si kanë zbritë në qytet, para katërdhetë vjetësh. Ai dhe baba i saj nuk kishin mundë ma me jetue në bjeshkë, prandej vendosin me kërkue fatin poshtë, në shehër.

Babëgjyshi nuk mundte me punue kurrëgjja. Ishte plak dhe — i verbët. Baba i vajzës njiherë mezi fiton finarin me ushqye veten e të atin. Mandej — pjek gështeja, bahet hamall — njiherë me samar e ma vonë me kerr të vogël, të cilin e ngreh... Pak nga pak, tue fitue, mbërrin me hapë një bakallhane të vogël, të vorfën. Prej saj veton, por nuk shkon shumë e detyrohet me heqë dorë prej saj. Prapë e kap shatin dhe del — rregullisht — në lamë të argatëve. Atëherë martohet me një vajzë të urtë, shërbëtoe të një pasaniku të madh të qytetit. Me te ban të parën fëmijë — vajzë.

Kjo asht vajza që njoh unë.

Prej babëgjyshit mori vesh se «Shqiptar» nuk don me thanë «katundar», sikurse kishte ndigjue prej vajzave pasanike, dhe se ajo ishte Shqiptare, megjithëse e thirrshin shoqet «Turkinja».

Babëgjyshin e ka pasë shumë të mençëm. Ai i kishte tregue kush janë ata që kanë qejf me i nda shqiptarët në

turq e katundarë, me i shti në grindje kundër njeni-tjetrit, me i anmiqësue edhe me banorët tjerë.

Vajza pak gja merrte vesh. Por — mendonte.

Kur i mbushi të njimbëdhetat, plasi lufta.

Kurrnga nuk e tronditi vajzën ma shumë se lufta.

Në ditët e para i vdiq babëgjyshi. Dy vjet ma vonë nisën me thanë: pat fat plaku që vdiq menjisherë! Paska qenë fatlum babëgjyshi im — thoshte vajza — sepse vdiq pa mbërri me pa çka panë sytë e mi, të një vajze ende të paçueme mirë në kambët e veta.

Çdo ditë shihte ndonji tmerr të ri. Nji ditë: rrahje në mes të pazarit; nji ditë tjetër: të varun në qendër të qytetit; ditën e tretë: të burgosun, në kolonë, tue u tërheqë zhag, të untë, të ligësht, të leckosun; ditën e katërt: tue u dhanë njerëzve voj peshku, përdhunë; ditën e pestë: vrasje në mes të rrugës; ditën e dymbëdhetë: djegje; ditën e njizetë: plaçkitje. Mandej — mitralime aeroplanësh. Bombardime.

Bashkëqytetarët e vajzës filluen me ikë prej qytetit. Ata që kishin dhe mundeshin — shkojshin në katunde, sa ma larg rrezikut të bombardimeve. Të tjerët — e ndër ata edhe familja e vajzës — dilshin në vneshta, jashtë qytetit.

Nji ditë erdhën aeroplanët edhe përmbi vneshta. Filluen me ba harqe mbi burra, gra e fëmijë të tmerruem. Si të donin me u tallë. Ta merrte mendja se mbaroi bota: prej tmerrit, prej klithmave, britmave dhe ushtimës së aeroplanëve. Strukeshin njerëzit nën gixha rrushi dhe brenda në bar; u ngjajshin strukthave, të cilët fusin kryet në zall, tue mendue se janë mëshehë prej gjuetarëve.

Aeroplanët luejtën edhe pak me nervat e njerëzve, mandej i zbrazën disa rafale prej mitralozave të tyne, që vuellën vdekje të shumta në vneshta, ndër të pafajshëm, të vorfun. . .

Nji prej këtyne e gjeti edhe babën e vajzës. Kur e pa kjo të atin të përgjakun, të vdekun, këceu mbi te, gati pa frymë. Klithi prej thellësish ma të mëdha të shpirtit: babë!.. babë!.. Mandej filloi me vrapue nën aero-

planë, ngat plumbave... me e kapë edhe ate ndonjeni prej tyne...

Mirëpo, shpëtoi vajza, e ama dhe vëllai...

Vështirë asht me i kujtue tash këto gjana.

Po, e zbrazët qe jeta që shkel-e-shkoi ajo menjihërë mbas vdekjes së të atit. Pushoi për te çdo gja në jetë. Në ato ditë: kurr gjja nuk mund ta tronditte; në ato ditë: kurr gjja nuk ndodhte; megjithëse çdo gja ishte si ma parë.

Më kujtohet, kam lexue diku: vështirë asht me folë për ditët, në të cilat nuk ndodh kurr gjja. Na duket si mos të kishim jetue në to. Dhe na kujtohen vetëm simbas kalendarit, si ditë kalendari.

Shumë ditë të tilla pat vajza, që isha unë.

Në këte apati e priti ajo edhe ditën, kur përnjimend ndodhi diçka. Çlirimi.

Mbas asaj dite të randësishme, mori pjesë në rindërtim kreu semimaturën — shqip. Te «uçitelat» që flitshin si ajo. E dojshin shokët dhe shoqet, ata të reonit dhe ata të shkollës. Ishte e dashun, e vyeshme, por disi e mbyllun në vete, e tërhequn, tepër e ngathët, thuej e paintesueme për jetën që zhvillohej rreth saj.

Vijshin e kalojshin muejt e majit, muejt e rinisë dhe të dashunisë, por ajo si mos t'i vërente: i përjetonte vetëm si ditë kalendari.

Kështu mori edhe maturën: plotësoi dëshirën e kahershme të nanës: u ba «uçitelicë» e saj!

Tash po e shoh sa e fortë ka qenë ajo vajzë! Sa e qëndrueshme! Tue i kujtue tash të gjitha këto, nuk po mundem me i besue vetes se jam unë — ajo.

A unë jam Sadija, ajo normalistja, së cilës ju afruen aq meshkuj në muejt e majit? Unë, ajo vajza, që mbas çdo ofrimi dashnor shtoi nga një — shok? Unë, ajo vajzë e urtë, e tërhequn? Bijë e nanës krenare, pse po i bahet çika «uçitelicë», motër e vëllait të dashun, mbesë mirënjohëse e dajës, që i mbajti gjallë prej ditës kur vdiq baba, kushërinë e mirë, e mençme, e dashmirëve të familjes së saj?..

Me pasë disi mundësi me u takue ajo Sadije me mue, sot dhe në këte vend, a thue kishte me sharrue në tokë,

për së gjalli? A thue do të turpnohej prej meje, pse dola kaq e dobët para jetës, para rrethit, paragjykimet e së cilit lypet me i luftue me mish e me shpirt?!.

Gjykatësi: — A pranoni se me vetëdije dhe me duert tueja e keni ba krimin?

Nuk dhashë kurrfarë shenje. Ai përsëriti pyetjen. Unë heshta prapë.

Gjykatësi: — Pse nuk pëgjigjeni?

Unë! — Pranoj, zotni gjykatës.

Gjykatësi: — Me vetëdije dhe me duert tueja e keni hedhë fëmijën në lumë?

Unë: — Po, kam veprue me vetëdije, por nuk e kam hedhë në lumë.

Gjykatësi: — Po si, pra?

Kaluen tre muej, e unë mendoja: jam mashtrue! Jam mashtrue!

Kur u binda se jam shtatzanë — ishte vonë me ndër-marrë çkado. — Si t'ja baj tash? — pyetsha vedin.

Shumë net i kalova pa gjumë. Nuk mundesha me ju shkëputë mendimit se kam ba një faj të pafalshëm. Ashtu isha edukue. Prej nanës. Prej rrethit.

Bleva një mantil, të cilin nuk e shkapërthejsa asnjherë veç kur mbyllesha në dhomën time. Edhe mësim fillova me dhanë me mantil. Nuk di çka mendojshin nxanësit për mue dhe për mantilin tim. Në shtëpi, te nana, shkojsa edhe ma rrallë. As para tyne nuk e hiqsha mantilin.

— Mos je gja e sëmunë, bijë? — më pyette nana.

— S'kam gja, jo, nanë, veç jam lodhë pak.

Por, erdhën ditët, kur ishte e pamundun ma me mëshehë ate që dukej gjithnji ma qartë. As mantili nuk më ndihmonte ma. Kot rrejsha.

Çka me ba? — pyetsha veten orë e çast.

Ju rrëfeva nanës. Ma së pari asaj. Mendova: në më kuptoftë ndokush në jetë, nana do të më kuptojë. Mendo-

va: në më ndihmoftë ndokush në këtë rast, nana do të më ndihmojë.

U mbylla në dhomë me te: vetëm unë dhe ajo.

Fillova, me frigë, me të zverdhun fytyre, me të dridhuna në shtat, e — ma vonë — edhe me lot:

— Nanë, i thashë, nanë e dashun, sa fatkeqe paskam qenë!

Nana zgurdulloi sytë.

— Prit, nanë. Prit, derisa të të them çka kam ndër mend me të thanë. Mos më ndërpre, të lutem.

Vazhdova:

— Nanë, asht mbushë vjeti e disa muej qyshse u njoha dhe u dashunova me një djalë. Ta kishe pa, ti nuk do të më kishe largue prej tij. Ishte shumë i kandshëm, i mençëm dhe i bukur, besa. Po të them, ta kishe pa, moj nanë, vetë do të kishe thanë: ju paska falë zoti njenin për tjetrin! Ti e din: unë nuk kam qenë kurr vajzë që mund të dashunohem me këdo. Të kujtohet: shumë vetë u interesuen për mue. Nanë, unë mendoja se nuk do të mundem me dashtë. Mendojsha: asht shue në mue ndjesia për dashuni, asht mbyhtë fuqia në mue me dashë. Ne kemi vuejtë shumë, nanë, apo jo?

Nanës filluen me i shkue lotët. Nuk m'u durue pa qa edhe mue:

— Atëherë erdhi Ai dhe m'u duk se linda së dyti. Ndjeva çka nuk kisha ndie asnjherë gjatë tanë jetës. Ju dhashë me zemër e me shpirt. Mendova se edhe ai më donte po në ate mënyrë. Më bindi se kishte vendosë me lidhë jetën me mue, se nuk mundte me jetue pa mue, se unë jam, në të vërtetë, vetë jeta e tij. Mbas të gjitha këtyne, ju dhashë edhe me trup. Disa muej jetuem shumë bukur, mandej ai la detyrën dhe shkoi shumë larg. Mora vesh, vonë, se jam vetë e dyta...

Si t'i kishte ra pika, nanës ju zverdh fytyra dhe e mbuloi me të dyja duert. Më shikoi mandej me sy të hapun, si të mos më besonte. Uli shikimin edhe në trupin tim...

— Prit, nanë, ta kryej. Ndëgjom, të lutem — i thashë. — Më ndëgjo deri në fund. M'i dërgoi Ai disa letra. Edhe

unë i shkrova. Por kur i tregova në njenën prej tyne se ç'ka ndodhë me mue — heshti përgjithmonë. Nuk dërgoi ma kurrfarë letrash, as kurrfarë lajmi... Nji të shtunë mora rrugë: me e gjetë, me u takue me te. Hoqa mjaft, por u pashë me te. Ja thashë të gjitha. Më priti zi e ma zi... Nanë, prej atij çasti nuk e desha ma. Tanë bota të çohet me na bashkue prap — nuk pranoj. Nuk mundem me e dashë ma... Prandaj vendosa me folë me ty, nanë. Qe, shiko në çfarë gjendje ndodhem. Besoj se do të më kuptojsh. Besoj se do të më ndihmojsh.

Mirëpo, nana nuk më kuptoi. Nana nuk më ndihmoi.

Nana më tha: po ku i pate mendtë, he të plaçin sytë?

Edhe vëllai, kur mori vesh, më tha: si do t'u dal shokëve përpara, prej turpit?! O, si nuk kërcet reja me të lanë në vend, por i vret të pafajshmit dhe ua djeg zemrat e kasollat?

Edhe daja, kur mori vesh, këceu mbi mue: a për këso punësh të rritëm, a? Me na marrë fytyrën, a?

Edhe kushërijt, kur morën vesh, ma këthyen shpinën.

I luta të gjithë. Luta nanën dhe vëllain, dajën dhe kushërijt: me më ndihmue, me më kuptue. Secilit ja tregova punën time disa herë, prej fillimit e deri në fund.

Por, ndera e shtëpisë, fytyra, ishte ma e fuqishme se bija e tyne me fëmijë në bark, se motra e tyne, se mbesa, se kushërina e tyne me dangë të marres në ballë.

Nana më tha: hupëm prej shtëpie, he të shitoftë zana!

Vëllai më tha: po më vjen turp që të kam pasë motër edhe deri tash.

Daja më tha: dera jeme qoftë mëshelë për ty sot e njiqind vjet.

Edhe kushërijt s'patën fjalë të tjera për mue.

E unë nuk gjeta fuqi në vete me u ba ballë të gjitha këtyne, me shpëtue veten si njeri i lirë, që prin kah e reja. Dështova para së vjetrës, para paragjykimeve, para rrethit, para vetëvetes.

Gjykatësit ja pashë fytyrën të zemërueme, kur e shikova.

Më tha: — Pse nuk përgjigjeni, e paditun? Disa herë

ju pyeta: na tregoni, a e keni hedhë fëmijën me vetëdije dhe me duert tueja në lumë? Ju një herë thatë po, pranoj se kam veprue me vetëdije, por nuk e kam hjedhë në lumë. Na tregoni, pra, si keni veprue?

— Më falni, zotni gjykatës, nuk jam mirë, po më merren mendtë, nuk po mundem me folë. Ju lutem, disa minuta pushim, kam nevojë për ajër...

Gjykatësi shikoi bashkëpuntorët e vet, trupin gjykues.

Ata pohuen me krye. Mandej u çue në kambë dhe tha:

— Gjykimin e vazhdojmë mbas dhetë minutash.

Dola në korridor.

N'e nesre të saj dite e nate bisede me të mitë, kur më përzunë përgjithmonë, u ktheva në katund, ku shërbejsha.

Zoja e shtëpisë, grue shumë e mirë, më priti plot zemër.

Mendova: ka njerëz të mirë bota; nuk duhet me u dëshpëru!

U mbylla në shtëpi të saj. Me të hollat që kisha kur-sye dhe me bujarinë e zojës së shtëpisë, qëndrova në dhomë, pa luejtë prej saj, derisa u lirova prej barrës. Ajo më ndihmoi shumë...

Po — ka njerëz të mirë në botë! Ka njerëz të mirë!..

Kur hyna prapë në sallën e gjyqit, vodha me sy ata që kishin ardhë me ndigjue e me më pa. Lypa nanën. Lypa ndokend temin. Por — çka mund të shohë njeriu i paditun, kur hyn në sallë. Ke mund të shohë ai, kur, të thuesh, nuk sheh gja, edhe me shikue!

— Po vazhdojmë — tha gjykatësi. — E paditun, na tregoni si e keni ba krimin?

Muejin e fundit nuk kam dalë aspak në rrugë. Kam qenë e mbyllun në një dhomë katundi, mos me më pa askush. Aty e kam lindë fëmijën. Mandej, mbas disa ditësh, u zgjova herët, shumë herët. Me terr. Erdha këtu, në këte

qytet. E mbështolla fëmijën mirë e mirë, me çka pata dhe e lëshova në ranë; afër lumit, te Ura e Zallit. Kështu kisha ndigjue se bajnë femnat me «kopila», kur duen me i heqë qafet. Kur isha e vogël, pata qëllue te Ura e Zallit, mu atëherë, kur e gjetën një fëmijë të hedhun, që ishte gjallë ende. Edhe djali im ka qenë — asish. Mos mendoni se nuk e kam dashë. Kam qe për te, edhe pa lindë, kam qe për fatin e tij dhe timin. Nuk pata fuqi me luftue me rrethin, me paragjykimet... Me rritë fëmijën pa babë. Isha e papregatitun për një fëmijë të tillë. U d e t y r o v a me e lanë ngat lumit, tek Ura e Zallit. Mendova: do ta gjejnë, do ta shpëtojnë dhe do ta rrisin të tjerët, mbasi unë nuk po guxoj.

— *A ishte gjallë, kur e latë te lumi?*

— *Gjallë, zotni gjykatës, gjallë.*

— *Mirëpo, fëmijën e kemi gjetë të vdekun, tanë ujë.*

Ra shi i madh ate mëngjez. Shiu do ta ketë mbytë, të shkretin. Nuk pata shkue mbrapa, në katund, as në gjysmë të rrugës, kur u pendova. Ju frigova shiut. Do ta mbysë, mendova. U ktheva me vrap. Dhe vendosa: do ta marr, do ta shpëtoj prej shiut, vdekjes. Dhe do ta rris. Vetë do ta rris. Edhe pse nuk ka babë. Edhe pse do të flasë mandej rrethi për mue gjithshka. Vrapova drejt qytetit si e marrë, e lagun deri në palcë, e tmerrueme. Shiu jo vetëm që nuk e pat mendjen me mejtë, por filloi edhe breshni. Kur erdha në Urë të Zallit, fëmijën nuk e gjeta ma aty ku e kisha lanë.

— *A nuk keni mendue aspak se mund ta marrë lumi? Pse nuk e keni lanë në ndonji vend tjetër?*

(*Kështu asht zakoni në këtë qytet: me i lanë ngat lumit, tek Ura e Zallit. Nuk ma ka marrë mendja se mund ta marrë lumi. Kush e dinte se do të bijë shi e breshën mbas një kohe të shkurtën?!*)

— *Po me ke e keni at fëmijë?*

Shumë ditë përpara ndëgjuem se do të na vijë një kolegj i ri, si drejtor i shkollës, ku shërbejsha unë. Morëm vesh se quhet Kadri dhe studjueka në shkollë të naltë pedagogjike.

Deri atëherë nuk kishim drejtor. Detyrën e tij e kryente mësuesi që ishte bashkë me mue njëri në moshë, tepër konservativ dhe me shumë pak njohuri pedagogjike. Para se të dilte mësues, kolegu im kishte qenë — hoxhë.

Lajmi i ri më gëzoi pa masë. Megjithëse nuk e njihsha aspak. Dhe isha plot kureshti çfarë njeriu do të jetë.

Mendojsha: çfarëdo me qenë, padyshim do të jetë ma i mirë se ky që asht.

Erdhi, kur nuk e pritshim. Na gjeti në mësim. Ma së pari kishte hy tek unë.

Sa u hap dera dhe e pashë në prak, e dita: Kadriu asht.

Nxanësit u çuen në kambë. Mue ma përshkoi shtatin një e dridhun e lehtë, të cilën nuk dita me shpjegue a asht prej gëzimit, apo prej turpit, prej habitës apo prej respektit.

— Vazhdoni, vazhdoni — tha Kadriu buzëgaz — veç vazhdoni. Unë jam Kadriu. Kadri Resuli, drejtor i ri...

— Gëzohem. Unë jam Sadije Maliqi... Nuk ju pritshim sot, na falni që na gjetët kështu, të papregatitun.

— S'ka gja, s'ka gja. Vazhdoni mësimin. Desha vetëm me u njohë, — tha, prapë tue qeshë, dhe doli.

Përshtypja e parë, në ndërrijen time, që: shumë njëri i mirë, simpatik, i ri dhe mjaft i bukur.

Nuk di si bana mësim ate ditë.

Shpejt u shoqnuem. Neve, madje, nuk na duhej shumë: mue dhe Kadriun na bashkojshin, para së gjithash, mosha, botëkuptimet e njejta, bisedat interesante.

Gjindeshim, gjithnji ma shpesh, njëni afër tjetrit — edhe kur nuk ishim në shkollë. Katundi kishte rreth të bukur, natyrë të kandshme, një pyll shumë tërheqës për të kalue në te orë të tana, me qejf.

Unë e Kadriu filluem me dalë në sheti shpesh. Unë i rrallova tepër të shkuemet në qytet, te nana e vëllai. Vazhdimisht arësyetohesha para tyne: kët të diel kemi

konferencë në katund, prandaj nuk mund të vij. Ose: këte javë na vjen inspektori, më duhet me u pregatit mirë. Ardhja e inspektorit zgjatte me muej. Çka kam me ba, u porositja të mive, s'kam çka me ba! Më duhet me qëndrue, megjithëse nuk po kam dëshirë me mbetë në katund dhe aty me kalue të dielat.

Rrejsha.

Konstatimi i parë për ndjenjat e mia të reja qe: fillova me mëshehë të vërtetën para ma të dashunve të mi. Për të parën herë në jetë.

Por, cila asht ajo vajzë që do t'u bante ballë shetive dhe bisedave me Kadriun? Cila asht ajo vajzë që do të mund të qëndronte e painteresue me për praninë e tij sa ma të gjatë, për buzëqeshjet e tij infektuese, pushtuese?

Ma së pari na u dashunuen duert. Menjherë mbas orëve të mësimit, mbas dreke, kapnin njena-tjetrën dhe niseshin në drejtime të njohuna: me shetitë në natyrë. Përqafshin njana-tjetrën, përkëdheleshin, luejshin. Herë kjo e imja gjindej në shuplakën e tij, herë i përzihejshin gishtat, herë lidheshin vetëm me gishta të vegjël.

Ne nuk flitshim kurrë: i lejsim duert tona të dashunue me folë. Unë ndjejsha kënaqësi të papërshkrueshme me mbajtë dorën sa ma gjatë në shuplakën e tij. Edhe kur mbërrishim ngat ndonji druni, e duhej t'i ndajshim duert tona të lidhuna, ai në njenën e unë në tjetrën anë — mbeteshim si rob: nuk donim me na i nda duert e përqafuna një dru i zakonshëm mes rruge. Herë vinte ai në anën time, herë dilsha unë në anën e tij. Duert i lejsim të pacenueme...

Mue më pëlqejshin shetitë me Kadriun, i doja bisedat me te. Ndoshta ma tepër se sa duhej, në fillim. Por, unë nuk kisha faj: kam pasë nevojë të madhe për një njeri, me të cilin do të mund të shkëmbejsha dy-tri fjalë të nderës.

Me kolegun tim të parë, me mësuesin ish-hoxhë, bisedojsha vetëm atëherë, kur duhej thanë diçka, zyrtarisht, në lidhje me mësimin. Edhe atëherë, rëndom, grindeshim. Sepse, unë nuk pajtohesha me metodat e tij «pedagogjike», të përfutueme në mejtepe. Unë kisha krye shko-

llën normale, isha mësuese e kualifikueme. Ai kishte qenë dhe mbetë vetëm — hoxhë.

— U ba gjithkush me dhanë mësim sot — ankohej ai. — Femna asht për punë shtëpie, e jo për shkollë.

Nuk më mërztitshin shumë fjalët e tij, megjithëse nuk isha krejt indiferente, kur i thoshte. Por, kisha zojën e shtëpisë që më donte dhe e dojsa. Kisha vajzat e katundit, të cilat dëshirojshin me ndejë me to sa ma shumë, me u tregue jetën time në shkollë, jetën e qytetit, me u folë për çdo të re që dijshe, apo kisha ndëgjue.

Kështu më kalojshin ditët dhe mezi pritshe me ardhë e shtuna, me shkue në qytet, te nana e vëllai, me shikue ndonji film të ri, me u pa me shoqet e mia të shkollës, që shërbejshin aty, me shetitë.

Ato më pyetshin: si po e kalon, moj Sado, në katund? A po mërztitesh? A je ba Afërditë e vërtetë, apo jo?

Qyshse kam pasë lexue «Afërditën», e cila më pat pëlqye aq shumë dhe e desha menjherë, vendosa: do të bahem edhe unë mësuese katundi. Si Afërdita.

Mirëpo, erdhi Kadriu dhe i ndërroi të gjitha. Ndryshoi gjithshka rreth meje: ma zhduku at monoton katundi, më liroi prej grindjeve me mësuesin ish-hoxhë, më bani me u interesue për shumë gjana të bukura në jetë. Pa te, kurrë nuk do të kisha shijue bukurinë e natyrës së katundit ku shërbeja. Pa te, nuk di si kam mundë me qëndrue. Sa erdhi, ndjeva se e kam pritë. Gjithmonë kam pritë me ardhë, ky, Kadriu, dhe asnji tjetër. Kështu si ishte: i buzëqeshun, i kandshëm, i mençëm, edhe i bukur, besa.

Kadriu kishte lexue shumë. Madje, merrej edhe me shkrime. Më thoshte: deri tash vetëm kam shkarravitë, kurrëgjja s'kam shkruue ende. Por, ti do të jesh motivi im i parë, i pari frymëzim i imi.

Ka pasë njifarë poezie të veçantë tanë kjo marrëdhënia jonë në ditët e para të ardhjes së tij në katund.

Nji ditë më tha: Sadush, po më pëlqen si shoqe, si kolege dhe — si vajzë. Ke njifarë elegance në të sjellun, njifarë krenarie në shoqni, njifarë bukurie në pamje, njifarë ambëlsie në të folun... sa nuk kam fjalë me i për-

shkrue. Dhe — nuk kam fuqi me u ba ballë... Sadush, unë jam dashunue në ty.

A kishte nevojë me ma thanë?

Pse ta thoshte kët gja, kur unë vetë ja kisha thanë, saherë, me shikime, me duert tona të dashunueme, se edhe vetë jam e tij, se e due.

Shpesh kam mendue: jeta ime, njimend, kishte me qenë një roman i mirë. Ah, sikur të dijsha me shkrue!

Vazhduen takimet tona kështu rregullisht. Katundarët filluen me pëshpëritë dhe me shikue me dyshim intimitetin tonë të tepruem.

Konstatimi i dytë për ndjesitë e mia të reja qe: dashunia po të detyrueka edhe mos me ça kryet fort për fjalë e shikime të botës.

Kurr gjja nuk mund të më ndajë prej Kadriut! — mendova prej asaj dite e tutje, deri vonë...

Gjykatësi: — Po mirë, e paditun, a keni ndër mend me folë, apo po presim kot?

(Pse po zemëroheni, zotni gjykatës? A mendoni se asht lehtë me ju përgjegjë pyetjes suej? Shkurt, me u çue dhe me thanë: po, fëmijën e kam pasë me Kadriun?)

Ju do ta thirrshit Kadriun. Edhe ai do të vinte këtu, në gjyq, para gjithë këtyne njerëzve. Dhe do ta pyetshit: a asht fëmija juej ai që bani kjo femën?

Kadriu do të zverdhej në fytyrë, si at ditë, kur e vizitova, por do të ngulte kambë: jo, kurrfarë fëmije nuk kam pasë unë me kët femën.

Kadriu do ta mohonte kategorisht, si at ditë, kur e vizitova).

Gjykatësi: — Folni, e paditun! Fëmijën do ta keni pasë me ndonji njeri, medoemos. Na thueni: cili asht?

Unë: — Zotni gjykatës, do të dëshirojsha dhe do të isha shumë ma e lumtun, nëse nuk ja përmendi emnin sot dhe në kët vend. A ban?

Gjykatësi: — Nuk po e shoh të arësyeshme aspak. Pse mendoni se nuk duhet me tregue emnin e të atit të fëmijës suej?

Unë: — Zotni gjykatës, fëmijën e kam ba unë dhe me vetëdije e kam lanë në ranë, pa u këshillue me askend, pra — as me të atin e fëmijës.

Gjykatësi: — E paditun, mos harroni se me këte jeni tue ja keqësue pozitën vetes! Po ju tërheq vërejtjen edhe një herë: na tregoni, cili asht baba i djalit? Gjyqi ekziston me i sqarue gjanat dhe don me i ditë të gjitha hollësitë...

(Po doni me më ba edhe ma fatkeqe se sa jam? A mundet gjyqi me ma kthye djalin, me ma kthye dashuminë e nanës, e cila nuk don me ndigjue për mue? A mundet gjyqi me ju përgjegjë, në emën të vëllait tim, të gjitha letrave që i dërgova deri sot në ushtri? A mundet gjyqi me më lidhë prapë me Kadriun? ...)

Ma pak, shumë ma pak se një vjet të tanë shkollor zgjati dashunia ime e madhe — dashunia jonë e përbashkët, atëherë. Menjherë mbas mbarimit të vjetit shkollor Kadriu shkoi në Beograd. Duhej të diplomonte.

Tue u nda, më tha: Sadush, mos u mërzit! Rregullisht kam me të shkruë letra. Kurrë nuk kam me të harrue!

Kur shkoi, m'u duk si të kisha mbetë krejtësisht e vetmueme në botë. Çdo gja më dukej e zbrazët, asgja nuk mund të ma plotësonte mungesën e tij. Në katund nuk qëndrova ma asnji ditë. Në qytet më dukej gjithashtu zbrazët pa Kadriun.

Mirëpo, letrat më qetësojshin mjaft. Kadriu më shkruente rregullisht, ashtu si më pat premtue. Edhe unë i përgjigjesha secilës letër, brenda ditës.

Mezi pritsha me kalue pushimet. Shtatori më dukej shumë larg, megjithëse duheshin vetëm edhe dy muej. Në shtator diplomonte Kadriu dhe kthehej prap mbrapa, në katund, në shkollë, tek unë.

Kështu ishim marrë vesh: mbas diplomimit do të martohemi e mandej, të dy do të studjojmë, privatisht. Unë shkollën e naltë pedagogjike, e ai — letërsinë në fakultet.

Ditët më kalojshin tue pritë letër prej Kadriut dhe tue i shkruë. Nanën e rreja, si gjithmonë: po më shkruen

nji shoqe e ime e shkollës, që asht tue studjue në Beograd, njifarë Kadrije, nuk e njeh ti, nuk asht prej qytetit tonë. Nana më besonte, sepse e dinte që unë nuk e kam mashtruar kurrë.

Ndonjihërë, rrallë, dilsha në qytet, me ble letra e pulla, me hedhë vetë letrën në postë.

Nji ditë m'u muerën mendtë, gati u rrëzova në mes të rrugës. U frigova: ç'pata ashtu menjihërë? Mos jam e sëmundë? Por, shumë shpejt më kaloi.

Mbas nji jave u përsërit e njajta gja. Tash më hyni droja për tamam. Kryet më dhimbte shpesh, apetit nuk kisha aspak, më vjellej. Fillova me u ligstue.

Por, fillova edhe — me dyshue: a mos asht e mundun?! U tmerrova vetëm pse më ra ndër mend kjo gja! Po nëse ndodh me të vërtetë? Qyqja unë!..

Ngushëllojsha vedin: sa budallaqe jam edhe unë! Verë asht, dielli me të pjekë, vapë. Gjithkuj i ndodh kjo.

Dy muej zgjati dyshimi. Mandej vendosa, me njimijë turpe e droje, me u këshillue me mjekun. Kur më shikoi e më tha: keni mbetë shtatzanë! — m'u ba se u shemb bota! M'u rrotullue ordinacioni dhe mjeku në te, m'u muerën mendtë... nuk më kujtohej ma çka ndodhi. Më kishte ra të fikët.

— A ka ndonji shpëtim? — luta mjekun. — Unë jam vajzë, nuk jam e martueme, as e fejueme, madje! Ju i dini zakonet tona! I dini njerëzit tanë!..

— Mjerisht, vonë asht me ndërmarrë çkado. Mandej, kjo jo vetëm që asht e ndalueme me ligj, por edhe do t'ju rrezikonte jetën... Duhet të luftoni kundër... — ndëgjova, tue dalë, fjalët e doktorit.

Nuk di si jam dukë rrugës, tue shkue në shtëpi. Nuk di as kah kam kalue, kush më ka pa... .

Kam hy në dhomë dhe ja kam fillue vajit, me shpirt, me ankth. Nana u frigue: ç'asht, moj bijë? Çka të ka ndodhë?

E gënjeva prap, natyrisht. Kryet po më dhemb — i thashë. Tepër po më dhemb kryet, po do me m'u ça, nanë!

E rrejta. Për të satën herë? A vetëm në rrena u bazueka dashunia?, mendova. Pse jam e detyrueme me rrejtë

nanën, që e kam dashë dhe e due Kadriun? .. Pse detyrohem me rrejtë tash? .. Turpi? .. Zakonet? .. Bota? ..

M'u kujtuen shpesh fjalët e doktorit. «... Duhet të luftoni kundër...» E dijsa kundër kujt duhet të luftoj. Edhe qesh e gatshme me luftue, vendosa me luftue. ..

Vendosa: mos me mbytë një jetë të re në mue, një krijesë të dashunisë sime. Vendosa: s'do të çaj kokën për turp, për zakone, për botë.

Menjiherë i shkrova Kadriut. I tregova hollësisht çdo gja. E në fund, edhe vendimin tim: ne e kemi për detyrë, Kadri, i thashë, me e pritë plot gëzim frutin e dashunisë sonë... përkundrejt zakoneve e fjalëve të botës... e kemi për nder me qenë njerëz, me qenë... .

Mbas dy ditësh mora telegram prej tij. Në te ishin vetëm tri fjalë: «Nuk besoj — Kadriu».

I shkrova edhe një letër tjetër. I tregova edhe një herë të gjitha simptomat para vizitës së mjekut dhe vizitën e fjalët e mjekut.

Mbas dy ditësh — nuk mora telegram. Nuk mora as letër.

Kadriu nuk e pa të udhës me më shkruë kurrë ma!

Gjykatësi: — Pse nuk përgjigjeni, e paditun? Sa duhet të presim?

Unë: — Sepse nuk po mundem, zotni gjykatës.

Gjykatësi: — Na thueni emnin e babës së djalit!

Unë: — Nuk mundem, nuk mundem, jo!

Gjykatësi: — A e keni të qartë, o femën, se jeni e paditun për një krim, për një vdekje, për një jetë? Pse nuk mendoni pak çfarë rrjedhimesh mund të keni?

Unë: — Kam veprue me vetëdije, zotni gjykatës. Kam qenë shumë e dobët, shumë e dobët... nuk gjeta rrugë tjetër... .

E kam dashë aq shumë, sa do t'ja kisha dhanë edhe jetën. Ai asht i pari mashkull që kam dashë në jetën time. Mendojsha se kam gjetë njeriun që më duhet, shokun e jetës.

Mbasi nuk më shkruente ma, as nuk donte me ndigjue për mue, shkova unë e kërkova e gjeta dhe biseduem.

Sa shumë u mashtrueka njeriu në njeriun!

Kurrë nuk e kam njoh Kadriun të atillë. As nuk kam mundë me e mendue ashtu. Shkurt, nuk desht me ndëgjue për kurrfarë shtatzanie. Por, kur u bind, qe aq i panjerëzishëm, aq karakter dobët dhe shpirtnisht i ulët, sa pati fytyrë e guxim me thanë: kët fëmijë mund ta kesh me ndonji mashkull tjetër, moj çikë!..

Me trenin e parë u ktheva mbrapa.

E ju tash, zotni gjykatës, po kërkoni prej meje t'ju them emnin dhe mbiemnin e tij. Pse? Me nda fajin tim? Me marrë edhe ai dënimin që meriton për vdekjen e djalit tonë?

Jo, zotni gjykatës. Kurrë nuk kam me jua tregue emnin e tij. Le të vazhdojë studimet. Ai studjon tash letërsinë. Do të bahet profesor dhe do të merret me shkrime... Qe, tash po i plotësohet dëshira: jeta ime do të jetë motiv i mirë. Fatin tim dhe përpjekjet e mia do të mund t'i përshkruej shumë bukur dhe besnikisht, sepsë i njeh deri në hollësi, me rrajë. Sepse edhe vetë gjindet në një pjesë të jetës sime: në ma të lumtunën dhe ma fatkeqen... Nji gja më intereson: a thue si do ta paraqesë veten. A thue do të pendohet ndonjiherë për ate që bani me mue — Sadushen e tij? ...

BAZENI

Natyrisht unë nuk guxoj të pyes pse je i tillë, baba, në kohë të fundit, ç'ke që je gjithnjë e më i mërzhitur, ti nuk ke qenë i këtillë përpara. Edhe pse sa herë e pyes ndonjë gjë, ai ma kthen me të rreptë e pa u menduar fare. Trus bythën e këqyr punën tënde. Edhe sot ma bëri njësoj, ndonëse prita të më përgjegjej mirë, sepse unë kisha nevojë të madhe të më përgjegjej për atë që e pyeta. Unë e pyeta me zë të ulët e me të butë, ashtu si flas gjithmonë me babain tim e jo si disa që llastohen e përqyrraven për çdo fjalë. Unë e pyeta babain tim: — Është e vërtetë apo jo, baba, se edhe ti e ke punuar bazenin tonë. — Më duhej përgjegjja e tij, pse u pata zënë me disa fëmijë të tjerë, moshatarë të mi atë ditë atje në bazen. Ata më thanë: — Ti s'mund të lahesh këtu, bazeni është i yni, ti lahu në Bisticë, ose lahu te Tabhanet, ose lahu në jaz, ose lahu në përrua, lahu ku të duash ose mos u laj aspak, por këtu ti nuk ke të drejtë. — Edhe plot fjalë tjera më thanë. Atëherë ua ktheva unë: — Bazeni është edhe imi sa juaji, edhe babai im ka punuar në të, ai vetë më ka treguar, ndaj s'mund të më ndaloni të lahem. — Nejse, u zumë, por nuk u rrahëm e unë kisha dëgjuar se këta madje ishin rrahur me kapeshmicanat. Edhe me ata kishin pasë filluar njësoj, jo nuk guxoni të laheni këtu, jo mund të shkoni e të laheni në kanal a mos të laheni aspak a ku e di unë ç'kanë biseduar ndër vedi, por më në fund ishin rrahur mirë.

— A është babai këtu? — e pyeta nënën posa u ktheva nga bazeni. Bëra keq ndoshta që nuk vazhdova të la-

hem, ata sigurisht kanë menduar se u frikësova, ndaj dhe ika menjëherë nga bazeni. Por unë erdha me vrap në shtëpi për të gjetur babain e, mundësisht, edhe ta marr me vedit, le t'u thotë edhe ai vetë me gojë të tij se asnjë fëmijë nuk mund të na ndalë të lahemi edhe unë edhe shokët e mi në bazen. Nuk ka të drejtë, as nuk guxon. **Babai im ka punuar në bazen, edhe ai ka punuar bashkë me të tjerët, e ka punuar bazenin bashkë me ata edhe për fëmijët e tyre edhe për fëmijët e vet, dua të them edhe për mua. Ç'ka po të duhet baba? — tha nëna. Dhe unë as që ju përgjegja, por fillova të bërtisja:**

— Baba, baba, o baba! — E dijsa se do të jetë në shtëpi. Kohëve të fundit, posa kthehet nga puna, mbyllet në shtëpi dhe nuk del fare, as me fqinjët nuk bisedon, është vazhdimisht i drojtur, i mërzhitur. Nuk di ç'ka baba im kohët e fundit. — Ç'ke, hej, pse bërtet kështu? — ma bëri babai dhe unë gati u friksova t'i dal para, kur e pashë të atillë. Një çap madje dhe harrova ç'desha të pyes, për çka u ktheva me vrap nga bazeni një sipër kishës deri këndeje në fund të qytetit, afër stacionit, ku gjindet shtëpia jonë. — Folë, pra, ç'ke, ç'do? — ma bëri baba, tani edhe më i mrrolur e me zë edhe më të rreptë. Sa fort e lakmova në atë çast babain tim të atyre ditëve të para, kur për çdo gjë vetëm më përkëdhelte, më miklonte, më merrte në prehër dhe, pa ditur gjë, më fliste plot gjëra të bukura. Shpesh ma përmendte edhe bazenin, se si janë mbledhur bashkë dhe kanë vendosur ta zbukurojnë atë djerrinë ku nuk shkelte këmbë njeriu e të bëjnë një bazen ku do të lahen të gjithë fëmijët e qytetit tonë e do të luajnë ndër vedit e do të kumbojë lart e më lart gazi i fëmijëve, gazi ynë gjer atje lart te Maja e Hasanit. Më vonë ju tregoj ç'ka ka qenë për ne Maja e Hasanit. Edhe bazeni, natyrisht, sepse mua më bëhej gjithnjë se, sikur të mos e kishim patur bazenin, këtë që e punoi edhe babai im bashkë me prindërit e tjerë të fëmijëve të tjerë, ne as që do të mund ta merrnim në gojë Majën e Hasanit, e cila na joshte vazhdimisht, gati-gati na cytte, si të donte të na thotë: «Më shkëlmi, më pushtoni, eni në majën time,

po nuk mundeni, nuk jeni të zot, nuk mundeni, nuk mundeni...»

Nejse, unë nuk i thashë babës se ishim zënë ndër vedi, vetëm e pyeta me zë të ulët e me të butë ashtu si flas gjithmonë me babain tim e jo si disa që llastohen e përqurraven për çdo fjalë. E pyeta babain tim: — Është e vërtetë apo jo se edhe ti e ke punuar bazenin tonë. Njëherë më pyeti se cilin bazen e, kur unë i thashë «bazenin tonë, bazenin e madh, atë që lahemi, atë mbi kishë, në të dalë të qytetit, gati në Grykë të Rugovës, babai ma ktheu pa një pa dy: — Trus bythën e kqyr punën tënde. Atëhere erdhi edhe nëna e u interesua edhe ajo ç'kam, pse jam mbushur me frymë, pse kam vrapuar kaq shumë. Unë nuk i thashë kurrgjë, vetëm ula kokën e mendojsha a duhet t'i zemërohesh babait tim pse ma mbyll kështu gojën vazhdimisht dhe çka do që e pyes nuk më përgjigjet ndryshe, po: «Trus bythën, apo...» Nëna pastaj e pyeti babain. — Ç'ka djali, o njeri, ç'ka do? — Dhe babai ja ktheu edhe asaj shkurt: — Trus bythën e shko kqyr punët e tua. Nëna nuk më tha më kurrgjë edhe babai nuk tha më kurrgjë e unë ngela në vend, nuk dijsa a të hy në shtëpi, apo të kthehem prapë në bazen. Atje ishte edhe Fetahu, edhe Syla, edhe Mithati, edhe Ramizi. Atyre nuk u tregova se u zura me fëmijët e nuk u tregova ç'më thanë. Në atë kohë ata ishin habitur duke mbledhur mana nëpër kodrat afër bazenit. Edhe unë i pëlqejsha manat, edhe vetë nuk di pse nuk shkova atë ditë bashkë me ata për të mbledhur mana. — Eja, Ahmet, — më ftuan, — eja të shkojmë për mana, pastaj kthehemi e lahemi! Eja, o Ahmet Shotani — ma bëri me gaz Syla. Syla gjithmonë mahitet me mua, me mbiemrin tim, kinse nuk mund ta mbajë në mend mbiemrin e vërtetë dhe më quan Shotani. Ndonëse fort mirë e di se unë quhem Ahmet Koshutani. Herë-herë fillon mirë Ko-shu... e pastaj përnjëherë, kinse i merret goja, e thotë vetëm atë Shotani. Në fillim, e drejta, zemërohesh pak, më vonë fillova të qesh edhe vetë e tani, sikur të më thërrasë ndryshe, më bëhet se tallet me mua. Më ftuan, pra, të mbledh mana e unë nuk shkova, edhe vetë nuk e di pse nuk shkova. Sikur të

kisha shkuar me ata, me siguri nuk do të isha zënë me fëmijët. Ndoshta jo, po ndoshta edhe po. Në mos atë ditë, me siguri ndonjë ditë tjetër. Ndash mendova se kam bërë mirë që nuk kam shkuar me shokët. Mirëpo babai më shpuri në hall edhe më të madh. Nuk dija a duhej të mër-zitesha më shumë për këtë që më thanë fëmijët në bazen e për bazen, apo për mërzinë që e kishte kaplisur kohët e fundi babain tim e sa vinte i bëhej më e madhe e më e padurueshme. Më thoshte mendja se mos është sëmure, gjë që e vuan në vedi, nuk do ta frikësojë nënën, nuk do të më trishtojë mua. Herët zgjohet e unë, duke ja shikuar sytë, unë vetëm sytë ja shikoj babait tim gjithmonë, vetëm sytë më bëhet se nuk i ka mbyllur tërë natën, mezi thotë ndonjë fjalë dhe shkon në punë si të mos kishte dëshirë të dalë nga dera. Kur kthehet, nuk flet as aq sa ka thënë në mëngjes e në mëngjes, ju thashë, gadi-gadi nuk i thotë dy-tri fjalë. Pastaj, mbyllet tërë ditën në shtëpi. Lexon ndonjë libër, por më së shumti «Borbën» dhe «Rilindjen», i ka blerë gjithmonë. Mua më dërgonte vazhdimisht t'ja bleja dhe unë dëgjojsa ardhjen e trenit e vrapojsha në Zall t'i merrja të dyja gazetatat. Në kohë të fundit, babai im ble vetëm «Borbën», nuk e lexon më «Rilindjen». Unë mendova njëherë: «E varfër është «Rilindja», s'ka shumë materiale interesante për të lexuar, ndaj nuk e ble babai. Unë jam ende i vogël për të lexuar gazeta, unë marr vetëm «Pionierin» e aty vetëm ndonjë vjershë lexoj. E luta një ditë babain: — «A do të ta blej edhe «Rilindjen»? Ai ma ktheu prapë si zakonisht: — Trus bythën po të them». Nuk e pyeta më. Ndoshta mendon të kursejë, më shkon mendja, mundet që i ruan të hollat. Edhe radion e shiti papritur. E kemi pasur atë që i pat dhënë sindikati qysh në dyzetetë, një «Kosmai» që nuk dinte të prishej kurrsesi. Shtatë vjet qe me ne. E shiti para disa ditësh. Unë kam qaj të atë ditë tërë ditën: — Si do të bëjmë pa radio, a bën shtëpia pa radio, — i thashë — si bën pa radio? Derdha lot përpara tij e ai ma preu: — Trus bythën, atë bëj.

Ne të tre flinim në një dhomë. Një natë, kur unë u

shtiva se kam fjetur, madje edhe krratnja herë-herë për t'i bindur se jam në gjumë, dëgjova një bisedë midis nënës e babait, që më bëri të mendoj shumë e nuk dija si të mendoj e ç'të mendj.

— Jo, moj grua, jo, kurrën e kurrës, jo, edhe sikur të di se më bëjnë copë e grimë, — i tha babai nënës — le të shkojë kush të dojë, unë jo. Ç'lypim ne atje, ç'do të bëja unë atje, ç'do të bënte Ahmeti? Atëhere tha nëna:

— Kishin shkuar ca të Kullashve, ca të Pilinxhurkajve, edhe Demajt po mendojnë të shkojnë. Muhaxhirët i kishin nxjerrë «visikat»...

— Trus, grua, e mos më lodh, gjithkush ka hall e veta, gjithkush hesapet e veta, unë i kam të miat, unë nuk luaj vendit, unë nuk shkoj, edhe sikur të më bëjnë copë e grimë. — Ishalla ty nuk të bëjnë gjë, — i tha nëna — ç'do të bëja unë e zeza pa ty e me Ahmetin e vogël, si do të jetonim, nëse ty të gjen gjë? — Trus, grua, e mos më lodh, nuk di gjë ti edhe mos qaj, se po e zgjon fëmijën — i tha babai. — Nuk po kuptoj, — shtoi ai, — pastaj nuk po i kuptoj disa gjëra, nuk di ç'është kjo, ndoshta nuk më punon më truri! Mundet të jetë ndonjë gabim, është e mundur të jetë e vërtetë kjo, apo të zgjasë shumë. Megjithatë, unë nuk po kuptoj edhe nuk po di si t'ja spjegoj vendit këtë, por pa dyshim do të jetë ndonjë gabim edhe nuk do të zgjasë shumë. . . Edhe shumë foli babai atë natë, mua më dukej si të fliste me vedi atë natë ai, si të grindej me vetveten. Unë, natyrisht, nuk kuptoja gjë ku di unë për çfarë fliste babai im, mua më kishte përfshirë vetëm halli i bazenit, ç'do të bëhej me ne dhe me të dhe sikur të ngjante gjë, ku do të laheshim, ku do të argëtoheshim, ku do të gjendeshim e të luanim. Mirëpo nëna ngulte këmbë të shkojmë edhe ne ajte ku kishin shkuar Kullashët, Pilinxhurkajt, ku mendonin të shkojnë Demajt, për ku i kishin nxjerrë «visikat» muhaxhirët. . . E babai vazhdimisht ja mbyllte nënës gojën me atë. «Trus e mos folë, ti nuk di gjë; tani nuk po di as unë e jo ti», e bukur shumë e zgjatën kështu ndër vedi, dikur pushuan. E mua atëherë filluan të më silleshin ndër mend gjithfarë mendimesh. Nuk më merrte më gjumi. M'u kujtua se edhe Muhamedi kishte

shkuar atje për ku fliste nëna. Për ne të gjithë pat qenë befasi e madhe si shkoi Muhamedi, shoku ynë i klasës. Ne të gjithë e donim. Edhe ai neve, por tha: «S'ka shteg tjetër puna e babës dhe puna e vëllait të madh.» Ne e dinim punën e babës edhe punën e vëllait të madh. Babai i tij ishte i papunë e vëllai i tij një kohë punoi si mësues, pastaj, kur doli në gjimnaz, atje një ditë erdhën dy veta me një automobil të mbyllur dhe e muarrën. Thanë armik. Prindët e Muhamedit dhe ai vetë shkuan duke qenë të bindur se pas tyre, posa të lirohet, do të shkojë edhe vëllai i madh, por, kur u lirua ai, nuk shkoi. E nuk shkoi edhe babai im, sepse unë fillova të qaj atë ditë kur ishim duke drekuar e nëna ja hapi babës prap të njëjtën bisedë.

— Nuk dua gërthita unë, nuk dua të shkoj atje e ju shkoni, po deshët (qajsha me të madhe), shkoni po patët zemër pa mua, unë nuk vij, nuk dua, jo. — Baba e la bukën e u zemërua pa masë. — Pse po e bën djalin të qajë, moj marroçe, — i briti nënës — trus, moj grua, e mos folë — shtoi e pastaj m'u kthye mua: — Jo, biro, mos u frigo jo, se nuk të le baba ty vetëm, as nuk shkojmë kurrkund, as mos i ço mendtë andej, hiq nënës, se nuk di ç'flet. E nëna filloi të qajë edhe vetë e tha: — Po sikur, ruena zot, të të gjejë gjë edhe ty ç'të bëj unë e zeza, si do të mbes gjallë me këtë fëmijë?

— Hesht e mos bën kiamet, — i briti prap babai çkado që të ngjajnë. . . me dynja. — Ç'më duhet dynjaja, dynjaja nuk ma ushqen mua fëmijën, mendo mirë, o njeri. Ç'ke në kojshi, prite në shtëpi herët a vonë. Po më mirë sa është herët, sa nuk të ka ngjarë gjë — vazhdoi prapë nëna gjithnjë duke qajtur. Baba u zemërua edhe më shumë. Edhe unë fillova të qaj tani edhe më shumë. Më dhimbej nëna që qante, edhe baba që zemërohej. Isha i sigurtë se, sikur të mos ishte mburrja, do të qante edhe ai bashkë me ne të dy. Por ai e daravitte vajin duke ngritur zërin e duke sharë nënën dhe mua, duke sharë të madh e të vogël. Njëherë, madje, i shau edhe ato vjet kur ka qenë në mal. Vonë më kanë treguar se babai im ka qenë në mal dhe ka luftuar kundër gjermanëve, edhe kundër italianëve, edhe kundër gjithë të huajve; krah për krah ka luftuar me shumë moshatarë të

vet të lagjes dhe të qytetit. I shau ato vjet e pastaj disi pushoi, heshti një çast e dikur shtoi: — Do të jetë ndonjë gabim, diç nuk është në rregull, ndoshta unë nuk po kuptoj, ndoshta e kam unë gabim. Si do që të jetë, ti grua trus, edhe ti Ahmet a din çka bën, kqyr punën tënde e mos pyet shumë. Atëhere na tregoi se e kishin pensionuar. I kishin thënë: «Mjaft ke punuar, je lodhur, tash shko e pusho...»

Një ditë, mbas asaj që u zura me fëmijët rreth bazenit, isha duke u rrezitur së bashku me shokët e mi të klasës. Ishim shtrirë pak sipër bazenit, në kodër, në gjelbërim. Të gjithë kishim ra në shpinë e, kokat mbështetë mbi duart e lidhura pas qafe, bisedonim, ç'nuk bisedonim! Unë nuk ua hapa fare kërcënimin që më bënë fëmijët, nuk dëshiroja të grindemi me ata, ndonëse herë-herë u lakmoja kapeshnicanave, por megjithatë mendoja se ne, si shkollarë, duhet të mos rrokemi. Ata duket se e harruan kërcënimin kur më panë bashkë me shokët e mi. U shtirën së nuk po më njoftin dhe harruan ç'më kanë thënë. Sytë i kishin ngulitur të gjithë në një pikë atje lart, para nesh, ke Maja e Hasanit. Të gjithëve na joshte ajo lartësi, na ishte bërë pikë në zemër, si themi ne për diçka që nuk na le të qetë asnjë çast. E lakmonim pa masë atë majë. Ramizi vazhdimisht propozonte: po nisemi një ditë, bëjmë gati bukën, marrim me vedit ç'na nevojitet dhe, herët në mëngjez, me terr, nisemi me siguri mund të hypim në majë. Të gjithë e lakmonim këtë, por a mund të arrijmë atje? Ai na mbushte mendjen dhe ideja e tij filloi të na piquej përditë. Edhe atë ditë thashë, i kishim qepur sytë në Majë të Hasanit, mendonim e matnim fuqinë tona a mundemi, a do t'ja dalim në krye. Atëhere arritën disa njerëz të veshur në bazen. Na tërhoqën vëmendjen menjëherë për arsye se shihej qartë që nuk kanë ardhur n'atë vend për t'u larë. Njëherë biseduan ndër vedit. Tre veta ishin gjithsej. Disa të tjerë, që lahashin, ju afruan më vonë. U afruan edhe ne. Shikonin përreth bazenit dhe tërë kohën përsëritnin:

— Sa më parë, sa më parë, menjëherë, qysh nesër.

— Ç'është, mor, ç'është? — pyetën të gjithë përreth. Për çfarë bisedojnë? Ç'thonë? — Atëhere shkuan. Neve na

u mbështoll diç në zemër si mulla. E dijshim se ardhja e tyre nuk ndjell mirë.

Të nesërmen erdhën disa punëtorë me vegla pune. Më së pari hapën ca gropa, më vonë ngulën në secilën prej tyre nga një dru. Ne i pyesnim: — Ç'bëni kështu, ç'ju nevojiten këto gropa, pse i ngulni këta huj? E ata heshtnin. Më vonë i prunë edhe telat, me qindra metra tel.

E rrethuan bazenin me tel me gjemba. Kur mbaroi e gjithë puna, një roje u vendos në të. Me pushkë. E sa i bukur ishte atë ditë moti. Ç'diell i këndshëm na shtynte të zhytemi në ujë si përherë e të luajmë gilash e të gërthasim e të kërcenim prej njerës anë të bazenit në tjetrën, duke ngacmuar njëri-tjetrin, por... — Largohu! — gërthiti roja me pushkë, kur provuam t'i afroheshim bazenit të rrethuar me tela gjemborë. — Largohu, se është e ndaluar — briti ai.

Disa menduan: A guxojmë të pyesim. Disa guxuan e pyetën: — Pse na rrethuat bazenin me tela gjemborë, ç'ju nevojitet roja me pushkë pranë tij? Njëri nga ata të tre, që erdhi ditën e parë, në vend të përgjegjes, pyeti: — I kujt je ti, djalë? Ai nuk i tha i kujt është, por iku. Pastaj, na briti neve të tjerëve: — Ikni, ç'pritni! Sylja i tha me të butë: — Duam të lahemi, nuk kemi ku të lahemi. — Lahuni në Bistricë, lahuni ke Tabhanet, lahuni në jaz e në përrua, ku të doni, fort çaj kokën unë për larjen tuaj. Ikni tash!

Ne u shpërndamë atë ditë të pakënaqur mjaft, por jo edhe të demoralizuar. Erdhëm të nesërmen. Aty afër zbuluam një gurrë uji të vokët; rreth saj rrinim e bisedonim me sy prore të ngulitur në Majë të Hasanit, duke bërë plane për ta pushtuar. Isha i bindur se Bistrica nuk është dashamirë e jona, e fëmijëve. E cekët, e ftohtë akull, mezi mund të mbanim dorën në te; bënim gara cili mund ta mbajë më shumë. Dora ngrihej pas pesë minute. Bistrica një vit e bënte shtratin këtu, vitin tjetër në vend tjetër, e paqëndrueshme e paafrueshme, e turbullt, gati as që mund të krahasohej me bazenin, të cilin e donim më shumë se çkado tjetër në qytetin tonë. Bazenin e kishim dashurinë

tonë më të madhe muajve të verës. Thuaj tërë vitin. Sepse edhe dimrit, edhe motet e ftohta jetonim me ditët e kaluara në bazen dhe mezi pritnim të vijë stina e re për bazen.

Nuk e donim Bisticën e cekët, të ftohtë e të pamirë. As gurët e saj buzë shtratit të saj të paqëndrueshëm. As rërën që na dukej disi më e ftohtë se sa ishte. Edhe për një gjë nuk e donim, pse së andejmi shifet bazeni i rrethuar dhe roja me pushkë. E bazeni, ai që e donim aq shumë, rrinte i vetmuar duke vajtuar për ne me atë syprinë të paluhatshme uji të mbushur plot, ku sodit qiellin dhe përcjell rrugën e diellit.

Një kohë u lamë nën atë gurrë me ujë të vokët, për të cilën nuk dinim ku e ka burimin, nga rrjedh. Aty rreth gurës u rrezitëm dhe ditë për ditë erdhi duke na u pjekur mendja t'i ngjitemi bjeshkës, që nuk na lente të qetë të arrijmë në Majë të Hasanit, në atë pikë të lartë mbi qytetin tonë, që na josh vazhdimisht. Atëhere ja hapa edhe babait këtë, i thashë:

— Ti, baba, sigurisht ke dëgjuar se na e kanë rrethuar bazenin, por nuk di a di se ne kemi vendosur të hypim në Majë të Hasanit.

Baba, gjithnjë i mrrolur, njëherë heshti e pastaj, disi me të vështirë, tha se ne jemi të marrë, se ne nuk dijmë ç'bënim, se duhet shikuar për të mbëtur gjallë, ne s'jemi për Majë të Hasanit. Më tha, ç'nuk më tha, plot pezëm. Po them kurrë nuk ka qenë babai im i këtillë. Mua, mëgjithatë, nuk më ndau nga shokët për t'ju ngjitur Majës së Hasanit. Unë u gëzova shumë që ma bëri këtë të mundshme. Ju gëzova babait tim edhe pse nuk pranoi të marrë atë rrugë të largët pa kthim, si disa që unë i quaj të dobët. Por nuk e dua babain tani aq shumë pse është vazhdimisht i mrrolur, pse mbyllet në shtëpi, pse e shiti radion, pse nuk e lexon më «Rilindjen,» kurse «Borbën» dëshiron t'ja shofë çdokush, pse mendon se ne s'mund të ngjitemi në Majë të Hasanit. Prapë e pyeta:

— Më thuaj, baba, e ke punuar edhe ti bazenin bashkë me të tjerë, apo jo? — Dojsha përgjegjen e tij, sepse, mendojsha unë, ata që e rrethuan, nuk do të kenë guxuar ta bëj-

në këtë pa pyetur edhe babain tim. Edhe i thashë: -- Ty sigurisht të kanë pyetur që e kanë rrethuar me gjemba. Edhe ja kanë vënë rojen me pushkë. Si i ke lejuar, baba? -- e pyeta. -- Edhe pse, pse lejove? E ai, në vend të përgjigjes, ma preu pa një pa dy:

— Trus bythën e kqyr punën tënde!

ABRAKADABRA

— Eureka! — gërthiti Ahmet Koshutani. — E gjeta! Atij i thonë: *Abrakadabra!* Kështu e kurrsesi ndryshe. Dora vetë. Po sa mirë m'u kujtua! — tha me vete dhe u krenua me këtë zbulim. — Do ta quaja kështu, do ta quaja ashtu, atë edhe e quajnë gjithsesi, edhe vetë e quan veten sipas vendit e kuvendit. Por, një është zbulimi, ky i imi, i emrit të tij, më i sakti, më i qëlluari, i vetmi: *Abrakadabra*.

Për ngjyrë të lëkurës dhe të flokëve, për formë të kokës, madhësisë së trupit e tipareve të tjera të dorës së dytë, tipare fizike, edhe ky i takon racës njerëzore — tha Ahmeti, me zë si të mbante ndonjë ligjëratë në shkollë, apo së paku të ishte duke biseduar me dikend. Ishte vetëm. Megjithatë vazhdoi: — Të thuash se është ndonjë ekzemplar, ndonjë unikat ose ku e di unë ç'gjë e rrallë, që meriton të zejë vend në kopsht zoologjik, në muze apo gjetiu, hajde de! Pse jo. Por, jo! Punë përrallash. Ç'është më e keqja, unë e takoj shumë shpesh. Aqë sa ndonjëherë, fare pa dashje, si i magjepsur, e zë veten duke bërë si ai. Ndalem përnjëherë dhe stepem nga befasia, nga mrekullia. «Ore, cili je ti, them, a je ti Ahmet koshutani, apo. . . ai tjetri, si i thamë, po *Abrakadabra?*» Shkoj rrugës unë, ashtu si shkoj rëndom, këta sy që shikojnë, e pastaj, gati pa vërejtur, shoh, bindem, edhe unë shkuakam rrugës si ai, edhe kokën e mbakam si ai, edhe shikuakam si ai. Është nga ata që të ngjiten si sëmundjet ngjitëse të qepen për lëkurë, nisin e të hyjnë brenda, të brejnë, të brejnë. . . njëherë ndjenjat, zemrën, pastaj edhe shpirtin e të bëjnë si veten, me ndjenja, që s'janë me ndjenjat e tua, që s'ja-

në ndjenja fare, me zemër, që s'është shpirt yt, që s'është shpirt fare. Del në rrugë e nuk di më cili je, je ai që je, apo je ai tjetri, edhe një Akrabadabra.

Tha Ahmeti — Është shumë infektues ai, koleroz. E po more ta tëhollosh, t'i hysh një çikë përbrenda, ta analizosh, ta njohësh sado pak, ç'do të gjesh? — Ahmet Koshutani u ndal, u kollit pak, duke u ruajtur që, së paku në këtë të ligjëruar, të mos jetë i infektuar nga ai, të jetë ky që është, pastaj vijoi: — Do gjesh një njeri... gjysmë-njeri; jo gjysmë, një gjysmë, por njeri i ndarë në dy gjysma njeriu. Një merre si ta marrish: as bardhë as zi, ndër-mjet mirëejobashmirë e keqejobashkeq, «ke të drejtë ti e ka të drejtë edhe ai»... shkurt: një mesnjeriu, diçka e ndarë përgjysmë.

Ai është njeri në mes, njeri që shkon përmes, që vepron mesatarisht, që është mesatar, njeri peshkaqen, gjysmë peshk, gjysmë njeri; njeri me gjysmë fjale, me gjysmë mendimi, me gjysmë buzëqeshje, me gjysmë pezmi, me gjysmë gazi e gjysmë loti, gjysmë loje e gjysmë goje, gjysmë hapi... shkurt: njeri me gjysmë jete. Apo, dhe më mirë me jetë të ndarë në dy gjysma, që janë antipode, që nuk përkojnë, shkojnë në dy anë, e kanë emërues të përbashkët atë vetë, burimin, pra.

Ja, të marrim, fjala vjen, buzëgazin e tij, buzëqeshjen. Njëherë, ai pothuaj çdo gjëje ja gjen dy anë, dy pjesë, dy gjysma. Nuk ka gjë në këtë botë, thotë ai, që s'është edhe kështu edhe ashtu, që nuk mund të merret edhe kështu edhe ashtu. E para e ka të fundit, e ulta e ka të lartën, e përpjeta ka të tatëpjetën, drita terrin, fytyra astarin, fleta faqet... Edhe bota, po, është e ndarë në dy gjysma, në dy pole. E ç'është njeriu, ky mikrokozmos, sa të bëhet një, i vetëm, i pandarë, kur gjithë rruzulli e çdo gjë në jetë është e ndarë në dy gjysma, dy anë, dy pjesë, është edhe kështu edhe ashtu.

Ja, të marrim buzëqeshjen e tij — tha prapë Ahmet Koshutani. — Është buzë, por me vështirësi mund të quhet qeshje. Aqë bukur e ka ushtruar këtë, saqë njeriu, kur e shikon të «buzëqeshur», nuk di ç'të mendojë, sepse kjo «buzëqeshje e tij aqë shumë anon njëherit, nga ironia,

përbuzja, neveria, pezmi, shfrimi, inati... e çmos tjetër, sa nuk të mbetet tjetër, por t'i besosh.

Edhe veshjen e ka disi të larme, përgjysmë; kurrë nuk ka veshur xhaqetë e pantallona njësoj. Po qe se xhaqeta është kësodore, pantallonat duhet të jenë aso dore.

Njeri me dy fytyra? Njërën kështu, tjetrën ashtu? Dy-fytyrësh? Jo. Ky ka një fytyrë, por të ndarë në dy gjysma. Nuk zgjohet kurrë më herët se të tjerët, por nuk bie kurrë më vonë se ata. Do të mendoni, zgjohet me kohë? Bie me kohë? Jo. Ai zgjohet dhe bie në mes të «mekohës» dhe të «pakohës». Sepse, thotë ai, kushedi...

Edhe kur ecën, ke përshtypjen se këmbët i shkojnë në dy anë: e djathta djathtas, e majta majtas, kështu që ngado ta shikosh, të duket se është duke ecur në drejtimin tënd, respektivisht të tjetrit. Po e shikuan ata që ecin djathtas, do të thonë: Me ne ecën, djathtas; ndërkaq, po e shikuan ata që ecin majtas, edhe ata do të thonë: Me ne ecën, majtas.

Nuk qëndron në ballë, nuk ulet kurrë në rreshtat e parë. Mirëpo, nuk rri kurrë as në fund. Nuk e merr kurrë fjalën i pari, por kurrë edhe nuk rri pa diskutuar. Sepse — si thotë vetë — kushedi. Po nuk diskutove, mund të të thonë nesër: Pse nuk ke diskutuar, pra. E po diskutove... Eh, e po diskutove, thotë ai, duhet të dish të diskutosh. Duhet të diskutosh ndërmjet, për rrëshqit, përgjysmë, një diskutim «mirëmeçdokend», as të lëvduar as të sharë, as gaz të qarë, as mirë as keq, as andej, as këtej... Sepse — si thotë vetë — kushedi. Po e lëvdove sot, nesër mund të gabojë diçka e lëvdova jote do të mbahet mend. E ka lëvduar! Po e e shave sot, nesër mund të ngjajë, ç'nuk mund të ngjajë, të bëhet diçka, e sharjen tënde do ta mbajë në mend. Ti je ai që më ke sharë asokohe, apo jo? Pa eja këtu një herë të të shoh. A ti na qenke ai? Etj. etj. — thotë ai. — Jo, nuk jam i marrë, s'jam budalla. Pse, a mos po ma di kush. A mos kam ndër mend të më ngrehin përmendore? Jo, or vëllaçko, jo, jeta nuk do tjetër pos *notues* të mirë. Po, po, notues. Të dish të notosh, do të thotë të dish të jetosh. A e di ti atë anekdotë, atë anekdotë me një njeri shumë të mençur dhe lundërtarin? Unë nuk e di mirë, asgjë më në

fund nuk e di tamam, krejt, por përgjysmë, andaj edhe këtë anekdotë po e tregoj si e di, përgjysmë, mjafton që njeriu të mësojë prej saj, qoftë edhe — përgjysmë. Nejse, janë disi në mes të detit, në lundër, ai farë Njeriu i mençur, dijetar, doktor shkencash apo ku e di unë ç'na paska qenë, janë pra mu në mes të detit bashkë me lundërtarin, e në lundrim e sipër zhvillohet, afërsisht një kësi dialogu:

DIJETARI: A e di ti, o lundërtar, ç'është... ku di unë... fjala vjen — astronomia?

LUNDËRTARI: (*rrudh krahët, mbetet gojëhapur*) Jo... jo...

DIJETARI: Po, mirë, o lundërtar, a e di ti ç'është... ku di unë... fjala vjen — mikrobiologjia?

LUNDËRTARI: (*rrudh krahët, mbetet gojëhapur, njësoj si më parë*) Jo... jo...

Vazhdon kështu dijetari ta pyesë lundërtarin: A e di ç'është kozmosi, a di ç'është matematika, a ti di ç'është kjo, a e di ç'është ajo dhe në fund i thotë: — Po ti, o lundërtar, pasi nuk i ditke këto, pse jetuake? S'ke nevojë të jetojsh, më mirë të vdesësh... Mirëpo, në lundrim e sipër, në midis të detit, njëherë ngadalë e pastaj më shpesh, u trazuan suvalët, u çuan valët, u vra moti, u bë një stuhi, një tufan, u lëshua një rrebesh, e të filloi lundra të kalamendej sa andej këtej, sa poshtë lart, si të ishte thupër. Një situatë pa shpëtim. Na i kthehet tani lundërtari dijetarit dhe e pyet:

LUNDËRTARI: (*duke u bërë gati të lëshojë lundrën dhe të notojë*). Po mirë, or ti... — dijetar, njeri i mençur, a ku di unë si i ka thënë, i thotë: — Po mirë, or ti... a di ti të notosh?

DIJETARI: (*rrudh krahët, mbetet gojëhapur*) Jo... jo...

LUNDËRTARI: Ti s'mund të jetosh, pra. Vdiqe...

Kështu ka ngjarë, po. Kot më mëson ti mua, ku di unë ç'shkenca e ç'dije në jetë, po s'dite të notosh, të notosh në ujë dhe në të thatë, do ta pësosh atë që e pësoi dijetari. Kështu e ka kjo jetë, të pëlqeu ose s'të pëlqeu. Dhe po pate pak mend, unë s'po them se duhet të jesh edhe krejt ashtu si lundërtari, të mos dish fare, asgjë; por ashtu, as shumë as

pak, përgjysmë. E kryesorja: të dish të notosh gjithkund dhe në çdo kohë. Sepse, kushedi...

Ahmet Koshutani i ra shpullë kokës: — Ja, a shikoni, fillova të flas për të, e pak nga pak, padashur dhe pa ditë, fillova të flas në emër të tij, të flas si ai. Është shumë i çuditshëm ai: Abrakadabra! E patën fjalën te diskutimi. Kështu gjykon (dhe vepron) ai. Nesër mund të them: Kur të kanë sharë, kur të tjerët s'e kanë hapur gojën fare, unë — mund të thuhet — të kam lëvduar; ose nesër mund të thohet — kushedi si bëhet — mund të thohet: kur e kanë lëvduar, a nuk e ka lëvduar. E të dyja anëve, për të dyja kohët. Kur të tjerët kanë heshtur, unë kam diskutuar...

Në kafene ai pi çaj; të mos i thonë; është i kafes. Në çajtores ai pi kafe; të mos i thonë është i çajit. Edhe kafen, edhe çajin e pi orta. Tatlisert. Ajron. Kur del në mbrëmje të shëtisë (njeriu duhet të dalë ndonjëherë të shëtisë, thotë ai, ku di ti ç'mund të thonë: pse s'del ky, pse është mbyllur!? Por edhe të dalësh çdo mbrëmje, edhe kjo s'ka kup-tim, ku di ç'mund të thonë: Pse del ky, ç'do të thotë me këtë të shëtitur për çdo mbrëmje!?). Kur del, pra, ndonjë mbrëmje, ai nuk shëtit krahut të djathtë të shëtitores. Pse t'i thotë pastaj dikush, nesër. Ti ke shëtitur krahut të djathtë, e jo të majtit. Ai, por, nuk shetit as krahut të majtë të shëtitores. Pse t'i thotë pastaj dikush, nesër: Ti ke shëtitur krahut të majtë, e jo të djathtë! Jo, më mirë rahat me zotin, thotë ai, dhe e gjen vazhdimisht një rryp rruge, për të cilin nuk mund të thuhet se i takon as krahut të majtë të shëtitores, as atij të djathtë, ndonëse, po t'i nevojitet, sipas nevojës, apo jo, mund të dëshmojë se ka shëtitur kurdoherë asaj ane që — preferohet. Ose e kundërta.

Ka gjysmëshokë dhe gjysmëmiq. Rri me tregëtarë dhe me letrarë. Të parëve u thotë: E mirë është tregëtia, e mirë, s'ka fjalë; e pastaj pothuaj menjëherë, për çdo eventualitet, shton: ... Deri diku. Letrarëve: E mirë është letërsia, e mirë, s'ka fjalë dhe prapë nuk harron të shtojë atë: ... Deri diku. Sepse, mendon me vete: Për tregëti, ku e di ti, njeriu mund të hyjë në fillad. E, besa, ku e di ti, edhe për letërsi, pse jo? Andaj nuk merret as me tregëti, as me letërsi, nuk shkruan prozë, as poezi. Sikur të shkruaja, mahitet ai për-

gjysmë: Do të shkruaja poezi në prozë ose — prozë poetike. Se ku e di ti ç'kohë do të vijë nesër, e prozës, apo e poezisë...

Po them, de: Njeri pa erë dhe pa shije, — i ndëhyri Ahmet Koshutani. Ja preu fjalën, që e thoshte me gojë të vet! Dhe prapë vijoi të ligjeronte për të, me frikë se përsëri do të shkrihej në të, gati-gati, do të njësohet. E këtë dobësi të vet Ahmeti e urrente më së shumti. Ai ishte më se i bindur, më se i sigurtë. Gëlltit njeriu të keqen, mund të kuptojë këtë dhe atë, por as gëlltitet, as mund të merret me mend njeriu si Akrakadabra. — Ky nuk hapet me asgjë, tha Ahmet Koshutani. Ky është një H₂O njeriu. Pa erë e pa shije. Ujë. Që mund ta pijë kush të dojë dhe ai, që sado pak e di ç'është uji, do t'i neveritet, do ta pëshytyjë jashtë. E, pra, ai pikërisht këtë do: Të jetë i pishëm. Natyrisht, jo nga krojet me ujë të kulluar, të ftohtë, por as edhe nga ata që nuk pihen fare. Një ujë mesatar, pa të cilin nuk munden e më të cilin megjithatë e kanë vështirë.

Nuk është edhe nga ata që trokasin shumë nëpër dyer. Jo. Nuk mërzit ky askënd, duke shfrytëzuar rast e pa rast. Të përshëndesë, të buzëqeshë, të vërehet, të bjerë në sy, ta mbajnë mend. Sepse — si thotë vetë — kushedi. Sot mund t'u dalë para, të shëtisë me ta e të jetë me ta, të bisedojë e të jetë në sy të mirë, por, po qe se gaboi ndonjëri nga ata, mund t'i thotë dikush nesër: Ti je ai, a, që i buzëqeshje, që i përkuleshe, që rrije e shëtitje me të. Ti faqelythë, që i hyje në . . . zemër. Ti, a? Jo, bre, vëllaçko, pse?! A s'është më mirë rahat me zotin, ti këqyr punën tënde, ai këqyr të vetën, e të dy — rahat me zotin. Unë s'po them, jo, që nuk duhet buzëqeshur, përshëndetur, shëtitur e kontaktuar. Jo, mazallah. Por — me masë. As shpesh, as rrallë. Mesatarisht. As i pavërejtur, as i mërzitshëm. Aty diku, në mes. Të mos thotë: As dashamir, as padashamir; as mik as armik. Kudo mesatarja. As kështu, as ashtu. Me çdokend mirë. Jo — shumë mirë. Orta. Kudo — me fener. Me qiri. As shumë nëpër dritë, as shumë nëpër terr.

Rri me ata që pinë dhe me ata që nuk pinë, e vetë — nuk pi. Por, kur rri me të parët. Jo, jo, për hatrin tuaj, të mos e prish, ja, vetëm një gotë. . . Kur rri me esullit — s'e shti në gojë për dynja. Pse t'i thonë: Është pijanec,

t'i thonë ata që nuk pinë? Gjella e tij — tyrlia. Sallata, miks, e përzier. I martuar? Jo. Do të thotë: I pamartuar! Jo. Sepse — si thotë vetë — po të jem i martuar, do më radhisin në radhën e atyre, të martuarve; e po të jem i pamartuar, desha, s'desha, do të më fusin në radhën e anës tjetër, të beqarëve. E nesër, kushedi ç'mund të ngjajë nesër? Kush më siguron se nesër do t'i kenë punët më mirë të martuarit, apo beqarët? Si janë duke u zhvilluar punët, jeta në martesë, në këtë evolucion revolucionit seksual a mund të më sigurojë njeri se do të jenë më të lumtur ata që kanë — grua? Seksi në grup, ndërrimi i bashkëshorteve, perverzitet e ndryshme, çelësat e automobilave në një kapele, ku zgjedhim bashkëshortet dhe loja priset vetëm po që se i bie çelësi i automobilit të — bashkëshortit...? Jo, or vëllaçko, jo, unë kam pak mend, kam fytyrë. Jo tepër, por ashtu, mesatarisht. Mjaft sa për idare.

Megjithatë e ka një grua, një femër. Kjo s'është as vajzë, as vejushë. Nuk ka qenë e martuar. Atë e ka dhe nuk e ka grua. Kurorë s'ka vënë, por asgjë mangut s'ka nga të kurorëzuarit. Me një ndryshim nga ata mund të thotë, kur t'i nevojitet, sipas nevojës — jam apo nuk jam i martuar. Sepse, ai vërtet, pikërisht kështu është, gjysmë i martuar, gjysmë i pamartuar. Është i lirë kur i lypet, si beqarët, por edhe me obligime — si të martuarit. Ai do që të gëzojë të dy të drejtat.

Shkurt ai është një ndër, një ndërdyjës, një ndërkohë, një ndërlumë, një i ndërlymë, një i ndërlymë, një që i ka hypur jetës ndërshit — në mes të dyja anëve të barrës; një mesarë, një mesditë, një mesunazë, një meskëputur, një as i ri, as i vjetër, një mesatar; një medium, një mediohomus, një mediocritas, një mediteran, një meduzë; një gjysmëhënë, një gjysmami, një gjysmazog, një gjysmagjel, një gjysmëlesh gjysmë pambuk...

Një gjysmëpjate, të lutem, a bën? — thotë në gjelltores; na bini një birrë e dy gota, ju lutem, a bën? — thotë në hotel. Në punë shkon në gjashtë e gjysmë gjer në trembëdhjetë e gjysmë — verës, e një orë më vonë — dimrit...

Nuk e pagëzova kot Akarakadabra — tha Ahmet Koshutani. Ai e ka emrin e vet; më vonë ja mësoi. Quhej

Fetah. E Ahmetit ju kujtua menjëherë edhe një Fetah, një shoku i tij i ditëve të shkollës, me të cilin luanin shpesh, e kur nisnin ndonjë lojë, e ndaheshin në dy grupe, atij i thoshin: Ti je — Fetah: as me ne, as me ata. Ku mund ta dijë Ahmeti a e kanë pagëzuar kështu pa dashje, apo është, ndoshta emri që e ka destinuar të jetë edhe jetë — Fetah. Ahmet Koshutanit nuk i pëlqeu ky emër. Jeta, tha, nuk është ajo loja gilash me shokë të shkollës, aty buzë Jarine, as loja me cikëla në Mazgjah, as loja me pacërka te Tabhanet, ku e mërzitnin Fetaun duke i thënë: «Fetah, Fetah, as me ne, as me ata!» Nuk është kjo jeta. Edhe Fetau, jo, emër që i gjegjet këtij Fetahu të ri. Ky, po, e mban këtë emër në atë letërnjoftim, të shkruar përgjysmë dhe thuaj të përgjysmuar: «Fetah L». Por, në të vërtetë, ky duhet të quhet dhe është vetëm Abrakadabra. Një hokus-pokus njeriu. Një e keqja e kurrkujt, por edhe — e mira e kurrkujt. Diviza e tij: Mos bën keq! Por, po ashtu: Mos bën mirë! Nuk di ç'të qet e mira e çka e keqja. Ndaj as mirë, as keq! Pa kripë e pa sheqer.

Ç'është e vërteta, edhe kameleon nuk është qind për qind. Përgjysmë, ndoshta. Nuk e ndërron ngjyrën aty për aty, as nuk kërcen si bie defi. Qind për qind. Përgjysmë, po sepse — si thotë vetë — kushedi... Atij i dhimbset dhe nuk i dhimbset njeriu. Kush i ka faj atij që këtë botë nuk e kupton si det dhe nuk di të notojë nëpër valë të saj? Njeriu duhet të mësojë çdo gjë në botë. Të dijë çdo gjë, të jetë pehlivan, gjithmonë të qëndrojë në këmbë e të dijë të notojë nëpër tokë, e të ecë nëpër det. Kështu e kërkon jeta. Mua, thonë, më kanë treguar prindërit, ndjesë paçin, më ka ardhë për dore noti qysh në djep. Ashtu paskam pasë luajtur me duar, në djep, duke u vërtitur me to sa andej-këtej, saqë, më kanë thënë, nuk po ju gënjej, besoni, qysh atëhere paskan klithur: Notues i mirë do të bëhet! Atëhere qenka zemëruar nëna: Uh, qyqja unë, fatzeza, po a për kurrgjë më mirë s'e paskam bërë? Jo, jo, i paskan thënë: Notues i mirë do të bëhet. S'është punë e vogël. Kjo! Po të më mbytet djali, gurit e drurit! — qenka zemëruar prapë nëna. Mos kërce, apo ndien, — i paska thënë babai, ti s'e di se ç'rëndësi ka noti. Kushedi, — paska

shtuar babai — kushedi nga mund ta sjellë dallga e jetës. Mundet të jetë në ndonjë anije, në udhëtim e sipër nëpër botë, ku e di ti, apo ndien, e çojnë dallgët Fetaun nesër, kur të rritet... Dhe, pastaj papritmas tërbohohet deti dhe fundoset anija. E kur fundoset anija, njerëzit bien në det. A mund të bien në tokë? Nuk mund të bien. Bien, pra, në det. E kur bien në det, duhet të dinë të notojnë. Po ditën not, shpëtojnë, po nuk ditën, hë, folë, ç'bëhet me Fetahun tonë, po nuk diti not? Hajde, folë ti, apo ndien?...

Ahmeti, duke e dëgjuar Abrakadabrën kështu, përpigjej t'i merrte me mend edhe prindërit e tij, në sajë të kësaj bisede mbi djep të tij. Me sytë e mendjes ja pa nënën: Amvise, e mbyllur brenda katër mureve, më e mëngëta mungesë e saj, që nuk di gjë jashtë shtëpisë, e frikësuar për fatin e të birit, me dovë nëpër gojë, me bismilah orë e ças dhe me dëshirë të vetme, t'i rritet fëmija, Fetahu, t'ja gjejë një nuse të mirë, të mësojë ndonjë zanat të mirë, të bëhet, bie fjala, berber. Pse jo? Berber nuk është keq. Është zanat i pastër. I vjen era kolonjë. Misk. Gjithmonë i rruar. Gjithmonë i qethur. Pastaj, besa, edhe vajzat i duan berberët. — E-he, s'është punë e vogël. Merr briskun e rrojës në dorë. Merr maqinën e fët-fët, për pesë dekika, e bën njeriun krejt tjetër. Ose, hajde, ja, le të mos bëhet berber, por ja, le të bëhet... le të bëhet, ja, mund të bëhet edhe pajtonxhi... Ishallah na ndihmon zoti e bëjmë, ja blejmë një pajton, një herë me apo «oponga» — në kuptimin e asokohshëm, të kohës kur Fetahu në krye të Zallit. — Hajde pajtonxhi! — e thërrasin njerëzit. Edhe vajzat. Për Bajram. Shkon deri te Kisha, përditë te stacioni e te hoteli, çka po lyp ti më mirë se këtë... e kështu disi. Ndërsa të atin, as me plis, as me kapuç të kuq, sikurse i mbanin shumica në sheher. Një dorë qytetarësh, «esnafë» u thoshin, ata, që të mos jenë as «ekstremë» në kuptimin e sotëm, «katundarë» apo «oponga» — në kuptimin e asokohshëm, të kohës kur Fetahu ishte në djep, nuk vinin plisa të bardhë në kokë. Mirëpo, që të mos u thuhet edhe se janë krejt «allaturka» e po jetojnë ende në «vakt të Sulltan Muratit», nuk vinin as kapuçi të kuq. Këta gjetën një mes: Do farë kapelash,

që përkah forma u ngjanin plisave, por asgjë mangut edhe kapuçave të kuq, mirëpo — nuk ishin as të bardhë si plisat, as të kuq si fesat, por ishin ngjyrë — të zezë. Këso farë kapelash banin «esnafët» Njeri «esnaf», me demek, i binte si njeri, që, në mos tjetër, dallohet nga të tjerët edhe, bre vëlla, këqyr punën e vet e nuk përzihet në punë të dynjasë. Ndonëse — e luan nga pak tregëtinë, e luan. Eh, pikërisht të këtillë e pa të atin e Fetahut, apo të Akra-kadabrës, Ahmet Koshutani. Një nga ata me kapelë as të bardhë, as të kuqe, që llogarinë e bën me «nokta» e të vetmin libër që ka, Elifin. Del të shtunave krye qytetit, i pret fshatarët, blen ve, pula, e i shet pastaj ditëve të tjera, kur ata nuk vijnë në qytet, kur bëjnë më shtrenjtë, sepse nuk është pazar dhe kështu gjallëron, mban familjen dhe e sheh tërë lumturinë e vet. Kur t'i rritet Fetahu, e t'i bëhet edhe ai «esnaf», e të hapi ndonjë bakallhane, një herë, e manifakturë më vonë, e të bëhet tregëtar, me kushedi sa magaze me mall, e plot shegerta, e plot pare, e pastaj të hapë prapë dyqane... e lum e lum, a e pres atë ditë...

Kështu disi, mendoi Ahmet Koshutani, do të ketë menduar edhe i ati. Ndoshta. E pastaj u habit edhe vetë nga i erdhi kjo ide, njëherë të paramendonte prindërit e tij, e pastaj edhe ç'kanë menduar për të. Në këtë lojë mendimesh, e cila e pushtoi Ahmetin, një ditë krejtësisht, ai shkoi edhe më larg; te gjyshi dhe gjyshja e Akrakadabrës. A thua çfarë kanë qenë? Pa dyshim tha, me kapuç do të ketë pasur gjyshin. Po gjyshen — krejt në shallvare. Po katërgjyshi — mendoi ai edhe më. — Me siguri, tha, me plis të bardhë. Po katërgjyshja — me pshtjellak.

Pse doli Fetahu i këtillë bastardi? — pyeti. Pse u bë Akrakadabra? Nuk diti të gjegjej. Një gjë e dinte: Fetahu ishte, vërtet, një abrakadabra njeriu, një hokus-pokus njeriu, një notues i aftë, por i neveritshëm, i jetës, një që lundron prora, por nuk arrin kurrë në breg, në asnjerin breg, është gjithmonë në det, madje as që lakmon ndonjë breg, këtë apo atë, nuk do ai brigje, do mesin e detit, mesin e lumit, mesin e... Edhe në ushtri nuk zuri vend kurrë në krye të rreshtit, as në fund. Në mes, në

mes. Ata që janë në krye të rreshtit, thoshte, mund të arrijnë herët, e ata në fund vonë. Po që në ballë, e kris — të rrok më shpejt; po erdhi nevoja për zbrapje, prapë ke pozitë të mirë, sepse je aty, nga mund të operosh në të dyja drejtimet. A di si thonë ndër ne: Kush ngutet për... lahet: Chi va piano, va sano (e va lontano). Rahat me zotin, apo jo?

Ahmet Koshutani shikoi përreth, si të kishte qenë gjer më tani në ajër, në kllapi, i dehur, a i fjetur, fërkoi sytë, u ul. Pushoi pak dhe, pasi u qetësua, filloi të shikonte në pasqyrën e mendjes, si ndonjë film, gjithë këtë që tha për Fetah L., të cilin e pagëzoi Abrakadabra. U habit. Ju bë se s'ka qenë ky, Ahmet Koshutani, ai që ligjëroi kaq shumë për Fetah L. sepse, e besoni, a jo, ai nuk di fare se kush është Fetah L. Edhe më tepër se kaq. Ai, tani mezi dinte të shqiptonte fjalën Abrakadabra, se jo më t'ja dinte kuptimin, domethënjen, pse e përdori, ç'ka të bëjë kjo fjalë me Fetah L., kush është ky, fare?

E, pra, ju kujtua mirë. E gjithë. Çdo hollësi. Mirëpo, sado që gjurmoi nëpër syze të mendjes të gjejë ndokend me emrin Fetah L., me përjashtim të Fetahut, e ky nuk ka të bëjë aspak me këtë, është antipod i tij, Fetahut nga femënia, shok shkolle, nuk gjeti njeri tjetër me këtë emër, të njohur, të ketë dëgjuar për të. Nga më polli, pra? Dhe — pse vetëm emri i plotë, e jo dhe mbiemri?! Fetah L. Ç'asociacione ma kanë krijuar në mendje në ndërdije këtë emër enigmatik? Po atë... si i thanë... Arba... Abrakadabra? Nga e kam? Dhe — ç'ka të bëjë kjo me emrin e panjohur, me njeriun që nuk ekziston dhe emrin e tij Fetah L? Ç'do të thotë: Abrakadabra?

Mori leksionin dhe shikoi a thua gjendet kjo fjalë aty dhe si spjegohet. Shfletoi, lexoi: Ab... abradim... Abrasio... dhe — shih — Abrakadabra! Lexoi spjegimin: Abrakadabra, fjalë ebreje, magjistare, pa domethënje, e cila, e shkruar në njëtrekëndësh këndrejtë në njëmbëdhjetë rreshta (secila germë në një rresht), mbahej rreth qafe si hajmali kundër etheve; sot përdoret vetëm për mahi; si dhe «hokus pokus».

— Eureka! — gërthiti Ahmet Koshutani. — E gjeta!
Ku di ç'amza të shikoj e të shfletoj e ç'regjistra emrash,
me siguri nuk do ta gjej askund: Fetah L.-në!

E gjithë kjo qenka, pra vetëm një — ABRAKADA-
BRA!

DUKE PRITUR

Ora ishte trembëdhjetë e katërdhjetë e pesë minuta kur ajo erdhi dhe u ul në bankë, në hyrje të parkut. E mbante shpresa se pesëmbëdhjetë minuta do të kalonin shpejt. Fëmijët i kishin lëshuar xhitat mbi qytet, dhe, ato ishin ngritur aq lart, sa mezi i shihte si pika të vogla në kaltëri...

Po mbas pesëmbëdhjetë minutash, si do kalojnë edhe dy orë të tëra?

«Më prit të mërkurën, në orën gjashtëmbëdhjetë!» i tha Shpendi. Dy orë! Më thellë në park loznin ca çapkenë, nja trekatër sish, ashtu i dukej sipas zërave, sepse nuk kthente t'i shikonte. Tani xhitat ju tretën. Në bankën tjetër teksa u ul një plak me kapelë futur bukur thellë në kokë, i mbushur frymë e hapi gazetën, e lëshoi shkopin me krryl të lëmuar afër.

«Egërsirat! Tmerr! Përherë të etshëm për gjak e krimel!» — *klithi me zë të lartë që ta dëgjonte edhe vasha.* Ajo u trand pakëz, por sakaq erdhi në vete.

«Kush, xhaxha?» — pyeti.

«Xhonsoni, amerikanët, imperializmi...» — gjegji plaku. Ngriti kapelën më lart, fshiu ballin me një facoletë të përlyer...

«Rreptë po i gjykoni».

«Kësisoj meritojnë!» — tha dhe futi skajin e gazetës në grusht. Mollëzat e gishtërinjve ju zverdhën.

«Rrëqethëse janë ato komente nga Vietnami...» — tha vasha.

«Po, bija ime. Merre me mend: Një nënë ka lindur

fëmijë me një vrragë të thellë që nga tëmthi e gjer në mjekër. Phu, nënën e... më falni...»

«Me vrragë?!»

«Ca ditë para se të lindte, qenka plagosur, e paska qëlluar një copë e granatës në bark dhe... — pështyu sërish para këmbëve. Topi që e shqelmoi vogëlushi flokë-kaçurrel u rrokullis mes dy bankave dhe u ndal para këmbëve të saj.

«Na falni!» — vogëlushi kërkoi ndjesë e shikoi vetëtimthi, por thellë, sikur të donte t'u thonte: «E di ç'po pritni...»

Atje paska lindur një foshnje me vrragë dhe plaku po pështyn, shan, e psherëtin, po sikur ta dinte se unë e kam mbytur një foshnje, do të kërcente në kambë, do të më shante e do të ma bënte fytyrën për një para. Mamia më pat thënë se do të lindte djalë, i shëndoshë si molla... Sa pata diktuar se më lëvizte në bark, u frigova shumë, dhe, vrik dola në rrugë. Mora të eci, ashtu pa kurrfarë caku, kryesore të bridhja, vetëm të mos e ndjeja si lëvizte, si rritej, si gufonte si brumi. Disi më bëhej se po e mbushi shtratin me bark, dhomën e vogël, një pjesë dilte përtej dritares. Më zihej fryma dhe më lidheshin nga disa nyje në fyt. Fqinjët e mia, që i njoha që kur erdha në qytet, sikur i dëgjoja duke pëshpëritur te kroni:

«Erdhi nga fshati dhe ja se ç'bëri!»

«Na e shtoi edhe një potere në rrugë!»

«Phu! Kopil he, ja paftë sherrin!»

«Por dihet i kujt është!...»

«Eh?»

«Hesht! Mos gabo t'ja zësh emrin në gojë!»

Ngrita me plogështi kokën nga nënkrejca. Vija dorën mbi bark. Sa ka zënë të rritet, të gufojë, dhe, më joshte ndonjë kumri që fluturonte kah dritarja. Ja kisha lakmi. Edhe unë dikur isha e lehtë si ajo...

«Juve si duket aspak nuk po ju intereson ai fëmijë?» — pyeti plaku.

«... Me vrragë?»

«E.»

«Edhe fort bile...»

«Trete, vashë, në mendime, sikur të mërzita».

«Jo!»

«Ndofta...»

«Më falni.»

«S'ka gjë, s'ka gjë... e, kur të rritet ai fëmijë, do të mendojë edhe më thellë si është plagosur në barkun e nënës. Phu! Nënë e... më falni vashë...»

Topi u ndal mu para këmbëve të tij. Vogëlushi pikalosh ishte ndalur nja tre hapa larg dhe nuk guxonte të avitej. Dukej fëmijë i urtë, andaj ajo u ngrit nga banka dhe ja hodhi topin. E bëri këtë që të mos zgjohej plaku i lodhur.

«Më kot po pritni — tha me sherri dhe, kur mori të kthehej, u shkeli synë shokëve. Ata ja plasën gazit.

«Kush, unë? ... — pyeti ajo.

«Po, ju...» shkrepri vogëlushi dhe vrapoi fluturimthi.

«Shqelmoje ti topin më mirë...» — tha dhe vu re sa shejt tretën ata pas topit, si kaproj të hareshëm.

«A e shihni, vashë?! Gjenerata! Phu» — plaku shfryu mllefin.

«Me këtë po më sulmon edhe mua?»

«Larg qoftë! Në sytë e tu po shoh virtytin, vashën e ndershme...»

U skuq si prushi.

Pat përënduar dielli duke derdhur nëpër degë pendëlat e arta. Fshati ishte gati të binte në fashë. Ajo bridhte skaj livadhut, afër shelgjeve, që kishin përlurur flokët gjer në tokë. Puhia luante me kallinj të e blertë të grurit. E dinte mirëfilli se Shpendi po e priste diku, andaj ja donte qejfi që të dilte sa më parë. Dridhej, e, megjithatë, kishte dëshirë të frigohej një herë e pastaj të ishte e qetë. Matanë gardhit dëgjon zërin e tij:

«Kumrie, Kumrie!»

Vasha u shtang dhe nuk bëri zë.

«Kumrie...» — thirri edhe një herë. Vinte duke mënjeluar anash degët e përlurura të shelgjeve.

«Hë, Shpend...» — gjegji vasha. Si të derdhej uji i valë në shtatin e saj.

«Eja ma këndeje, ç'dreqin po pret?!»

«Kurr gjë.»

«Po dridhesh?»

«Edhe ti.»

«Ma jep dorën!»

«Ç'po të duhet?»

«Nj'ashtu... ma jep dorën! Po shkoj ushtar...»

«Ç'dobi nga kjo, ti gjithsesi do të shkosh...»

«Ishe vasha ma e bukur në skenë.»

«Po bën shaka.»

«Sa bukur interpretoje... më erdhi keq që nuk isha nxënës i rregullt... çka të bëja, nuk pata mundësi të ndiqja shkollën dhe m'u desh t'u shtrohem provimeve me vonesë...»

«S'prish punë? Kalove shkëlqyeshëm.»

«Fakt. Isha më i mirë ndër privatistët...»

«Mrekulli! — tha Kumria dhe mezi këputi një pip të hollë nga kunora e kulumrisë dhe zu ta gricmojë me dhëmbë.

«Ma jep dorën!»

«Jo.»

«Unë po shkoj...»

«Do të na zëjë nata. Ika!»

«Kur do të shkosh në qytet?»

«Nuk e di...»

«Do të bëhesh mësuese?»

«Jo. Nëna është e sëmurë. Do të mësoj për daktilografe. Ika.»

«Pa ma dhënë dorën?!»

«Ja...» — bëri ajo. Ja shtriu dorën me droje, thujse posa ta prekte dora e tij, do të ndizej një zjarr. Dridhej... , treti si thëllëzë... .

«Kumrie...» — e thirri. Më nuk e pa. Flokët e saj të shprishur u zhdukën sa ora në terr.

Plaku paloi gazetën, nxori kutinë me cigare dhe e ndezi një. Duke hequr një fije duhani nga buza, tha:

«Vashë, më fal, nuk të ofrova cigare...»

«S'ka gjë, nuk e pi...»

«As tinës?»

«Jo, xhaxhi.»

«Vashë, pleqtë janë si fëmijët...»

«Si fëmijët?! — pyeti Kumria. Lëshoi shikimin në akrepat e orës, dhe vrik e ngriti kah plaku me sy kureshtar, dhe ai pos kureshtjes, në sy kishte pak frikë se vasha do të zemërohej...»

«Po, vashë, një dreq plaku po më ngacmon të pyes» — tha dhe sërish hoqi me gisht fije duhani nga buza.

«Unë nuk jua shoh për të madhe...»

«Pak më parë të lodha me luftën.»

«Jo, — njeriu duhet të reagojë, të kërkojë të drejtën...»

«Edhe pse është marri t'ja hysh kësaj pune...»

«Paj...»

«E, ku ishim? Po, po... në dreq të mallëkuar! Ja tani edhe fabrikat punojnë me hile, ja çfarë duhani na shesin, derdhet cigarja dhe...»

«Xhaxhi, me sa po shoh, nuk po ju le të qetë diçka tjetër?!»

«Nj'ashtu është... ti s'ma sheh për të madhe, unë mundem të jem babai yt.»

«S'ka fjalë.»

«Kë po pret?»

Asaj i këceu mendimi furishëm, ashtu me vrull si uji nga gypi i gomës në rrugë, si asaj mbrëmje kur rruga e qytetit shkëlqente, kurse nëpër trotuar kalonin njerëzit. Kumria ecte pak me turp, meqë për herë të parë kishte marrë në dorë çantën e zezë dhe dronte se të gjithë ja shikonin, madje nuk kishte vetëm këtë telash, edhe xhaketa i binte ngushtë...»

«Vashë e bukur, ende nuk gjetët banesë? — pyeti njeriu me fytyrë bukur të gjatë, me hundë të mprehtë. Djathtas, në ballë, kishte lëshuar edhe lëmuar balluken, e cila nuk ishte e dendur, këte e kishte bërë ai për ta mbuluar ballin që kishte zënë të rritej kah tupa...»

Shpërtheu furishëm uji dhe dy kalimtarë këcyen anash, në trotuar që të mos spërkatnin, u gjetën në mesin e vashës dhe njeriut të panjohur. Vasha ndjeu sikur diçka thellë e urdhëroi: «Shfrytëzoje rastin dhe ik! «Ky njeri ka qëllime të këqija!» Dhe, ajo mblodhi forcë, por

ja, këmbët nuk i punuan dhe mbeti në vend. Djelmoshat vazhduan trotuarit...

«He, vashë, mëkat, si s'keni gjetur banesë?» — pyeti ai. Lëmonte balluken.

«Njashtu... kërkova po... më ranë këmbët... ku po e dini ju se...?!»

«Ju përcolla sot. Kur erdhët, isha në stacion...»

«Nuk kishit tjetër punë?!» — tha Kumria. I lëshoi një shikim të rreptë.

«Më falni, vashë, unë pyeta, sepse ndjeva dhembje për ju. E di se ç'do të thotë të mos njohësh asnjëri në qytet. Mos më keqkuptoni! Unë jam njeri familjar, andaj s'do të mund të humb kohë më. Zaten kjo s'më leverdis fare. Po më panë të njohurit, edhe këtu në qytet, fjala merr dhenë. Po ke frigë? Mirë, unë po eci...» — tha ai e pas tre hapash kthei me të shpejtë. Shtoi: — Posa ktheva në shtëpi për drekë, i rrëfeva gruas sime dhe ajo më tha që të dal t'ju kërkoj...»

«Edhe në qytet paska njerëz bujarë», mendoi ajo dhe u nis. Tani u turpërua pse pak më parë deshte të ikte...

Teksa Kumria erdhi në vete për t'ju përgjegjë plakut, ai, duke hapur gazetën, shtoi si duke murmuruar nën mustakë:

«Më fal, vashë, nuk desha të të pyesja.»

«Pres dashnorin...» gjegji ajo me zë.

Ai paloi gazetën dhe buzëqeshi.

«Ndonjë djalosh bukurosh?»

«Po.»

«Duheni?»

«Me zemër»

«Kaherë?»

«Kaherë.»

«Ç'punë bën ai?»

«Është shofer. Ka mësuar të vozisi në ushtri e, këto ditë ka dhënë provimin...»

«Po ti?»

«Jam daktilografe.»

«Mrekulli. A jeni e qytetit?»

«Jo, kam ardhur nga katundi.»

«Jeni fejuar?»

«Shpresojmë, ende jam e re...»

«Rueju, o të paça, këtu në qytet djelmoshat janë të rrezikshëm!?»

«Edhe ai është nga katundi» — gjegji Kumria dhe vodh me bisht të syrit në hyrje të parkut. Një i ri që hyri, i ngjante bukur shumë Shpendit, por jo. Pas tij hyri nji grua bionde me karrocë para vetes...

Kur kthëu te kiosku, Kumria pahiri shkeli në një gropë të vogël dhe ju dridh pak gusha e bardhë. Ai e soditi dhe ajo dridhje e shqetësoi, e ngacmoi diçka që ta përqafonte para botës. Ajo e diktoi dhe zu të dyshojë pakëz. Ngadalësoi hapat.

«Më pritni këtu!» — tha ai.

«Ku po shkoni?!»

«Në këtë kiosk më duhet t'ja blej djalit një lodër, nuk guxoj të shkoj në shtëpi, po nuk bleva një majmun lodër nga ata që, kur kurdisen, u bien daulleve. Më ka thënë vogëlushi, më pritni!»

Dolën nga lifti dhe ai vrik e hapi derën...

Ajo hyri brenda, ky e mbylli derën dhe lëshoi çelësin në xhep.

Gruaja me karrocë kalonte mu para këmbëve të tyre, pranë bankave në park. Fëmija me faqe të buta si brumi i bardhë kishte paluar qepallat dhe buzët në çastin kur e kishte zënë gjumi duke buzëqeshur ëmbël. A thua është vajzë apo djalë? Sa i bukur! Çfarë vetullash që më paska! Edhe djali im do të ishte kaq. Ndofta më i madh... Nuk vu re kur i rrodhën lotët nëpër mollëza. Mamia më pat thënë... Pse lejova? Njësoj si ta kisha mbytur unë. Krim! Më mirë të isha turpëruar, tek e fundit pëshpëritjet do të ishin shuar e dhembja, e kjo që po më bren...

«Imperializmi! Phu, nënën... vashë, më falni! — u shqirr plaku me zë tingëllues dhe fërfëlloi bishtin e cigares në lulishte. Kumria e shikoi, u trand. Më tepër u turpërua, kur diktoi se ai po ja soditte lotët rrëke.

«A?» bëri me habi. Nuk mund të kthjellohej me të shpejtë.

«Kulçedra janë ata... duan gjak... të etshëm për gjak. Phu! Fëmija ka lindur me vrragë.»

«Ndërsa ky që flente në karrocë ishte shëndoshë si vera.»

«Syri i keq mos e paftë! — tha plaku.

«Sa ëmbël flente!»

«Të vodha sapo e shikoje. Ke zemër bujare, vashë. Menjherë të rrodhën lotët... Mos paç punë me pensionistë. Ti pret dashnorin, kurse unë të mërzis me informata. Phu, imperialistëve!» — pështyu plaku. Po soditte plepat; gje-thet e tyre zbardhonin herë pas herë kur i rrihte era e lehtë, ato dukeshin si aeroplana të bardhë drejt me atë copë kaltërie, deri atje ku po zhytej në tymin e dendur të fabrikës. E shikoi edhe një herë atë sikur të donte të thoshte, por tha me zë të butë: — E, unë tani po shfletoj gazetën, kurse ti prit të dashurin...»

Ai e ndezi vetëm llambën e mbrëmjes pranë kanapesë dhe, duke buzëqeshur, tha:

«Uluni, thëllëzë e bukur, uluni! Dëshironi kafe?»

«Kurr gjë! — tha Kumria thekshëm. Vetëm kur nxori këtë zë tingëllues, i ra në mend se bëri mirë që u shqirr.»
Ndofta do të më dëgjoj ndokush mendoj, unë sërish do të bërtas...»

«Diçka duhet të pini, thëllëzë — tha ai dhe, sa u përul të nxjerrte filxhanat nga vitrina e vogël, i ra ballukja e rrallë më poshtë në ballë dhe ju zbulua një pjesë e kokës tullace. Filxhani dridhej...»

«Ma çilni derën! Dua të dal!

«Mos ashtu, thëllëzë. Tani është vonë. Në rrugë ka shumë të rinj, dhe, s'keni hesap të shkryheni në park, këtu e keni mirë. Çfarë kafe pini?»

«Kurr fare! — shkrepj ajo dhe ja plasi vajit.

Nëna e pat përcjellë gjer afër rrugës ku për çdo ditë kalonte kamioni i druvarëve, dhe, sa u dëgjua sirena e fortë atje larg, ku shtëllunga-shtëllunga po ngrihej plu-

huri, që derdhej dhe shpërndahej dendur në pyllin e gështenjave, i pat thanë me lot ndër sy:

«Po shkon bija ime? Të qoftë rruga e mbarë!...

«Do të vij të shtundeve...»

«Të ka rritur nëna me skame...»

«Do të hyj në punë dhe...»

«Merre bohçen. Erdhi kamioni!» — i tha dhe fshiu lotët. Nuk deshti ta shohin druvarët të përлотur. — Rueju, bija ime! Qyteti është qytet. Mund të mashtrohesh. Rueju!

«Nënë... — deshi ajo të thotë diçka, por u ngurrua...»

Kamioni u nis me të shpejtë dhe ajo mbeti skaj rrugës. Larg kthesës u ngrit pluhuri i dendur dhe tani derdhej mbi gjethet e arrave.

«Pije, vashë, kafen, dhe mos keni frikë!»

«Nuk dual!»

«Oh, sa të egra e të ëmbla që më jeni ju që vini nga fshati».

«Pse më gënjyet se keni grua?!»

«Nuk gënjeva, vashë».

«Ku është».

«Përkohësisht jetoj vetëm. Ashtu e lyp detyra ime. — tha dhe muer të kurdiste majmunin lodër».

«Thatë se keni edhe fëmijë?!»

«Kam...»

Ora ishte nëndë e trembëdhjetë minuta.

Nuk vu re kur e lëshoi lodrën mbi tryezë. Diktoi vetëm atëhere kur zu të bumbullojë daullja. Majmuni i binte me të dyja shputat. Sytë e lodrës shkëlqenin. Ai diktoi si u tremb ajo, e rrëmbeu e puthi me afsh. Ajo u bë prush dhe u shtang. Pastaj u përmbloodh si iriqi dhe e shtyu me hov. Ai u rrëzua në dyshëmë, me krahun e majtë e qëlloi tehun e tryezës. Transistori ra. Majmuni heshti. Ai deshti të ngrihej, por vasha ja dha një shqelm në gjoks, rrëmbeu karrigën, e ngriti lart si e çmendur, dhe, deshti ta qëllojë në tepe tani të zbuluar, sepse flokët i kishte të shprishur, por ky, me të shpejtë e tërhoqi tepihun dhe vasha u rrëzua. Llamba e vogël sikur vraponte nëpër hapësirën e dhomës. Derdhte mija yje xixëllues. Ofshani mbytur dhe zu të pëshpëriste diçka që nuk kuptohej...

U ngrit ngadalë si bisha, me sy të çartur. Po ja zbërthente kopsat e xhaketës.

«Domethënë, kah ora gjashtëmbëdhjetë duhet të vijë apo?» — pyeti plaku.

«Në qoftë se vjen... — tha me sherri një vogëlush tjetër, i djersitur.

«Po.»

«Vështirë është të presësh — vu re plaku. Lëmonte krrylin e shkopit me duart e thata me damarë të mbufatur. Shikonte butë e ngrohtë vashën. Ajo ishte zbehur. Ishte hutuar duke shikuar gruan biondinë dhe burrin e saj. Ata tani po zbritnin shkallëve të lulishtes...

Fëmijët luanin e bënin potere mbas topit.

«Por, ai do të vijë — tha Kumria dhe ja donte zemra ta shihte tani duke hyrë në park, duke buzëqeshur...

«Nuk ka kurrëgjë më të bukur se kur vasha pret një dashnor, ja siç po pritni ju e jo si ato që bëjnë njëmijë të zeza e tani me sa sy e faqe e venë dyvakun e bardhë dhe para ofiqarit thonë me zë të ëmbël: «E dua, e kam dashur vetëm këtë, me gjithë zemër...» Phu! Gjenerata! Çka dreqin u bë kështu, oj vashë?!... A dilni në mbrëmje në këtë park?»

«Kurrnjëherë, axhë».

«Sikur të dilnit në mbrëmje. Tmerr! Ndiqen si macat. Pi hi, hi pa, ha ha... Phu! Si kudrat... më falni vashë...»

«S'ka gjë...»

«Kush bën ashtu?!» — e pyeti vogëlushi plakun me qëllim që ta ngacmojë. Ky e fërflloi gazetën, dhe e qëlloi në shpinë tarapushk me shkop. Ai treti duke klithur, kurse topi u zhyt në lulishte...

Dielli po derdhte shokën e mbrame të rrezeve përmbi fshat. Njerëzit u kthyen nga varrimi. Kthei edhe Kumria pranë kasolles dhe po qante në mesin e grave. Sytë e saj ishin të enjtur, merre frymë rëndë. Në oborr sikur po dëgjonte zërin e nënës, atë zë të ëmbël. I bëhej se ajo po

vjen me njato rrudha të thella, të dashura e fisnike në fytyrë.

«Sonte do të flesh tek unë» — i tha gruaja e bëshme.

«Ndofta do të vijë...» — u gjegj Kumria. Ishte e lodhur, mezi lëvizi për ta mbërthyer kopsën e mantilit. U trand kur lëvizi fëmija në bark, dhe, *dreshti* mos edhe gratë e muarën vesh. Gati i ra të fiktë. Brofi një nuse dhe i tha duke e mbajtur për krahësh:

«Siç kemi lindur, do të vdesim, Kumrie».

«Të gjallët me të gjallë, kurse të vdekurit...» — shtoi një tjetër.

Ajo ofshani disa herë duke i përcjellur gratë e mahallës; dhe kthei te votra e zjarrit, aty në atë postaçi rrinte nëna e shtrime sa herë ndjente dhembje. Pranë saj, ulur në shkëmbë, shpesh i thonte Kumria:

«Do të të çoj te mjeku, nënë, me rrogën e parë...»

«O, të paça. Kur të bëhet këmisha për arna e trupi për barna...»

«Do të shërohesh, nënë.

«Kështu thonte edhe yt atë (ndjesë pastë), donte të shiste lopën e kositi për këtë plakurinë..

«Por, nënë...»

«Oh, të paça, është prishur koka, zemra, gjaku... As guri nuk do të mund të qëndronte sa unë, ti ishte e vogël, s'e ke parë gjakun në fytyrën e Sherifit, kur e sollën me sajë... hajt, nënë, hajt... atij dimri, kur e sollën me sajë, hajt nënë, hajt, dëgjova si m'u lidh diçka nyje në fyt pastaj ajo nyje pëlciti, dëgjova si më kërciti tepeja e kokës edhe një damar në tamtha, hajt, nënë, hajt... gjeraqina ime. Rritu ti, bënu e zonja e vetes, mos t'u bëftë këmisha për arna...» — thoshte kështu ajo dhe mirrte umin e ndezur, shkapuriste hirin, thuese aty donte të fuste thellë ato skena të atij dimri të fortë, që ja kositi djalin e hasretit dhe ma s'pa ditë të bardhë.

«Çohu, Kumrie!» — e zgjoi zëri i Gjyles. Kishte ardhur kaherë dhe ishte ndalur para derës.

«Ai?! — kërceu ajo dhe ju ba se mu në atë çast nëna e lëshoi umin e ndezur në hi dhe i buzëqeshi dhembshëm.

«Kumri, sot nuk është dita, por...»

«Ç'do të më thuash? — e pyeti me zë të lartë edhe pse vrik u pendua.

«Aman, në çdo letër po më lutet Shpendi...» tha ajo dhe zu të kafshojë thekun e shamisë, dridhej, nuk kishte guxim t'ja lëshojë sytë.

«Ç'po të shkruan?» pyeti. Mbushi grushtin me hi.

«Plasi të ta dijë adresën...»

«Nuk gjete ditë tjetër?!» — u kërcnua dhe u mat për t'ja hedhur hirin syve.

«Më fal, por ai... ti e di...»

«Mjaft!» tha Kumria me të kaluar shkallën e gardhit të oborrit të fqinjës.

Nusja po e priste.

«Eja, nesër ke për të udhëtuar, je e lodhur...»

«Ndofta nuk mundem, a po punojnë akoma druvarët?»

«Po, për çdo ditë»

Fryjti papritmas një erë e vokët dhe gjethet e ftonjve dhe të kumbullave u derdhën në tokë. Kumria ofshani dhe fshiu lotët. Gjylja treti e turpëruar mes degëve gjysmë të zhveshura, dhe, nuk e kthei më kokën. Kur muar të hyjë në derë, dikah nga larg thuese era ja sillte zërin e dashur të Shpendit: «Ma jep dorën, Kumrie, po shkoj ushtar, Kumri!»

Retë e murme të mbrëmjes veshin qiellin në mes dy bjeshkësh, që ngriheshin madhërisht kah perëndimi...

«A e sheh? Phu! Nuk të lanë të qetë!» u ankua plaku i mbushur frymë e më shumë mllef.

«Mos ua vini veshin...»

«Ama, ku është edukata? Ku është?! Të thotë ky plak i mbetur se nuk është larg kiameti. Po, ai kiameti me këpurdha të zjarrta».

«Fëmijë janë...»

«Edhe unë... edhe ti kemi qenë fëmijë... edhe ti je vashë, por ja shih e më fal, shikoje atë kudër!»

Një djalosh me flokë të gjatë po puthte një vashë, e cila nuk shihej fare. Shihej vetëm fustani i saj i ngushtë, dallohej mirë, sepse ishte i bardhë. Shiheshin dhe duart e saj duke e përkëdhelur në supe.

Ajo nuk bëri zë. Uli kokën.

«Phu! Gjenerata. Phu! Nuk ka qetësi nga të rinjtë, edhe nga fëmijët. A e pe si ma nxori gjuhën?!»

«Po, e pashë».

«Shejtanë si fëmijë, edhe më shejtanë kur rriten...»
— Luajti pak nga vendi, shtoi: «Ja, thua jse nuk kanë vend tjetër për t'u puthur. Phu! Bile të kishte pasë ky i marrë kë të dashurojë. Ajo me gjasë, dy herë ka abortuar. Phu! — Plaku futi kapelën edhe më thellë në kokë, dhe vetëm atëhere i ra ndër mend të kërkojë falje.

Ishte mbrëmje e ftohtë dimërore, kur erdhi zonja e shtëpisë dhe e thirri këtë derisa ishte shtrirë.

«Kumrie, çohu, po të pret te dera...»

«S'i duhem kurrjë».

«Si do ta kalosh natën kështu e sëmurë?!»

«Ethe janë këto, kalojnë...»

«Po të pret kërroca... — Zonja muar të dalë kur ai u fut brenda duke lëmuar balluken.

«Ç'po pret më?!» — pyeti ashpër.

«Ç'të duhet ty!»

«Çohu!»

«Nuk dal e gjallë!»

«Ta heqim këtë turp! — Mezi ja mbusha mendjen mamisë. Këtë nuk do ta bënte për gjithkënd...»

«Të shkoj në spital?!» — pyeti ajo dhe puliti sytë e friguar.

«Çfarë! Në shtëpinë e saj.»

Vringëllonte kamxhiku i karrocierit. Ajo nëpër çadrën e grisur vu re si u trembën serrat përmbi pullazet e shtëpive skaj qytetit dhe shikoi bukur gjatë a mundet në shpejtësi t'i zbërthejë kopsat e drujta të çadrës. Mbërritën tek ura, pa vetëm një pjesë të lumit ngarkuar me akuj të thyer. Me të dalë prej urës, ajo brofi, e, nuk besoi se do të ketë fuqi, dhe si vetëtimë hapi çadrën e karrocës, këceu ashtu si e pakokë, vrapoi si dallgë kah parmaku i urës u katrris dhe, kur bëri të këcejë duke rrudhur sytë, me dëshirë se pa vonuar do të binte në ata akuj, dora e tij e fuqishme e kapi për këmbësh. E tërhoqi kah ka-

rroca dhe e futi brenda. Vringëlloi kamxhiku dhe turma kureshtare, e cila akoma nuk ja doli të grumbullohet, mbeti prapa në atë tollovi e pshtjellim të paqartë.

Karroca u ndal para derës së oborrit. Ai zbriti, i ra ziles, kurse qeni i madh brofi dhe zu të lehë. Grithte me mllef stelën...

«A, vashë, mezi po të pritet...» — tha plaku duke lëpirë për së gjati cigaren para se të ndizte.

«Hë...» bëri ajo. Ndjeu dhembje në kokë.

«Vjen, vjen...»

«Edhe unë besoj... — tha ajo. Prekte tamthin me gisht.

«Kur jeni pa së voni?»

«Para disa ditësh, në plazh...»

Ja behi kamerieri simpatik, ndërroi hapat me elegancë dhe si ushtar u ndal para tyre:

«Më falni, ndofta po ju shqetësoj...»

«Ç'kemi?» — pyeti ai. Hoq syzet e diellit.

«Telefoni.»

«Kush më kërkon?»

«Nuk më rrëfeu. Ju kërkojnë me urgjencë!»

Ata u nisën kah hoteli, kurse Kumria mbeti ashtu e brylëzuar. Sodiste valët, që ngriheshin me furi dhe, kur rrihnin shkëmbinjtë, shpërthenin përpjetë e bredheshin në rërë si margaritarë.

«Zojushë, sa hijeshi që m'i paske dhënë plazhit!» tha Shpendi. U përul me ngadalë. E puthi ngrohtë. Asaj ky çast ju duk si përrallë e bukur, kurse djaloshi si princ, që del nga përralla, ndofta nga deti, nga ato valë lazdrane, që përdridhen mrekullueshëm rreth gurëve.

«Kur erdhe?!»

«Sa ja mbërrina.»

«Ç't'u desha?!»

«Si ç'm'u deshte, budallaqja ime!»

«Shpend, të lutem...» — qante.

«Erdha të të marr me vete...»
 «Ik, Shpend! Po u kthye...»
 «Këtu do ta pres!»
 «Kurrsesi!»
 «Ai nuk bren hekur?!»
 «S'ka ç'i bën!»
 «Do ta shohim, Kumrie!» tha dhe u ul pranë saj.
 «Eja!» — shtoi dhe diktoi si dridhej, mu si veli i një barke, që po zhytej atje larg në kaltërinë e detit.
 «Nuk mundem».
 «Apo nuk do?»
 «Edhe njëra edhe tjetra!»
 «Ashtu, zozushë, e, unë i marri në rojë, vonë natën mendoja për ty, dëshiroja të di ku je ç'bën, ashtu, unë i marri. Të kërkova, kurse ti ikën...»
 «Shpend, çdo gjë ka vdekur...»
 «Unë jam i gjerë sa deti. Po, mu sa ky det, a e sheh sa magjik është! E, njëmend jam i marrë. Po të shqetësoj e deti është i bukur, ja si krrokasin pulëbardhat...»
 «Ato po më duken të zeza!»
 «Dokrra»
 «Shpend!»
 «Ma jep dorën, Kumrie! e luti ai dhe u ngrit në këmbë.
 Ajo ja shtriu duart dhe ashtu e përlotur ju hodh në parzëm si valët në bregun me rërë.
 «Thonë i pastër si loti, kurse këta lot po më duken shumë të ndyrë!»
 «Shpend!...»
 «A të besoj se më do, a t'u besoj lotve?»
 «Si të duash...»
 «Eja të ikim!»
 «Jo. Të dua, por...»
 «Kumrie, një muaj kurseva. U ushqeva vetëm me bukë e me kos. A e sheh si jam dobësuar. Para se ta merrja këtë rrugë. Kam marrë vetëm gjysmë rroge, nuk jemi rentabël, Kumrie...»
 «Ik! Po vjen!»
 «Andaj po pres!»

Ajo mbeti si statujë, kurse ai ndërroi një hap anash dhe po priste si graniti. Valët rreth shkëmbinjeve sikur u shqetësuan.

«Kush je ti që e shqetëson?!» — pyeti ashpër.

«Eja të marrësh vesh më hollësisht!»

«Edhe po kërcnohesh! Ty të ta shtrydhësh gjuhën, të rrjedhë tambël.

«Provoje!»

«Hup e mos m'i përlyej duart!»

«Si duket unë do t'i përlyej. Ku e ke gruan? Po fëmijët?»

Ai avitej. Kumria klithi:

«Shpend!» dhe vrapoi t'i thirrte turistët në ndihmë.

Djaloshi uli kokën dhe e sulmoi si dem i shqetësuar. E goditi në bark dhe ja ndau frymën. U plandos. Pastaj i hipi me grushta fytyrës, kokës. Ja vu gjunjtë në bark dhe gishtat në fyt.

Dy turistë arritën para të tjerëve dhe ndërhyjnë. Mezi e mbanin...

Skaj lulishtes u duk Shpendi buzagaz.

Plaku ngriti kapelën më lart në tepe dhe shikoi atë kur u ngrit lehtë, por nuk harroi ta përshëndeste gjithë gaz...

ZANA

Ta kam pasur frikën duke ditur se do të qasesh një herë, po nuk ma ka marrë mendja se kjo do të ndodhë sonte. Pse shoh fytyrën tënde të bukur, buzëqeshjen e dhembshme, sytë e shkruar që ngulen në një pikë dhe janë të dhembshëm, lëvizin rreth kësaj pike diku në dhomën time dhe kërkojnë mëshirë. E për çudi sytë janë të butë, rrëshqasin prajshëm prej asaj pike dhe më drejtohen, uli kokën me shpresë se ma nuk do të më shqetësojë, po kjo nuk zgjat shumë. Ngre shikimin me frigë, e ti nuk m'i ndan sytë... Erdhe e m'u qase sonte, kur jashtë bie shi rrëke, sonte, kur rënkojnë muret, pullazet, me ta marrë mendja se po vajton ky ritëm i shiut dhe erës herë të mejtun e herë të fortë. Ç'kërkon prej meje, bukuroshe e fshatit? Atëbotë unë isha vogëlush si të gjithë të tjerët dhe nuk pata ç'të bëj tjetër pos të vrapoj pas shiut të vjeshtës nëpër livadhin e vokët, duke më mikluar e xigëluar fijet e buta të barit. Pa më thuaj një herë: Pse më qasesh?!

«Mba mend kur të përqafova?!

«Si sot...»

«Ama kur isha nën vel të bardhë?»

«Të parin më pate vokur me lotë»

«Gjersa vajtoja blerimin...»

«Arat, bjeshkët...»

«Pastaj erdhën krushqit...»

«Edhe qerret, kuajt, Zanë»

«Nuk ke harruar klithjet e fundit?»

«Jo. Të përcollëm gjer te mëshitekna».

«A e ke parë vogëlushin tim?»

«Atij i ngjan.»

«Shpesh kthen në shtëpi i përlotur...»

«E rrahin fëmijët?»

«E gërgasin...»

«Si?»

«Djal' i plakut — vaji sokakut!»

Ndofta posa të prajë shiu, fytyra jote do të zvetnohet dhe do të tretë me shkretimën e lehtë të vetëtimave atje lart ndër kreshta. Do të mbesë në kujtesën time vetëm ai çast kur pashë fytyrën e buzëqeshur, bukurinë e dhembshme dhe rrezet e mëshirës në ata sy të butë. Shiu nuk po pushon. Nata, është e gjatë, e pafund. Ngre dorën me plogështi nate dhe mënjanoj perden e butë prajshëm. Në xham lahet qyteti me shi e me drita të zbeta, herë e shoh e herë jo, si përrallën në kujtesën e fëmijës... Shko! Tret sa më parë e këtu do ta këpus rrëfimin për ty, sepse aq më ke piklluar sonte sa njëmend nuk di nga t'ja filloj e aq më pak si të mbaroj. Shihe, akoma nuk ja fillova e po ndjej si më shtyp njëfarë barre e rëndë, e padukshme, më shtyp. A është ky kujtimi për bukuroshen e fshatit? Ky rëndim i shiut dhe erës, që rrahin muret — është fati i saj? Më fal që kësaj here po ndërprej këtu, sepse në valën e rrëmbyeshme të këti ankthi, që më shtrëngon në fyt — për të rrëfyer diçka për ty, vetëm mund të ofshaj, si era dhe të rënkoj si ky ritëm mbi pullaz. E, vetëm jam...

«Nuk je tim»

«Dakord»

«Mjafton kjo?!»

«Jo, ç'të bëj?!»

«Rrëfe!»

«Pasi të praj shiu...»

«Nuk do, të kesh kohë.»

«Si?!»

«Do të vraposh nëpër livadhet e fëminisë...»

«Të ndalem te caku yt, Zanë?»

«Mos, të lutem!»

- «Edhë te dashnori?»
 «Të vdekurit i leni të qetë!»
 «Pse e vranë?!»
 «Më donte më shumë se sytë...»
 «Kush e qëllloi?»
 «Një shigjetë motil!»
 «Ka qenë i bukur, Zanë...»
 «Mos gërvish në plagë!»
 «Atëhere, tret, ikën!»
 «Kaherë e kam pritur këtë çast.»
 «Këtë apo atë në shelgjishtë?»
 «Të dytë»
 «Ç'të fali ai çast, Zanë?»
 «Një kujtim t'ëmbël e një t'idhët.»
 «Jam shumë i lodhur, Zanë»
 «Pat ndodhur diçka e këndshme atëbotë...»
 «Në shelgjistë?»
 «Një vdekje pas tre muajsh, një lindje mbas nëndë muajsh...»
 «Je më e dhembshme se ky ritëm i shiut vjeshtak».
 «Çfarëdoqoftë, jeta është e ëmbël, vogëlushi im i fshatit...»
 «Mos qofsha në lëkurën tënde!»
 «As unë në të birit tim»
 «Akoma e gërgasin?»
 «Më vjen të klith: nuk është ky biri i plakut»
 «Mos, Zanë!»
 «Do të klith si atëbotë nën duvak...»
 «Të vinte era e njomë, pastërti të faqeve e flokut të shprishur».
 «Si degët e shelgjeve»
 «Më ledhatove me duart e mallit.»
 «Flokët kanë zënë të më bien.»
 «Flokët e zez, të pastër, të bukur?»
 «Buzëqeshjen që po sheh nuk është ajo. Ka perënduar...»
 «Më qasesh si kokonë?!»
 «Desha të të kthej në livadhe. Vrapo!»

«Të mos e ndal vrapin gjer te shelgjet?»

«Kam droe se atje të vret kujtimi»

«Oh, Zanë. . .»

«Burrat nuk ofshajnë. Shiu po rënkon, çoje perden!»

«Poshtë, qyteti po lahet në shi, në djersë. . .»

«Mos i përmend djersët!»

Më fal. Ajo natë ka qenë e dhembshme, e trishtueshme, e rëndë. Është futur plaku në dhomë, ka mbyllur derën prapa dhe ka zënë të fluturojë me flatrat e magjisë së syve të tu dhe të bukurisë. Ka dashur të të puthë! E ke larguar me aq rrëmbim, sa ai ka rënë mbi arkën e vjetër. Ç'ke parafytyruar në atë mes, Zanë? Djalin duke i shpërndarë me duar e me sy degët e holla, të dendura të shelgjes, duke i ngritur lart e më lart që të mos i kenë kokat e lëvruara, të pikëlluara. . . Po plaku? E ndezi një cigare duke u dridhur, duke ofsharë? Sërish ka marrë flatrat e vyshkura për t'u futur në gjirin e lules së çelur, a e joshi era e qenjës sate, e gushës së bardhë? Në cilin rreth të gushës desh të mbështjellë çerdhen? A u shkëput çershja sërish dhe a ra mbi arkën e vjetër? Sa vite kështu?

«Gjer më sot. . .»

«E tutje?»

«Me të vjetrën. Tani e kam më lehtë. . .»

«Më lehtë?!»

«E ka lënë edhe ajo fuqi. Flej me tim bir. E dua shumë. . .»

«E plaku?»

«Kush do ta donte fëmijën e huaj!»

«Pse të mban?!»

«Ruan emrin. Edhe fytyrën»

«Fytyrën?!»

«Më fal që t'u qasa sonte. Akoma bie shi?»

«Si me shtamë. . .»

«Merre me mend, edhe shelgjet pikojnë. . .»

«Ti prapë atje, te blerimi»

«Unë kam jetuar vetëm pak çaste. Ndalunjëherë. Vene penën mbi ballë dhe orvatu ta kuptosh, të peshosh, të përjetosh sa rëndë është. . .»

Kur kërciti pushka e parë, vashëzat rrëshqitën dhe

ranë nga luhajat, picrruan sytë atje ku futej këmbësorja në gjiun e rrugës më të gjatë të fshatit. Nëpër oborre vlonin burra, gra e fëmijë dhe filloi një vaj i tmerrshëm. Ne carrokët hoqëm dorë nga gjuetia me sokol. Edhe ai lëvari flatrat dhe pas pak treti përtej zabelit të dendur. Sakaqë ra një fashë që na e zinte frymën. Të gjithë heshtën, e sërish vaji, ishte edhe më i dhimbshëm, prekës e rrëqethës. Nuk dëgjuam një fyell atje përmbi kullosë. Nëna e djaloshit të shituar ngarendi kah fundi i këmbësorës dhe u hodh në gjoksin e tij të kuq. Dita e bukur veshi një futë. Vashëzat më nuk hypën nëpër luhaja, i copëtuan gjerdanet e shkruar... Gjakësi lëshoi një shami të zezë në tokë dhe u fut në pyll...

«Ku ishte atë ditë, Zanë?»

«Në bisht të livadhit...»

«Ç'bëre, bukuroshe?!»

«Preka fëmijën në bark...»

«Fëmijën?!»

«Lëvizi tri herë, gjallërisht.»

«Pastaj?!»

«Ra në gjumë... Desha të marr vrapin si e çmendur nëpër ara, ta këpus përruan, t'i shqetësoj shelgjet e t'i shpërndaj me duar, me furi si era kur i rreh ato, si era kur i shprishte flokët e mi atëbotë, të gjunjëzohem e t'i pëshpërit në vesh se si nuk ka vdekur...»

«Pse u ndale?»

«Lëvizi fëmija edhe një herë...»

«Të kuptuan?»

«Fort mirë.»

«Pastaj?»

«Heshtën?»

«Heshtën.»

«Ma deshti zemra të më flisnin ndonjë gjë, isha e gatshme të sulmoja dike. Por, si të luftoja kundër hesh-tjes? Nuk pat dyluftim...»

«Nuk qajte?»

«Me zemër, po»

«Kush derdhi lot?»

«Nusja e gjakësorit. I rrëmbeu dy vashëzat si dy fëllënza të shastisura, i përqafoi dhe mallëkoi çdo gjë që pa si në mjegull me sytë e mbushur me lot; mallëkoi barin, përruarin, arën, livadhin, qiellin, mua, dashnorin, zakonet...»

«Plaku ku ishte?»

«Tuhaste krye livadhit.»

«Heshtte, apo?»

«Si toka... kruente lythin në mjekër»

«Athua ç'pëshpëritte në heshtje?»

«Më shpëtoi fytyra!»

«Fytyra?»

«Po vogëlushi im. Shiko, a ka pushuar shiu?»

«Me gjasë po. Andej mbi majet e bjeshkëve po vetëton»

«Edhe vetëtimat i urrej, heshtin...»

«Ta do qejfi të buçasin?»

«Nganjëherë po. Të jehojë diçka e fuqishme ndër lugje...»

«E çuditshme je, Zanë!»

«Ke menduar se fshataret janë marroqe?!»

«Jo, Zanë.»

«Hajde, lëshoje pendën nga balli. Shkruaj!»

«Nga t'ja filloj, bukuroshe?»

«Mundesh nga buzëqeshja...»

«Nuk kam fuqi»

«Nga sytë...»

«T'ja filloj nga shelgjet?»

«Mos. Ai cak është i mallëkuar!»

«Bën nga djali i zemrës?»

«Mundesh. Shih, or, gjithnjë e më shumë më bën të dyshoj se kurrë nuk do të mund të bëhesh shkrimtar i fshatarëve, që ecin këmbë zbathur nëpër shkrepë, nëpër hulli...»

«Kjo është e tepëruar!»

«Këtë jetë të idhët po e thith që kur e pashë bukuroshin duke shiluar kalin allgj, kurse ti nuk ke guxim të fillosh, të shkruash... Ka pushuar shiu?»

«Plotësisht. Vetëtimat jo.»

«Ç'e do. Lugjet nuk po jehojnë!»
 «Ama ç'je mbështjellë ndër këto jehona!»
 «Dua t'i zgjojnë zanat e malit nga gjumi...»
 «Ti je e hollë, bukuroshe...»
 «Pse urrej heshtjen?»
 «Tamam»
 «Ta thom edhe një herë, vogëlushi im i livadheve,
 ajo më vret!»
 «Sepse në heshtje nuk ngjet asgjë...»
 «Mirë e ke. Ja pra, filloja! Mirë mbeç!»
 «Të nisi nga shelgjet, Zanë?»
 «Mos prek në cakun e mallëkuarë!»
 «Po ëndërron djali yt?»
 «Ëmbël...»
 «Nuk po ta shoh buzëqeshjen, bukuroshe?!»
 «Aq më mirë. Të thashë se të gjitha kanë perënduar...»
 «Ku i ke sytë e shkruar?»
 «Nuk kërkoj mëshirë!»
 «Ballin me djersë, duart e buta erën e...»
 «Dielli im ka rënë pas kreshtës. Po munde, shikoji
 zanat e tjera kah fundi i livadhit, ja si heqin valle me
 plepat e gjatë...»
 «Nga lindja?»
 «Ëhë»
 «Më le në vetëmi, bukuroshe?!»
 «Shkrimtarët kurrë nuk janë vetëm, nuk kanë qetësi...»
 «Të luftoj kundër heshtjes... Vetëm po vetëton?!»
 «Parafytyro jehonat, që rrahin brigjet me kamxhik!»
 «E mrekullueshme dhe e dhembshme je, bukuroshe
 e fshatit...»
 «Mirë mbeç, filloja, ç'po pret?!»
 «Kah trete? Ç'u bëre?! Edhe zëri yt treti ndër jehona,
 që po shpërlajnë faqet e qytetit atje poshtë, e dora ime
 mbet në perde si flutur e plagosur, ta lëshoj perden e të
 ndahem nga pamja magjike e përrallës së fëmijëve nga
 qyteti. Le të lëvaret edhe pakëz. Dridhjet nuk mund t'i
 ndal, e tregimi për bukuroshen nuk di ku zë fillë. Ndoshta
 m'u në atë vrragë të bregut ku e rreh kamxhiku i jehonës,
 por, jo. Edhe kjo është heshtje...»

ASAJ NATE TË EGËR

Pasi prani së lehuri qeni dhe pas tij, për një kohë, ulurima e ujqve, Zarifja ja vuri shulin derës dhe u kthye te e bija, që ishte strukur në qoshen e djathtë të kthinës, buzë oxhakut dhe dridhej si thupra në ujë. E shprishi në të kthyer prushin në vatër dhe pa bërë zë u ul afër saj. E mbështeti kokën në mes të të dyja shuplakave dhe heshti si shkëmbi. Terri përthekehej në çdo anë e stuhia derdhej jashtë e tërbuar. Degët e rënduara nga pesha e borës kërcitnin frikshëm. Retë përziheshin në atë turbullirë dimri. Herë-herë qeni i shtëpisë së tyre klithte në kasollën e vet, e ujqit afroreshin përherë e më tepër.

Veriu frynte furishëm. Monotonia e natës thyhej në fishkëllimën e erës. Shtinte frikë në zemrat e strukura të të dyja krijesave të strukura midis të kthinës. Nënë e bijë. Njëra lutej e tjetra, e përcjellë me dridhje, kafshonte buzët e njoma. Shnali i vjetër dhe i zi katran qëndronte përballë tyre. Drita e tij lëpihej pas asaj errësire të verbër. Heshtja rëndohej e dridhjet shtoheshin. Zarifja u ngrit. Ju afrua dritares së vogël dhe derdhi shikimet në errësirën e zezë dhe të ftohtë. Stuhia gjëmonte. Degët shtypeshin nën atë peshë të bardhë. Shikoi gjatë. I bëhej se nëpër tërë atë furtunë shihte vetëm këmbët e të shoqit, që i afroreshin shtëpisë, po që kurrqysh s'mund të mbërrinin gjer te dera. Gjurmët i përziheshin bashkë me erën. Përballë saj shihte këmbët. Dëgjonte hapat nëpër borë. Nuk u përmbajt. Thirri. Një herë ngadalë. Zoja e dëgjoi, po përsëri u shkri në dridhje e frikë. Zarifja bërtiti edhe një herë me zë të lartë, e Zojës i kërceu zemra në fytyrë. U rrëqeth. Trupin ja përshkoi një ftohësi e hatashme.

Nuk mundi as të lëvizte. E shikoi të ëmën, po ajo e kishte mbështetur kokën mbi mur dhe qante. U ngrit e rënduar. Shikoi prapa në gjysmerrësirën e kthinës dhe me hap të gjatë e të ngutshëm ju afrua së emës. Ju duk sikur dikush ju lëkye prapa. Nuk foli asgjë. E kapi për dore dhe e tërhoqi kah vatra, po Zarifja, duke e parë frikën e saj, i fali një buzqeshje. E bija u ngroh në atë shpalim të buzëve të së ëmës. Ja përkëdheli mollëzat dhe ja fshiu lotët. U kthye përsëri në vendin e mëparshëm. Zarifja hodhi edhe do krande në flakën e vatrës, që kishte nisur të shuhej. Heshtja përzihej me dridhjet e tyre. Era vazhdonte me lojën e vet të ftohtë. Errësira përtheqohej më dendur. Degët kërcitnin frikshëm. Nata villte frikë e lot. Ëmë e bijë qëndronin të përqaftuara në mesin e asaj errësire të frikshme. Gjithshka përreth tyre ishte e ngurtë dhe e trishtueshme. Vetëm ulurima e ujqve dëgjohej tani më qartë, ndërsa qeni i shtëpisë dhe të tjerët kishin prajtur me kohë. Nata lundronte në velin e vet të zi, e heshtja shtonte frikën.

Ju bë sikur përsëri dëgjoi hapat. I zgurdulloi sytë në drejtim të derës, po priti kot. Ajo nuk u hap. Nuk u hap as atëherë, kur ajo thirri, u shkoq nga kraharori i Zojës dhe u përplas përsëri në dritare. Shikoi jashtë dhe përsëri i bëhej se shihte hapat e të shoqit. U zbraps dhe me dorën e djathtë e mbylli gojën që të mos bërtiste. Hapat i shihte. Gjurmët i shtoheshin para syve. Ndjente borën që kërcitte nën këmbët e tij. Po atë nuk e shihte. Asgjë nuk shihte tjetër nëpër atë mjegullinë të syve të saj. Bëri të kthehej, por u shtang në vend. Mishi i luajti nga eshtrat. Gjunjët e lëshuan. E ndali frymën. Shtrëngoi nofullat. Preku kraharorin. E kishte humbur ngrohësinë. U rrëqeth. Malet e larta përreth dukeshin si kulla të djegura. Zoja qante. Zëra të ndryshëm shkoqeshin nga ato kulla dhe e lëndonin zemrën e Zarifes.

— Nënë!..

E ktheu kokën kah ajo.

— Do të vijë!..

Përgjegjen e mbyti ofshama e saj.

— Ai s'ka bërë asgjë, nënko, pas po? Përse ta marrin tani në këtë kohë? Ai është babai im. Ai s'ka faj! Jo, jo, ai do të kthehet qysh tani, nënko! Do të kthehet...

Përsëri mbretëroi qetësia. Përsëri nisi loja e mëparshme. Përsëri dridhje. Përsëri... Krejt të mëparshmet nisën përsëri. Tella thyhej në dritën e shnalit, e shullani i erës endej nëpër oborrin e strukur në ngricë. Prushi shuhej qetas. Nata derdhej lëmueshëm. Nënë e bijë dridheshin. Zarifja e skundi veten prej do mendimeve të egra që ja kapluan kokën, dhe ju afrua së bijës.

— Po, bijë! Ai do të kthehet. Ai nuk ka faj. Është i fortë ai, bijë, i fortë si shkëmbi. Nuk mundet gjithkush ta shembë atë qëndrim të tij. Jo, bijë, jo. Ai do të kthehet, e ne do të mburremi me të. Të rrallë janë si ai. Do të vijë dita, kur do të kuptosh edhe ti se ç'baba ke. Ai është komunist...

— E këta?!

Zarifja e ndjeu një lehtësim. Ju duk se e zgjidhin lëmshin e zemrës.

— Këta, bijë, janë tradhëtarë e të huaj. Kanë ardhur prej përtej detit të na presin ose të na lënë rob gjithmonë...

— E babai?

— Babai? Babai nuk e duron robërinë. Ai me shumë shokë një ditë do t'ja hanë kryet të huajit. Të huajt janë të poshtër e tradhëtarë.

Zoja u habit nga ky rrëfim i shkurtër. Zarifja e shtrëngo për kraharori.

— Ah! Kur kthehet babai?!

Ajo përplasi sytë në dorezën e derës.

— Ai do të kthehet, bijë!

Nënë e bijë u derdhën në shikime të përlotura. Nuk deshën të liroheshin nga ato vakje sysh, po dëgjuan një ushtimë pushke, që shpërtheu diku në zgurën e asaj nate dhe jehoi ndër lugjet e rënduara nga bora. U shkrinë të tëra në sy e veshë për të dëgjuar edhe një herë, po çdo gjë përsëri ra në gjendjen e mëparshme.

— Të merr gjumi, bijë?

Përgjegjen ja kthyen shikimet hetuese të Zojës, thu-

ase donin t'i thoshin së ëmës, «si mund të fle unë tani, kur babai akoma s'është kthyer».

— Ne do ta presim, nënko. Do ta presim gjer në mëngjez, e ai do të kthehet! Do të kthehet...

— Po, bijë, ai nuk dorëzohet lehtë. Do të kthehet, frik bile!

Nënë e bijë heshtën, thuase u liruan nga ajo barrë e rëndë që i shtypte në shpirt. «Do të kthehet, do të kthehet», i bluante këto mendime Zarifja. «Do të kthehet. Po, bijë, po qysh e kur?!» Këtu ndalej. I vakte sytë me ata lot të nxehtë në errësirën e zezë dhe të ftohtë. E shikonte prushin. Shnalin. Buzët i dridheshin në vaj. «Kur?» Shikonte kah dera. Ajo prante përgjumshëm. Përgjonte. Stuhia lodronte e çartur. Ujqit ulërinin egër. Shtëpia rëndohej nga një heshtje e ngurtë. Shnali zbehej. Flaka e tij dridhej përgjumshëm. Heshtje e pritje. Frikë e dridhje. Nënë e bijë, të mbetura në mesin e kthinës në përçafim, prisnin të ndodhte diçka e jashtëzakonshme. Shikimet s'i ndanin nga rezja e derës.

— Një britmë gruaje, nënko! A s'e dëgjon?

Ajo brofi në këmbë. Hoqi shulin e derës. Ajo u hap. Bora çarmatosi vakjen e kthinës.

— Jo, bijë, të kanë bërë veshët! Shih! S'ka asgjë. Kurrfarë britme nuk dëgjohet.

Çupa uli kokën. Ju dhimbs e ëma. Zarifja e mbylli derën me rrëmbim, për ta larguar frikën. Përsëri i njëjti ritëm. Nata shpalonte dridhje e frikë. Ulurima shtojh. Nënë e bijë luteshin...

— Oh! Dëgjo!

U bënë sy e veshë. E ndalën frymën.

— Nuk më bëjnë veshët, nënko! Një grua po bërtet! Po thërret në ndihmë.

Zarifja e shikoi e çmendur të bijën, e cila s'kishte fuqi të nxirrte më fije zëri jashtë, po kishte drejtuar gishtin tregues në drejtim të derës dhe përbihej rëndë. Dridhjet e morën me vete. Dera u hap përsëri me rrëmbim. Në zë ju duk se u shkoq nga zemra e asaj errësire e furtune.

— Zot! Në dorë tënde! Zot, zot, ç'e zezë e madhe do të na përlejë sonte!

Përsëri një zë nga errësira ja pickoi zemrën e vrarë.
— Njeri! Njeri! Ku je, ku je!? Njeriii!..

Furtuna përzihej ethshëm. Terri i verbër fshihte çdo sekret të saj. Bora kërcitte nën këmbët e dikujt. Zarifja u çmend.

— Njeri! Njeri!..

«S'ka kthim njeriu yt, po hyrë brenda, grua e mjerë! Hyrë, gjersa s'të ka përllarë furtuna e zhdukjes. Hyrë, hyrë! Burri i juaj është nisur për në varr. Mos u hidhëro! Ka qëndruar si burrat. Hyrë, hyrë brenda, e Zojën ruaje si sytë! Hyrë, hyrë! Nuk do të ndodhë kurrëgjë tjetër e zezë!..»

— Kush je, që mëshihesh! Dil, të të shoh e të të them se burri im do të kthehet! Dil!

«A nuk ma njeh zërin?»

Zarifja kafshoi buzët. «Zot, zëri i burrit».

— Nuk e njoh dhe as që të besoj për ato që thua. Po të jetë ashtu, do të dilje që të të shoh se kush je dhe çka kërkon në këtë kohë!

Një hije e zezë i doli përpara syve. Nuk lëvizte, por dukej si trup i pagdhendur lisi. Zarifja bërtiti. Zoja i ishte ngjitur për trupi dhe qante me zë.

«Hyrë, hyrë brenda, oj zoja e shtëpisë! Burri juaj nuk do të kthehet më. E kanë shkallmuar së rrahuri. U ka ndihmuar atyre të maleve. Nuk ka pranuar të dorëzohet i gjallë para torturave, e sonte ai shkoi, po do të lindin të tjerë si ai, të fortë si graniti, të shpejtë si rrufeja! Po ti, hyrë brenda, se Zoja është e re e nerth! Hyrë, hyrë! Unë jam roja juaj!..»

E pa, kur-hija u zhduk. E mori Zojën në krah dhe, pasi ja fshiu lotët, i thirri:

— Zojë, bijë! Mos qaj! Kurrëgjë s'është, jo! U largua! Shkoi! Shkoi, pasha lokën! Treti...

— Unë s'pashë asgjë, nënë! Kush ishte?

— Askush, bijë, askush!

E tundi kokën dhe u kthyen brenda.

— Nënë, a ke frikë shumë?

Nëna ja fali një buzëqeshja të zorshme, e Zoja ju rras edhe më tepër në gji.

— Jo, bijë! Përse të frigohem. Tani të kam ty afër, e më vonë do kthehet edhe babai yt e...

— E ajo gruaja që po bërtet, sigurisht frigohet. Ndoshta ajo s'ka kurrkend afër!

Zarifja e kuptoi se Zoja frigohej. Luajti kokën në drejtim të saj dhe me majet e buzëve ja puthi ballin.

— Oh, Zojë, të pastë nëna! Nuk ka kurrfarë bërtime e as thirrje, por të bëhet ty sikur i dëgjon!

Të dyja e ulën kokën. Pas pak Zoja i hapi sytë përsëri në drejtim të derës. Sigurisht e dëgjoi përsëri të njëjtin zë, po nuk foli më asgjë. Zarifja ja fali shikimet shulit, thuase e lutte t'ua falte shpëtimin e asaj nate. Thuase e shtrëngonte të qëndronte atë natë më shumë se kurrë.

Ishte mesi i natës. Era e përzier me borë përplasej në çdo anë. Drunjtë fishkëllonin nën peshën e borës dhe lëkundjet e fuqishme të frymës. Nata villte dridhje e frikë! Ëmë e bijë ishin shtrirë në shtratin përbri me kashtë. Asnjëra s'flinte, por nuk flisnin gjë. Të dyja ishin të rrasura në mendime të njëjta, në mënyra të ndryshme, për një temë: «A do të kthehet?»

Nata trokiste me trokun e vet në kohën e saj të gjatë.

Ndërsa kapakët e syve ju kishin rënduar në gjumin e parë, e Zoja kishte sharruar plotësisht në të, Zarifes ju bë sikur dëgjoi emrin e vet nga jashtë. Kërceu në këmbë si e pickuar. U ndal e pa frymë të dëgjojte, por errësira e gjumi e tradhëtuan. E ndjeu atë heshtje të rëndë nate dhe përsëri e pałoi kokën në kashtën e egër të shtratit. Ofshani thellë dhe për herë të parë e mallëkoi veten dhe jetën. E shikoi të bijën gjatë dhe fyti ju drodh në frymëmarrje. Tanimë çdo shpresë për kthimin e të shoqit ja gëlltiti nata e pritja e egër. Rrotullohej në shtrat, por askund s'gjente prehje. I mbështeti buzët në faqet e njoma të Zojës dhe dëshiroi të mbetej në atë pozitë.

«Zarife! Zarife! ..»

Kërceu në këmbë. Zëri ju duk i qartë. Ishte i burrit të saj. E thirri Zojën.

— U kthye, u kthye! Çohu, çohu më! Qe, po thërret!

Dili përpara! Gjuaju në kraharor! Puthe, qafe! . . . Oh, Zojë, bijë, më në fund. . .

— Zarife. . . Oh. . . oh. . . ku jeni?

Ajo e hapi derën. Bora përzihej. Zoja e përgjumshme shkeli në borën e ftohtë.

Zarifja thërriste. Bërtiste me të madhe. Vraponte. Ndalej, po nuk dinte kah të shkonte. Gjëmimin e ndjente. Frikë më nuk kishte. Vraponte. Terri përzihej. Era frynte. Ajo u largua nga oborri. Zoja nisi të qajë. Stuhia fishkëllente dhe shkundtte degët. Piskama arriti t'i zgjonte edhe fshatarët e tjerë. Dritaret e shtëpive të tyre filluan të hapen si guaca me nga një dritë të zbetë. Qentë vërsuleshin në vargonj e lihnin me të madhe. Alarm zhurme në çdo anë. Veriu shponte.

— Zarife. . .

Ajo e ndjeu prapa. U kthye.

«Zojën, Zojën!»

I hapi sytë. I ra ndër mend se e kishte lënë Zojën vetëm. U kthye prej nga erdhi. Hyri brenda. Thirri. Zoja tanimë nuk ishte aty. Të dridhurat e kapluan.

— Zojë, Zojë! Ku je, loke, Zojë?

E dëgjoi edhe vajin e saj. Bëri të kthehej prej nga i erdhi zëri. Zëri tjetër në anë të kundërt e muroi në vend.

— Oh, nënë! . . . Oj, oh. . . ohaa. . .

Ajo mbeti në midis. Nuk dinte kah t'ja mbante. Të shkonte kah Zoja, ndjente gjëmimin e të shoqit, të kthehej kah ai, Zoja shashtisej. E kapi kryet me të dyja duart dhe bërtiti me sa fuqi që kishte.

— Njeri! Zojë! Ku jeni?

Do hije filluan të afrohen. Kush me drita e kush me drurë e sëpata. Zarifja akoma thërriste. Zoja, duke e ndjekur zërin e së ëmës, ju afrua. E kapi për skajin e dimive. Tani Zarifes ju kthye shpirti. Nuk vuri re rrethin e fshatarëve që kishin ardhur afër saj dhe shikonin të habitur se ç'ndodhte, po me Zojën në krah u zhduk në errësirën e zezë prej kah shkulej gjëmimi.

Rendi i fshatarëve u nis kah shtëpitë e veta.

Donin t'i ndihmonin, por ajo ishte e ndaluar. Tretën

pas bërrylit të errësirës dhe u ndrynë me helm e dhimbje pas parmakëve. Vetëm një djalosh i ndihmoi Zarifes. E shtrinë trupin e shkallmuar të të shoqit në shtratin e kash-tës. Gjaku i ishte ngrirë; kishte varrë të shumta. Thonj, tanimë s'kishte. Ja kishin hequr e pulpat ja kishin rris-kuar.

Drita e shnalit dridhej ethshëm e lodhshëm, kur gje-lat filluan këngën' e tyre të hershme.

Të nesërmen, vonë, shumë vonë, Zoja u zgjua. E shikoi gjatë të atin dhe, qau me zë. . .

VORRAXHIU

Pasi nxiu shikimet në blozën e zezë të tymit, që ishte varur nëpër muret e trasha dhe të vjetra të oxhakut, pësh-tyu idhshëm dhe zgjati duart për t'i ngrohur mbi flakën e mekur që lëpihej pas futës së kuisë së varur në vargojt e nxirë të vatrës. Pas kësaj, menjëherë, dorën e djathtë e përplasi mbi gju po të asaj ane dhe kokën e vari në atë qafë të hollë të qëndisur me pejzi, të hollë e damarë të zez. E shtrëngoi gjurin me atë dorë të rëndë dhe ju duk se pesha e saj ishte më e rëndë atë mbrëmje.

Shtriu duart edhe një herë kah gjuha e flakës që merrte herë-herë nga ai, dhe ju duk se gjeti qetësinë. Kapakët e syve ju rënduan. Qiriri, prapa shpinës së tij, tretej padiktueshëm pak nga pak, në atë blozë të asaj errësire. Nata përthekohet ngadalë dhe errshëm. Ai qëndronte buzë oxhakut. Në mendje i përfillej jeta e tij e vogël, e lindur dikur, në dyert e mëshirës, nga një gji i rjepur ndër kohëra e shtigje lëmoshe ndër rrymat e ndryshme të jetës. Hapi sytë edhe një herë si i pickuar. Shikoi derën. Shikimet ju thyen në rrezen e ndryshkur të derës, prej kah pritte që ajo të lëvizte dhe të hynte e shoqja. Lëvizi kokën dyshueshëm dhe u kthye përsëri në jetën e tij dhe në kuptimin e saj. Preku duart dhe fshani. Përkujtoi edhe një herë varrin e ri dhe, padashur, ngriti vetullat sikur e nëmi jetën. U mbështet me bërriyla mbi gjunjët që i dridheshin.

«Zotëri! Jam i gatshëm të dëgjoj urdhërin tuaj! — padashur i shkoi ndër mend.

«Erdhe?»

«Po, zotëri, erdha».

«Qe këtë qese me të holla!»

«Përse, zotëri?»

«Më pak të pyesësh dhe më shumë të dëgjosh!»

«Më fal, zotëri!»

Zotëria, pasi ja lëshoi të hollat në tavolinë, u kthye kah dritarja dhe lidhi duart prapa shpine. Vorraxhiu, pasi qëndroi edhe pak i heshtur, shtriu dorën dhe mori të hollat.

«Ç'duhet të bëj, zotëri?»

Zotëria u kthye pritueshëm. E shikoi nëpër ato syze të zeza, dhe prapë u kthye kah qe më parë. Lëvizi pak me këmbën e djathtë dhe, si për vete, tha:

«Ti je vorraxhi?»

«Po, zotëri».

«I të gjithëve?»

«I fesë sonë, zotëri».

Ai e hapi një krah të dritares.

«Punë e mirë, pas po?»

«Punë varresh, zotëri, punë me të vdekur...»

Ai u kthye dhe u ul në karrigë. Shfletoi disa letra të shpërndara nëpër tavolinë dhe nisi të këndonte një këngë, që më tepër i përngjante një belbëzimi të hatashëm. Vorraxhiu qëndronte para tij dhe nuk dinte nëse ishte më mirë të qëndronte ashtu apo të kërkonte leje dhe të shkonte. Këmisha e shkoçur leckë më leckë, ja shpalonte gjoksin e thatë dhe leshatuk. Mjekra e parruar qe sa kohë e bënte edhe më të vjetër, dhe dukej se nuk ishte ai, vorraxhiu i ri, që s'i kishte mbushur akoma të tridhjetë e pesat.

«Ti i njeh mirë ata... të fesë sate, vorraxhi?»

«Po, zotëri! I njoh të gjithë. Bile edhe ata të vdekurit», u përgjegj duke u ngutur.

«Dhe ti i don, bie fjala, sikur ata ty?»

«Po, zotëri».

«Atëherë, mashtrohesh, vorraxhi!»

Vorraxhiu theu vetullat dhe ngrysi ballin.

«Mashtrohesh, mashtrohesh, o vorraxhi! Ata nuk të duan ty!»

«S'po ju kuptoj, zotëri».

«Më shumë don të gjallët apo të vdekurit?»

«Mendova: grua apo burrë...»

«Burrë!»

Vorraxhiu u mat të shkonte. Shikoi edhe një herë nëpër dhomë sikur kërkonte diçka të vetën, pa të cilën s'mundej. Shtrengoi të hollat në grusht dhe u kthye të shkonte, por zëri i zotërisë e ndali në vend.

«Sonte bëhet varrimi, vorraxhi! Kufoma është gati, dhe nuk guxon të shplohët!»

«Siurdhëron, zotëri!»

«Tani shko!»

«Zotëri...»

Ai u kthye kah ai. E vështroi prej kembëve gjër në kokë dhe i dha shenjë që të fliste.

«Zotëri! Nëse është e mundur që sot e shoqja të lirohet më herët nga punët tuaja, se...!»

«Më shumë se çdo herë tjetër ka punë, vorraxhi! Gjindu, si të dish. Por... prit! Afrohu edhe pak! Ulu këtu!»

Vorraxhiu u afrua. Gjunjët i dridheshin. Bebëzat i luanin ndër sy.

«Ti je vorraxhi, dhe vorraxhitë janë të varfër — këtë e di. Se ke nevojë për të holla — edhe këtë e di. Ta kesh të shoqen përherë në shtëpi — e di se është e nevojshme. Dhe të gjitha këto vetëm unë mund të 'i jap».

Vorraxhiu u qetësua. Një fije gazi i mbiu në fytyrë, por edhe ashtu u mundua të mos jepet. Sipas fjalëve të zotërisë, e ndërtonte një ëndërr të bukur, por mendimi «përse zotëria i bënte tërë këtë të mirë?» ja prishte tërë atë ëmbëlsi që ja ngrohu dridhjet. Atëherë, fill pas këtyre mendimeve, e shuante ngadalë atë buzëqeshje, dhe mbe-tej përsëri ai, vorraxhiu, që pret ta mashtrojë zotëria.

«Por, duhet të më dëgjosh mua!»

Pasi piu pak ujë nga gota që e mbante mbi tavolinë, filloi përsëri duke menduar se i ra në shpirt vorraxhiu, dhe tani mund ta bëjë lehtë atë për çka i premtonte atij.

«Je vorraxhi i varfër, prandaj duhet të më ndih-mosh...!»

«Sa të mundem, zotëri».

«Atëherë, nëse të gjitha këto që t'i përmenda i don, më trego, kush ka. . ?

«Çka, zotëri?»

«Asi de. . .»

Ai përplasi duart për tavolinë.

«Si nuk merr vesh!»

«Jo, për krye, zotëri, nuk po të marr vesh për se e ke fjalën».

«Vajza, vajza apo ndonjë grua të re në shtëpi, prej fesë suaj!»

Vorraxhiu u zverdh. U lëkund vendit dhe shtrëngoi nofullat. Tamthat i rrahën egër e kapaku i kresë ju duk se i doli vendit. «Don të më prekësh në erz tani, qen». E përbiu këtë mendim me një të luajtur koke dhe mezi belbëzoi:

«Zotëri. . .»

«Qe edhe një qese!»

«Zotëri! Asgjë nuk di për atë çka më pyetët».

Ai i premtoi edhe shumë gjëra të tjera të çmueshme. Ndërsa vorraxhiu kishte ngulur këmbë në fjalën e vet dhe nuk e luante dot. Zotëria, për t'ja shtuar edhe më tepër peshën, u lëkund vendit dhe i tha:

«Ti, merre edhe këtë qese me të holla dhe do të më tregosh për të gjitha ato që të pyeta dhe, plus tyre, ke për t'i varrosur edhe katër kufoma të tjera, e ato janë të fesë suaj, pa kryq. Dhe, nëse pyet se çka janë, qysh tani mund të të tregoj se të gjitha janë femra — vajza dhe nuse, tuajat».

Vorraxhiun vetëm sa s'e përbiu toka. Ju suall dhoma vërdallë. Preku ballin e djersitur, dhe nuk bëri zë, por u ngrit nga karriga. Zotëria e përcolli. U ngrit edhe ai, i erdh një herë rrotull dhe ju ndal para hundëve.

«Vorraxhi, e mira jote dhe e të tjerëve është të tregosh për atë çka të pyeta!»

Vorraxhiu heshti dhe shtrëngoi nofullat e dhëmbët para tij. Ai u mërdhez dhe i ra shuplakë. Vorraxhiu u mbështet për muri. Sytë i fluturuan mbi revolen që ishte mbi tavolinë, por ishte shumë larg dhe nuk kishte si të mbërrinte te ajo. Desh të drejtohet, por grushti tjetër i zotërisë, që e qëllloi mu në llullë të barkut, e mbështeti

edhe një herë për muri, por këtë herë pa frymë. Goditjet vazhduan. Vorraxhiu shuajti e shuajti, por pas disa goditjeve shpërtheu:

«Nuk do të të tregoj kurrëgjë, bishë! Dhe tani do të të shqej si...» — Një grusht i rëndë u përplas në fytyrën e zotërisë, të cilit i shpërthyen hundët gjak. Vorraxhiu ish çartur. Vërsulej mbi të, gjersa dy gjendarmë, që hynë atë moment në zyrë, e kapën për dy krahët dhe e mbështetën për muri. Ai klithi, shante, lëvizte. Përpëlitej në duart e tyre. Turrej kah zotëria, por nuk mund të shkoqej nga duart e gjendarmëve.

Zotëria, vetëm pas një pushimi, u ngrit tërë i përgjakur dhe ju afrua vorraxhiut.

«Tani do të tregosh krejt, fëlliqan!»

Goditjet filluan përsëri. Grushtat derdheshin mbi fytyrën e tij si breshër. Gjaku i derdhej për hunde e goje, ndërsa syrin e majtë nuk mund ta hapte fare.

«Don të tregosh tani, çka të pyeta, vorraxhi?»

«Bisha...»

Goditjet u derdhën përsëri. Vorraxhiu pa se ishte buzë fundit të jetës. U lëshua në gjunj për t'u mbrojtur nga goditjet dhe foli. Tregoi...

Tani, gjersa endej në këto mendime të hatashme, ju bë sikur dëgjoi hapat e së shoqes. U ngrit. E hapi derën, por asgjë nuk pa pos errësirës që e mbyti diku një të lehur qeni, dhe disa krizma pushkësh, që trokitën në hesh-tjen e natës dhe perënduan në jehun e tyre, që zgjati ethshëm. Veriu ngrinte. Heshtje. Ftohët... U end sikur i çmendur nëpër atë gjysmëterr, dhe prapë u ul. Mungesa e gruas e brente. E brente sepse kurrë nuk kishte ngjarë, prej se ajo punonte te zotëria, të jetë vonuar tri ditë. Mblodhi gjunjët dhe perëndoi prapë në të parën.

«Është me kryq», «burrë», «vajza e gra të reja të fesë suaj» — këto e bënin të dyshonte më tepër. U ngrit përsëri në këmbë. Filloi të shetiste nëpër dhomë. Dridhej. Fërkonte duart. Fërkonte ballin. Endej. Shikonte flakën e lodhur dhe të hollë. Sakaq shtrëngonte dhëmbët. Ndalej. Përsëri mendonte: «Shtatzanë... Tri ditë. Gruaja... fëmija...» E hapi derën. Heshtje. Nata derdhte trishtim.

«Vorraxhi! Ke varrosur sot një kufomë dhe s'e di se kë ke mbuluar me dhe. Nuk i ke fshehur kufomat më parë, vorraxhi» — ju bë sikur dëgjoji nga terri. Mbylli derën. Prapë hapa. Prapë dridhje. Të njëjtat mendime. Qiriri shkrihej. Pikat e djersës së ftohtë lodronin rrudhave të ballit.

«Pse s'erdh më, mortja e marrtë! Asnjëherë s'është vonuar kështu!»

Qiriri tretej. Zjarri fikej. Uji i vakët fishkëllonte trishtueshëm në kusi. Krismat e pushkëve lodronin nëpër varrët e asaj nate të ftohtë.

«Kush ka vajza e gra të reja, prej fesë sate?» Ngrihej. Mbështetej për muri. Mendonte. Prapë ecte. Zemra i rrihte këcyeshëm. «Gratë e vajzat janë për ato punë. S'prish asgjë punë pse jam me kryq» — e theri përsëri zëri i zotërisë. Fshehu sytë pas shpulakës së dorës që e rëndoi mbi ballë dhe u ndal. Dëgjoji melodinë e asaj nate. Eci. E ndal përsëri dhe këceu i tmerruar.

«E kanë mbytur!» — e trëndi ky mendim.

— E kanë vrrarë! — tha bukur me zë.

— Dhe unë e kam varrosur. Pasha kryet, unë! . .

E kapi kryet, por nuk bërtiti. E gjeti lopatën e kazmën dhe u flug në errësirën e zezë dhe të ftohtë.

Ecte. Vraponte. Ndalej dhe merrte frymë. Mandej, përsëri vraponte. S'ndalej. Kaloi rrugët. Edhe urën, e i mbushur frymë u gjet para varreve. Ju duk se të gjithë ata që pushonin ndër ato varre, i ka vrrarë, dhe i dukej se për vdekjen e tyre, ishte ky vetë fajtor. Njëherë i shkoi ndër mend të largohet nga ai vend, sepse ndjente një frikë të rëndë, por nuk mundi. U ul në gjunjë para varrit të ri, dhe heshti. Një grusht dhe e bluajti në dorën e tij të thatë, po të fuqishme. Shikoi përsëri varret përreth. U ngrit në këmbë. Mori lopatën. Dheu hiqej me të shpejtë. Gropa zmadhohej përherë e më fort. Vorraxhiu groponte dhe rrëqethej sikur të ishte kjo hera e parë që hapte varre. Herë herë drejtonte kurrizin për të thithur ajër. Gropoi, gjersa lopata hasi në dërrasat e kufomës. Nata dirgjej në atë qetësi të ngrirë. Vetëm aty-këtu dëgjohej ndonjë krismë pushke. Vorraxhiu gërryente dhe me grushta

e thonj, thuase donte të ruante qetësinë e kufomës. Pas-
troi arkivolin nga dheu i lagët dhe e nxori jashtë. U ndal
para kufomës dhe mori dro.

«Po të jetë me të vërtetë me kryq, sikur më pat
thënë? Kuku, pasha lokën, tutem prej tyre. Gabova që e
nxora. Të kisha pritur bile edhe sonte!»

Një krismë topi e shkundi natën dhe e pruri më vete
Vorraxhiun. U ngrit në dy gujnjët dhe ja hoqi kapakun.
E shpaloj kufomën dhe ra përmbys mbi të. Krismat shto-
heshin. Vorraxhiu vdiq mbi kufomë të gruas, buzë varrit
të çelur dy herë.

FURKA

Mbramja e ftohtë e asaj vjeshte paralajmëronte mëngjez me brymë. Mala e skajoi furkën, derisa tjerrin e bani lamsh. Pastaj, ma herët se netve tjera, shtroi për të fjetë.

Nji krismë depërtoi deri në dhomë dhe ja prishi gjumin e parë. Por të birit nuk i bani za.

«Luftë a, e lufta çka s'qet», mendoi.

Krisma vazhdoi. E dëgjoi edhe i biri.

— Le të thërrasin! Thërrasin e thërrasin e shkojnë — tha ajo.

Përndryshe, pa u çelë derën, askush nuk do të mund të hyjë, meqë oborri ishte i rrethuem me mur të naltë, e dyert ishin të forta.

— Po dal, nanë— tha djali, sepse nuk i duronte dot ato krisma tingëlluese.

— Dalë për dalë, del nana — ja ktheu ajo dhe pa dëgjueshëm hapi derën e dhomës e në majë të gishtave ja behi deri te dera e oborrit.

Jo nga frika, por nga kureshtja, trupi nisi t'i rrëqethet, meqë mendja nuk dinte t'i tregojë kush do të mundte me qenë në derë.

— Çka dreqin keni? Na tranuet në pikë të natës. Rehat në shpi s'na latë — tha mbas një trokitje, që aty prapa dyerve i erdhi si krismë topi.

— Dada Malë, na jemi, na — tha dikush përtej dyerve.

— Po kush dreqi jeni, ju? — pyeti ajo e ja muer mendja se atë za e kishte dëgjue diku.

— Djali i Shaqës, me shokë — gjegji i njajti za.

— Mo bre!

— Hajde pra, po kah po vini në këtë vakt? — i pyeti, kur ua hapi derën. Kur pa se ishin të armatosun, u ngut dhe foli:

— Edhe stupca paski, a?!

Dikush qeshi e dikush gjegji:

— Ku ke pa komitë pa stupca?

— Partizanë, hallo, partizanë jemi — tha nji za serioz.

Po, atë vit, edhe në fshatin e Malës vepronte nji grup partizanësh. Në mesin e tyne gjendej njeni edhe nga fshati.

— Mos u mahitni me plakën. Kallxoni se unë nuk di ça asht partizani — foli Mala edhe pse për këtë emën kishte dëgjue.

— A jini ju ç'ata, që po luftoni pse po na marrin drithë e gja? — pyeti Mala.

— Ç'ata, cok! — pohoi dikush e tjetërkush shtoi:

— Ç'ata që po luftojnë me gjermanë.

— Ah! — bani Mala, dhe u duk se parafytyroi lopën që nji javë ma parë e kishte nxjerrë nga grazhdi e dhanë pa i pasë kujt borxh.

— O Demo! Demë bre, pa dil, nano! Ec se nuk të ka ba nana me nejt veç në shtrat!

Thue se i njifte të gjithë, djali ishte veshë e ba gati që t'u prijë mysafirëve deri në odë. Aty ua ndezi zjarrin dhe, mbasi u shtruen darkën, ua rregulluen vendin për fjetje.

* * *

— Demë, a s'je fjetë a? E pse s'po flen, djali em — u ngut t'i thotë kur dëgjoi se u rrotullue në krahun tjetër.

— Jo hala — gjegji ai.

— Flej djali em, flej — tha e vazhdoi të dëgjojë gërhamat, që depërtonin nga oda nëpër murin e hollë e të lyem me një pluskë lloç. Pastaj u dha mbas mendimeve. Përkujtoi veten të re, kur njisoj si këta, në dorë mbante

pushkën. Dhe, njisoj si këta, me të shoqin i duhej të strehohej diku, të trokiste në dyer të hueja për një trohë bukë, për një sy gjumë.

— E baba, nanë, a ka pasë pushkë? — pyeti djali papritmas dhe ja ndërpreu mendimet.

Nuk i tha gja. U duk sikur dëshironte një herë ta shihte vetë si dukej i shoqi, të cilën përnatë e «shihte» ose bisedonte me të. E kishte afër, përtej murit të oborrit dhe herë mërзитеj «e ftonte» për të bisedue. Nganjihërë mendjen e çonte atje, pranë vorrit të tij.

— Po, djali em, edhe pushkë ka pasë — gjegji ma në fund ajo.

— E ku a pushka e babës? — pyeti djali, meqë, kur ishte ma i vogël, e ama i kishte tregue ndodhitë e të atit si komit.

E dinte Mala se mbas pyetjes së parë djali do t'i bante edhe pyetje të tjera. Por, nga dëshira që sa ma shumë të «qëndrojë» me mendje me të shoqin, bani që përsëri të heshtë dhe të mendojë e edhe «ta pyesë» të shoqin:

— Çka po thue me i ba djalit? — tha me të vogël e shpejt e kuptoi se ç'po ndodhte me të, andaj përmbodhi mendjen dhe ju drejtue djalit.

— Flej ebu, çka po të duhet pushka!

— Jo, veç pvetë — ja ktheu ai dhe u rrotullue në krahun tjetër tue u përpjekë që të flinte.

* * *

— Çonu, o komit! Çonu, po ku keni pa, komitin me e zanë gjumi?!

Të pamësuem me këso thirrjesh, edhe pse ledhatuese, djelmoshat u trembën. Të përgjumshëm u veshën me ngut. Mbasi hangrën, Mala i përcolli oborrit.

— Kthehu, oj hallë — i tha dikush tue i shtri dorën në shenjë falënderimi.

Mala nuk ua dha dorën. U kthye kah shtëpia dhe shikoi disi hutueshëm. Pastaj foli:

— Pa ndalni, se harrova diçka! Mos kujtoni, nuk u lëshon Dada me dalë si pej mali — tha e thirri:

— Demë! Demë, bre! Pa ec te nana diçka!

Nuk e kuptoi kush se çka donte të thoshte plaka.

I biri vrapoi dhe u përzje me mysafirët.

E mati e ama të birin tinëzisht, pale sa asht rritë. Kur e shikoi mirë, pa se ishte burrë.

— I njomë a, veç qe — edhe Dema em le të vijë me ju — u tha.

Të habitun, të gjithë e shikuen Demën pakëz të hutuem. — Komiti i nanës — foli plaka. E përqafoi e tha: — Komit e as stupc s'ka! Pa kadalë, djali em, kadalë. Mos të vjen keq — tha e nxitoi kah shtëpia.

Kur u kthye, në dorë mbante furkën, së cilës, posa ju afrue djalit, ja hoqi shllungën e leshit e ju drejtue të birit:

— Qe, djali em, merre, ta ka ruejtë nana.

Dema tanima nuk ishte fëmijë që ta dëshironte furkën. Andaj nisi të skuqej, por e ama u ngut e foli:

— Qe, djali em, çile vetë. Qe qysh çilet — tha e, kur ja hoqi një mbështjellëse ngjyrë gjaku, në rrezet e diellit flakëroi mauzeri.

— Nana ta ka ruejtë. Rueje edhe ti — i tha.

Ato çaste ishin si andërr e vërtetë për të gjithë. Dhe të gjithë i kaploi habia.

Malën — një gëzim i papërshekruem.

Djalit ju realizue një andërr e kahershme që të kishte pushkë.

— Ah, nana eme — piskati nga gëzimi dhe e zgjati dorën.

— Pa kadalë, kadalë, djali em. Pushka s'jepet kollaj — tha Mala e piskati:

— Ah, virane bre — tha e fshatit jehuen tri krisma.

— Qe, mbaje e rueje veten e pushkën — i tha e ja dorëzoi tue e përqafoe si dinë nanat.

— Me shëndet, djali em. Le të dihet, shtëpia m'u ba me zot. Lotët e gëzimit ja lagën faqet e vyshkuna.

Mysafirët u nisën. Me ta shkoi edhe djali i saj. Qëndroi Mala bri derës së oborrit, derisa u mshehën mbas një kthese. Mbas tyne, rrugës së fshatit, u ngrit një pluhun i hollë. Malën prapë e kaploi një gulshim e një dhi mbje e hatashme. U duk se nga gjoksi ju shkëput edhe ajo copë zemre, që i kishte ngelë mbas vrasjes së të shoqit.

GJAKU I NJOMË

E pamësueme të presë e të përcjellë kend në shtëpinë e burrit, Hana nuk ja vuni veshin trokitjes në derë. E kur thirrja e trokitja u përsëritën, në shpirt ndjeu diç që ndillte mirë. U ngut dhe, posa doli në prak, pyeti kush ishte.

— Lila, Lila!

I lakmoi ajo tjetërkujt. Por, nuk i erdhi keq as për Lilen. Ishte ky kryeplaku, por i një fshati tjetër përtej bjeshkëve të Bogazit. Njeri pasanik e edhe bukëdhanës. Tek ai Sokoli bashkë me Hanën kishin kalue shumë ditë. Pati mësue Hana se ai ishte edhe dost i të atit të Sokolit, dhe për të njisoj si i shoqi, kishte bindje se vërtet, nëse kund ka burra, atëherë Lila asht i tillë.

Ju duk asaj larg derisa ja çeli derën.

— Jo, Hanë, nuk i kemi senet. Niem çka u bani vaki. Hajr ishalla! Sot po shkoj në shehër e nashta zateti nokan të hyqymetit. Do i njoh, e besoj bahet nojsen për Sokolin — i tha Hanës e këto fjalë nuk lejuen që ta luste së pakut të çlodhej pak. Zoten, kush e kishte mendjen e qytetit, këtë rrugë tanima e kishte marrë. Edhe Hanës ju duk larg të nisej. Nxitoi kah shtëpia dhe prej andej solli një kënatë ujë. Kur e përcolli, i dha edhe një facoletë të qindisun nga dora e saj.

— Çoja, e bani selam. Thuej: «Mos u mërzit. Gajle për shpi mos baj...»

— Ti, Lilë, kthehu kënej e nashta më kallxo qysh ish?!

Kur përsëri në mbramje u dëgjue trokitja në derë,

Hana nuk priti të përsëritej. E diti kush ishte dhe shpejt u nis kah dera.

— Ke, e? Edhe e pave?

— Po, Hanë, kesh dhe e pashë! Paj, o Hanë, veç haps që i thonë, se keq nuk e ka.

— I mirë hapsi, o Lilë, po dihet, nuk a. Edhe zogu e di, e në kafes shtirë rri — gjegji Hana.

— Nuk kemi çka t'i bajmë as u, as ti. Ja ka ba veti, e tash, bezbeli duhet me hjekë pak. Besoj, nuk e mbajnë shumë. Veç, mos kujto, as pak jo. Hyqmi nuk le me luejti me ta, — tha Lila e kjo Hanën e dëshpëroi, madje edhe i ngjalli një grimë urrejtje ndaj tij. Por, u përmbajt e nuk foli.

— Fola edhe me Sokolin, Hanë, bajagi shumë. I thashë atij, e po të thom edhe ty. Merre djalin e hajde në shpi teme. Çka kam për veti, kam me pasë për ty e për atë thëmi. Idare më ka çue zoti. Ec, e ishalla Sokolit ja falin, e vjen në shtëpi të vet — tha Lila.

E shikoi Hana Lilën habitshëm e nuk i tha gja.

— Edhe Sokoli më ka thanë me të marrë, — vazhdoi Lila e shtoi:

— Me marrë hollë, nuk a hieshëm me nejt këtu qyqe vetëm. Derën kush s'ta çel. Hallku flasin gjithshka. Ta prishin punën e të dalin fjalë edhe me Sokolin. Ngom, Hanë, shkojmë — përfundoi.

Hanës i ndërroi fytyra. I erdhi keq pse i tha «Je metë qyqe vetëm», kur qe i biri pranë saj. E kur përnjimend u nisën, i erdhi shumë keq pse rrugës nuk i printe ai që e donte, por njeriu, të cilin përnjimend e dinte të mirë, por ishte i huej. Kundër dëshirës, por për hatër të Sokolit, të cilit asnjherë nuk ja kishte thye fjalën, qysh atë natë u gjet përtej bjeshkëve të Bogazit, në shtëpi të Lilës...

Edhe pse jetonte në kushte krejtësisht të reja e ma të mira, java e parë ju duk vit i tanë.

— Mirë ish, Hanë, mirë — i tha Lila Hanës kur u kthye nga tregu dhe asgja tjetër nuk foli.

Priti ajo edhe deri të premtën tjetër, e bindun se do të kuptojë diç ma shumë për të shoqin.

Lila atë mbramje u kthye ma vonë, atëhere kur të gjithë kishin ra në gjumë dhe Hana nuk dëshiroi ta trazonte. Mirëpo, kureshtja bani që tanë natën të kalojë pa shti pikë gjumi në sy.

— E di, të besoj, Hanë, randë të vjen! Edhe mue më erdhi keq. Për çata bile pramë nuk desha me të kallxue kurrë. Ma merrte mendja se jet pa fjetë. Por ça me ba — nisi Lila të flasë, ndërsa Hanës ju duk vit i tanë derisa i tha këto fjalë.

— Kush ka mendue kështu, — vazhdoi Lila e ajo ma nuk qëndroi dot pa i thanë:

— Ça the, lum Lila, kallxomë!

— Qe, de, tue të kallxue jam, veç po më vjen keq.

Nash beso, nash jo, tanë natën gjumë s'kam ba. Kush ka besue? Kryet e kisha qitë në cung se e ban atohen. Po qysh më ra hise, se ? Ta kisha ditë kështu, kurrë nuk ja kisha mësy ati, e beso, as ty nuk të kisha marrë këtu.

Hana i zgurdulloi sytë. Më kot përpiquej ta kuptonte për çka e kishte e çka donte të thoshte. Lila u ba i mirë dhe i ndihmoi shpejt ta kuptonte tanë çashtjen.

— Qe, Hanë, — tha, dhe nga xhepi i setrës, që mbante në krah, nxori një letër — qe ka çkruen burri:

— Cili burrë ej — e pyeti Hana habitshëm.

— I yti, po cili. Sa burra ke — ndërhyri Lila e nisi ta lexojë letrën, që mbante në dorë.

«Hanë, e di sa të kam dashtë. Po, Hanë, ma nuk të due. As sytë nuk due me t'i pa!»

Hana, sikur të mos dëgjonte se ç'ishte tue thanë Lila me atë letër në dorë, andaj nuk u shqetësue. Nuk u besoi ajo për një kohë as syve të Lilës, as veshëve të vet. Mirëpo, nuk vonoi e ndërroi: Lilës ja flugu një shikim të rrëmbyeshëm, u përbi dhe ja grabiti letrën. E hudhi e doli nga dhoma.

Ai u nis kah oda, ndërsa Hana u kthye në dhomë. Veshët i ushtonin dhe i dukej sikur Lila ja lexonte letrën. Përpiquej ta kuptonte tanë domethanjen e letrës. Nuk arrinte dot. Tanë javën, deri të premtën tjetër mendoi vetëm për këtë. E harroi veten dhe djalin. Sokoli e letra e tij, e tronditën. Por, edhe pse e kaplueme nga urrejtja, për-

sëri nuk dinte kë të urrente: Sokolin, letrën apo Lilën, që ja solli?

Pazarit tjetër, Lila nuk shkoi në qytet, edhe pse Hana e dëshironte këtë pa masë. Kur kah dreka dikush thirri në derë, e Lila u kthye me një letër në dorë, Hana i shkoi mbrapa. Dëshironte të dëgjonte, qoftë edhe fjalë të randa, vetëm që të mos jetonte në zjarrin e urrejtjes.

— Sokoli ka çue letër, a — pyeti ajo.

— Mirë po e di. E mençme je ti xhanëm — ja kthehu ai, pastaj e hapi me ngadalë e nga letra nisi si me grep të nxjerrë fjalët. I bani Hana veshët si të lepurit.

«Theje qafën Hanë, kah të duesh. E jemja s'je. Për ty po kalbem».

— Për mue po kalbet. Për mue! — tha e desh piskati kur kuptoi përmbajtjen e letrës e tue mos ditë ç'të bajë, ju drejtue Lilës:

— Lum Lila, çka po thue me ba? Kah po thue me thye qafën?

Ku me ditë ç'vlonte në atë moment në shpirtin e tij, por me një gjakftohtësi neveritëse, tha:

— Nuk e di, Hanë!

U hodh Hana përsëri me mendje gjithkrah. Përjetoi përnjiherë të kaluemen. Rugëdalje nuk gjente. Lila i dukej mbështetje e vetme. Ndaj tij ushqente shpresa të mëdha. Ai u ishte gjetë në momentet e vështira, atëhere kur me Sokolin nuk dinin kah t'ja mbante. Ai, edhe tani do të dijë ta mësojë. Andaj e pyeti:

— Kallxo, lum Lila, çka me ba?

— Besomë, të kisha mësue, po qysh? — nisi Lila të fliste për ta bindë se përnjimend e kishte vështirë ta mësonte dhe se edhe vetë ishte në situatë të palakmueshme.

— Por, Hanë, në daç... — tha pastaj e u përbi, i friguem se mos po e idhnonte.

— Kallxo, lum Lila, çka po thue — ndërhyri Hana plot shpresa se do t'i ndihmonte.

— Paj desha me të thanë, e nuk kam edhe çka me të thanë. Ti e di, u grue kam. Rri në daç e dallaj bëjmë — tha e shtoi.

— Beso, për ty e kam. Me nejt këtu, e Sokoli mos

me të dashë, munden hallku me folë gjithshka. Kështu... zori çka s'ban. Ti faj nuk kie. Faj ka aj edepsuz që të ka marrë e po të le n'sokak. E ti, ymrin, e të ritë e ke dhanë mas tij...

Nji terr sa nji natë e pahanë dhe pa hyj, ja verboi sytë. Dësh të rrëxohet. Çka të mendonte ma, nuk dinte. Ta shtijë Sokolin në krye, i dukej kot. Në mendje përsëritte letrën e tij, fjalët e letrës dhe ato të Lilës. Veçmas këto të fundit. Në vete thirrte të vogël: «Sokol more, po qysh, more Sokol këshu! Çka të mërzita? Mos, bre Sokol, se a e di sa të kam dashë. Po të pres, bre Sokol, sa të kam ymër. Qe edhe djali po të pret — tha e u kthye kah i biri.

— A po, djali em? A e presim babën bashkë — tha me vete dhe ju duk se fëmija pohoi. Mirëpo, do mendime që i vlonin, shpejt ja ndoqën këto dhe ma në fund përsëri ju drejtue Lilës.

— A shkojmë ni herë bashkë te Sokoli, veç dy fjalë kisha me ja thanë!

— U jo — ja preu shkurt e shtoi:

— A nuk u ngine, Sokol a? Qe, qyre letrën, e sheh Sokolin. Të ka kallxue mirë se nuk të do. E ti, hala Sokoli, Sokoli!

— Po më vjen keq, se qe edhe ni letër tjetër — tha.

Hana i zgurdhoi sytë, tue pritë me padurim që të kuptonte se ç'përmbajtje kishte ajo.

«Lilë, vëlla të paça, hiqma qafe atë dejuzkë! Ban çka të dësh e çka të mundesh. Përze, në daç edhe për grue merre!»

Ajo veç që nuk piskati. Brofi në kambë e doli në oborr.

— Ec, Hanë se po të kallxoj edhe diçka.

Tue mos ditë kah t'ja mbajë, u kthye.

— Besomë, në shpirt po më dhimbesh. E di çka do-methanë me marrë këso letrash. Pra, grue kam, e fort nevojë për të nuk kam. Veç, nuk e di, kah shkon ti? Babës i ke ikë, edhe ai ma s'a gjallë. Sokoli nuk të do, e edhe haps a. Pra, kah dreqi po shkon? Me të majt veç

kështu, a si me të marrë grue. Ti e di, ban qysh të duesh...

Atë natë Hana ra ma herët. Mendjen ja fali së kaluemes së idhët dhe Sokolit. Dëshironte ta shihte ashtu si e dinte, burrë të fjalës. Dëshironte t'ja thonte vetëm pak fjalë. Por, ku ta merrte kur gjendej larg, në mes të mureve të trasha, ndoshta i unët, pa gjumë e i lodhun. Dhe, sikur të kishte farë mundësie, do të piskatte, njisoj si atëhere kur i ruente bagëtinë e shtyhej me mocanikët për të pa kush ka za ma të bukur e ma të fortë.

Sa leu hana, e iku edhe gjumi. Shikonte kah dritaret pa ja nda. Përgjumshëm diktoi andej një siluetë që gjithnjë rritej.

Dera ishte pa dry e silueta hyni. Hana u hutue. Të piskasë, do të thoshte ta alarmonte fshatin në pikë të natës. Shukati ajo, ashiqare, tue dashtë që i panjohuni të tregonte kush ishte.

— Nieri i keq dihet, oj Hanë! Po qysh i shkruen burri grues letra. Hajde me kanë me të dhanë gjajret?! Por, po të shkruen kështu. Vaki s'ka ba. Po, kush ka pa hajr prej komitit? Mandej, kushedi kur lëshohet. Ec e qite poshtë të ritë! Kushedi a jemi gjallë dej atëhere, a jo? More, bahesh halloke e s'ka kush të man...

Të gjitha këto ja tha Lila kur ma nuk pati durim të priste që Hana të pyeste kush ishte. Ajo përsëri, edhe pas këtyne fjalëve heshti.

— Çka po ta merr menja? — e pyeti prap.

Hana nuk foli. E, edhe sikur të fliste, çka do t'i thoshte. E kuptoi edhe Lila se bindjet ishin të kota, andaj u kthye kah kishte ardhë, por shpresëplotë se ndonjiherë tjetër do të fitonte mundësi ta bindte. Besonte se edhe Hana ma në fund do të mendonte ma mirë për këtë.

Nisi ajo ta urrente dhe gati plasi pse i hyni në dhomë. Mirëpo, një leheje e qenve dhe turri i tyne i vrullshëm kah dyert e oborrit, ja çoi mendjen atje. U kthill sikur të kishte ba gjumë të qetë dhe përcolli me kujdes çdo zhurmë.

Trokitja që pasoi ja shtoi kureshtjen dhe me pa-

durim priste të dilte Lila. Edhe kjo ma në fund ngjau dhe dy vetë ngjiteshin oborrit.

E shikoi Hana një herë të birin, a mos ishte zbulue. Pastaj, desh i shkeu sytë kah dritarja. Sa ma shumë që rriteshin figurat e zeza në oborr, aq ma tepër i shtoej habi dhe mendja nuk arrinte të kuptonte se ç'ngjante në atë kohë të natës.

— Qe, atje... — e dëgjoi zanin e Lilës.

«Por, kujt po i tregon tani kështu?» tha me vete. Edhe pse e habitun, prapë me padurim priste që ma në fund të hapej dera e të shihte ç'ngjante.

«Hanë», dëgjoi e nuk u besoi veshëve.

Me shpejtësinë ma të madhe të mendjes, përkujtoi të gjitha momentet e përjetueme ditëve të fundit, veçmas prej atëhere kur mori vesh për letra. U orvat të kuptonte se ç'e kishte sjellë Sokolin në këtë kohë.

Mezi u ngrit dhe u rrokën n'grykë. Lotët i lagën faqet e saj dhe fytyrën e tij të parrueme. Mbas një përqaftimi tjetër, Hana u përpoq ta shtynte pak që të mund ta shihte mirë.

U largue pastaj ajo dhe ja mësyni djalit. Me të në dorë u turr kah i shoqi.

— A po sheh, ta ka pre kryet! Qe, a nuk a Sokol i vogël a? — tha edhe pse në terr, as ajo as ai nuk mund ta shihnin fëmijën.

— Hanë, kohë s'ka...

«Pse, bre Sokol, kurrë nuk pate kohë! Po kah të mirën po ngutesh», mendoi t'i thoshte, por nuk foli, meqë Sokoli kërkoi që të shpejtonte e të bahej gati. Edhe ajo mezi e kishte pritë këtë. Dëshironte të dilte një herë nga kjo shtëpi, bukëdhanëse, por e huej.

Me ngut përgatiti djalin dhe në terrin ma të dendun të natës, duelën nga dhoma, pa i bëzajtë kujt.

— Çka u ba kështu, Sokol — e pyeti mbas do kohe.

— Pse, po të vjen keq që erdha, a?

— Jo, more, por pa tutna për ty. A të lëshuen, a ike? Të vrasin e unë jes gjallë!

— Kur je ba kaq tujzajkë — ja ktheu ai pak si në mahi, e pak për ta ngacmue dhe vazhdoi:

- Hanë, bashkë do të vdesim, mos u frigo!
- E ti kur u bane kaq i mirë — e pyeti ajo tue dëshirue që ai t'i fliste për letrat, që kishte marrë.
- Edhe të keq po më ban, a? Pa kallxomë, kur u bana i keq — tha habitshëm, meqë vërente se diçka vlonte në shpirtin e saj.
- Letrat, Sokol, po i harron! S'po flet për to, as nuk po më kallxon pse më shkruajshe — i tha.
- Çfarë letrash, mori, a je në veti?!
- Mos u shti? «Çka po më duhesh! Theje qafën!» Tana këto m'i ke thanë.
- Kush, bre? — tha të madhe sa do të ishte dëgjue larg, nëpër bjeshkët e Bogazhit kah kalonin atë natë.
- Ti!

— Rrenë koftë!

Pas kësaj, të dy, u banë dru, si ata lisa të maleve kah kalonin. Hana e lëshoi djalin, që e mbante n'grykë dhe u nis kah i shoqi. I tregoi për çdo gja, madje në hollësinë, tue mos e harrue asnji fjalë nga letrat, të cilat, ja kishin copëtue zemrën.

— Lila, a?! — pyeti Sokoli.

— Po pse s'kallxojshe sa isha atje?

— A ka harrue çka më ka thanë, a? tha tue mos u gjendë. Nji terr ja muer dritën e agut të parë, e as mendja nuk i punonte.

Pas pak, i hutuem e i humbun nga ajo që dëgjoi, foli:

— Hanë, kah po ja majmë? Shkojmë në shpi — tha ashiqare, pse dëshironte të çlodhej, dhe aty të bisedonte për tanë atë që mësoi.

— Shkojmë — pohoi edhe ajo.

Kur në qiell shpërtheu dielli, arritën në cak.

U shtrinë në kashtë e shpejt i zuni nji gjumë i randë...

— Sokol — i bëzani të vogël Hana pa mundë t'i hapte sytë. Kapakët i ishin randue nga nji gjumë ndjellakeq.

Ai vetëm u rrotullue. U kthye kah djali. E përkëdheli dhe desh të flinte.

— Sokol, a jam n'andërr, a po rreh kapixhiku?

Të trembun nga këto fjalë, sytë i mbërthyen kah oborri.

Panë diellin. Nxente lakmueshëm. Lakmuen të qëndrojnë aty, së bashku.

— O Sokol! — u dëgjue nji za i thekshëm.

— Dil se je rrethue!

U bindën për gabimin e bamë. Por, dihet, komiti nji herë gabon. Andaj, e urrejtën gjumin dhe jetën. Filluen të mendojshin ma mirë, si të veprojshin. Kohë nuk kishin për këtë. Të dy brofën në kambë. Hana u nis kah dera. Sokoli gjurmonte dhomës. Dëshironte të gjente diç, qoftë edhe ndonji copë dru. Do të mjaftonte, mendonte ai, ta paguente veten, meqë, ishte i bindun se tanima gabimi i vogël ishte rritë e duhej pague ma shtrenjtë.

— Sokol more, a po del, a... — e pyetën nga jashtë.

Atij nuk ja merrte mendja të dorëzohej. Nuk i dronte ma burgut, por fatit të së shoqes dhe të birin. Të ndahej prej tyre dhe të shkojë prapë në burg, do të thoshte ta linte të shoqen përsëri në duert e Lilës dhe të shokëve të tij.

— Çka po doni, bre! As gjumë s'po leni me ba. Hupni, po çfarë Sokoli po lypni këtu? Nieri haps, po kalbet, e ju s'po na leni rehat — u tha Hana tue u përpjekë t'i bindte se i shoqi nuk gjendej aty.

E gjindarmët, sa e diktuan, ju vërsulën. Shkëlqimi i pushkëve dhe i syngjive, ja muerën sytë.

— Sillni! A mos po u tutna, a?! Jo, jo, Hana nuk tutet — tha e shikimin e hudhi kah i biri, që donte të qante, ndofta pse kërkonte gjinin e së amës që tani kacafytej me gjindarmët.

Sokoli kishte vendosë të mos dorëzohej. Bani atë që ja muer mendja se do t'i ndihmonte të dilte nga kurthi, që i ishte përgatitë.

«Qe, ni hap, e në mal. Tanaj, u kallxoj», mendonte. U ngrit oxhakut të hapun dhe nga ai soditi përreth. Në nji qoshe të gardhit, nën strehë të kasolles, diktoi të strukun nji gjandar. Si tigër ju hudh në shpinë. Arriji t'ja merrte pushkën dhe shpejt u gjet përtej gardhit. U gëzue si fëmijë, kur pak ma larg e diktoi edhe Lilën.

Batarja e pushkëve e trazoi fshatin...

Hana u vërsul jashtë shtëpisë. Shpejt u gjet para puçillës së gjakut të njomë.

FYELLI

Ajri, të cilin e thithi kur doli në oborr, bashkë me qiellin e kuqërremtë, që paralajmonte diellin, thuese ja largoi lodhjen, që e kishte kaplue nga puna e ditës së kalueme.

«Shkova» — i tha grues.

Ajo kurrnjihërë nuk, kishte zakon t'ja kthente fjalën dhe shpejt ja përspjette para tij.

«Ani, ani» — i tha dhe e përcolli deri te dera e oborrit, ma tepër sa për ta mbyllë.

«O njeri, (kështu e quente të shoqin) mos e harro i kërpeshe për kishk. A po e sheh se na la ta tamël? — ja përkujtoi në të ndamë.

Latës ju duk se e ngarkoi edhe me një barrë të randë dhe, tue ecë, pyeti:

«Edhe aj dreq u ba për kërpeshe, a?!» — I tha kështu dhe ua dha livadheve. Bari i njomë ja lagu opingat, ndërsa lulet gjithfarëshe, bashkë me rrezet e para, që shpërndau dielli dhe kanga e bretkosave, ja joshnin shpirtin dhe e shtynin që të ecte.

Dikur Lata e kalonte atë rrugë nga dy herë në ditë. Çdo mëngjez nisej nga shtëpia, ndërsa në mbramje kthehej me të praruem të diellit. Tani, disi i përmalluem për ato ditë të rinisë, shpejtonte. E dinte dhe se treni i mëngjezit do t'ja çatiste shpejt.

I thelluem në kuakamën e bretkosave, herë - herë të përcjellun me zanin përmallues të qyqes, që dëgjohej nga një shpat, mezi ju kujtue çka mbante në shpinë. E, kur e preku strajcën, vërejti se në të kishte edhe bukë. Pastaj nisi të mendonte për atë që duhet blë në treg. Të

vogël thoshte: «Një kërpesht për kish, ni parë opanga për djalë, ni parë për çikë, asaj ni peshqir e ni kofe me ni kënatë». Asgjë nuk harroi dhe sa e përfundoi këtë mendim, fishkëllima e lokomotivës ja behi para tij, thuese i bante me dije se arritën bashkë.

U ngjiti shkallëve e, kur zuni vend në një kupe, ju duk sikur rrugës kishte ba gjumë të kandshëm. Nuk njohu kënd nga bashkudhëtarët, dhe mbas një shikimi tinzak, përsëri u thellue në mendime. Vetëm fishkëllima e lokomotivës ja përkujtonte se ishte udhëtar, ndërsa fluturimi e livadheve, pyjeve e përrojeve para syve të tij, bajshin që të mendonte se ishte andërr.

Në tunelin e parë, bashkë me terrin, nëpër dritaren e harrueme çelë, u rras një tym i dehun. Një mendje ja solli edhe frikën, meqë tymi njiherë e xigloi e pastaj gati ja zuni frymën.

«Qe, de, për së gjalli në dhe!» tha e shtoi:

«Po! Veç kjo nuk a kurrëgjja. Jam në rrotë. E rrotët po sillen. Shpejt dalim në tjetrin skaj. Eee, me e ditë këta ngat meje qysh a kanë atëhere, cok... Jo, por ata nuk e dinë. As nuk besojnë se çka domethanë me e shpue tokën, edhe këtë alamet bjeshke». Tha kështu, e pastaj ju kujtuen edhe pak fjalë nga dita e parë, kur erdhi të punonte aty:

«Qe, djalë i mirë, këtu do të punojsh, duhet ta shpojme tej për tej», i patën thanë punëdhanësit.

Deri atëhere besonte se s'kishte forcë ma të madhe se ajo e muskujve të tij njizetvjeçarë. E, kur kazma shkaktoi xixa në shkamb, e kuptoi me kë kishte punë. Tanë ditën me shokë shpoi në gurë derisa shumë të tjerë punonin me shpojëse, dhe mezi ja banë një shenjë. Tregoi atë natë Lata edhe në shtëpi për punën, që kishte ba. Dëshironte t'u tregonte edhe bashkudhëtarëve për këtë. Por, kujt, kur ata sigurisht mendojnë për tjetër, e nuk besojnë se ka qenë vështirë...

«Por, çfarë të shpuemi, ej? A shpohet kodra», i patën thanë do pleq, kur u tregoi. Madje me habi e pyetën: «Mos jeni çue peshë para taksiratis? Po a shpohet bjeshka!» Megjithkëtë, Lata vazhdoi punën tanë verën, dimnin

dhe verën tjetër, deri atëhere kur drita e njenës dhe e anës tjetër të bjeshkës u bashkuen.

«E çfarë gëzimi a kenë?! Rribshin kazmat, ndiheshin krismat e shokëve, e na merrte mendja se janë të noj tjetër dynjaje. Sill ata, sill na kënej dhe — tuneli u shpue! Dhe, qe...» tha kështu e në fytyrë i shkëlqeu një rreze gëzimi, njisoj si dikur kur me këmishë të bame qull nga djersa, u takue me shokët e anës tjetër të tunelit, që në atë terr të përshkuem me një dritë sa xixëlloja, i dukeshin se ishin të botës tjetër.

Tani drita, që mbas tunelit depërtoi në kupe të tij, ja ktheu mendjen kah e tanishmja dhe sytë i drejtoi sipër vetes, ku e kishte vjerrë strajcën. E afroi e pastaj përsëri nisi të mendonte:

«A do të bahet farë pazari?»

Mendja i besonte se njimbëdhjetë fyej, sa kishte në strajcë, do të mund t'i shitte herët bile. Dhe, pse të mos i shette?

«Qe çfarë fyejsh janë! Veç pak me i fry e gishtat me ua ndërrue, këndojnë si bylbylat».

Sa zbriti në tokë, pa se vapa e kishte kaplue qytetin. Me strajcë në shpinë u zhyt në atë tollovi njerëzish, që ja kishin mësy pazarit, e mbas pak zuni vend në një skaj. I nxori fyejt dhe i vuni para.

«Një bankë ma! A ka ku shko ma lirë? Për marakli — badihava», thoshte me vete, por nuk bëzante, edhe pse të tjerët i dëgjonte kah e lavdërojshin mallin e tyne.

«Çka me piskatë? Edhe me u çkye, kur nuk donë me i marrë, nuk i blejnë», i thoshte një mendje.

E kur një bozaxhi i kaloi pranë, ja ngjalli zilinë, lakminë, por edhe e shtyni të mendonte:

«Çka po pisket për bozë — «e mirë dhe e lirë», qe edhe fyejt e mij janë edhe të mirë, edhe të lirë».

Në atë çast, njani, tue kalue e pyeti:

«Sa fyejt, axhë?»

«O, burrë, n'e paç me ble, i lirë, edhe i mirë, ni bankë ma!»

Blesi e shikoi fyellin. Edhe Latën, në sy. Pastaj, fyellin e çoi kah goja, nisi t'i fryente dhe tja luente gishtat.

Melodia e kandshme theu monotoninë e asaj dite të nxehtë në tregun e mbushun dhe detyroi shumë shtunakë, të ktheheshin aty. Zaten, reklamë ma të mirë as që mund t'u bante kush fyjeve të tij. Në saje të kësaj, gjashtë sish i shiti shpejt. Me pesë të tjerë, e me strajcë, në të cilën i kishte mbetë edhe buka «moravçe», u nis kah dyqanet. Ishte mbasdite dhe duhej ble ajo që kishte ndër mend...

Treni e ktheu aty nga e kishte marrë atij mëngjezi të kthjellët e shpresa plot për ditë të mbarë.

Kur erdhi në shtëpi, grueja me fëmijët e pritën te dera. I lodhun, pa dëshirë e hapi strajcën.

«Qe për atë hajlazin» — tha tue u mahitë.

U gëzue e shoqja për kërpesh të kishkut e sytë i mbante në strajcë, ku shihej edhe kënata.

«Baba edhe juve ju ka ble diçka» — u tha fëmijëve dhe u dha dy sheqerka.

«E, opingat?»

«Nuk kish, djali em. I gjeta do të këqija...» — nisi të arsyetohej, e shtoi: — U blen baba tjetër herë.

— Edhe mos me u ble, verë a. Shumë ma mirë dathun! A nuk a ma mirë, a? Kallxoni babës?

«Ma mirë, ma...» — thanë horas djalë e çikë dhe turras duelën në livadh.

Latës i rrodhën dy kokrra lot, së pari, pse i erdhi keq që nuk i gëzoi, dhe, pse u gëzue, kur i diktoi tue vrapue si zogj.